



BASHKIA VAU-DEJËS

Plani i Përgjithshëm Vendor

**ANALIZA E THELLUAR DHE
VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE TË TERRITORIT
(Draft)**

Vau-Dejës 2017

**ANALIZA E THELLUAR DHE
VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE TË TERRITORIT**

- BASHKIA VAU-DEJËS -



Parathënie

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të bashkisë Vau-Dejës mbështetet nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (dldp) në Shqipëri, përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC). Në tetor të vitit 2016, në takimin e Komitetit Koordinues të dldp, ambasadori zviceran Z. Kristof Garf, zyrtarizoi nismën për mbështetjen financiare dhe teknike që do i jepej bashkisë Vau-Dejës për hartimin e PPV. Në atë takim gjithashtu u firmos edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit mes MZHU, AKPT, DLDP dhe Bashkisë Vau-Dejës, si një hap i parë i që përshkruante kornizën e angazhimeve dhe bashkërendimit të aktorëve kryesorë në këtë proces.

Gjatë vitit 2016, Ministria e Zhvillimit Urban, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, ka mbështetur dhe bashkërenduar procesin e hartimit 26 PPV për bashkitë kryesore të vendit. Pavarësisht specifikave dhe kontekstit zhvillimor të secilës bashki të dalë pas Reformës Territoriale Administrative, këto dokumente, shumica prej të cilave të miratuara tashmë, kanë krijuar një bazë solide, orientuese dhe referuese, për të gjithë autoritetet vendore që përfshihen në procesin e planifikimit.

Paralelisht me këtë proces të rëndësishëm për zhvillimin dhe kontrollin e territorit Ministria e Zhvillimit Urban dhe AKPT kanë udhëhequr dhe procesin e hartimit të tre instrumenteve themelore të planifikimit në nivel kombëtar: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin dhe Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës, që përbëjnë shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë të vendit. Mbas një procesi shumë të gjerë konsultues, me kontribute teknike si në nivel qendror ashtu dhe lokal, tashmë këto dokumente kanë marrë miratimin final në KKT.

Kuadri ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, përmes direktivave dhe orientimeve që jep, për hartimin e Planeve të Përgjithshëm Vendor (PPV) siguron që produkti final i këtij procesi të jetë një dokument orientues strategjik për zhvillimin e bashkisë në tërësi. Synimet dhe objektivat e PPV sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë në aspektin urban, infrastrukturor, bujqësor, mjedisor dhe çdo element tjetër të rëndësishëm për 15-20 vitet e ardhshëm. Gjithashtu ndër objektivat kryesorë të këtij dokumenti është edhe siguri i një kohezioni social dhe ekonomik mes Njësisë Administrative, pjese përbërëse e bashkive pas Reformës Territoriale Administrative.

Pjesë e këtij projekti, është “Analiza e thelluar e gjendjes ekzistuese të territorit” bashkë me materialin grafik përkatës ku hartëzohet situata aktuale. Në këtë fazë të parë të projektit jepen të dhënat bazë teknike dhe ligjore, të dhënat statistikore dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm që lidhet me territorin e Bashkisë Vau-Dejës, në nivel qendror dhe lokal, si dhe referenca nga dokumente të ndryshme strategjike të hartuara në vite për bashkinë ose rajonin përreth.

Duke e konsideruar këtë dokument si shumë të rëndësishëm, që do shënojë fillimin e procesit të punës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe do të hedhë bazat për kuptimin dhe adoptimin e tij, vlerësojmë maksimalisht përkushtimin dhe seriozitetin e shprehur nga ekspertet e Bashkisë Vau-Dejës, Qarkut Shkodër dhe AKPT-së, të cilët vazhdimisht kanë mirëpritur diskutimet dhe kanë dhënë udhëzime shumë të vlefshme për hartimin e këtij Dokumenti.

TABELA E SHKURTIMEVE

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BE	Bashkimi European
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjië, Ujit dhe Mjedisit
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
MEI	Ministria e Energjië dhe Industrisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Minsitria e Mjedisit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU	Minsitria e Zhvillimit Urban
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
PDV	Plan i Detajuar Vendor
PKS	Plan Kombëtar Sektorial
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë 2015-2030)
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ToR	Terma Reference
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMMTB	Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes të Tokës Bujqësore
ZRPP	Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

LISTA E FIGURAVE

Fig. 1: Gjetje arkeologjike në Koman.....	16
Fig. 2: Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë	26
Fig. 3: Plani Rajonal Shkodër – Lezhë	28
Fig. 4: Kufiri i Planit Kombëtar Sektorial	31
Fig. 5: Kufiri i studimit.....	33
Fig. 6: Kufiri i planit të bashkisë Vau-Dejës	34
Fig. 7: Nënrajonet me potencialet bujqësore	36
Fig. 8: Qendrat e banuara (qytete/fshatra) të Bashkisë Vau-Dejës	43
Fig. 9: Njësitë administrative të Bashkisë Vau-Dejës	44
Fig. 10: Pozicioni rajonal dhe strategjik i Bashkisë Vau-Dejës	46
Fig. 11: Pozita gjeografike e Vau-Dejës	51
Fig. 12: Mali i Cukalit 1722 m (Burimi: httpwww.panoramio.com)	52
Fig. 13: Harta topografike e Vau-Dejës	52
Fig. 14: Ultësira e Zadrimës	53
Fig. 15: Harta e zonave klimatike	54
Fig. 16: Shpërndarja brendavjetore e rrezatimit të përgjithshëm diellor dhe rrezatimit UV	55
Fig. 17: Ecuria brendavjetore e diellzimit.....	55
Fig. 18: Ecuria brendavjetore e temperaturës së ajrit.....	56
Fig. 19: Shpërndarja brendavjetore e reshjeve atmosferike	57
Fig. 20: Trëndafili i erës për dy muajt karakteristike të vitit.....	59
Fig. 21: Harta hidrogeologjike e qarkut Shkodër - Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	71
Fig. 22: Baseni ujëmbledhës i lumit Drin	77
Fig. 23: Harta e epiqëndrave të tërmeteve karakteristike	82
Fig. 24: Harta e izoseisteve të tërmetit të 1 Qershorit 1905	83
Fig. 25: Harta e izosejsteve të tërmetit të 17 dhjetorit 1926	84
Fig. 26: Harta e izoseisteve të tërmetit të 30 Nëntorit 1967.....	85
Fig. 27: Harta e izoseisteve të tërmetit të 15 Prillit 1979	85
Fig. 28: Harta e zonimit neotektonik (Pliocen-Kuaternar) të Shqipërisë	86
Fig. 29: Harta sizmotektonike e Shqipërisë	88
Fig. 30: Harta e PGA për Vau Dejës në truall shkëmbor, me RP 475 vjet.....	89

Fig. 31: Paraqitje grafike e rrezikut sizmik për njësitë administrative	90
Fig. 32: Pamje nga Kalaja e Sapës	92
Fig. 33: Pamje nga Kalaja e Vigut	94
Fig. 34: Zona arkeologjike A dhe B	97
Fig. 35: Pamje nga Varrezat e Komanit.....	98
Fig. 36: Pamje nga Kalaja e Dalmacës	100
Fig. 37: Pamje nga Kalaja e Vaut të Dejës.....	102
Fig. 38: Pamje nga Kisha e Shën Mërisë (përpara shembjes)	104
Fig. 39: Pamje nga Kisha e Shën Markut.....	106
Fig. 40: Pamje nga Kalaja e Shurdhahut.....	108
Fig. 41: Pamje nga Kompleksi Ndre Mjeda	110
Fig. 42: Rezervat peshku, liqeni i Vau-Dejës.....	120
Fig. 43: Liqeni i Vau-Dejës	121
Fig. 44: HEC i Vau-Dejës	121
Fig. 45: Diga e Komanit.....	123
Fig. 46: Liqeni i Komanit.....	124
Fig. 47: Harta e pasurive minerale, qarku Shkodër, viti 2014 (Burimi: Shërbim gjeologjik Shqiptar).....	125
Fig. 48: Harta gjeomjedisore, qarku Shkodër, viti 2014 (Burimi: Shërbim gjeologjik Shqiptar).....	126
Fig. 49: Pamje ajrore e peizazhit të mbrojtur	127
Fig. 50: Harta e PUTM në bashkinë Vau-Dejës	128
Fig. 51: Shpella e Malagjisë	129
Fig. 52: Pamje nga landfill-i i Bushatit	130
Fig. 53: Harta e zonave të urbanizuara të miratuara sipas VKM Nr. 5, Dt. 29.12.2014 për Bashkinë Vau-Dejës.....	138
Fig. 54: Tipologjitë hapsinore	141
Fig. 55: Sistemi bujqësor, bashkia Vau Dejës	150
Fig. 56: Aksi Tiranë – Hani i Hotit (Aksi i ri)	165
Fig. 57: Aksi Tiranë – Hani i Hotit (Aksi i vjetër)	165
Fig. 58: Aksi Shkodër-Kukës	166
Fig. 59: Aksi Balldre-Bushat	166
Fig. 60: Aksi Mjedë-Melgush	167

Fig. 61: Aksi Qafë-Laç – Koman	167
Fig. 62: Harta e rrugëve, Bashkia Vau-Dejës	168
Fig. 63: Transporti ujor në linjën Koman - Fierzë	170
Fig. 64: Foto historike e stacionit hekurudhor Mjedë (Burimi: AQTN)	171
Fig. 65: Vendndodhja e stacioneve të pompimit (majtas: jashtë funksionit; djathtas: në funksionim).....	172
Fig. 66: Harta energjetike e rajonit	175
Fig. 67: Pasqyre permbledhese e HEC V.Dejes	176
Fig. 68: Rrjeti energjetik rajonal.....	177
Fig. 69: Skema e rrjetit prodhues te energjise elektrike, rajoni V. Dejes	177
Fig. 70: Koeficienti bruto i lindjeve (INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2016)	184
Fig. 71: Struktura e bizneseve (sipas numrit)	197
Fig. 72: Peshë specifike e të ardhurave në buxhet (%)	198
Fig. 73: Struktura e shpenzimeve në vite sipas klasifikimit ekonomik (%-je).....	200
Fig. 74: Pamje e Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”	205
Fig. 75: Shkollëa e Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”	206
Fig. 76: Pamje nga Qendra sëhndetsore Vau Dejës	207
Fig. 77: Paraqitje skematike e përpunimit të informacionit	226
Fig. 78: Paraqitje skematike e tipeve të topologjisë	227
Fig. 79: Paraqitje skematike e modeleve.....	231
Fig. 80: Informacioni për çdo shtresë	234
Fig. 81: Paraqitja e ciklit të Procesit të Komunikimit.....	237
Fig. 82: Faqja zyrtare në web e bashkisë.....	238
Fig. 83: Regjistri i integruar i territorit.....	239
Fig. 84: Faqja në facebook e PPV.....	239

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Kuadri ligjor	21
Tabela 2: Vendimet e KRRTRSH dhe KKT për Bashkinë Vau-Dejës	23
Tabela 3: Qendrat urbane të prekura nga Masterplani i Alpeve	31
Tabela 4: Njësitë administrative, zonat urbane dhe qendrat e banuara	42
Tabela 5: Sipërfaqet e njësive administrative	44

Tabela 6: Intensiteti i reshjeve (mm) për disa intervale orare	58
Tabela 7: Rastisja e erës sipas intervaleve	59
Tabela 8: Klasifikimi gjeologo-litologo-inxhinierike i shkëmbinjëve dhe dherave	62
Tabela 9: Vlerat e rrezikut sizmik: PGA e SA (g) për Bashkinë Vau Dejës	90
Tabela 10: Shpërndarja e sipërfaqes për llojet kryesore pyjore. Burimi: (Drejtoria e Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Bujqësisë, Bashkia Vau-Dejës)	117
Tabela 11: Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau-Dejës	118
Tabela 12: Sipërfaqet e sistemeve	134
Tabela 13: Inventar i ndërtesave publike (Bashkia Vau-Dejës)	140
Tabela 14: Toka bujqësore në Bashkinë Vau-Dejës	149
Tabela 15: Prodhime bujqësore (në ton) për vitin 2016	151
Tabela 16: Prodhime bujqësore (në ton) për vitin 2016	152
Tabela 17: Kanalet e I-rë kullues në pronësi të Bordit Rajonal të Kullimit	153
Tabela 18: Kanalet e II-të kullues në pronësi të bashkisë Vau Dejës	153
Tabela 19: Përmbledhëse e kanaleve kullues të bashkisë Vau Dejës (në km)	155
Tabela 20: Kanalet parësor të ujitjes në pronësi të Bordit Rajonal të Kullimit	156
Tabela 21: Kanalet parësor të ujitjes në pronësi të Bashkisë	156
Tabela 22: Përmbledhëse e kanaleve vaditës të bashkisë Vau Dejës (në km)	158
Tabela 23: Përmbledhëse e kanaleve ujitës dhe kullues (në km)	158
Tabela 24: Të dhëna për sipërfaqet bujqësore	159
Tabela 25: Inventari ARRSH (Bashkia Vau-Dejës)	164
Tabela 26: Inventari rrugëve rurale (Bashkia Vau-Dejës)	169
Tabela 27: Inventari rrugëve rurale sipas njësive administrative	169
Tabela 28: Të dhënat e popullsisë	181
Tabela 29: Ndryshimi i popullsisë (INSTAT)	181
Tabela 30: Popullsia 2000-2015 (Bashkia Vau-Dejës)	182
Tabela 31: Përbërja e popullsisë 2011 (INSTAT)	183
Tabela 32: Profili ekonomik i njësive administrative	186
Tabela 33: Terreni dhe topografia	187
Tabela 34: Fermat në Bashkinë Vau Dejës	188
Tabela 35: Të dhëna për fermat bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Vau Dejës	189
Tabela 36: Numri i krerëve në blegtori	192

Tabela 37: Përmbledhëse e të ardhurave në buxhet sipas burimit (%)	197
Tabela 38: Raporti tarifave/strukturës së të ardhurave të veta (000/lek)	199
Tabela 39: Struktura e të ardhurave kryesore për tarifat vendore (000/lek)	199
Tabela 40: Numri i familjeve me asistencë sociale.....	204
Tabela 41: Numri i infrastrukturave arsimore dhe shëndetsore në bashki.....	206
Tabela 42: Statusi i përdorimit të banesave (%).....	211
Tabela 43: Tabela e stokut të banesave	212
Tabela 44: Legjislacioni për pronat pas viteve '90.....	215
Tabela 45: Struktura e të dhënave nga AKPT	222
Tabela 46: Struktura e të dhënave Gjeoportali Kombëtar	223
Tabela 47: Projektioni i të dhënave	226
Tabela 48: Inventari i kapaciteteve.....	228
Tabela 49: Kategoritë e të dhënave dhe shtresat e informacionit.....	231

Përmbajtja

Hyrje.....	12
1 Të përgjithshme	14
1.1 Bashkia Vau-Dejës: historik i shkurtër.....	14
1.2 Konteksti aktual dhe sfidat kryesore.....	16
1.3 Qëllimi dhe objektivat	18
2 Analiza e planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve 21	
2.1 Kuadri ligjor, standardet dhe normat	21
2.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit dhe PPV-ve të mëparshme	23
2.3 Analiza e planeve, strategjive, politikave, dokumenteve dhe proceseve ekzistuese.....	24
2.4 Planet ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale	25
2.4.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar	25
2.4.2 Plani rajonal Shkodër-Lezhë (2005-2020)	27
2.4.3 Plani Operacional i Zhvillimit Lokal për bashkinë Vau-Dejës	29
2.4.4 Projekti STAR (Support of Territorial and Administrative Reform)	30
2.4.5 Planet e Përgjithshme Vendore të bashkive Lezhë dhe Shkodër	30
2.4.6 Master Plani i Alpeve të Shqipërisë	30
2.4.7 Plani Strategjik i Zhvillimit Ndërkomunal i Zadrimës	32
2.4.8 Dokumente të tjerë	32
2.5 Zbatueshmëria e dokumenteve strategjik dhe planifikues.....	36
2.6 Çështje dhe zonat e rëndësisë kombëtare	37
2.6.1 Të përgjithshme	37
2.6.2 Analiza e elementeve përjashtuese	38
3 Skanimi i territorit dhe vlerësimi	42
3.1 Vështrim i përgjithshëm.....	42
3.1.1 Metabolizmi urban	50
3.1.2 Topografia dhe klima;	51
3.1.3 Gjeologjia inxhinierike;.....	60
3.1.4 Hidrogjeologjia dhe hidrologjia;.....	69
3.1.5 Zonimi makrosizmik dhe në varësi të rëndësisë, zonimi mikrosizmik; ..	79
3.1.6 Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike	91

3.2	Analiza mjedisore	114
3.2.1	Burimet natyrore	114
3.2.2	Sipërfaqet ujore	120
3.2.3	Pasuritë minerare	124
3.2.4	Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.....	126
3.2.5	Landfill-i i Bushatit	129
3.2.6	Rreziket mjedisore si pasojë e pranisë së landfill-it	131
3.3	Përdorimi ekzistues i tokës; Aktivitetet dhe ndikimet e tyre	133
3.3.1	Ndarja në 5 sisteme bazë	133
3.3.2	Kategoritë e përdorimit të tokës.....	134
3.3.3	Sistemi urban.....	136
3.3.4	Analiza e zhvillimit hapësinor dhe tipologjik.....	140
3.3.5	Lidhja me infrastrukturën kombëtare	142
3.3.6	Sistemi natyror.....	143
3.3.7	Sistemi Bujqësor.....	147
3.3.8	Sistemi Ujor	161
3.3.9	Sistemi Infrastrukturor.....	163
3.4	Analiza e vlerësimeve demografike.....	180
3.4.1	Lëvizjet natyrore dhe hapsinore.....	184
3.4.2	Projeksionet.....	185
3.5	Aspektet sociale dhe ekonomike.....	186
3.5.1	Profilet ekonomike	186
3.5.2	Sektori i Bujqësisë	188
3.5.3	Zhvillimi i Blegtorisë	191
3.5.4	Bletaria	192
3.5.5	Bimët mjeksore dhe aromatike	193
3.5.6	Sektori i Turizmit.....	193
3.5.7	Artizanati.....	196
3.5.8	Të ardhurat e Bashkisë.....	196
3.5.9	Problemet sociale, kriminaliteti dhe marginalizimi.....	201
3.5.10	Papunësia dhe përkrahja sociale	203
3.5.11	Edukimi dhe aktivitetet social - kulturore e sportive	204

3.5.12	Shërbimi shëndetsor	207
3.5.13	Zhvillimi dhe Integrimi Gjinator	210
3.5.14	Stoku i banesave.....	210
3.5.15	Toka dhe çështjet e pronës	213
3.5.16	Pronat publike	219
4	Përgatitja e bazës të dhënave territoriale në platformën GIS.....	221
4.1	Përditësimi i të dhënave ekzistuese	221
4.1.1	Harta bazë dhe GIS.....	221
4.1.2	Legjislacioni	221
4.1.3	Identifikimi dhe Mbledhja e të dhënave	222
4.1.4	Analiza e informacionit.....	225
4.1.5	Përpunimi i Informacionit	225
4.1.6	Analiza e situatës ekzistuese.....	228
4.1.7	Krijimi i Strukturës së Bazës së të Dhënave	229
5	Plani i komunikimit	236
5.1	Strategjia e komunikimit është proces.....	236
5.2	Mekanizmat e komunikimit.....	238
5.2.1	Interneti si mjet informimi dhe komunikimi	238
5.2.2	Takimet si mjet komunimi dhe ndërveprimi.....	240
5.2.3	Anketime/Pyetësorë/Skeda informative	240
5.2.4	Mediat tradicionale (TV, radio, shtypi)	241
6	Aneks	244
6.1	Aneksi 1: Mbledhje dhe takime për hartimin e PPV	244
6.2	Aneksi 2: Aneksi i hartave	244

Hyrje

Në këtë dokument është paraqitur një skanim i detajuar i territorit të Bashkisë Vau-Dejës, bazuar në gjithë informacionet teknike të vëna në dispozicion nga institucionet qendrore dhe lokale. Përveç informacionit të dhënë nga AKPT, konsulenti në zbatim të Termave të Referencës është angazhuar në grumbullimin e informacioneve të ndryshme edhe në institucionet lokale në varësi të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau-Dejës. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e analizës së thelluar të territorit, në lidhje me dokumentin e Strategjisë Territoriale dhe produktin final (PPV) konsulenti është angazhuar maksimalisht në përditësimin dhe saktësimin e të dhënave (statistikore dhe hartografike). Ky dokument është i ndarë në 2 kapituj kryesor dhe në fund është dhënë dhe aneksi i hartave. Në vijim është paraqitur një përshkrim në terma të përgjithshëm i këtij dokumenti.

Kapitulli 1 – Informacion i përgjithshëm mbi historikun dhe kontekstin e zhvillimit të territorit të Bashkisë. Në këtë kapitull përshkruhen shkurtimisht sfidat kryesore të zhvillimit si dhe qëllimi dhe objektivat e PPV bazuar mbi nismën e hartuar nga bashkia, legjisllacionin në fuqi si dhe termat e referencës për hartimin e planit.

Kapitulli 2 - Analiza e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve nënkupton rishikimin e gjithë raporteve dhe dokumenteve teknik të ofruar nga Bashkia, AKPT dhe MZHU. Për territorin e bashkisë janë hartuar disa studime me karakter zhvillimi strategjik dhe urban, në shkallë të ndryshme, nga të cilat disa edhe të aprovuar në nivelet lokale. Analiza e këtyre dokumente, të hartuar në vite, është me rëndësi për të kuptuar evolucionin e prioriteteve dhe vizionin për territorin. Një vëmendje e veçantë në këtë kapitull i është dhënë parashikimeve të instrumenteve kombëtar të planifikimit që janë tashmë të miratuara. Direktivat e zhvillimit të dhëna në PPK janë detajuar në kontekstin territorial të bashkisë Vau-Dejës. Duke marrë në konsideratë hierarkinë e instrumenteve të planifikimit të vendosur nga kuadri ligjor këto parashikime të përcaktuar në këto dokumente të nivelit kombëtar do përbëjnë referencat bazë në gjithë procesin e hartimit të PPV-së.

Kapitulli 3 - Skanimi i territorit ka për qëllim të japë një pasqyrë të qartë të të dhënave të ndryshme, në të gjithë shtrirjen territoriale të Bashkisë Vau-Dejës, në përshtatje me kërkesat e planifikimit vendor. Tipi i të dhënave në këtë kapitull mund të ndahet në dy grupe kryesore:

- mjedisi fizik (topografia, gjeologjia, hidro-gjeologjia, etj. dhe duke mbaruar përshkrimin e pesë sistemeve bazë territoriale);
- mjedisi social dhe ekonomik (strukturat institucionale administrative, demografia, klima e biznesit, veprimtaria prodhuese që ndodh në këtë zonë dhe shërbimet që ofrohen).

Gjithashtu në këtë kapitull janë trajtuar edhe disa tematika në lidhje me kërkesat shtesë, krahasuar me kërkesat e kuadrit ligjor për planifikimin e territorit, të parashikuara që në Termat e Referencës përta i përket:

- Lidhjes së PPV me PBA (kryesisht grumbullim informacioni, studimi i PBA 2016-2019 të miratuar nga bashkia Vau-Dejës, etj.)

- Përfshirjen e diasporës si një grup interesi që mund të sjellë impakt pozitiv në zhvillimin e bashkisë dhe planin e komunikimit (pyetësorët, faqet online, etj.)
- Komponentin e trajnimeve të stafit të bashkisë duke evidentuar edhe nevojat kryesore përsa i përket rritjes së kapaciteteve dhe nevojave infrastrukturore (staf, zyra, pajisje teknike, etj.)

Kapitulli 4 - Përgatitja e bazës së të dhënave territoriale e integruar në platformën GIS, një sistem i përbashkët gjeoreference, që do shërbejë si bazë për gjithë procesin e hartimit të PPV-së. Duke pasur si qëllim final përgatitjen e një dokumenti që paraqet zhvillimin e bashkisë në 15-20 vitet e ardhshme, një kujdes i veçantë i është kushtuar përgatitjes dhe përpunimit të saktë të të gjithë bazës së dhënave që përshkruajnë gjendjen ekzistuese të territorit, proces ky që do ndikojë drejt për drejtë dhe në saktësinë dhe qëndrueshmërinë e parashikimeve që do propozojë PPV për të ardhmen.

Në fund të Raportit gjendet edhe një evidentim i gjithë takimeve të organizuara në Njësitë Administrative dhe me fokus grupe të ndryshme gjatë këtij procesi. Këto evidenca të përmbledhura përmbajnë kryesisht foto dhe listë-prezenca të pjesëmarrëseve/ekspertëve në takime. Nga kompania, gjithashtu po arshivohen të gjithë proces-verbalet e takimeve që do i dorëzohen bashkisë në përfundim të çdo faze të hartimit të PPV .

1 Të përgjithshme

1.1 Bashkia Vau-Dejës: historik i shkurtër

Historiku i qytetit me emrin sot Vau-Dejës nis me vendbanimin e vjetër të Danjës, i themeluar rreth vitit 1127. Ekzistenca e trojeve të vjetra të kështjellës dhe kishës së Shën Markut, e cila është ndër më të vjetrat në Ballkan, ende sot mbartin vlera arkeologjike për studime historike. Sipas historianëve në këtë zonë organizohet çdo vit një panair i madh në të cilën merrnin pjesë banorë nga krahina e Zadrimës.

Në majën që ndodhet në kodrën e Danjës, i mbiquajtur Mali i Shën Markut, ndodhen edhe rrenojat e një kishë që mban të njëjtin emër. Nga emri i kësaj kalaje mori emrin e gjithë zona. Të dhënat arkeologjike flasin për një vendbanim të zhvilluar mesjetar.

Kalaja e Danjës sot Deja ka qenë një qendër e zhvilluar dhe me ndikim të madh në të gjithë zonën e Zadrimës. Në këtë kala është bërë lufta me e madhe me Venedikasit ku është vrarë Lekë Zaharia. Ai është varrosur në kishën e Shën Mrisë në Vaun e Dejës e cila është tashmë e rindërtuar. Me vdekjen e Lekë Zaharisë kalaja u pushtua nga Venecianët, të cilët më pas u larguan nën presionin ushtarak të Gjergj Kastriot Skënderbeut. Mbas rënies së kalasë së Dejës një pjesë e mirë e popullsisë emigroi drejt Italisë.

Deja (ose Danja) ka qenë qytet mesjetar shqiptar shumë i rëndësishëm me një histori vërtet interesante. Qyteti u ndërtua në shek.XI-XII në pikën ku del Drini nga malësitë. Zotëronte rrugën e karvanëve dhe vilte të ardhura të shumta nga doganat që paguheshin për kalimin e Vaut të Dejës. Nga fillimi i shekullit XIII qëndroi nën sundimin e feudalëve serbë. Këtu u fuqizua familja feudale e Zahariajve. Me formimin e principatës së Balshajve, Deja u bë pjesë e saj. Më 1396, Gjergji II Balsha ia kaloi qytetin Venedikut. Në vitet 1423-1443, Deja kaloi dy herë në dorë të osmanëve për tu çliruar në 1443 pas kryengritjes së përgjithshme antiosmane. Zotërimi i Dejës u bë shkak konflikti midis feudalëve N.Dukagjini dhe L.Zaharia në 1445. Pas vrasjes së këtij të fundit, qyteti iu ridorëzua nga e ëma e tij, Venedikut. Ishte pikërisht kërkesa e Skënderbeut që Venediku t'i dorëzonte Dejën që shkaktoi luftën mes tij dhe Venedikut. Skënderbeu e rrethoi në 1447-1448, por nuk e mori dot. Qyteti qëndroi nën Venedikun deri në 1479, kur e ripushtuan osmanët. Pas kësaj, ai nuk u rimëkëmb më. Sot mund të shihet ende Kalaja e Dejës, brenda së cilës janë gërmadhat e një kishë.

Qyteti mesjetar **Sarda**, sot kalaja e Shurdhahut ndodhet një ishull të liqenit Vau-Dejës. Zona përreth kësaj qendre kulturore është një nga vendet më të rëndësishme arkeologjike dhe historike. Këtu ndodhet vendbanimi i hershëm i Gajtanit (Shpella e Gajtanit), vendbanimi i Jubanit (Shpella e Jubanit), Qyteza e Gajtanit, kalaja e Danjës, kalaja e Dalmacës.

Qyteza e Sardës deri në fund të shek. XV ka qenë një qendër e rëndësishme kulturore dhe pikë takimi i tre kulturave kryesore të gjithë trevës së veriut, kulturës së Malësisë, të kulturës së Mirditës dhe të Zadrimës të cilat me karakteristikat e veçanta që i dallojnë nga njëra tjetra u kanë rezistuar kohës dhe rrymave kulturore të huazuara nga pushtues të ndryshëm.

Për këtë qytezë kanë shkruar shumë studiues të huaj dhe studiues arkeologë shqiptarë, të cilët e kanë vlerësuar si një mbartës të kulturës Ilire. Vetë emri i saj i transformuar në Shurdhah ka origjinë Ilire nga qyteti i Sardis, këtu janë gjetur rrënojat e një kalaje romake të shek 6 - 8 p.e.s. Sarda ka qenë një stacion pushimi në rrugën e vjetër të Dardanisë. Në vitin 877 ka qenë qendër e krahinës së Polatit që përfshinte malësitë në të anët e Drinit nga Liqeni i Shkodrës deri në Kukës. Sarda dikur një qytezë përbri Drinit, si një gadishull strategjik dhe si një pikë ndërlidhëse me rrugën e vjetër Gjakovë-Shkodër-Ulqin, ishte vendbanim i familjes të madhe feudale të Dukagjinëve ku ata ndërtuan pallatin mbretëror; sot një qytezë e pabanuar e rrethuar me kurorën e bukur të ujit të kristaltë të Drinit, është kthyer në një ishull interesant dhe në një pikë të rëndësishme turistike; çfarë ka mbetur sot: përbëhet nga hyrja kryesore e pallatit dhe një kishë e arkitekturës Romake. Uji i liqenit, malet dhe kodrat përreth me gjelbërimin e tyre, krijojnë një Peizazh me bukuri të rrallë, duke i dhënë këtij ishulli vlera të mëdha ekoturistike.

Kur flitet për Shurdhahun si një pikëmbërritje turistike është e pamundur që ta ndash nga liqeni artificial i Vaut të Dejës dhe brigjet e tij piktoreske. Ndërtimi i Liqenit të Vaut të Dejës (sip. 24,7 km²) më 1971, e ka kthyer ishullin e Shurdhahut në një destinacion unik. Liqeni me ujin e tij të pastër krijon mundësi për një udhëtim të veçantë dhe mjaft të këndshëm. Ai ka mbuluar murin rrethues të kalasë së Shurdhahut. Megjithatë, përsëri muret e mbetura të kishave dhe të kalasë janë mjaft domethënës dhe që bien lehtë në syrin e vizitorit.

Liqeni i Vaut të Dejës që rrethon Shurdhahun me ujërat e tij, shtrihet thellë nëpër lugina dhe udhëtimi gjatë brigjeve të tij të ofron pamje piktoreske dhe të veçanta ku ndërthuren uji i liqenit, bimësia përreth dhe kafshë të egra që rriten aty dhe shkëmbinjtë gëlqeror që janë herë të thepisur herë jo. Udhëtimi në liqen mund të fillohet nga diga e H/C të Vaut të Dejës ose nga diga e Rragamit. Gjatë rrugës mund të shihet dhe mësohet për Kalanë e Danjës në të cilën gjendet Kapela e Zonjës së Dejës e ndërtuar nga Gjergj Kastrioti pas një fitoreje mbi ushtrinë venedikase në malin e Shën Markut, në majë të të cilit është kjo kala.

Gjithashtu në afërsi të dy qendrave mesjetare shtrihen dhe gjetjet arkeologjike në Koman, të cilat dëshmojnë një zhvillim edhe më të hershëm të territorit.

Kultura e Komanit është një kulturë e hershme e Arbërisë, që e vazhdon kulturën ilire, që do të thotë se bartësit e saj, arbit, janë shqiptarë të hershëm, pasardhës të ilirëve. Zbulimet e bëra në Delmace të Komanit i hapën rrugë një rindërtimi arkeologjik dhe historik, duke u bërë një pikë reference për mënyrën e zhvillimit të Ballkanit Perëndimor në shekujt VI-XIII pas Krishtit.

Në vitin 1898 u ra në gjurmë të një varreze të madhe, pranë Kalasë së Dalmaces, në fshatin Koman të Pukës. Në vazhdim u zbulua një numër i madh varrezash të ngjashme, rreth 30, të përhapura kryesisht në Shqipërinë e Veriut e në atë të Mesme. Shpërndarja gjeografike, tipologjia, inventari dhe kronologjia e njëjtë e këtyre varrezave i ka shtyrë studiuesit të identifikojnë në to kulturën e hershme mesjetare shqiptare, të quajtur "Kultura e Komanit" (shek. VI-VIII). Në vitet e fundit zbulime të

"Kulturës së Komanit" janë bërë edhe në Shqipërinë e Jugut si dhe përtej kufijve shtetërorë, në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni e në Greqi.

"Kultura e Komanit", qoftë në trashëgiminë e saj të kulturës së lashtë ilire, qoftë me elementet e reja të periudhës së hershme bizantine e, në fund, me shenjat e qarta të besimit të krishterë, është specifike për hapësirën ku dëshmohen shqiptarët në mesjetë.



Fig. 1: Gjetje arkeologjike në Koman

Vendbanimi i Komanit (Dalmacija e Vjetër), është një vendbanim shumë i rëndësishëm për historinë e antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme në Shqipëri. Komani si vendbanim, i ka dhënë emrin Kulturës së Komanit, përdorur nga historiografia shqiptare dhe arkeologjia, si përkufizues i hipotezës së kalimit nga ilirët tek arbrit. Pothuajse e gjithë shtrirja përkon në territorin shqiptar. Zbulimet tregojnë se bëhet fjalë për një qendër të shtrirë minimumi në 35 ha më një vitalitet ndërtimor dhe dendësi banimi të jashtëzakonshme të paktën përgjatë 1000 vjetëve.

Komani është konsideruar gjithnjë si vendbanimi mitik i shqiptarëve. Në aspektin historik është një aset arkeologjik shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Nga zbulimet e fundit kuptohet se është një qytetërim i tërë, kjo do të thotë që ka qenë një qytet me kisha, shtëpi e punishte.

Duke filluar në **Shek. XX**, vihet re një spostim i qendrave historike drejt zonave bujqësore dhe infrastrukturës së rrugore dhe hekurudhore. Gradualisht qendra historike si Vau-Dejës humbasin rëndësinë dhe qyteza të reja si Bushati do të thithin flukset kryesore të popullsisë.

1.2 Konteksti aktual dhe sfidat kryesore

Arsyet e nevojës së hartimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Vau-Dejës lidhen edhe me sfondin ligjor por edhe me situatën e gjendjes ekzistuese të Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrative - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, kufijtë administrativë të Bashkisë Vau-Dejës ndryshuan dhe për rrjedhojë një Plan i Përgjithshëm Vendor është mjaft i rëndësishëm të kryhet, pasi nevojitet integrohen studimet e mëparshme zonale dhe do trajtohen së bashku të gjitha njësitë administrative brenda territorit të ri.

Nga ana tjetër Ligji për Planifikimin e territorit ka ndryshuar dhe orienton të gjitha njësitë vendore në kryerjen e planit. Në këtë mënyrë, hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor vjen edhe si detyrim ligjor, por edhe si nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të territorit dhe të gjitha sferave të tjera të zhvillimit në Bashkinë e re.

Një ndër sfidat me të cilat do të përballlet bashkia e re është territori dhe zhvillimi i tij i qëndrueshëm. Territori i bashkisë është kompleks, për faktin që në përgjithësi gjatë 25 viteve të fundit territori në Shqipëri është zhvilluar vetvetiu dhe dirigjuar mjaft pak. Si rrjedhojë kjo qasje ka prodhuar sfida të shumëllojshme, por edhe pasi bashkia tashmë është një aglomerat i tokës urbane ku jetohet, punohet e konsumohet, i tokës së kultivuar ku prodhohet dhe i territoreve periferike që ndërmjetësojnë mes të dyjave. Bashkia Vau-Dejës nuk është më një qytet, ku sfida e vetme e zhvillimit është si të ofrosh hapësira të banueshme me standarde të larta, hapësira pune e shplodhje të integruara me njëra-tjetrën, por territor apo organizëm kompleks, ku cikli i jetës ndodh i plotë. Sfida e bashkisë së sotme do të jetë si të përdoren burimet natyrore e sidomos tokën bujqësore; për të arritur vetëmjaftueshmërinë dhe fleksibilitetin e domosdoshëm ekonomik në kushtet e një organizimi të ri dhe të një ekonomie të re, e cila nuk kërkon të varet aq shumë nga zhvillimet urbane/ekspansioni urban, sikurse ka qenë rasti deri pak kohë më parë, sepse ky ekspansion ka ndodhur kryesisht në mënyrë spontane dhe mjaft pak i drejtuar nga ide/dokumente zhvillimi të qëndrueshëm.

Në mënyrë të veçantë kjo fazë e parë e PPV-së, përpiqet të evidentojë të gjithë vlerat që përbëjnë thelbin e ekzistencës së Bashkisë jo vetëm si territor dhe njësi administrative, por edhe si një komunitet me identitetin e tij, si edhe të identifikojë vlera të reja potenciale që do e përforconin këtë identitet. Qëllimi është jo vetëm për ti ruajtur ato por, për më tepër, për ti forcuar dhe promovuar ato vazhdimisht.

Bashkia Vau-Dejës shërben si nyje ndërlidhëse mes dy qendrave të rëndësishme ekonomike dhe urbane të veriut të vendit; Shkodrës dhe Lezhës. Gjithashtu, ky territor përfaqëson edhe një nga portat më interesante për zonën e alpeve, nëpërmjet lundrimit nga Komani në Fierzë. Bashkia Vau-Dejës ka një karakter kompleks që ofron potencialin për zhvillimin e ekonomisë rurale dhe bujqësore, që ka një industri energjetike me rëndësi kombëtare dhe mbart asete turistike e peizazhistike të paeksploruara dhe me potencial të lartë zhvillimi.

Bashkia përbëhet nga 6 njësi administrative dhe 48 qendra urbane, vetëm një prej të cilave qytet. Vau-Dejës dhe Bushati janë dy qendrat urbane me intensitet më të lartë të aktivitetit ekonomik dhe urban.

Aktualisht bashkia Vau-Dejës përbëhet nga zona me tipare të ndryshme të cilat zhvillohen të pavarura dhe të pintepruara në një sistem të harmonizuar. Ndër hapësirat kryesore që përbëjnë karakterin e bashkisë mund të përmendin zonën historike dhe urbane të Vaut të Dejës, qendrën ekonomike dhe bujqësore të Bushatit,

zonën energjetike në Bushat, Vau-Dejës dhe Koman, resurset ujore turistike dhe peizazhistike të liqenit të Vaut të Dejës dhe atij të Komanit, zonat e mbrojtura dhe monumentet e kulturës, zonat e zhvillimit të artizanatit (Zadrima) etj. Zhvillimi strategjik i bashkërenduar i këtyre zonave në një skenar të balancuar, është objektiv primar i PPV dhe një sfidë e rëndësishme për pushtetin vendor. Pa dyshim që në kuadrin e një modeli zhvillimi të qëndrueshëm, duhet të kemi një përputhshmëri në shkallë kombëtare dhe rajonale me strategjitë e politikave zhvillimore si dhe përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe atyre Ndërsektoriale.

Potencialet bujqësore, turistike dhe artizanati janë ndër elementët kryesorë për të promovuar dhe zhvilluar karakterin e territorit të Bashkisë. Gjithsesi, motori ekonomik i mbështetur tek bujqësia dhe energjetika duhet të krijojë një balancë mes punësimit dhe zhvillimit ekonomik me shfrytëzimin e burimeve natyrore duke ofruar një model zhvillimi të qëndrueshëm. Ndërthurja mes turizmit dhe ekonomisë është një element që kërkon një qasje të integruar në kontekstin territorial, social dhe ekonomik të bashkisë Vau-Dejës.

Landfilli i Bushatit është një element i territorit ku kujdesi ndaj impaktit mjedisor duhet të jetë maksimal duke garantuar ruajtjen e aseteve mjedisore të zonës. Gjithashtu, ruajtja dhe zhvillimi i brigjeve ujore të luginës së Drinit dhe Gjadrit, është një prioritet që do të garantojë zhvillimin e një sistemi të integruar mes bujqësisë dhe turizmit duke pasur në vëmendje ruajtjen e mjedisit. Rehabilitimi i potencialeve mjedisore dhe zhvillimi i bujqësisë janë baza e një sistemi të qëndrueshëm ekonomik dhe ambiental për pjesën më të madhe të territorit të bashkisë. Gjithashtu, konservimi i peizazhit është një domosdoshmëri sidomos për zonat me vlera të spikatura natyrore, urbane, dhe historike.

Përmirësimi dhe shtrirja e sistemit të infrastrukturës mbetet një sfidë drejtpërdrejtë e lidhur me zhvillimin ekonomik dhe turizmin sidomos në zonat malore dhe në fshatrat e thellë.

1.3 Qëllimi dhe objektivat

Hartimi i PPV të Bashkisë Vau Dejës vjen si një domosdoshmëri për të krijuar kushte për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit në tërësinë e tij nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore. Në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe duke vlerësuar potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet, PPV synon të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë. Si rezultat PPV është zbatimi i standardeve të unifikuara të planifikimit, të cilat janë nivelet optimale të cilësisë, që përdoren si norma e referenca gjatë procesit të vazhdueshëm të planifikimit dhe të cilat mundësojnë një zhvillim të qëndrueshëm brenda kufijve të territorit.

I parë në këndvështrimin rajonal, zhvillimi i qëndrueshëm i Bashkisë Vau-Dejës, synon të arrijë objektivat ligjorë, respektimin e normave dhe standardeve territoriale dhe mjedisore, si dhe të respektojë zhvillimin demografik duke siguruar mundësitë për ecurinë e aktiviteteve industriale, tregtare, të biznesit, të infrastrukturës; plotësimin e nevojave sociale, të banimit, të pushimit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si mjete të domosdoshme, që garantojnë qëndrueshmërinë dhe integrimin e zhvillimit të Bashkisë.

Kjo fazë është tepër e rëndësishme, për shkak se produkti final do të bazohet pikërisht mbi këto të dhëna. Më konkretisht, për procesin e Analizës objektivat do të ishin:

1. Konceptimi i ecurisë dhe rritjes së qëndrueshme të Bashkisë si pjesë integrale në zhvillimin e rajonit;
2. Kuptimin e synimeve dhe orientimeve, që Bashkia synon të arrijë, të shpërndara sipas zonave;
3. Klasifikimet që ndikojnë pronësinë dhe vlerën e tokës nëpërmjet:
 - Pesë sistemeve territoriale bazë
 - Klasifikimit funksional;
 - Hapat dhe mënyrat e implementimit (futjes në zbatim);
 - Norma e sipërfaqes së ndërtimit dhe tipologjia e banesave që do të jenë si rezultat i mekanizmave të implementimit;
4. Kategorizimi në zonat funksionale të territorit, nisur nga situata ekzistuese, përdorimet e mundshme, dendësia e popullsisë, infrastruktura aktuale sociale dhe inxhinierike si dhe rregullat që duhet të aplikohen në rast ndryshimi të funksioneve të lejuara. Këto sipërfaqe do të përcaktohen bazuar mbi parimet aktuale të përdorimit të territorit.

Qëllimi i kësaj Analize dhe Vlerësimi të thelluar të territorit është të krijojë një bazë të dhënash për hapat e mëtejshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), të identifikojë problemet me të cilat përballlet zhvillimi i qytetit dhe se si mund të zgjidhen në të mirë të komunitetit. Kuptimi i këtyre zhvillimeve të qytetit shihet i lidhur ngushtë me zhvillimet në një shkallë më të gjerë rajonale dhe kombëtare.

Zhvillimi i integruar i kësaj Bashkie nënkupton marrjen në konsideratë dhe përfshirjen në një paketë propozimesh aspektet që mbështesin dhe garantojnë ndryshimet pozitive që do të ndodhin. Në këtë pikëpamje do të përfshihen, analizohen dhe kombinohen aftësitë ekonomike, sociale, mjedisore, të planifikimit territorial, aftësitë e institucioneve publike dhe ato të sektorit privat.

Në mënyrë më të përmbledhur, studimi synon të pasqyrojë:

- Strukturën e përgjithshme organike të territorit të përvijuar nëpërmjet elementëve që përcaktojnë llojin e zhvillimit, në veçanti nga rrjetet kryesore të transportit elementët natyrore, rrjeti i infrastrukturës ekzistuese dhe sipërfaqet e rezervuara për qëllime strategjike për Bashkinë dhe rajonin.
- Përcaktimi i ndërhyrjeve për ruajtjen e aseteve bujqësore, historike dhe pejsazhistike së bashku me kufizimet në lidhje me përdorimin e tyre, si dhe elementët e dhënë nga normativat shtetërore, në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

- Studim të situatave hidrologjike, gjeologjike dhe sizmike të territorit në mënyrë që të vlerësohet përputhshmëria e planeve të propozuara me to.
- Kufizimet mbi ndërtimet për ato territore apo zona që janë të ndjeshme në lidhje me mjedisin, peizazhin dhe trashëgimitë kulturore e historike.
- Ruajtja e funksionalitetit të infrastrukturës dhe zonave që kanë interes publik. Mbrojtja nga rreziqet e mundshme për banorët dhe objektet vulnerabël.
- Përcaktimi i rrethanave që mund të kërkojnë një rishikim të PPV-së. Ky rishikim duhet të derivojë nga kërkesa e popullsisë dhe indeksi i rritjes, përdorimi i tokës dhe intensiteti i mbulimit të sipërfaqes së ndërtimit, si dhe nga elementët e përgjithshëm, që fillimisht kanë ndikuar klasifikimin origjinal të territorit në zonim.

PPV duhet të sigurojë gjithashtu mbështetje për çështjet të cilat janë kompetencë e Bashkisë Vau-Dejës, si:

- Infrastruktura dhe shërbimet publike,
- Funksionet Social-Kulturore dhe rikrijuese,
- Zhvillimi ekonomik lokal,
- Rendi dhe siguria.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit, që do të mbështetet te instrumentet e planifikimit për të operuar me efikasitet, ka gjithashtu nevojë për një kapacitet të përshtatshëm menaxhues të stafit të Bashkisë, në veçanti për monitorimin dhe modernizimin e planeve përmes kësaj periudhe zhvillimi.

2 Analiza e planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve

2.1 Kuadri ligjor, standardet dhe normat

Më poshtë në trajtë të përmbledhur është dhënë i gjithë kuadri ligjor, në kontekstin e të cilit është përgatitur dokumenti i Analizës dhe Vlerësimit të Territorit të Bashkisë Vau-Dejës. Përveç akteve ligjore dhe nënligjore për planifikimin e territorit të cilët kanë qenë referenca kryesore në hartimin e këtij dokumenti, më poshtë janë dhënë disa nga ligjet dhe VKM kryesore sektoriale që janë përdorur nga ekspertët e fushave të ndryshme në procesin e analizës dhe vlerësimit.

Tabela 1: Kuadri ligjor

Ligj	Nr. 107/2014 dt. 31.07.2014	“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2015, Dt.Aktit: 09.07.2015)
Ligj	Nr. 115/2014 dt. 31.07.2014	“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me Ligjin Nr.180/2014, Dt.Aktit:18.12.2014)
Ligj	Nr. 139/2015 dt. 17.12.2015	“Për vetëqeverisjen vendore”
Ligj	Nr. 7850 dt. 29.07.1994	Kodi civil i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 8378 dt. 22.07.1998	Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 72/2012 dt. 28.06.2012	“Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”
Ligj	Nr. 91/2013 dt. 28.02.2013	“Për vlerësimin strategjik mjedisor”
Ligj	Nr. 9408 dt. 07.04.2003	Për trashëgiminë kulturore (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9244 dt. 17.06.2004	Për mbrojtjen e tokës bujqësore (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9710 dt. 10.04.2007	Për portet turistike (i ndryshuar me Ligji Nr. 28/2012)
Ligj	Nr. 9385 dt. 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9693 dt. 19.03.2007	Për fondin kullosor (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9817 dt. 22.10.2007	Për bujqësinë dhe zhvillimin rural
Ligj	Nr. 8906 dt. 06.06.2002	Për zonat e mbrojtura (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 93/2015 dt. 27.07.2015	Për turizmin
Ligj	Nr. 10463 dt. 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve (i ndryshuar)

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Ligj	Nr. 111 dt. 15.11.2012	Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore
VKM	Nr. 408 dt.13.05.2015	“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (ndryshuar me VKM. Nr. 672, dt 29.07.2015)
VKM	Nr. 671 dt. 29.07.2015	“Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”
VKM	Nr. 1096 dt. 28.12.2015	Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.
VKM	Nr. 219 dt. 11.03.2015	“Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”.
VKM	Nr. 575 dt.24.06.2015	Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte
VKM	Nr. 31 dt.21.01.2016	Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit
VKM	Nr. 691 dt. 29.07.2015	“Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020”
VKM	Nr. 829 dt. 07.10.2015	Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor në Shqipëri” tema - Hidrografia
VKM	Nr. 942 dt. 18.11.2015	Për miratimin e rregullores “Për planifikimin dhe realizimin e fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë”
VKM	Nr. 1077 dt. 23.12.2015	Për miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”
VKM	Nr. 1078 dt. 23.12.2015	Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri”, tema - Kufijtë e Njësive Administrative
VKM	Nr. 410 dt. 27.06.2012	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës
VKM	Nr. 1354 dt. 10.10.2008	Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor
VKM	Nr. 153 dt. 07.04.2000	“Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)
VKM	Nr. 628 dt. 15.07.2015	Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve (i ndryshuar me VKM Nr. 111, dt.10.02.2016)
VKM	Nr. 283 dt. 01.04.2015	Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore
VKM	Nr. 426 dt. 13.07.2007	Për miratimin e kartës shqiptare të restaurimit
VKM	Nr. 369 dt. 18.05.2016	Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”
VKM	Nr. 712 dt. 29.10.2014	Për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”
VKM	Nr. 768 dt. 29.09.2015	Shpalljen e zonave arkeologjike "A" dhe "B" të vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër) dhe miratimin e rregullores së administrimit

Gjithashtu, material kryesor referues, për të gjithë procesin e hartimit të PPV-së për bashkinë Vau-Dejës janë dhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe Planet Ndërsektoriale.

Gjatë fazës së parë janë siguruar edhe dokumente të tjerë që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin ndër vite të zonave urbane në territorin e Bashkisë Vau-Dejës. Një përmbledhje më e hollësishme e dokumenteve të planifikimit paraqitet në vijim.

2.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit dhe PPV-ve të mëparshme

Siç u trajtua më sipër Bashkia Vau-Dejës është e përbërë nga 6 njësi administrative, nga të cilat asnjëra nuk ka një Planin të Përgjithshëm Vendor të miratuar. Në vitet e fundit janë bërë përpjekje për hartimin e një seri dokumentash strategjikë dhe planifikues për njësi të ndryshme administrative të bashkisë, por në asnjë rast nuk është arritur miratimi i PPV-ve.

Në vijim paraqitet një listë e Vendimeve të KRRTRSH dhe KKT në territorin e Bashkisë Vau-Dejës.

Tabela 2: Vendimet e KRRTRSH dhe KKT për Bashkinë Vau-Dejës

Vendime KRRTRSH	Nr. 03 19.10.2001	Për sheshin dhe lejen e ndërtimit për hidrocentralin e Bushatit ne rrethin e Shkodrës.
	Nr. 14 07.05.2005	Për miratimin e studimit urbanistik dhe sheshit te ndërtimit për Objektivin "Kazerma e repartit ushtarak nr.1101 Vau Dejës-Shkodër, i forcave tokësore. Miratohet sip.364.03 ha
	Nr. 08 21.11.2006	Për miratimin e sheshit dhe lejes se ndërtimit për nënstacionin e ri elektrik 110/20 KV ne Bushat, Shkodër.
	Nr. 03 22.05.2007	Për miratimin e sheshit dhe lejes se ndërtimit për objektin « Vend depozitimi rajonal te mbetjeve urbane, ne komunën Bushat, Shkodër »
	Nr. 01 14.07.2009	Miratimi i sheshit te ndërtimit për Hidrocentralin e Ashtës ne Komunën Bushat, Qarku Shkodër.
	Nr. 04 21.07.2009	Për miratimin e studimit urbanistik dhe sheshit te ndërtimit për Objektivin "fabrika e çimentos ne komunën Bushat", ne qarkun e Shkodrës, për shoqërinë "SEASIF GROUP" sh.p.k
	Nr. 14 21.07.2009	Detyrë Projektimi dhe Studim Urbanistik ne Komunen Bushat, Qarku Shkoder.
	Nr. 05 29.12.2014	Për identifikimin e zonave te urbanizuara ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund te ndërhyhet ne funksion te zhvillimit urban (i ndryshuar)

Vendime KKT	Nr. 01 30.07.2015	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore (i ndryshuar)
	Nr. 09 09.09.2015	“Leje Ndërtimi për objektin “Hidrocentralet Gjadër 1/1; Gjadër 1/2; Gjadër 2; Gjadër 3; Gjadër 4; Gjadër 6”, me vendndodhje në Komunën Qerret, Rrethi Pukë, Komuna Ungrej, Rrethi Lezhë dhe Komuna Vig Mnelë, Rrethi Shkodër, me subjekt aplikues shoqërinë konçesionare “S.P.E Gjadër” sh.p.k.
	Nr. 09 09.09.2015	“Leje Ndërtimi për objektin “Hidrocentralet Gjadër 1/1; Gjadër 1/2; Gjadër 2; Gjadër 3; Gjadër 4; Gjadër 6”, me vendndodhje në Komunën Qerret, Rrethi Pukë, Komuna Ungrej, Rrethi Lezhë dhe Komuna Vig Mnelë, Rrethi Shkodër, me subjekt aplikues shoqërinë konçesionare “S.P.E Gjadër” sh.p.k.

Studimi i këtyre dokumenteve bëhet për të kuptuar kontekstin ekzistues, për marrjen e të dhënave të cilat mund të jenë të ri-përdorshme në lidhje me territorin nën studim, por mbi të gjitha për të analizuar vizionet e mëparshme të zhvillimit.

Kjo analizë do të ndihmojë në propozimin e skenarëve më të qëndrueshëm në raport me territorin e bashkisë në fjalë.

2.3 Analiza e planeve, strategjive, politikave, dokumenteve dhe proceseve ekzistuese

Kjo fazë është mjaft e rëndësishme për njohjen me dokumentet bazë mbi të cilat administrohet dhe zhvillohet territori. Në këtë mënyrë do të mund të bëhet një analizë komplekse mbi përputhshmërinë e dokumenteve të ndryshëm, impaktin dhe efektshmërinë e tyre në politikat zhvillimore të deritanishme. Këto dokumente do të vlerësohen në disa këndvështrime: ligjore, urbane, ekonomike, sociologjike dhe historike. Burimet e informacionit do të jenë: bashkia Vau-Dejës dhe bashkitë kufitare, instituti i statistikave, AKPT, institucione të tjera kombëtare etj. Gjithashtu do të shfrytëzohet edhe dokumentacion jo zyrtar që do të mund të plotësojë panoramën e informacionit mbi territorin dhe mekanizmat e zhvillimit. Në një tentativë për të mbledhur dhe bashkuar copëzat e këtij mozaiku, do të bëhet leximi dhe deshifrimi i mekanizmit zhvillimor. Ky proces do të ndihmojë në vlerësimin pasardhës të qasjes strategjike dhe në krijimin e vizionit të ri mbi territorin.

Gjatë gjithë procesit të mbledhjes së të dhënave, konsulenti do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet publike, në nivel lokal dhe kombëtar. Koordinatorin do të supervizojë procesin e mbledhjes së të dhënave dhe do të garantojë bashkëveprimin efikas me institucionet përkatëse. Vëmendje e veçantë në këtë fazë do të kushtohet marrëdhënies me AKPT-në dhe MZHU-në për identifikimin e politikave kombëtare të planifikimit që influencojnë zhvillimin e bashkisë Vau-Dejës. Informacioni i mbledhur dhe i analizuar nga ekspertët do të bëhet pjesë e vlerësimit të përgjithshëm dhe

analizës së thelluar të territorit, që paraprin propozimet konkrete në nivel strategjik të PPV-së.

Në vijimësi të reformës territoriale dhe procesit kombëtar të planifikimit, konsulenti është i vetëdijshëm për nevojën mbi qasjen e integruar në shkallë rajonale dhe kombëtare. Në mënyrë që të reflektohen dhe të përmbushen më së miri objektivat zhvillimore, një analizë e hollësishme do të zhvillohet mbi dokumentacionin kryesor në shkallë kombëtar.

Dokumentet bazë mbi të cilat do të mbështetet analiza dhe vlerësimi paraprak i territorit janë:

2.4 Planet ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale

2.4.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Në aspektin ligjor dhe teknik, dokumenti i Planit të Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030” vendos kornizat ligjore dhe parametrat madhorë të zhvillimit, të detyrueshëm për zbatim nga organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal. Si i tillë, ky dokument ofron referencën bazë për zhvillim strategjik afatgjatë e cilësor të territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim:

- sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik e social të vendit,
- menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij,
- mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që siguron përdorimin racional të tokës.

Bazuar në hierarkinë e vendosur nga kuadri ligjor për planifikimin e territorit, PPK do shërbejë si dokumenti kryesor orientues në procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau-Dejës.

Propozimi i PPK-së për Polin e zhvillimit rajonal Shkodër - Lezhë, porta perëndimore e rajonit malor verior, ku përfshihet edhe bashkia e Vau-Dejës.

Ky pol përbëhet nga 5 bashki, ku bashkia Shkodër parashikohet si qendra kryesore, bashkia Lezhë si qendër e specializuar dhe bashkitë Vau-Dejës, Malësi e Madhe, Kurbin, janë qendra lokale. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it në vitin 2001 në rajon numëroheshin 344.213 banorë, ndërsa në vitin 2011 308.797 banorë, duke shënuar një pakësim të popullatës me 10.3%. Gjithsej sipërfaqja territoriale e tij është 310.093 ha dhe përbëhet nga 37 njësi administrative. Ndonëse ky pol nuk ka sipërfaqe territoriale të konsiderueshme, ai është shumë i pasur me pasuri natyrore dhe me vlera kulturore ku vlen të përmendet plazhin i Shëngjinit, i Velipojës, liqeni i Shkodrës, lumi Mat, Buna, Drini, Alpet e thepisura, fushat e pasura bujqësore, aktivitetet agroturistike, folklori dhe muzika karakteristike, toleranca fetare etj.




Fig. 2: Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë

Ndër projektet më të rëndësishëm, që parashikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar janë:

Referuar sistemit natyror, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Shpallja dhe promovimi i parkut kombëtar të Alpeve si park me rëndësi rajonale dhe hartimi i politikave dhe instrumenteve financiare për nxitjen e zhvillimit të turizmit malor.

Referuar sistemit ujor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Përcaktimin e Vijës Blu dhe respektimin strikt të saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi dhe Rregullores së Planifikimit të korrikut 2015, në mënyrë që të mbrohet ekosistemi natyror i zonës.
- Qendrat primare dhe sekondare duhet të pajisen me impiant të trajtimit të ujërave të ndotur, përpos 3 impianteve ekzistues/të planifikuar Shkodër, Lezhë - Shëngjin dhe Velipojë, në mënyrë që brenda vitit 2030 të mos derdhen më ujëra të zeza në lumenj, det dhe të rritet cilësia e baseneve.
- Itinerarin turistik vozitës lumor - liqenor, duke integruar vozitjen dhe lundrimin në një rrjet rekreativ: Vau-Dejës - Liqeni i Shkodrës - Pulaj - Ishulli i Bojanës.

Referuar sistemit bujqësor:

- Krijimin e një tregu rajonal bujqësor, i cili do të plotësonte zinxhirin ekonomiko-bujqësor në agro-përpunimin e produkteve bujqësore.

Në lidhje me Infrastrukturën e transportit:

- Zhvillimin e qendrës primare të Shkodrës dhe Lezhës si dy qytete-porta, nisur nga modalitetet portuale, hekurudhore dhe rrugëve kombëtare që ofrojnë, si dhe zhvillimin e qendrave Bajzë, Koplik, Laç si hub-e logjistike, për rolin

kryesor, pozicionin kufitar që kanë si pika grumbullimi të produkteve bujqësore dhe stacione me rëndësi për njerëz dhe mallra.

- Përmirësimin e kushteve dhe fuqizimin e kapacitetit akomodues të portit të Shëngjinit si nyje shumë e rëndësishme për polin ekonomik Shkodër – Lezhë
- Integrimin dhe funksionimin me kapacitet të plotë sipas modaliteteve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: Hani i Hotit, Bajzë, Koplik, Grilë, Milot si stacione mallrash; Shkodër, Lezhë si stacione qendrore, si dhe rigjallërimin e stacioneve për pasagjerë, Mjedë, Baqël, Laç, Gjorm, Mamurras.
- Itinerarin peizazhistik blu në këtë zonë, përgjatë qendrave: Ulqin - Velipojë - Shëngjin - Lezhë – Kune-Vain, të paraprirë nga projektet strategjike të MTI-së dhe MM-së.
- Ndërtimin e tubacionit të gazit IAP, i cili parashikohet të fillojë nga Fieri, të përshkojë këtë rajon për në Malin e Zi në dy degëzime, mbi dhe nën liqenin e Shkodrës. Përtej Malit të Zi, degëzimi IAP-it do të mundësojë lidhjen me Bosnjë - Hercegovinën dhe Kroacinë.
- Në përputhje me OST-në, ndërtimin e nënstacioneve të reja në Koman dhe Lezhë. Në këtë të fundit janë parashikuar të kalojnë edhe linjat 400 dhe 220kV që do të lidhin Shqipërinë me Kosovën dhe me Malin e Zi.
- Ndërtimin e parkut energjetik, i cili do të përbëhet nga dy parqe eolike dhe një termocentral biomasë me kapacitet vjetor prodhimi përkatësisht 1.1 Twh dhe 750 Gwh.
- Vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative, duke synuar që rrezatimi prej 2700 orë/vit të shfrytëzohet në ndërtimin e parqeve fotovoltaike.

2.4.2 Plani rajonal Shkodër-Lezhë (2005-2020)

Plani rajonal për zhvillimin e rajonit Shkodër–Lezhë për periudhën 2005-2020 ka karakterin e një plani strategjik dhe përfshin territorin e Qarkut Shkodër dhe Lezhë dhe gjithashtu trajton korridoret kryesore rajonale, kryesisht me Kosovën dhe Malin e Zi.

Ky plan i parë, në kuadrin e një zhvillimi hapësinor multi-sektorial, mbështetet në pesë drejtime kryesore:

- Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin urban;
- Përcaktimi i infrastrukturave strategjike (kryesisht transporti dhe energjetika);
- Përcaktimi i një strategjie për zhvillimin ekonomik duke përfshirë element që kanë lidhje direkt me zhvillimin e territorit;
- Përcaktimin e një strategjie mjedisore që siguron një zhvillim të qëndrueshëm në lidhje me përdorimin e tokës në mënyrë sa më efektive, infrastrukturën e nevojshme dhe duke dhënë gjithashtu propozime konkrete zhvillimi ekonomik;
- Përcaktimin e instrumenteve efektiv për implementimin e kësaj strategjie, në lidhje me organizimin e institucioneve vendore, buxhetet përkatëse dhe mjetet financiare.

Duke konsideruar pozicionin gjeografik, konstatohet se pothuaj gjithë territori i bashkisë Vau-Dejës përfshihet në këtë Plan dhe si i tillë mjaft nga propozimet strategjike zhvillimore do merren parasysh në hartimin e PPV-së për këtë bashki.




Fig. 3: Plani Rajonal Shkodër – Lezhë

Disa koncepte bazë të këtij plani janë si më poshtë:

- Zhvillimi i Shqipërisë së Veriut, si një rajon i fortë e kohesiv. Një vizion ky që parandalon mbi përqendrimin në zonën Tiranë - Durrës të potencialeve ekonomike të Shqipërisë.
- Krijon një "Rajon Urban Policentrik", përgjatë kufirit me Malin e Zi, duke lidhur ekonomitë urbane të Shkodrës, Lezhës, Podgoricës, Tivarit dhe Ulqinit në një kornizë për zhvillimin ekonomik rajonal dhe shpërndarjen e popullsisë.
- Krijon një korridor të transportit rajonal nga Kosova tek porti i Tivarit përgjatë rajonit Shkodër - Lezhë, e deri në Malin e Zi, duke krijuar një shkallë të lartë të mundësive të zhvillimit përmes rajonit verior.

- Zgjeron zonën e rivierës së Malit të Zi, drejt jugut, në afërsi të bregut Shqiptar duke ndërtuar një urë Ulqin - Velipojë përgjatë lumit Buna, duke krijuar kështu një qendër të madhe për zhvillimin e turizmit.
- Racionon strukturën fizike dhe ekonomike të "Zonës së Largët Malore". Menaxhohet rritja e popullsisë ndërsa rritet cilësia e jetës.
- Stabilizon popullsinë e qyteteve të Pukës, Kurbinut dhe Mirditës, kështu që një produkt rajonal në rritje është në gjendje të shpërndajë të mirat në mënyrë maksimale.
- Mbron tokën bujqësore, dhe kufizon ndërtimin e fshatrave të "rajonit urban", karshi familjeve që janë pjesë autentike e ekonomisë rurale.
- Harta e mëposhtme tregon disa projekte të rekomanduara dhe interesante për fuqizimin rajonal dhe zhvillimin e ndërkufitar me vendet fqinje, si Mali i Zi dhe Kosova, ashtu si korridori kombëtar Shqiptar dhe i transportit ndërkombëtar. Më poshtë, në trajtë skematike, janë paraqitur ndërhyrjet kryesore strategjike që propozon Plani Rajonal Shkodër - Lezhë:
- Akset kryesore rrugore,
- Projektet e zhvillimit ekonomik dhe
- Zonat e rritjes urbane

2.4.3 Plani Operacional i Zhvillimit Lokal për bashkinë Vau-Dejës

Projekti i hartimit të Planit Operacional të Zhvillimit Lokal (POZHL) u iniciua nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore në bashkëpunim me projektin STAR. I përmbyllur në mars 2016, POZHL rezulton si sfidë kryesore dhe nevojë imediate për të pasur një plan të integruar të veprimeve dhe masave që bashkia e re duhet të marrë, për të siguruar kohezionin administrativ dhe territorial të të gjitha njësive administrative të saj, pas reformës territoriale. Sigurimi i kohezionit administrativ dhe territorial kërkon masa dhe veprime që mund të përfshijnë ristrukturimin administrativ, të shërbimeve administrative dhe shërbimeve publike, të infrastrukturës lidhëse të njësive administrative etj.

Konkretisht, POZHL është dokumenti kryesor që do të orientoj punën, do të bashkërendojë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm në periudhën afatshkurtër (rreth 3 vjeçare) me qëllim sigurimin e kohezionit administrativ dhe territorial të bashkive të reja.

Kjo nismë synon të asistojë Bashkinë e Vau Dejës në planifikimin e masave dhe veprimeve, përfshirë projektet e investimeve kapitale, për periudhën afatshkurtër (2-3 vjeçare), të integruara në POZHL. Qëllimi i këtij instrumenti konsiston në analizën e situatës aktuale, duke synuar të evidentojë fillimisht përparësitë territoriale dhe problematikat kryesore dhe më pas prioritetet që adresojnë nevoja, në përgjigje të të cilave duhet të propozohen ndërhyrjet në formën e projekteve.

2.4.4 Projekti STAR (Support of Territorial and Administrative Reform)

Projekti STAR ka ardhur si një reagim i menjëhershëm i mbështetjes që donatorë të ndryshëm ofruan për Qeverinë Shqiptare në përpjekjet e ndërmarra për zbatimin e Reformës Administrative Territoriale.

Raportet e fazave të ndryshme të këtij projekti (në nivel qarku, bashkie dhe njësisë administrative), nëpërmjet një analize të thellë fiskale, financiare, ekonomike, sociale, kulturore, demografike administrative të Njësive të Qeverisjes Vendore adresojnë çështjet kryesore të procesit të decentralizimit si:

- demokratizimin e qeverisjes;
- efikasitetin në ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- zhvillimin ekonomik lokal;
- zhdukjen e pabarazive dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Duke konsideruar përparësitë por dhe problematikat kryesore me të cilat bashkitë “e reja” po përballen në procesin e implementimit të kësaj reforme, gjykojmë që raportet dhe analizat e Projektit STAR ofrojnë një kornizë mjaft me vlerë për njohjen e gjendjes aktuale shumëdimensionale të bashkisë Vau-Dejës por njëkohësisht dhe mundësitë dhe prioritet kryesore zhvillimore.

2.4.5 Planet e Përgjithshme Vendore të bashkive Lezhë dhe Shkodër

Duke konsideruar pozicionin strategjik të bashkisë Vau-Dejës mes bashkive Shkodër dhe Lezhë që janë dhe dy ndër polet kryesore të zhvillimit në gjithë rajonin verior, propozimet strategjike rajonale për sa i përket infrastrukturave kryesore dhe ndërveprimit lokal të këtyre Planeve do jenë në fokus të hartimit të PPV.

Pavarësisht se akoma të pamiratuara në instancat përkatëse, këto plane tashmë janë në fazën finale dhe si të tilla janë një ndihmë konkrete për grupin e punës për të kuptuar kontekstin zhvillimor rajonal të bashkisë Vau Dejës.

2.4.6 Master Plani i Alpeve të Shqipërisë

Master Plani i Alpeve të Shqipërisë i cili aktualisht, bazuar në kuadrin ligjor për planifikimin e territorit, po trajtohet si një Plan Sektorial për Zhvillimin e Turizmit të Alpeve të Shqipërisë është një tjetër dokument kryesor që do konsiderohet në hartimin e PPV të bashkisë Vau-Dejës.

Zona që studion Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit shtrihet në pjesën Veriore të Shqipërisë. Kjo zone është identifikuar si “Zona Bërthamë” dhe do të jetë subjekti i Planifikimit Hapësinor (Planifikimi Territorial) nëpërmjet një Plani Sektorial siç përshkruhet në nenin¹⁷ të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit të vitit 2014.




Fig. 4: Kufiri i Planit Kombëtar Sektorial

Zona Bërthamë, përbëhet nga njësitë administrative vendore me karakteristika të përbashkëta territorial lidhur me aspektin e dimensioneve gjeografike, demografike, socio-ekonomike dhe infrastrukturës, si më poshtë:

Si rezultat, zona e planifikimit, ndryshe Zona Bërthamë përbëhet nga 12 njësi administrative vendore:

- Pult, Shosh, Shalë të Bashkisë Shkodër;
- Shllak dhe Temal të Bashkisë Vau-Dejës;
- Kelmend dhe Shkrel të Bashkisë Malësi e Madhe;
- Bajram Curri, Bujan, Margegaj, Lekbibaj dhe Tropojë e Vjetër të Bashkisë Tropojë.

Konkretisht territoret e bashkisë të përfshira në këtë Master Plan janë kryesisht ato të njësive administrative Shllak dhe Temal.

Tabela 3: Qendrat urbane të prekura nga Masterplani i Alpeve

Vau-Dejës	Zona bërthamë	Temal	Fshatrat: Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Killogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë.
		Shllak	Fshatrat: Vukjakaj-Gegaj, Palaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj
		Vau-Dejës	Qytet: Vau Dejës, Fshatrat: Mjede, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe
	Zona mbështetëse	Bushat	Fshatrat: Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hotën
		Vig-Mnelë	Fshatrat: Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig
		Hajmel	Fshatrat: Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë

2.4.7 Plani Strategjik i Zhvillimit Ndërkomunal i Zadrimës

Plani Strategjik i Zhvillimit Ndërkomunal i Zadrimës, i përgatitur nga FSHZH në vitin 2011, është një dokument që përfshin territorin e ish-bashkisë Vau-Dejës si dhe katër ish- komunave Hajmel, Bushat, Dajç dhe Blinisht, të cilat përbëjnë rajonin e Zadrimës.

Ky dokument përbëhet nga tri pjesë kryesore:

- Analiza e gjendjes ekzistuese, ku behet një panoramë e fushave kryesore të zhvillimit të zonës si dhe të problematikave dhe potencialeve të tyre;
- Vizioni, Qëllimet Strategjike dhe Plani i Veprimit japin orientimet strategjike si dhe propozojnë projekte konkrete për secilën drejtim zhvillimi;
- në pjesën e trete parashikohen burimet e mundshme të financimit si dhe mënyrat e monitorimit të ecurisë së zbatimit të planit.

Tri nga njësitë vendore, objekt studimi, (Vau-Dejës, Hajmel dhe Bushat) janë tashme pjesë e bashkisë së re të Vau-Dejës. Për sa i përket këtij territori, ky plan do të ketë një rëndësi të veçantë gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

2.4.8 Dokumente të tjerë

Nga komunikimi me stafin e bashkisë Vau-Dejës rezulton që në 5 vitet e fundit janë hartuar disa dokumente planifikimi me fokus zhvillimin urban të qendrave të banuara (qytetit të Vau Dejës, fshatit Bushat, zhvillimet urbane përgjatë superstradës Lezhë - Shkodër, etj.) të cilët nuk janë miratuar në organet kombëtare sipas kërkesave të kuadrit ligjor. Pavarësisht statusit të tyre, grupi i punës do analizojë këto dokumente dhe do shfrytëzojë të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të hartimit të tyre.

1) Detyrë Projektimi dhe Studim Urbanistik në Komunën Bushat, Qarku Shkodër.

Më datë 21.07.2009 me Vendim nr.14 miratohet n KRRTRSH “Detyrë Projektimi dhe Studim Urbanistik ne Komunën Bushat, Qarku Shkodër”. Kjo detyrë projektimi ka vlerat e saj, duke na parashtruar një kuadër të përgjithshëm të gjendjes ekzistuese dhe nevojat që ka komuna Bushat për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm brenda një kuadri planifikimi. Komuna Bushat përbëhet prej 25000 banorësh, të cilët jetojnë në 14 fshatra (Bushat, Barbullush, Rranxa, Stajkë, Kosmaç, Ashtë, Melgushë, Plezhë, Shkjezë, Kukël, Sumëz, Fshatii Ri, Hoten dhe Konaj). Rritja e popullsisë në Komunën Bushat ka qenë sa rritja natyrore e saj prej 2.5%.

Detyra e projektimit bazohet në:

- Përcaktimin e vijave kufizuese të 14 fshatrave të Komunës Bushat.
- Studimin përgjatë superstradës Shkodër – Lezhë, në thellësi 240m në dy krahët e superstradës dhe studimi i rrugës nga kryqëzimi Vau – Dejës deri në fshatin Shelqet.
- Studimin në zonës nga kryqëzimi Vau – Dejës deri në kryqëzimin e fshatit Barbullush.

Vizioni zhvillimit komunës Bushat:

- Komuna do të tërheqë investime të brendshme maksimale (dhe investime lokale), në mënyrë që të krijojë numrin më të madh të arritshëm të punëve të cilësisë më të mirë. Kjo do të bëhet në një mënyrë të qëndrueshme, duke trajtuar pengesat për një investim të tillë.

Qëllimi:

- Zhvillimi i zonës së Bushatit si një rajon i qëndrueshëm dhe i fuqishëm, duke i dhënë vlerë potencialit ekonomik të kësaj zone. Potenciali ekonomik i Shqipërisë nuk duhet të mbiqendërzohet në zonën Tiranë – Durrës.
- Krijimi i një “Zone Urbane Policentrike” duke krijuar mundësi për të lidhur ekonomitë urbane të Shkodrës, Lezhës, Podgoricës, Bar-it dhe Ulqinit në një strukturë që ndikon në rritjen ekonomike rajonale dhe rritjen e cilësisë së jetesës së popullsisë së zonës.




Fig. 5: Kufiri i studimit

Disa nga potencialet e ndërhyrjes për zhvillimin e Komunës sipas fushave të ndryshme mund të përmblihen:

- Bujqësia, Blegtoria , Bletaria, Gjuetia dhe peshkimi, Kullimi dhe sistemimet, Ruajtja e mjedisit, Kultura , Artizanati, Infrastruktura, Shërbimet shëndetësore dhe sociale, Forcimi i kapaciteteve të Organeve të Pushtetit Vendor .

2) Detyra e projektimit, Bashkia e Vau të Dejës.

Në prill të vitit 2008, është përgatitur nga bashkia e Vau të Dejës me mbështetjen e Intercooperation, Albania dhe Zvicër “Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Tirana dhe Albania Urbaplan, Zvicër”, Detyra e projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit Vau-Dejës.

Kërkesat kryesore dhe objektivat që duhet të plotësojë Plani i Përgjithshëm Rregullues i Bashkisë Vau-Dejës.



Fig. 6: Kufiri i planit të bashkisë Vau-Dejës

Plani i Përgjithshëm Rregullues duhet të rikonceptojë hapësirat e brendshme dhe të ardhshme të qytetit duke marrë për bazë këto elemente kryesore:

- riorganizimin e territoreve të qytetit nga pikëpamja funksionale, duke e vënë theksin tek promovimi i zonave me funksione mikse, duke krijuar kështu zona urbane me dinamike dhe me më leverdi nga pikëpamja e përdorimit të tokës dhe efijencës.
- përmirësimin e parametrave të jetës urbane duke përfshirë elementet e gjelbërimit publik, ambienteve rekreative, sportive dhe sociale si dhe duke përmirësuar nivelin e shërbimeve që ofrohen në qytet
- të krijojë një skemë efijente të qarkullimit të mjeteve dhe këmbësoreve në qytet duke u bazuar në rrjetin rrugor ekzistues, hapësirat e lira si dhe nevojën për përmirësimin e aksesit të lirë të qytetarëve në vende ku është i kushtëzuar nga elemente natyrore apo nga struktura ekzistuese urbane
- të modifikojë apo të “çlirojë” qytetin nga varësia dhe ndikimi që ka rruga ekzistuese interurbane Shkodër – Pukë, që kalon mes për mes qytetit, duke dhënë alternativa të mundshme lidhjeje si dhe duke analizuar me kujdes ndikimin që do të kenë këto alternativa në strukturën e ardhshme urbane të qytetit të Vau-Dejës.
- koordinimin e zhvillimeve të propozuara urbane dhe infrastrukturore të qytetit me propozimet e Strategjisë së Zhvillimit të Rajonit Shkodër, nga pikëpamja e tematikave të zhvillimit, ndërhyrjeve primare në infrastruktura dhe shërbime
- të ruajë fondin e tokave bujqësore përreth qytetit duke orientuar zhvillimin e ardhshëm urban në territore me të përshtatshme si dhe duke kontrolluar dhe disiplinuar tendencat e ndërtimit në këto toka bujqësore
- të përcaktojë me kujdes përdorimin e sipërfaqeve të pashfrytëzuara që gjenden në brendësi të territorit të qytetit duke marrë në konsideratë lidhjen me çështjet e pronave dhe infrastrukturave shtesë të nevojshme.

- të identifikojë njësitet strukturore të nevojshme në territorin e qytetit të cilat do të shërbejnë si instrumentet e menaxhimit të territoreve urbane të qytetit në varësi të propozimeve të Planit të Përgjithshëm Rregullues
- të integrojë në strukturën urbane të qytetit, zonat periferike informale në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues
- të koordinojë propozimet e Planit Rregullues të Përgjithshëm me propozimet e Planit të Zhvillimit Lokal të gjithë territorit të Bashkisë së Vau-Dejës, duke krijuar kështu një harmonizim të zhvillimeve urbane të qytetit me zonat rurale dhe rrjetet kryesore të infrastrukturave dhe shërbimeve.

3) Koncepti strategjik i zhvillimit rajonal (GIZ/ Këshilli i Qarkut Shkodër)

Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal është hartuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër, me mbështetjen e GIZ, si instrumenti kryesor i planifikimit strategjik, që vendos parimet dhe prioritetet kryesore mbi të cilat do të orientohet zhvillimi i Qarkut Shkodër gjatë viteve në vijim. Fushat prioritare të përcaktuara nga KSZhR-ja janë:

- Arsimi, trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve
- Infrastruktura dhe Shërbimet
- Turizmi dhe agrobiznesi
- Bashkëpunimi Ndër-rajonat dhe me partnere të tjerë
- Mbrojtja nga përmbajtjet

“Skenarët e Zhvillimit Nënrajonat në Qarkun Shkodër”(2015)

Nga analiza, janë identifikuar nënrajonet e mëposhtme, me potenciale të ngjashme në zhvillimin e sektorit të bujqësisë/ blegtorisë:

- Nënrajonat i Mbishkodrës: i cili përfshin pjesë të komunave Shkrel, Kastrat, Qendër
- Nënrajonat i Nënshkodrës: i cili përfshin komunat Ana e Malit, Bërdicë, Dajç Bregu i Bunës, Gur i Zi, Bushat, Hajmel dhe Velipojë (Ky nënrajon përmban rreth 41% të tokave bujqësore të Qarkut Shkodër, me bonitet të lartë (kategoria 1-4). Po ashtu, në këtë nënrajon vërehet një përqendrim i lartë i qendrave të përpunimit të qumështit.)
- Nënrajonat i Pukës: i cili përfshin pjesë nga komunat Fierzë, Iballë, Qelezë, Temal, Qerret, Rrapë, Qafë Mali, Blerim dhe Gjegjan dhe bashkitë Pukë dhe Fushë Arrëz. Në këtë nënrajon shtrihen rreth 61% të kullotave të të gjithë Qarkut Shkodër.




Fig. 7: Nënrajonet me potencialet bujqësore

2.5 Zbatueshmëria e dokumenteve strategjike dhe planifikues

Siç konstatohet, për territorin e Bashkisë Vau-Dejës, në vitet e fundit janë hartuar disa dokumente strategjike dhe planifikimi që pasqyrojnë mundësitë e zhvillimit ekonomik në kontekstin lokal dhe rajonal. Këto dokumente gjykohen mjaft të vlefshme për t'u marrë në konsideratë kryesisht në fazën e dytë të hartimit të PPV që ka lidhje me përcaktimin e vizionit dhe objektivave të zhvillimit. Duke konsideruar edhe faktin që mjaft prej këtyre dokumente kanë kaluar në procese të gjëra konsultimesh në nivel lokal dhe qendror tregon një vlerë të shtuar të tyre në lidhje me marrjen në konsideratë të mjaft gjykimëve dhe vlerësimeve të ekspertëve të ndryshëm dhe të grupeve të interesit. Sa më sipër vlen të theksohet që të gjithë këto dokumente do jenë në fokusin tonë, për përfshirjen e tyre kryesisht gjatë procesit të hartimit të Strategjisë të zhvillimit territorial të Bashkisë Vau-Dejës, pjesë integrale e PPV-së.

Në lidhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau-Dejës dhe Komunës Bushat (të pamiratuara) disa nga aspektet kryesore të analizës me fokus zhvillimin urban janë paraqitur në paragrafin në paragrafët pararendës. Gjithsesi zbatueshmëria dhe integrimi i propozimeve të këtyre planeve në PPV të Bashkisë Vau-Dejës do shikohet edhe në kontekstin e përputhjes me parashikimet dhe direktivat e Instrumenteve Kombëtar të Planifikimit (PPK, PINS për Bregdetin).

Edhe përsa i përket Planeve Strategjike të zhvillimit të komunave Bushat, Hajmel dhe Vig-Mnelë do të vlerësohet mundësia e integritit të qasjeve kryesore me strategjitë dhe vizionin e PPV. Kjo strategji do të jetë një sintezë e objektivave të këtyre planeve me një vizion territorial unifikues dhe bashkërendues. Zbatueshmëria e dokumenteve

të mësipërm do të vlerësohet edhe në kontekstin e përputhjes me Instrumentet Kombëtar të Planifikimit dhe përputhjes me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Në përmbyllje të këtij paragrafi, vlen të theksohet që e gjithë baza e të dhënave teknike, hartografike dhe analizat karakterit social dhe ekonomik që këto dokumente planifikimi përmbajnë, kanë qenë shumë me vlerë dhe janë referuar në mjaft raste në këtë fazë të paraqitjes së gjendjes ekzistuese për këto njësi administrative.

2.6 Çështje dhe zonat e rëndësisë kombëtare

2.6.1 Të përgjithshme

Bazuar në kuadrin ligjor për planifikimin e territorit, “çështje, zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit” janë ato çështje, zona dhe objekte që njësohen ose lidhen me interesa shtetërore ose kombëtarë. Zakonisht, për zonat me rëndësi kombëtare, ka akte të miratuara për mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre, nga organet qendrore (ministrinë dhe agjencitë) që mbulojnë sektorët përkatës.

Nga analiza territoriale e bashkisë Vau-Dejës rezulton që çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit janë:

- Infrastruktura kombëtare e transportit (rrugore dhe hekurudhore)
- Infrastruktura energjetike
- Zonat me vlera të veçanta natyrore dhe mjedisore
- Zona me vlera të veçanta arkeologjike, historike dhe të trashëgimisë kulturore

Ndër elementët më të rëndësishëm mund të përmendim:

- Infrastruktura e transportit: Aksi Kombëtar Tiranë – Shkodër – Hani i Hotit, Aksi Kombëtar Shkodër – Pukë – Kukës, hekurudha Tiranë – Shkodër.
- Infrastruktura energjetike: Hidrocentralet Ashta I dhe Ashta II, Hidrocentralet e Vaut të Dejës dhe Komanit
- Zonat e mbrojtura dhe ato natyrore: Parku Kombëtar i Alpeve (parashikuar nga PPK), Zona e Mbrojtur Lumi i Bunës-Velipojë, Fusha e Liqethit, Fragment i thyerjes tektonike Shkodër – Pejë, Shpella e Malagjisë
- Zonat historike dhe arkeologjike: Zona arkeologjike A dhe B e vendbanimit të Komanit, Kalaja e Sapës, Vigut, Vaut të Dejës, Shurdhahut, etj.

Në vijim të këtij materiali janë paraqitur në formë të detajuar përshkrimet për secilin nga grupimet e paraqitura më sipër të zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare shoqëruar dhe me bazën ligjore përkatëse. Gjithashtu në aneksin e hartave jepen të paraqitura grafikisht dhe të gjeoreferencuara gjithë zonat dhe objektet të rëndësisë kombëtare për territorin e bashkisë Vau-Dejës.

Duhet pasur parasysh që përveç bazës ligjore sipas së cilës mbrohen dhe menaxhohen këto zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare edhe KKT, duke vlerësuar gjendjen ekzistuese të zhvillimeve urbane kaotike gjatë viteve të fundit, ka pasur një seri vendimmarrjesh për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe

rehabilituese të tyre. Kjo me qëllim kontrollin e zhvillimit në afërsi të tyre nga pushteti lokal dhe ministritë e linjës. Në vijim disa prej vendimeve të KKT-së:

- Vendim KKT Nr.1, dt. 8.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të Planit të Integruar Sektorial për brezin bregdetar”
- Vendim KKT Nr.4 dt. 18.10.2013 “Për masat emergjentë të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonat me rëndësi kombëtare mjedisore”
- Vendim KKT Nr.3 dt. 22.08.2014 “Për miratimin e nismës për përcaktimin e disa çështjeve / zonave të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”
- Vendim KKT Nr.1 dt. 9.9.2015 “Për përcaktimin dhe shpalljen si zona të rëndësisë kombëtare në planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të ministrit të kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015”

2.6.2 Analiza e elementeve përjashtuese

Analiza e elementeve përjashtues merr në shqyrtim elementet që ndikojnë ose pengojnë zhvillime të caktuara në zona të ndryshme të territorit (kryesisht ndërtimin).

Për infrastrukturën, zonat e mbrojtura, elementet hidrografikë etj., legjislacioni në fuqi dhe instrumentet kombëtar të planifikimit (PPK, PINS Bregdeti) përcaktojnë zonat përreth apo përgjatë tyre ku nuk lejohen ndërtimet e reja ose ku ndërtimet duhet të respektojnë limite të ndryshme lartësie etj.

Në vijim është bërë një përshkrim i detajuar i gjithë elementëve kryesor përjashtues bazuar në legjislacionin përkatës dhe gjithashtu në aneksin e hartave, do të gjeni të paraqitur grafikisht të gjithë këto parashikime që ndikojnë në zhvillimin urban përmes fashave mbrojtëse të infrastrukturave kryesore apo zonave buferike për element të veçantë territorial.

Bregdeti

Plani i Integruar Ndër-Sektorial për Bregdetin për të cilin, në vijim do trajtojmë në formë të detajuar synimet dhe objektivat kryesore që impaktojnë në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm zhvillimor, jep mjaft përcaktimeve për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij asemi mjaft me vlerë për vendin tonë, kryesisht në zhvillimin e turizmit. Sipas këtij instrumenti bëhet një ndarje horizontale dhe vertikale e zonës bregdetare (përcaktimi i fashave me karakter të ndryshëm zhvillimor) dhe për secilën prej tyre jepen orientimet dhe përcaktimet bazë që duhen marrë në konsideratë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Megjithatë bashkia Vau-Dejës nuk është bregdetare, kushtëzimet e PINS Bregdeti aplikohen në territorin e bashkisë Vau-Dejës pasi ajo bën pjesë në fashën e bujqësisë dhe blegtorisë, në fashën e vlerave historike dhe kulturore si dhe në fashën e territorit ku kalon infrastruktura për aksesin e bregdetit. Pikërisht këto fasha, janë mbështetje për aktivitetin turistik në bregdet.

Brigjet e lumenjve dhe liqeneve

Ligji Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore (neni 4, pika 8), përcakton gjerësitë e brigjeve të deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave, pellgjeve dhe lumenjve si rripat anësorë të tokës përgjatë, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona:

a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

b) me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun.

Infrastruktura hekurudhore

Kodi Hekurudhor, miratuar me ligjin nr.9317, dt. 18.11.2004, në përcaktimet e tij (neni 3, pika 11) përkufizon "Brezin e vijës hekurudhore" si toka në të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi minimale 5 metra, duke u nisur nga fundi i skarpatës së trasesë, kur nuk ka kanale, dhe nga fundi i kanaleve mbrojtëse dhe kulluese. Në vazhdim (pika 12, në po të njëjtin nen), përcakton "Brezin mbrojtës të vijës hekurudhore" si brezi i tokës nga të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi 100 metra, nisur nga ekstremi i jashtëm i brezit hekurudhor.

Infrastruktura rrugore

Sipas VKM nr.153 date 07/04/2000 "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se, sipas kategorive të ndryshme të rrugëve, brezat e rezervuara jashtë qendrave të banuara që duhen respektuar për ndërtimet e reja apo zgjerimet e zonave urbane, nuk mund të jene me pak se:

- a) 60 m për rrugët e tipit A
- b) 40 m për rrugët e tipit B
- c) 30 m për rrugët e tipit C
- d) 20 m për rrugët e tipit F

Ndërsa largësitë nga kufiri rrugor në brendësi të qendrave të banuara që duhen respektuar për ndërtimet e reja, në rindërtimet apo në zgjerimet përballë rrugës, nuk mund të jene me pak se:

- a) 30 m për rrugët e tipit A
- b) 20 m për rrugët e tipit D

Infrastruktura e energjisë elektrike

Infrastruktura e energjisë elektrike dhe kryesisht linjat e tensionit të lartë janë një tjetër element përjashtues që duhet marrë në konsideratë pasi gjatë ndërtimit të banesave apo zgjerimit të zonave urbane duhet ruajtur doemos një distancë sigurie. Kjo distance përcaktohet me VKM të vitit 1978, në “Normat Teknike të Projektimit” ne librin “VI KTP 17, 18, 19” – 1978.

Në pikën 11.2 parashikohen largësitë horizontale nga përcjellësit anësorë të linjës ajrore (ne pozicionin e pamënjanuar) deri në pjesët e dala të godinave të veçuara, jo më të vogla se:

- 10m – për linjat 6-10 KV
- 15m – për linjat 35 KV
- 20m – për linjat 110 KV
- 25m – për linjat 150-220 KV
- 30m – për linjat 330 KV

Ne pikën 12.6 parashikohen largësitë horizontale nga përcjellësit anësorë të linjës ajrore, jo më të vogla se:

- 2m – për linjat 6-10 KV
- 4m – për linjat 35 KV
- 5m – për linjat 110 KV
- 6m – për linjat 150-220 KV
- 8m – për linjat 330 KV

Përsa i përket linjës së inter-koneksionit Tiranë Podgoricë (400kV) duhet të themi që gjatë procesit të ndërtimit të saj, gradualisht qeveria shqiptare ka bërë edhe shpronësime përkatëse duke formuar kështu një fashë të rezervuar për kalimin e saj. Gjithashtu, duke pasur parasysh që tashmë rrjeti kombëtar i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike është lidhur dhe është pjesë e një rrjeti më të gjerë ballkanik-rajonar dhe si rrjedhim përveç kësaj rregulloreje duhen respektuar edhe parashikimet e normave ndërkombëtare në këtë aspekt.

Varrezat

Sipas VKM Nr. 712, dt. 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë” jepen normat dhe rregullat e projektimit, të çdo elementi përbërës të varrezave, për ndërtimin dhe funksionimin e tyre. Sipa përcaktimeve të kësaj rregulloreje, territori i varrezës duhet të kufizohet nga zonat e banuara, nëpërmjet zonës së rezervuar. Zona e rezervuar përcakton distancën minimale nga kufiri i fushës së varrimit deri tek kufiri i zonës së banuar ekzistuese, ose të planifikuar në planet e përgjithshme vendore të bashkive përkatëse. Zona e rezervuar konsiston në një sipërfaqe të mbjellë me drurë dhe gjelbërime, ku nuk lejohet ndërtimi i objekteve të reja, apo zgjerimi i atyre ekzistuese. Në të mund të parashikohet vetëm ndërtimi i parkimeve, ose i objekteve në shërbim të varrezave. Distancat që duhen respektuar janë:

- për qendrat e banuara, me popullsi > 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 100m,

- për qendrat e banuara me popullsi < 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 ml.

Gjithashtu në VKM nr.671, date 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Kreu IV - Standarde dhe tregues planifikimi, (seksioni 2 dhe 3), parashikohen një seri rregullash dhe specifikimesh për përcaktimin e fashëve dhe zonave buferike për element të ndryshëm territorial. Këto norma dhe përcaktime, pavarësisht se nuk janë paraqitur këtu, do konsiderohen rigorozisht në procesin hartimit të PPV-së bashkisë Vau-Dejës.

Në këtë dokument të analizës së territorit të bashkisë Vau-Dejës, janë trajtuar edhe disa nga rreziqet kryesore (natyrore) të cilat ndikojnë si në gjendjen ekzistuese të zonave urbane ashtu edhe në procesin e planifikimit. Ndër ato më me ndikim përmendim, rreziku hidrologjik (përmbytjet), aktiviteti sizmik (tërmetet), rrëshqitjet e tokave etj. Harta të veçanta “tematike” janë përgatitur për këto rreziqe natyrore të cilat direkt ose indirekt përfaqësojnë element përjashtues të zhvillimit urban. Gjithsesi duhet theksuar që zhvillimi në këto zona nuk është i pamundur por kostoja e ndërtimeve dhe e urbanizimit rritet ndjeshëm duke pasur parasysh faktin që gjatë projektimit dhe procesit të ndërtimit duhen marrë masa shtesë për zbutjen e rrezikut përkatës që cënon cilësinë e jetës së banorëve dhe shërbimet bazë të nevojshme.

3 Skanimi i territorit dhe vlerësimi

3.1 Vështrim i përgjithshëm

Bashkia e re Vau Dejës ndodhet në Qarkun e Shkodrës dhe shtrihet në pjesën veriore të vendit. Qendra më e madhe e afërt urbane është qyteti i Shkodrës, vetëm 20 km larg; ndërsa largësia nga Tirana, kryeqyteti i vendit është 92 km. Bashkia kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e bashkisë është qyteti i Vaut të Dejës.

Bazuar në Reformën Territoriale, miratuar me Ligji 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Vau-Dejës, Temal dhe Shllak. Bashkia ka nën administrim 47 fshatra dhe një qytet. Njësia administrative Bushat ka numrin më të lartë të fshatrave (14 fshatra), i cili vijohet nga Temal (10 fshatra). Njësitë administrative Vig Mnelë dhe Hajmel kanë një numër shumë të vogël të fshatrave, respektivisht tre dhe pesë. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Shkodër të Qarkut Shkodër.

Bashkia Vau-Dejës përbëhet nga gjashtë njësi administrative të rrethit Shkodër, të cilat janë:

Tabela 4: Njësitë administrative, zonat urbane dhe qendrat e banuara

Bashkia	Njësitë administrative	Nr. Zonave urbane	Qytetet dhe Fshatrat
Bashkia Vau-Dejës	Vau-Dejës	(1) Qytet (8) Fshatra	Qytetet: Vau Dejes, Fshatrat: Mjedë, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe
	Bushat	(14) Fshatra	Fshatrat: Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten
	Vig-Mnele	(3) Fshatra	Fshatrat: Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig
	Hajmel	(5) Fshatra	Fshatrat: Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë
	Temal	(10) Fshatra	Fshatrat: Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Killogjen, MalagjiKajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë
	Shllak	(7) Fshatra	Fshatrat: Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj
Total	6 Njësi administrative	48 zona urbane	



Fig. 8: Qendrat e banuara (qytete/fshatra) të Bashkisë Vau-Dejës

Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 468 km². Densiteti i popullsisë llogaritet të jetë 35.1 banorë për km² në bazë të të dhënave të Censurit 2011. Njësia administrative e Temalit ka sipërfaqen më të madhe të territorit ndërsa Hajmeli shtrihet në vetëm 31 km², duke përfaqësuar njësine administrative me sipërfaqe më të vogël të bashkisë.

Kufiri territorial i bashkisë Vau Dejës, i referuar në këtë dokument dhe në gjithë materialin grafik, është ai i miratuar Ligjin nr. 115/2014, dt. 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (marrë nga AKPT).

Duke marrë në konsideratë ankesat dhe pretendimet e disa bashkive në lidhje me kufijtë territorialë, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore ka udhëhequr një proces negociimi dhe koordinimi me gjithë bashkitë e reja me qëllim saktësimin e tyre. Duke

pasur parasysh dhe pretendimet e bashkisë Vau Dejës në këtë proces, kompania konsulente është në kontakt të vazhdueshëm me AKPT dhe institucione të tjera që udhëheqin procesin, me qëllim reflektimin e saktë të kufirit territorial, duke mbajtur në konsideratë gjithmonë dhe aspektin ligjor të kësaj problematike.



Fig. 9: Njësitë administrative të Bashkisë Vau-Dejës

Tabela 5: Sipërfaqet e njësive administrative

Njësitë administrative	Bushat	Vig Mnelë	Temal	Shllak	Hajmel	Vau-Dejës	Total
Sipërfaqja (km ²)	99	73	101	72	31	99	475

Më poshtë janë treguar distancat e qytetit të Vaut të Dejës nga qendrat administrative kryesore të vendit dhe rajonit:

- 20 km nga Shkodra
- 35 km nga Lezha
- 40 km nga Velipoja
- 44 km nga Porti i Shëngjinit
- 47 km nga Ulqini
- 69 km nga Podgorica
- 80 km nga Aeroporti Rinasit
- 94 km nga Tirana

- 105 km nga Durrësi (Porti i Durrësit)
- 147 km nga Kukësi
- 220 km nga Porti i Vloës
- 261 km nga Prishtina

E veçantë për këtë Bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, një pjesë e konsiderueshme e të cilit gjendet brenda territorit administrativ të Bashkisë; lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shpëputet nga lumi i parë, rreth 1km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vau-Dejës punonin në Hidrocentral, në Fabrikën e Përpunimit dhe Pasurimit të bakrit si dhe në kooperativat bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në aktivitetet e vogla ekonomike si shërbime dhe tregëti, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau-Dejës si dhe përgjatë rrugës kryesore kombëtare Shkodër Pukë.

Pjesa perëndimore e territorit të bashkisë përfshihet në rajonin e Zadrimës. Rajoni i Zadrimës është një nga rajonet më të njohura të Shqipërisë: fusha e Zadrimës me toka pjellore e prodhimtari të lartë bujqësore; popullsia e zonës me traditat dhe zakonet zadrimore, veshja e tyre karakteristike, prodhimet e tyre të bukura artizanale me motivet karakteristike zadrimore. Rajoni i Zadrimës është i njohur për figurat e shquara të letërsisë dhe kulturës shqiptare si: F. Bardhi, P. Zarishti, N. Mjeda, Gj. Fishta, Gj. Gjadri. Zadrima është e pasur me monumente historike që dëshmon për lashtësinë e kësaj zone dhe historinë e saj.

Pozicionimi i bashkisë përgjatë rrugës Shkodër Pukë – Kosovë e ka identifikuar Vau-Dejës si një portë hyrëse në drejtim të Kosovës, duke identifikuar nevojën për të studiuar dhe trajtuar korridorin rrugor kryesor Mjedë Vau-Dejës, si dhe rristurimin urban të territoreve të banuara në këtë segment.

Ndërtimi i autostradës Durrës – Kukës – Morinë, i cili ka shkurtuar ndjeshëm kohën e transportit midis zonës Verilindore dhe Kosovës me korridorin qendror të zhvillimit Tiranë Durrës, ka sjellë edhe zhvlerësimin e rrugës Shkodër - Pukë - Kukës.

Ky problem duhet adresuar me kujdes në PPV me synimin për të krijuar një kontekst vizionar në lidhje me zhvillimin e Vaut të Dejës, si pjesë integrale e rajonit verior të Shqipërisë.

Një komponent i rëndësishëm në Strategjinë Rajonale Shkodër Lezhë është krijimi dhe konsolidimi i një Rajoni Policentrik, duke u fokusuar në këtë mënyrë jo vetëm në Shkodër, por edhe në qytezat satelite, si Vau-Dejës e Bushati apo në qendrat e tjera më të vogla. Për këtë arsye është e nevojshme që qyteza të tilla, të eksplorojnë mundësitë më të mira për të thithur një pjesë të konsiderueshme të fluksit të migrimit nga zonat e thella në lindje drejt fushëgropës së Shkodrës. Në këtë mënyrë, do të tentohet kalimi drejt zhvillimit të “tregut” të popullsisë, dhe rrjedhimisht të krahut të punës në këtë bashki, element ky vendimtar në zhvillimin ekonomik dhe social të një qendre të banuar.

E parë në këtë kontekst afërsia e bashkisë dhe e qytetit të Vaut të Dejës me qytetin e Shkodrës konsiderohet si një potencial shumë e mirë për akomodimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, në shërbim të qendrës urbane të rajonit, duke vënë në shfrytëzim sa më eficient burimet natyrore dhe njerëzore të Bashkisë Vau-Dejës.



Fig. 10: Pozicioni rajonal dhe strategjik i Bashkisë Vau-Dejës

Bashkia Vau-Dejës paraqet shtrirje jouniforme të shërbimeve publike si edukimi, shëndetësia dhe aktivitete të jetës sociale, kulturore dhe sportive. Bazuar në dinamikat e lëvizjes së popullsisë për të siguruar këto shërbime bazë, qyteti i Vaut të Dejës përbën qendrën e jetës komunitare për gjithë njësitet administrative të bashkisë. Shtrirja jouniforme e shërbimeve bazë, nga njëra anë ka krijuar komunitete lokale të marxhinalizuara (veçanërisht në njësitet Vig Mnelë, Temal e Shllak) dhe nga ana tjetër, rritjen e presionit në Vau-Dejës për të ofruar shërbime që tejkalojnë popullsinë e qytetit.

Popullsia e bashkisë arrin në 30,438 banorë (Census 2011). Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, popullsia raportohet të jetë 49,399 banorë (Rregjistri Civil 2015). Njësitet administrative të Bushatit dhe Vau Dejës kanë numrin më të lartë të popullsisë rezidente për njësi. Vetëm në Bushat jeton 46% e popullsisë së bashkisë, ndërsa popullsia që jeton në Bushat dhe Vau Dejës përbën 73% të popullsisë totale të bashkisë. Katër njësitet e tjera administrative kanë numër shumë të vogël të popullsisë; popullsia totale e tyre përbën vetëm 27% të popullsisë së bashkisë.

Ekonomia e bashkisë është bujqësore mikse, malore dhe me drejtim energjetik. Ndryshe, mund të thuhet se në sektorin e bujqësisë janë të përfshirë 65-85% e të punësuarve, ndërsa sektori energjetik punëson më shumë se 5% e forcës punëtore.

Bashkia e Vau Dejës ka një sërë avantazhesh që krijojnë kushtet ideale për një zhvillim ekonomik dhe mirëqenie të popullatës lokale. Bushati dhe qyteti i Vau Dejës përfaqësojnë qendrat zhvillimore të bashkisë dhe më gjerë për shkak të potencialeve të tyre për zhvillim. E ndodhur në rrugët kryesore që lidhin vendin tonë me vendet fqinje dhe që shërbejnë si rrugë kalimi mes vendeve fqinje (Mal i Zi, Kosovë), si dhe e shtrirë gjeografikisht mes dy qendrave më të zhvilluara të veriut të vendit (Shkodrës dhe Lezhës) i japin bashkisë Vau-Dejës avantazh konkurrues në krahasim me qendra të tjera më të vogla të veriut.

Përveç këtij avantazhi gjeografik të bashkisë, zhvillimi ekonomik është lehtësuar dhe mbështetet edhe nga infrastruktura e përmirësuar rrugore, ku përmendim rrugën kombëtare Tiranë-Shkodër, që kalon përmes kësaj zone si dhe përkatësisht tre rrugë rajonale që lidhin qytetin e Shkodrës me qytetin e Lezhës, të cilat janë të një niveli të mirë. Linja hekurudhore kombëtare Tiranë-Shkodër që kalon në territorin e bashkisë, ndonëse në gjendje të amortizua, mbetet një potencial i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, sidomos në aspektin e transportit hekurudhor të mallrave. Kjo linjë është edhe e vetmja linjë hekurudhore që lidh Shqipërinë me vendet e tjera.

Bazuar në akumulimet e sipërmarrjeve ekonomike dhe në tendencat e sotme të zhvillimit, Bushati dhe Vau-Dejës përcaktohen si dy qendrat e zhvillimit ekonomik bashkisë. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik i njësive të tjera më të vogla administrative si Vig Mnele, Hajmel, Temal dhe Shllak paraqitet i ndërlidhur dhe i ndërvlarur me zhvillimin e dy qendrave Bushat dhe Vau-Dejës.

Konteksti ekonomik i Bashkisë përfaqësohet nga një ekonomi mikse, me prirje në disa sektorë si bujqësia, blegtoaria, shërbimet, dhe industria energjetike. Megjithatë, ekonomia lokale dominohet nga bujqësia dhe është një ekonomi tipike rurale. Bujqësia përbën drejtimin kryesor ekonomik të popullatës (me një peshë specifike të vreshtarisë

dhe frutikulturës) si dhe blegtoria. Industria energjitike dhe potencialet ekzistuese të erës dhe të ujit ofrojnë mundësi reale të rritjes ekonomike lokale dhe rajonale. Këto dy sektorë paraqesin edhe burimet më të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik lokal dhe në planin rajonal marrin një domethënie të veçantë.

Njësitë administrative të Temalit dhe Shllakut, duke u gjendur në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës, ndodhen të veçuara me pjesën tjetër të bashkisë. Për më tepër që lidhja historike me bashkinë e re nuk ka qenë e fortë. Për sa i përket zhvillimit ekonomik, këto njësi nuk janë po kaq të avantazuara sa njësitë e tjera të bashkisë për të nxitur një zhvillim ekonomik lokal. Infrastruktura tepër e dobët rrugore që lidh këto njësi me zonën më të afërt urbane dhe mungesa e tokave bujqësore ka ndikuar negativisht në zhvillimin lokal. Aksesit i ulët në shërbimet bazë në këto komunitete, dhe aksesit i vështirë në tregjet lokale e bën popullatën e Temalit dhe Shllakut me mundësira shumë të kufizuara për të diversifikuar ekonominë lokale.

Në bashki ka zhvillim edhe sektori i prodhimit të energjisë për shkak të potencialeve të jashtëzakonshme ujore që ka territori. Për këtë arsye, Vau-Dejës bën pjesë në fashën kombëtare energjitike të vendit tonë - tre liqenet (Vau Dejës, Fierzë, Koman). Hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit, përbëjnë edhe veprat e prodhimit të energjisë elektrike.

Ekzistenca e industrisë energjetike, potenciali ekzistues energjetik i ujit dhe i erës mund të vendosen në një kontekst të tillë përdorimi dhe menaxhimi në favor të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të bashkisë Vau-Dejës por edhe të gjithë Rajonit të Shkodrës.

Turizmi përfaqëson një drejtim ekonomik të rëndësishëm me shumë potencial në të ardhmen. Bashkia e Vaut të Dejës ka potenciale të jashtëzakonshme për të nxitur zhvillimin e turizmit si një mundësi për rritjen ekonomike të popullatës lokale.

Potencialet për zhvillimin e turizmit lidhen më burimet e mëdha të zonës të cilat janë të shumëllojshme (historike, kulturore, natyrore, etj.).

Territori i Bashkisë është i pasur me monumente historike të cilat mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Ndër to përmëdim: Kalaja e Danjës, Kalaja e Shurdhahut, Kalaja e Qytezës, Kalaja e Dalmacisë. Gjithashtu, ndodhen një sërë kishash të vjetra dhe objekteve fetare me shumë interes për t'u vizituar.

Pejsazhet panoramike të tilla si kodrat dhe malet me një bukuri natyrore të veçantë, shëtitjet me varka në liqen apo plazhet buzë liqenit, fshatrat e vendosura në kodrat e bukura dhe të buta të zonës, ushqimet lokale bio dhe gatimet tradicionale e kthejnë Vaut të Dejës në një territor të përshtatshëm për agroturizëm.

Bashkia paraqet një zonë të pasur etnografike. Etnografia e Zadrimës, Mirditës, Malësisë së Madhe dhe pjesa e qytetit janë pjesë e mozaikut të pasur të trashëgimisë kulturore, historike dhe shpirtërore të bashkisë.

Prodhimet artizanale përfaqësojnë një drejtim tjetër angazhimi ekonomik në zonë që përbëjnë një vlerë të shtuar për turizmin. Në këto aktivitete janë përfshirë gratë dhe vajzat. Punimet në tezgjah, ato të dorës dhe të qeramikës kanë rizgjuar traditën e vjetër të prodhimeve artizanale.

Një komponent që duhet marrë në konsideratë në lidhje me propozimet e Strategjisë së Zhvillimit Shkodër Lezhe është zhvillimi i turizmit natyror dhe turizmit të përkrahur. Në rastin e Bashkisë Vau-Dejës, është e rëndësishme të merret në konsideratë potenciali që kjo zonë ka, duke pasur parasysh zhvillimin e turizmit ujor, apo edhe agroturizmit. Propozimet në Strategjinë lokale në Vaun e Dejës duhet të trajtojnë pikërisht mundësinë e shfrytëzimit të këtyre potencialeve, duke krijuar kështu oportunitete të tjera për rritje dhe zhvillim.

Papunësia përbën një nga problemet kryesore për popullatën vendase. Shkalla e papunësisë për bashkinë paraqitet shumë më e lartë se mesatarja e papunësisë për vendin tonë. 43.9% është indeksi i papunësisë për bashkinë, kur mesatarja për vendin e këtij treguesi është 29.2%. Papunësia e lartë shpjegohet kryesisht nga numri i ulët i bizneseve.

Territori i bashkisë Vau-Dejës karakterizohet nga burime ujore të konsiderueshme, lumenj, liqene, rezervuare dhe përrenj. Liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës përbën sipërfaqen më të madhe ujore. Në territorin e bashkisë kalojnë lumi Drin dhe Gjadër dhe një rezervuar me sipërfaqe 2500 ha ndodhet në Vaun e Dejës. Për shkak të këtyre potencialeve të jashtëzakonshme ujore, Vau-Dejës përfaqëson edhe fashën kombëtare energjetike të vendit tonë.

Burimet e shumta ujore të territorit të bashkisë, ngrenë më të madhe edhe rëndësinë e menaxhimit të tyre duke marrë parasysh regjimin e çrregullt të ujit në këtë zonë. Për më tepër, rastet e përmytjeve të dekadës së fundit kërkojnë vëmendje për çështjen e menaxhimit të burimeve ujore.

Përsa i përket shërbimeve bazë si edukimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive lëvizja e popullsisë për të aksesuar ato është e orientuar drejt dy qendrave më të madhe të bashkisë: Vau-Dejës dhe Bushat. Vau-Dejës ka dy shkolla të mesme ndërsa në Bushat tre, duke përfshirë këtu edhe një shkollë të mesme profesionale. Të rinjtë nga njësia e Temalit, Shllakut, Vig Mnelë udhëtojnë drejt këtyre shkollave, për shkak të mungesës së shkollave të mesme në këto njësi.

Shkolla e mesme profesionale "Ndre Mjeda", Bushat, një shkollë kombëtare e çelur më 2013 përbën një vlerë të shtuar për zhvillimin ekonomik të territorit, veçanërisht bujqësisë. Shkolla ofron arsimim dhe formim profesional në veterinar, teknologji ushqimore, bujqësi, ekonomi bujqësore. Edhe pse e çelur rishtas, kjo shkollë ka një traditë të konsoliduar në edukimin bujqësor, duke qenë se fillesat e saj datojnë herët, që në 1972 kur shërbente si shkolla e Mekanikës bujqësore për rajonin e veriut.

Përsa i përket shkollave 9 vjeçare ato nuk paraqesin problem në lidhje me shpërndarjen e tyre në territor, por në lidhje me infrastrukturën fizike e cila në disa raste vlerësohet si emergjente për ndërhyrje. Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shkolla e kopshte, ku prioritet mbetet ngrohja, transporti i nxënësve në zonat e largëta dhe lirimi i hapësirave publike në oborret e shkollave janë nga çështjet më kritike për t'u adresuar.

Në lidhje me shërbimin shëndetësor, ai ofrohet nga 30 qendra shëndetësore dhe ambulanca të shpërndara sipas njësive administrative.

Objektet social-kulturore e sportive janë mjaft të pakta në numër dhe të përqendruara vetëm në dy njësi; Vau-Dejës dhe Bushat.

Në përgjithësi, gjendja e rrugëve rajonale paraqiten e mirë dhe pjesa më e madhe e tyre është e afaltuar. Rrugët lokale, në masën më të madhe janë të paasfaltuara. Problematike mbeten rrugët lidhëse me njësinë e Shkllakut dhe Temalit ku gjendja paraqitet mjaft e keqe.

Shërbimi i pastrimit në bashki është një shërbim funksional dhe është një praktikë e suksesshme për vendin tonë. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet instrumentit të bashkëpunimit ndërvendor, instrument i konsoliduar mes disa njësive vendore në rajon që përpara reformës territoriale. Ndërkomunalja e Zadrimes lehtëson ofrimin e shërbimit për një pjesë të madhe të territorit të bashkisë Vau-Dejës. Mbetjet organike, bimore apo shtazore, kompostohen pranë shtëpive me qëllim ripërdorimin e tyre për pleh për kulturat bujqësore, ndërsa mbetjet inerte depozitohen në vendpozitime të caktuara. Një organizim i tillë ka ulur ndjeshëm kostot e depozitimit dhe transportimit të mbetjeve. Megjithatë, ende ky shërbim nuk ofrohet në të gjithë territorin, si në Temal e Shllak.

Aktualisht, në territorin e bashkisë, në Bushat, gjendet edhe landfilli i grumbullimit të mbetjeve urbane, që ka një periudhë shërbimi për 20 vjet.

3.1.1 Metabolizmi urban

Të dhënat e mbledhura mbi territorin do të vlerësohen dhe analizohen në vijimësi (gjatë fazës së hartimit të strategjisë territoriale) në përputhje me parimet e metabolizmit urban si një metodologji komplekse për kuptimin e territorit dhe përbërësve të tij.

Sipas përcaktimeve të VKM 671 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të territorit”, analiza metabolike është pjesë e hartimit të strategjisë territoriale të PPV dhe një model për analizën dhe identifikimin e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Në një vështrim të përgjithshëm, qyteti shihet si një organizëm i gjallë që ka nevojë për energji dhe burime për të funksionuar dhe që nga funksionimi i tij prodhohen mbetjet. Modeli krijon mundësinë e studimit të ndërveprimit midis sistemeve natyrore dhe njerëzore në një rajon. Kjo qasje studion flukset në territorin urban dhe zhvillohet përmes identifikimit të hyrjeve dhe daljeve kryesore në sistemin urban. Metabolizmi mund të përcaktohet si tërësia funksionale e proceseve sociale, ekonomike dhe teknike që ndodhin në qytete, si pasojë e rritjes së tyre, prodhimit të energjisë si dhe asgjësimit të mbetjeve. Ky është në thelb një bilanc i ndikimit të qytetit në mjedis që përcakton masa përmirësuese apo neutralizuese të ndikimit negativ. Praktikisht, metabolizmi i një sistemi urban është një përmbledhje e numrit të hyrjeve dhe daljeve (input-output) dhe mënyrës së përdorimit të ujit, energjisë, ushqimit, mbetjeve etj. në të.

Hyrjet në sistemin urban (toka, uji, ajri, energjia, burimet e tjera) ndryshojnë pasi kalojnë në të, duke u transformuar në dalje (mbetje dhe shkarkime në ajër, ujë dhe tokë). Nëpërmjet analizës kryhet bilanci i burimeve natyrore të shfrytëzuara (hyrjet),

mënyrës së përdorimit të tyre dhe ndotjeve e humbjeve që shkaktohen në sistemin urban (daljet). Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që mundësojnë funksionimin e territorit si një i tërë.

Metabolizmi konsiderohet si një proces dinamik fluksesh në një vend të dhënë, në një moment të dhënë, në një stad të dhënë të zhvillimit urban, dinamikë e cila shpjegohet me konceptin e vazhdimësisë ekologjike. Me "vazhdimësi ekologjike" kuptohen proceset e ndryshimeve në strukturën e specieve të një bashkësie ekologjike përgjatë kohës; ky proces varet nga kushtet klimatike, toka dhe ndërhyrjet njerëzore.

3.1.2 Topografia dhe klima;

Bashkia e Vau-Dejës bën pjesë në Qarkun e Shkodrës, me distance 20 km nga Shkodra, 92 km nga Tirana dhe 81 km nga Aeroporti i Rinasit. Ajo ka një sipërfaqe prej 496 km² ku 11677 ha janë tokë bujqësore. Bashkia e Vau-Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkitë Shkodër dhe Tropojë, në lindje me bashkitë Fushë-Arrëz dhe Pukë ndërsa në jug me bashkinë Lezhë.

Bashkia Vau-Dejës shtrihet midis gjerësive gjeografike: 42° 15' 4.6368" N – veri, 41° 52' 51.189" N – jug dhe midis gjatësive gjeografike 19° 53' 54.2112" E – lindje, 19° 25' 39.165" E – perëndim.



Fig. 11: Pozita gjeografike e Vau-Dejës

Vau-Dejësi është i vetmi qytet në këtë bashki. Ai pozicionohet në pjesën veriore të Zadrimës, në ndërprerjen e lumit Drin dhe Gjadër dhe shtrihet përgjatë rrugës nacionale që lidh Shkodrën me Pukën dhe ndodhet rreth 20 km nga deti Adriatik.

E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, që përbën një pasuri natyrore të vlefshme për zonën, ku dominojnë liqeni i Vaut të Dejës, liqeni i Komanit, lumi Drin dhe lumi Gjadër. Mbi lumin Drin janë ndërtuar disa hidrocentrale si: hidrocentrale i Vau-Dejës, i Komanit, si dhe Ashta 1 e Ashta 2.

Territori i bashkisë është i larmishëm, me një reliev kryesisht fushor në pjesën jug-perëndimore dhe malor në pjesën veri-lindore. Duke filluar nga mali i Kakarriqit i cili shërben edhe si një kufi natyror me bashkinë e Lezhës me pikën e tij më të lartë maja

e Kamberit (392 m), kodra e Zefjanës (249 m), kodra e Melgushës (162 m) kodra e Barbullushit (79 m), kodra Plezhë-Shkjezë (kodra e Hoxhës 100 m - Kodërlec 78m), maja e Shitit 614 m në vargun jug-lindje (pjesë e njësisë administrative Vig-Mnelë), duke vazhduar me kodrën e Dushkakuqit (256 m), malin e Bardhë (323 m), mali i Laçit (367m), mali i Bokes (464 m) maja e Gzhoprës (846m) në pjesën qendrore të territorit. Pjesa veri-lindore e bashkisë dallohet kryesisht për terrenin e thyer malor, maja e Zbuçit 835 m, e Darcit (944 m), e Mëgullës (955 m), e Vilës 1514 m, për të arritur në majën e Cukalit me lartësinë më të madhe mbi nivelin e detit 1721 m.



Fig. 12: Mali i Cukalit 1722 m (Burimi: <httpwww.panoramio.com>)




Fig. 13: Harta topografike e Vau-Dejës

Një rëndësi të madhe në këtë territor ka edhe ultësira e Zadrimës, e cila është e vendosur në anën lindore të malit të Kakarriqit dhe të kodrave Barbullush-Bushat-Bërdicë deri në anën perëndimore të vargmaleve të Velës, Kreshtës, Shitës dhe të Bokave të Naraçit. Në jug kufizohet me qytetin e Lezhës, ndërsa në veri me lumin Drin.

Ajo ka shtrirje në dy qarqe veriore të vendit, Shkodër (Bushat, Vau i Dejës, Hajmel) dhe Lezhë (Dajç dhe Blinisht). I gjithë rajoni shtrihet në një sipërfaqe rreth 349 km², ku sipërfaqja më e madhe e tij ndodhet në qarkun Shkodër (68% e territorit) dhe vetëm 32% në qarkun e Lezhës.



Fig. 14: Ultësira e Zadrimës

3.1.2.1 Veçoritë e përgjithshme klimatike

Në përputhje me rajonizimin klimatik të territorit të Republikës së Shqipërisë, zona ku shtrihet territori i Bashkisë Vau-Dejës, bën pjesë në zonën me klimë mesdhetare fushore. Veçoria bazë e përgjithshme klimatike e kësaj zone janë dimrat e butë dhe të lagët dhe vera të nxehta e të thata.

Në kuadrin e elaborimit të PPV, përveç veçorive të përgjithshme klimatike të zonës, është kryer dhe vlerësimi i detajuar i elementëve meteorologjikë kryesorë dhe të rëndësishëm. Ky vlerësim është bazuar në analizën e informacionit shumëvjeçar arkival të vendmatjeve meteorologjike, si stacioni meteorologjik i Bushatit, Shkodrës dhe Lezhës




Fig. 15: Harta e zonave klimatike

3.1.2.2 Rrezatimi diellor

Energjia diellore, e shprehur nëpërmjet rrezatimit diellor dhe diellzimit, studiohet jo vetëm për rëndësinë e saj, si një ndër faktorët kryesorë klimëformues, por edhe si një element me vlera të veçanta që ndikon konsiderueshëm në procese e dukuri biokimike. Për këtë arsye, bazuar në trajtimin e të dhënave shumëvjeçare të rrezatimit të përgjithshëm diellor dhe diellzimit është vlerësuar shpërndarja brendavjetore e sasisë së energjisë diellore (në pjesën valëshkurtër të saj), e orëve me diell si dhe pjesa ultraviolete e energjisë diellore. Nga kjo analizë, rezulton se sasia vjetore e rrezatimit të përgjithshëm diellor që merr kjo zonë është mjaft e lartë. Konkretisht, gjatë një viti sasia e këtij rrezatimi arrin vlerën 1.486 kWh/m^2 . Sasia e nxehtësisë që merr sipërfaqja horizontale e kësaj zone paraqet një variacion brendavjetor të shprehur qartë me një maksimum në muajt e verës dhe një minimum në muajt e dimrit (Figura 1). Nga shpërndarja brendavjetore e rrezatimit diellor, rezulton se vlera më e lartë arrihet në korrik ($6.735 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$), ndërsa më e ulëta në dhjetor ($1.565 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$).

Një komponent i rëndësishëm i rrezatimit të përgjithshëm diellor është edhe energjia e ardhur në diapazonin spektral që i përket rrezatimit ultraviolet. Energjia e ardhur në këtë diapazon spektral ka ndikim të veçantë në proceset e dekompozimit të mbetjeve urbane. Ashtu si dhe rrezatimi i përgjithshëm diellor, edhe rrezatimi UV paraqet një ecuri brendavjetore të shprehur qartë, me një maksimum në muajt e verës ($350 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$) dhe një minimum në muajt e dimrit ($63 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$).

Forma pothuajse sinusoidale e shpërndarjes brendavjetore e energjisë diellore, përveç të tjerash, shpreh efektin e lidhjes së drejtpërdrejtë me ecurinë vjetore të diellzimit (të orëve me diell). Diellzimi është një tregues tjetër i rëndësishëm i cili plotëson kuadrin e vlerësimit të sasisë së energjisë që merr sipërfaqja e tokës. Edhe në bazë të këtij treguesi, kjo zonë karakterizohet nga vlera të larta. Mesatarisht gjatë vitit, kjo zonë merr rreth 2.492 orë me diell. Sasia më e madhe e orëve me diell arrihet në korrik (350 orë) dhe ajo më e ulët në janar (104 orë). Në figurën në vijim jepet shpërndarja brendavjetore e diellzimit për këtë zonë.




Fig. 16: Shpërndarja brendavjetore e rrezatimit të përgjithshëm diellor dhe rrezatimit UV




Fig. 17: Ecuria brendavjetore e diellzimit

3.1.2.3 Temperatura e ajrit

Evidentimi i veçorive të regjimit termik të zonës në fjalë është kryer nëpërmjet shqyrtimit të disa prej treguesve kryesorë klimatologjikë të temperaturës së ajrit, si temperatura mesatare, temperatura maksimale, temperatura minimale, numri i ditëve me temperaturë mbi apo nën një prag të dhënë, që kanë kontribut të dukshëm në zhvillimin dhe intensifikimin e dukurive dhe proceseve biofizike në mjedis të caktuar. Temperatura mesatare vjetore e ajrit në këtë zonë është relativisht e lartë, prej 14.7 °C. Ndërkohë duhet të vëmë në dukje që temperatura mesatare e ajrit ndryshon në

mënyrë të konsiderueshme duke kaluar nga një stinë në tjetrën. Për të evidentuar këtë fakt, në figurën në vijim, jepet shpërndarja brendavjetore e temperaturës së ajrit.




Fig. 18: Ecuria brendavjetore e temperaturës së ajrit

Siç shihet edhe nga ky grafik, ecuria brendavjetore e temperaturës karakterizohet nga një kurbë me formë të funksioneve trigonometrike, me një maksimum në muajt e verës, korrik/gusht dhe nga një minimum në muajt e dimrit, janar/shkurt. Muaji më i ftohtë për këtë zonë është muaji janar me temperaturë mesatare të ajrit 6.2 °C, ndërsa muaji më i ngrohtë është muaji korrik me temperaturë mesatare 24.2 °C.

Me interes për njohjen e regjimit të temperaturës së një zone është edhe shqyrtimi i temperaturave maksimale dhe minimale të ajrit ku rëndësinë më të madhe e kanë përkatësisht temperaturat mesatare maksimale dhe ato mesatare minimale. Për këtë arsye, në grafikun e figurës 3, bashkë me temperaturën mesatare të ajrit, janë paraqitur edhe kurbat e ecurisë vjetore për temperaturat mesatare maksimale e ato minimale.

Siç shihet, ecuria brendavjetore e këtyre temperaturave është krejtësisht e ngjashme me atë të temperaturës mesatare të ajrit. Konkretisht, temperatura mesatare e maksimumeve luhet nga 9.6 °C në muajin janar, deri në 30.4 °C në muajin korrik, ndërsa temperatura mesatare e minimumeve luhet përkatësisht nga 2.6 deri në 18.1 °C në korrik. Diferenca ndërmjet temperaturës mesatare maksimale dhe asaj mesatare minimale në fund të fundit shpreh shkallën e luhatjes së temperaturave gjatë ditës për një muaj të dhënë, apo e thënë ndryshe, amplitudën mesatare ditore të temperaturës për muajin përkatës. Në përgjithësi, vihet re një vlerë më e vogël e amplitudës së temperaturës gjatë muajve të dimrit në krahasim me ato të muajve të verës.

Një tregues tjetër, në regjimin e temperaturës është edhe vlera absolute e temperaturave ekstreme e vërtetuar në këtë rajon. Kështu, temperatura minimale absolute e kësaj zone është -10.0 °C, ndërsa temperatura maksimale absolute është 39.0 °C.

Janë evidentuar në mënyrë të veçantë ditët që karakterizohen nga këto temperatura. Konkretisht, numri i ditëve në të cilat termometri ka zbritur nën 0 °C është 24 ditë/vit, ndërsa numri i ditëve me temperaturë nën -5 °C është 9 ditë/vit. Në këtë zonë numri i

ditëve, në të cilat temperatura e ajrit, kalon kufirin prej 30 °C është 47 ditë/vit. Ndërsa numri i ditëve me temperaturë ekstremale mbi prapun 35 °C është mjaft i vogël, mesatarisht, jo më shumë se 5 ditë në vit.

3.1.2.4 Reshjet atmosferike

Në kuadër të evidentimit të veçorive të regjimit klimatik, reshjet atmosferike përbëjnë një ndër elementët më të rëndësishëm të tij. Në këtë zonë, reshjet atmosferike kanë një regjim të pastër mesdhetar, i cili karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit dhe një minimum në muajt e verës. Duhet shënuar që kjo zonë karakterizohet nga sasi e konsiderueshme reshjesh. Brenda një viti në këtë zonë bien mesatarisht 1528 mm reshje.

Në figurën në vijim është paraqitur shpërndarja brendavjetore e reshjeve që bien në këtë zonë. Ashtu siç u përmend edhe më lart, reshjet janë të përqendruara kryesisht në periudhën e ftohtë të vitit gjatë të cilës bien mesatarisht 66 % e reshjeve vjetore. Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor në të cilin bien mesatarisht 206 mm, ndërsa muaji më i thatë është muaji korrik në të cilin bien mesatarisht 35 mm.




Fig. 19: Shpërndarja brendavjetore e reshjeve atmosferike

Në kuadër të evidentimit të veçorive të regjimit të reshjeve atmosferike interes të veçantë paraqet dhe njohja e numrit të ditëve me shi (në praktikën meteorologjike ditë me shi konsiderohen ditët me reshje të matshme 0.1 mm). Në studimin konkret, janë marrë në konsideratë të dhënat shumëvjeçare të ditëve me sasi reshjesh mbi prapjet 1 mm dhe 10 mm. Në këtë zonë regjistrohen mesatarisht 96 ditë në vit me reshje që tejkalojnë 1 mm. Ndërkohë, në këtë zonë janë vrojtuar mesatarisht 47 ditë në vit ku sasia e reshjeve të rëna është më e madhe se 10 mm. Shpërndarja brendavjetore e vlerave të këtij treguesi, është e njëjtë me atë të sasisë së reshjeve të rëna. Pra, numri më i madh i ditëve me shi vrojtohet gjatë periudhës së ftohtë të vitit, ndërsa gjatë periudhës së verës numri i ditëve të tilla është shumë i vogël. Në muajin nëntor vrojtohen mesatarisht 12 ditë me reshje > 1 mm, ndërsa në muajin korrik vrojtohen mesatarisht vetëm 3 ditë të tilla.

Intensiteti me të cilin bien reshjet është një tjetër tregues i regjimit të reshjeve atmosferike, i cili paraqet interes për projektimin e veprave hidroteknike, veprave të trajtimit të efluentëve urbanë dhe depozitimit të mbetjeve urbane. Reshjet intensive bëhen shkak për intensifikimin e shplarjes së mbetjeve të depozituara dhe për funksionimin jo normal të veprave të trajtimit të ujit.

Sasia më e madhe e reshjeve të rëna brenda 24 orëve është treguesi bazë dhe më i rëndësishëm i cili përdoret jo vetëm në llogaritjet e ndryshme hidroteknike, por njëkohësisht ai shërben edhe për llogaritjen e intensitetit të reshjeve për intervale më të vogla kohore, në ato stacione ku nuk disponohen pluviografe. P.sh, zona e Bushatit karakterizohet nga vlera relativisht të larta të intensitetit të reshjeve. Madje në raste të veçanta ato arrijnë vlera mjaft të larta, si p.sh, në datën 23.09.1963, në Bushat kanë rënë 330 mm shi, etj. Prandaj njohja e vlerave të intensitetit të reshjeve me një siguri të dhënë do të shërbente jo vetëm për të siguruar funksionimin normal të veprave, por njëkohësisht do të shërbente edhe për përcaktimin e masave që duhen marrë në ruajtjen e ekosistemit të territorit të bashkisë. Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat e intensitetit të reshjeve për periudha të ndryshme përsëritjeje për intervale të ndryshme kohore.

Tabela 6: Intensiteti i reshjeve (mm) për disa intervale orare

Intervali (orë)	Periudha e përsëritjes (vjet)				
	100	50	20	10	5
24	246	222	190	166	140
12	223	200	169	146	121
6	203	183	157	137	115
3	143	129	111	97	82
1	59	53	45	40	33

3.1.2.5 Era

Njohja e karakterit të drejtimit dhe shpejtësisë së lëvizjes së ajrit mbi zonë dhe afër saj ka interes të madh në pikëpamje të studimit të ndikimit të veprave në zonën përreth. Në praktikën meteorologjike lëvizja e ajrit shprehet nëpërmjet elementit erë me treguesit e saj: drejtim dhe shpejtësi.

Siç dihet, era është një element që varet në mënyrë të konsiderueshme nga forma e relievit. Për këtë arsye, për të ndërtuar trëndafilin e erës për zonën territoriale të Bashkisë Vau-Dejës, u morën në konsideratë jo vetëm të dhënat arkiviale mbi këtë element në vendmatjet klimatologjike të Shkodrës dhe Lezhës, por edhe morfologjia lokale e relievit në vende të caktuara, si p.sh në zonën ku është ndërtuar venddepozitimi i mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Bushat, që ndikon konsiderueshëm në modifikimin si të shpejtësisë ashtu edhe të drejtimit të erës.

Ndërkohë, duke qenë se kjo zonë ndodhet në një distancë jo të madhe nga deti, është e kuptueshme që ndikimi i këtij të fundit luan një rol të konsiderueshëm në regjimin e erës. Konsideruar të gjithë faktorët e mësipërm janë ndërtuar trëndafilët e erës për 2 muajt karakteristike të vitit, muajin janar dhe muajin korrik. Me shikimin e parë, vërehet një ndryshim i theksuar ndërmjet trëndafilave të këtyre 2 muajve (Figura 5). Ndërsa

në muajin janar predominojnë erërat që fryjnë nga drejtimi i veriut dhe verilindjes, në muajin korrik predominojnë erërat që fryjnë nga kuadranti i perëndimit.




Fig. 20: Trëndafili i erës për dy muajt karakteristikë të vitit

Konkretisht, gjatë muajit janar, erërat që fryjnë nga drejtimi i veriut, kanë një rastisje prej 23 %, ato që fryjnë nga verilindja një rastisje prej 13 %. Duke ardhur nga brendësia e territorit, këto erëra bien masa ajrore të ftohta dhe për rrjedhojë krijojnë kushte për shfaqjen e temperaturave të ulta. Gjatë këtij muaji, rastisja e erërave që fryjnë nga kuadranti i perëndimit, është mjaft e vogël, duke arritur deri në 1 % të të gjitha rasteve.

Në muajin korrik, që pranohet si muaji përfaqësues për stinën e verës, rastisjen më të madhe e ka drejtimi i erës që fryn nga perëndimi me 13 % të rasteve dhe ai i jugperëndimit me 7 %. Megjithatë, rastisja e erës që fryn nga drejtimi i veriut dhe verilindjes në këtë muaj është përsëri i dallueshëm. Drejtimi i veriut ka një rastisje prej 9 %, ndërsa ai i verilindjes 5 %.

Një regjim i tillë i erës gjatë këtij muaji është rezultat i drejtpërdrejtë i ndikimit të brizës detare e cila gjatë ditës fryn nga deti për në tokë ndërsa gjatë natës nga toka në det.

Për studimin konkret ka vlerë të veçantë treguesi tjetër i lëvizjes së masave ajrore, ai i shpejtësisë së kësaj lëvizjeje. Shpejtësia mesatare vjetore e erës në këtë zonë është 2.5 m/s. Në muajin janar shpejtësia e erës arrin në 3.3 m/s, ndërsa në korrik 2.1 m/s. Një rastisje të konsiderueshme në këtë zonë ka edhe qetësia, apo rastet pa erë. Qetësia gjatë vitit zë rreth 48 % të të gjithë kohës.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë mbi rastisjen e shpejtësisë së erës, me poshtë po paraqesim një tabelë në të cilën jepet rastisja e erës me shpejtësi për pragje të ndryshme.

Tabela 7: Rastisja e erës sipas intervaleve

Intervali (m/s)	0 - 1	2 - 5	6 - 10	11 - 15	> 15
Rastet (%)	50	35	10	3	2

Siç shihet, edhe nga kjo tabelë, rastet më të shumta i takojnë intervalit 0 - 1 m/s (50 %), por në të njëjtën kohë, nuk janë të neglizhueshme edhe rastet me shpejtësi ere mbi 15 m/s. Këto raste përbëjnë 2 % të të gjithë kohës.

3.1.2.6 Problematika lidhur me kushtet klimatike

Kushtet klimatike të zonës së marrë në analizë, krijojnë disa probleme mjedisore, për shkak të ndryshueshmërisë të treguesve klimatikë midis zonave. Disa prej këtyre impakteve, si pasojë e vlerave ekstreme të elementëve të klimës, janë:

- Reshjet intensive shkaktojnë përmbytje, erozion të tokës, erozion të brigjeve të lumenjve, dëmtim të cilësive të tokës, vartësi të prodhimit bujqësor, vështirësi për kafshët dhe sektorin e blegtorisë.
- Temperaturat ekstreme dhe dëbora dëmtojnë infrastrukturën rrugore, erozion të shkëmbinjve në saj të alterimit nga ndryshimi i temperaturës, vonesa të proceseve bujqësore, kërkesa më të larta për ngrohje gjë e cila çon në rritjen e shkarkimeve të gazeve të ndryshme në mjedis.

Për të përballuar riskun e faktorëve ekstreme klimatikë si përmbytjet, zjarret, erozionin, menaxhimi kërkon:

- Planifikimin e masave, si vënia në efikasitet të plotë e sistemeve të kullimit, parandalimin e efekteve nga veprimtaritë ekonomike si menaxhimi i hidrocentraleve për të kryer shkarkime të parashikuara, masat për parandalimin e erozionit etj.
- Projektimin e rrugëve dhe ndërtesave duke marrë parasysh faktorët klimatikë për rritjen e qëndrueshmërisë nga dëmtimi.
- Ndërtimin e brezave të gjelbër mbrojtës nga era, veçanërisht në zonat tipike të erërave të Shirokës dhe Nënshkodrës. Brezat e gjelbër krijohen me kate të kombinuara të drurëve të lartë me brezin e shkurreve.

3.1.3 Gjeologjia inxhinierike;

3.1.3.1 Formacionet litologjike, inkuadrimi gjeologjik i tyre

Në territorin Bashkisë Vau-Dejës përfshihen segmente të zonave tektonike Krasta-Cukali, Kruja, Mirdite. Territori lindor dhe verior i Bashkisë Vau-Dejës Territori karakterizohet nga shkëmbinj te formacioneve karstike të Krast Cukalit si dhe shkëmbinjte magmatike te zonës Mirdita.

Shkëmbinjte mesatarisht te fortë, përfaqësohen nga flishi i zones së Krastës dhe më pak nga rreshpe argjilasilicore të serise efuzivo-sedimentare te zonës Mirdita. Dherat e ketyre zonave jane pa lidhje kohezionale, ndërkohe qe zhavorret e përroit të Gomsiqes karakterizohen nga ndërthurje te vogla dhe shume pak argjila.

Proceset gjeodinamike te kësaj zone karakterizohen nga një tektonike e tipit mbihipje dhe përfaqësohet nga ndërthurja e zonës Mirdita dhe Krasta-Cukal. Tektonika shkeputese është pak e zhvilluar. Rrëshqitjet janë karakteristike për formacionet flishore. Rrëshqitje masive janë evidentuar ne aksi e rrugës automobilistike Vau-Dejës -Koman sidomos ne zonën e Karmës. Erozioni është i formës sipërfaqësore. Erozioni

qe zhvillohet ne zonën e Gomsiqes ka bërë që liqeni i Vaut të Dejës te zvogëlojë sipërfaqen e tij nga prurjet e përrrenjve. Rrëzimi i gurëve si fenomen është vënë re në afërsi te urës se Gomsiqes dhe te shkollës se Karmës. Karsti shprehet në formën e fushës karstike në zonën e Shllakut.

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, ne sipërfaqe shfaqen shkëmbinj rrënjësore dhe dhera te kuaternarit te tipit mbulesor por që kane trashësi te tille qe nuk mund te neglizhohen gjate kryerjes se ndërtimeve ne fusheperhapjen e tyre. Sipas Konomi N.[Konomi N., 1998], kemi adoptuar një klasifikim gjeologo – litologo – inxhinierik (tabela në vijim) te shkëmbinjve dhe dherave.

Në këtë klasifikim shkëmbinjtë ndahen në tre grupe:

- shkëmbinj të fortë;
- shkëmbinj mesatare;
- shkëmbinj të butë.

Kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (R_{sh}).

Ndërsa dherat janë klasifikuar në tre grupe:

- dhera pa lidhje kohezionale
- dhera me lidhje kohezionale
- dhera me veti të veçanta

Kriteret e ndarjes së dherave, janë: kohezioni (c), (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse) dhe këndi i fërkimit të brendshëm (φ).

Më poshtë për secilën kategori (të shkëmbinjeve dhe dhereva) është bërë një përshkrim i shkurtër mbi pozicionin e tyre në lidhje me zonat tektoniko – faciale të përmendura më sipër dhe karakteristikat bazë fiziko mekanike.

Tabela 8: Klasifikimi gjeologo-litologo-inxhinierike i shkëmbinjëve dhe dherave

SHKËMBINJ TË FORTË			SHKËMBINJ MESATAR			SHKËMBINJ TË BUTË							
Lloji i shkëmbit	Simboli	Emërtimi	Lloji i shkëmbit	Simboli	Emërtimi	Lloji i shkëmbit	Simboli	Emërtimi					
Ultrabazikë	I_u	Harzburgite, Dunitë, Peridotite	Konglomerate e ranore me çimentim deri mesatar	K_i	Konglomerate e ranore të kuqërmenjta, lenda çimentuese hekuro-alevrollore. Sullta "Luma"	Depozitime të vjetra Kuaternare të padijagjenzuara plotësisht	D_e	Depozitime në trajtën e konuseve të vjetra prulivale					
	Bazikë	Gabro, Troktolite	Etuzivo-sedimentare	E_S	Vulkanite bazike (diabaze), me ndër-shtrësa silicore e reshpeesh argjilore	Kolluvione pjesërisht të çimentuara	C	Depozitime në trajtën e konuseve kolluviale					
Mesatar acid	I_{ma}	Dionitet, dionitet kuarcore, plaglio - granite, grano-dionite, granite	Flisheritnike shtrëse hollë argjilo-alevrollo-ranore	F_i	Ndërthurje argjilo-alevrollo-ranorike	Serperitinitë, millonite	M_S	Depozitime që ndryshojnë me daljen në sipërfaqe					
Bazikë	E_b	Llavat bazike, diabazet me pak çarje	Flish ranorik dhe ranore masive	F_r	Ndërthurje ranorësh masive me shtrëseza argjilo-alevritore. Ranore masive deri shtrëse trashë								
Mesatar acid	E_{ma}	Hialoandezite, keratofine kuarcore											
Metamorfike reshporë	R_m	Reshpe argjilo-silicore, filitike, reshpe alevrolitike	Evaporite	G	Gipse, anhidrite, kripe								
	GR	Gëlqerorë të rikristalizuara (mermerizuar), ndërthurur me reshpe argjilore	Argjilite masive	A_{rm}	Argjilite masive me ndërshtrësa të pakta ranore, të prekura nga procesi i diagjenizimit								
Gëlqerorë-reshporë	G	Gëlqerorë masive deri shtrëse trashë, shumë të karsiezuara në sipërfaqe të thellësi.	Mollasa argjilore	M_a	Argjila masive të Ultesies Frane Adriatike me veti plastike								
Gëlqeror	G_{Si}	Ndërthurje gëlqerore me ndërshtrësa silicore, me permbytje dhe material argjilor	Mollasa ranoro-konglomeratike	M_{rk}	Ranorë masive me çimentim deri mesa tar								
Gëlqeror dolomitikë	GD	Dolomitë shtrëse trashë deri masive, kompakte											
Brekcie, konglomerate fortësi të ndryshme	B	Brekcie dhe konglomerate me çimentim karbonatik të depozituara në vjetra Kuaternare											
Rezistenca në shtypje një-boshlore të			Rezistenca në shtypje një-boshlore të			Rezistenca në shtypje një-boshlore të							
Rrsh mbi 500 bar ($> 500 \text{ kg/cm}^2$)			Rrsh 50 - 500 bar ($50 - 500 \text{ kg/cm}^2$)			Rrsh më e vogël se 50 bar ($< 50 \text{ kg/cm}^2$)							
DHERA PA KOHEZION			DHERA MEKOHEZION			FORMIME ME VETI SPECIALE							
Lloji i dherave	Simboli	Emërtimi	Lloji i dherave	Simboli	Emërtimi	Lloji i dherave	Simboli	Emërtimi					
Formime të shkriftëta pa lidhje kohëzonale	R	Rrëz koker mesëm dhe pluhurore me gjenjeze eolotike (pjesa sipërfaqësore e shtrijës)	Formime të shkriftëta me lidhje kohësionale ($c > 0, f > 0$)	S	Surgjilat janë me gjenjeze eluviale, deluviale ose aluviale me ndërthurje lirzash surerash, suargjilash të lehta deri të rënda me ose pa lageshti varët nga niveli i un Konsistencës e forte deri plastike e butë deri plastike të miedhshme	Formime evaporitike me karst të zhvilluar	G_{rk}	Gipse, Anhidrite, Kripa gurt					
Rrëz k. mesëm		lunore, liqenore dhe delare, rrëz që shtrihen në nivelin e ujërave nën-lokësore të zonës bregdetare	Suargjilat e llojeve të ndryshme. Janë kryesisht pluhurore		Torfike, suargjila torfike	T			Torfat, suargjilat torfike				
Rrëz k. imet			Suargjila të vendosura mbi rrëz, shqetërojnë brezin e rrëzave bregdetar. Suargjila pluhurore mesatarisht të ngjeshura, plastike, plastike të buta		Lumo-argjilore					L_{Ar}	Lumet argjilore, Argjilat e kripura		
Rrëz pluhurore					Argjilat e kripura							R_p	Rrëz pluhurore
Rrëzë					Rrëz pluhurore me mundësi lëngëzimi								
Suargjilë pluhur													
Zhavoret e Poplat me origjinë aluviale dhe prulivale me trashësi $> 200 \text{ mm}$		Reshpe argjilo-silicore, filitike, reshpe alevrolitike											
Sipërme:	P	Gëlqerorë të rikristalizuara (mermerizuar), ndërthurur me reshpe argjilore	Surgjila të vendosura mbi zhavoret (Szh) ose mbi materialin copëzore deluvional (De). Në shpatë janë të paqëndrueshme	S_{zh}	Perhapen në formën e mbulesave të trasha në terracat mbi zalishitore të lumenjve ose mbi Deluvione ose Kolluvione								
Zhavoret poplore		Gëlqerorë masive deri shtrëse trashë, shumë të karsiezuara në sipërfaqe të thellësi.											
Mesme:		Ndërthurje gëlqerore me ndërshtrësa silicore, me permbytje dhe material argjilor											
Zhavoret													
Shume heterogjen	$c=0, f=0$												
E ₀ = 50 bar deri 100-1000 bar (1 bar = 1 kg/cm ²)			Nga pikpamja gjeoteknike ndahen në suargjila; me kolone të plotë: suargjila me ndërthurje thjerrzash ose linzash surere deri në 5 m			Nga pikpamja gjeologo-inxhinierike këto formime kërkojnë (kerkohen) në mënyrë kategorike përmirësim të vetive gjeoteknike gjatë hapjes dhe sidomos për inkastim themelesh të çdo lloji apo kategorie qofshin							

A - Shkëmbinjtë e fortë. Rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh) >500 bar. Në hartë janë paraqitur me ngjyrë të kuqe.

Në këtë grup hyjnë:

Gëlqeroret (G). Gjejnë përhapje në zonat tektoniko - faciale “Mirdita”, N/z. “Krasta” dhe zona “Kruja” nga Triasiku i mesëm deri Eocen.

Ne zonën “Mirdita” kane përhapje te kufizuar. Perhapen ne jugperëndim ndërtojnë Shitin e Hajmelit ne veriperëndim kurrizore e Karmes, dhe ne afërsi te Fierzës. Mosha gjeologjike e tyre është Triasik i Sipërm - Jurasik i Poshtëm (T3-J1), triasik i poshtëm - mesëm (T1-2) dhe kretak i poshtëm (Cr1). Mbizotërojnë gëlqeroret me megalodonte, gëlqeroret amonitike dhe konglomerate etj, te dolomitizuar dhe dolomitet. Janë te prekur nga një sistem çarjesh shume i zhvilluar sipas se cilave zhvillohen fenomene karstike si gropa dhe hinka karstike.

Ne zonën “Krasta – Cukali” gëlqeroret kane përhapje mesatare. Mosha gjeologjike e tyre është e Triasikut te Siperm (T3), Jurasikut te Poshtem - Mesem (J1-2) dhe Kretak i Sipërm (Cr2). Përhapen ne forme masivi ne Prekal ne malin e Cukalit dhe një pjese malin e Shoshit, ne zonën e Pultit dhe ne forme brezash dhe pullash ne afërsi te Brashtes, Toplanes, Merturit dhe Komanit. Janë te përbërjes gëlqerore biomikritike me globotrunkana, gëlqerore turbiditike dhe me rralle gëlqerore silicore. Kane strukture pllakore shtrese vogël (1 – 2 cm) deri ne 40 cm rralle masive.

Ne zonen “Kruja” kane perhapje ne formen e dy brezave paralel, brezi malit te Rrencit dhe atij te Kakarriqit pjeset veriperendimore te tyre. Mosha gjeologjike e tyre eshte Kretak i Siperm (Cr2), Paleocen (Pg1)

Gëlqerorët silicore (Gsi). Gjejne perhapje te kufizuar ne zonat tektoniko – faciale “Krasta-Cukali” dhe “Mirdita”.

Ne zonen “Mirdita” kane perhapje shume te kufizuar ne zonen e Merturit dhe te Fierzës. Jane te moshes Jurasik i Mesem – i Siperm (J2-3) dhe Jurasik i Poshtem - Mesem (J1-2). Kane perberje karbonato – silicore me ngjyra te kuqrrimte dhe trendafili.

Ne zonen “Krasta-Cukali” kane perhapje te kufizuar. Zakonisht markojne gelqeroret e Kretaku te Siperm. Perbehen nga nderthurje te gelqeroreve shtreseholle me silicore te kuqrrimte. Jane te moshes jurasik i siperkretak i poshtem (J3-Cr1)

B - Shkëmbinjtë mesatare. Rsh 50 - 500 bar. Në hartë ngjyrosen me ngjyrë manushaqe.

Konglomerate dhe ranore te kuqrrimte (KI) zene nje siperfaqe te kufizuara ne zonat strukturoro – faciale te “Mirdites” dhe “Alpeve Shqiptare”.

Ne zonen strukturo-faciale “Mirdita” kane perhapje relativishte te vogel ne veri te rrethit Puke, ne fshatin Bugjon. Takohen ne formen e nje brezi me gjeresi 0.2-0.3 km dhe gjatesi rreth 4 km. Jane te moshes Permo - Triasike (P-T1). Perfaqesohen nga konglomerate dhe ranore te kuqrrimte

Shkembijnjtë efuzivo - sedimentare (Es). Takohen ne formen e nje brezi me shkeputje ne pjesen perendimore dhe veriperendimore te zones “Mirdita”, nga Vig-Mnela - Karma deri ne Porav - Miliska. Si dhe ne afersi te Kçires. Jane te moshes Triasik i mesem - Jurasik i poshtem (T2 - J1). Perfaqesohen kryesisht nga diabaze te nderthurur nga rreshpe argjilo - silicore te kuqe. Kontaktojne kryesisht tektonikisht me shkembijnjtë rrethues.

Shkembijnjtë flishore dhe me pamje flishore (Fl): Zene nje pjese te konsiderueshme te territorit te qarkut Shkodër. Keta shkembijnj gjejne perhapje ne zonat tektoniko – faciale “Mirdita”, Alpet Shqiptare; “Krasta - Cukali” dhe “Kruja”. Mosha gjeologjike e tyre varion qe nga Jurasiku i Siperme (J3) deri paleocen. Ne zona te ndryshme shkembijnjtë flishore dhe ata me pamje flishore kane moshe te ndryshme litologjike dhe perberje po ashtu te ndryshme. E perbashketa e tyre eshte nderthurja ritmike midis perberesve litologjike argjilore, alevrolitore dhe ranore (me rralle edhe brekçe).

Ne zonen “Mirdita” shkembijnjtë flishore i perkasin Jurasikut te Siperme (J3), Depozitimet flishore te J3 karakterizohen nga prania e nderthurjeve te silicoreve me brekçe ofiolitike. Perhapen ne zonen e Kaftalles, Kreshtes, nga Komani deri ne Fierze, ne formen e nje brezi te ngushte me shkeputje

Ne zonen “Krasta - Cukali” shkembijnjtë flishore kane perhapje te madhe qe nga Drishti ne Berdice, nga Komani deri ne Fierze. Vendoset siper gelqeroreve te Cr2 nepermes pakos kalimtare dhe paraqitet me nderthurje ritem holle te komponenteve alevrolitore, argjilave, mergeleve dhe ranore, rralle ndershtresa gelqerori. Ne siperfaqe ky flish paraqitet shume i copetuar dhe i prekur nga tektonikat rrudhosese

Ne zonen “Kruja” shkembijnjtë flishore kane perhapje te kufizuar. Zene pjeset me te ulta te kurrizoreve te Rrencit dhe Kakarriqit ne zonen e Velipojes ne kodrat e Bushatit dhe ne Oblike ashtu edhe shkembijnj me pamje flishore. Shkembijnjtë flishore i perkasin moshave te Oligocenit te Poshtem (Pg31). Ndertohen nga ndethurje te shtresezave argjilo – ranoro – alevrolitik.

Shkembijnjtë mollasik ranoro-konglomeratike (Mrk): Gjejne perhapje vetem ne zonen “Mirdita”. Takohen ne Korthepule Keçire, Fierze dhe Qafe Mali Gurth. Kane kontakte tektonike me shkembijnjtë e tjere. Jane te moshes se Pliocen - Pleistocen i poshtem (N2-Q) dhe jurasikut te siperme (J3). Perfaqesohen nga konglomerate ranore dhe me pak argjila. Zene siperfaqe te kufizuar ne forme pullash dhe rralle ne forme brezash

C - Shkëmbinj të dobët me rezistencë në shtypje njëboshtore me pak se 50 bar. Ne harte ngjyrosen me ngjyre jeshile

Serpentinitet (Ms) takohen vetem ne zonen strukturoro - faciale “Mirdita” ne formen e nje brezi me gjeresi 0.3 km dhe gjatesi rreth 6 km nga Berisha deri ne Bugjon. Jane shkembijnj te perpunuar dhe millonitizuar. Kontaktojne tektonikisht me shkembijnjtë rrethues.

D - Dherat pa lidhje kohezionale (c=0). Ne harte ngjyrosen me ngjyre portokalli.

Zhavorre e popla me origjine aluviale te perziera me pak material argjilor (P): Konturohen ne fushen e Mbishkodres, ne rrjedhat e siperme te lumenjve dhe ne brendesi te zonave malore si ne Kelmend, Dukagjin dhe me pak ne zonen e Pukes

dhe ne Hot dhe Hajmel. Shenohen ne harte me simbolin (Qp-h). Ndertohen nga copra te shkëmbinjeve rrethues te pa perpunuar plotesishte te perzier me pak material argjilor. Kane veti te larta filtruese. Madhesia e coprave te tyre eshte teper heterogjene dhe kane trashesi 2-15m.

Rerat (R): Kane perhapje ne forme rripash dhe ne vetvete nenkuptojne depozitime aluviale (Qh) me granulometri te ndryshueshme prane liqenit te Shkodres dhe depozitime detare (Qh) te quajtura rera te plazheve ne Velipoje dhe Rrjolle. Mund te jene rera nga kokrrizmadh deri kokrriz imet deri ne surera me trashesi nga 2 deri ne 20 m.

E - Dherat me lidhje kohezionale ($c \neq 0$) Ne harte ngjyrosen me ngjyre te verdhe.

Kryesisht suargjila te perziera me material zhavoror (Szh): Perhapen kryesisht ne fushen e Nenshkodres nga Berdica dhe Stajka, ne veri-verilindje deri ne Velipoje (Luarze) ne jug-jugperendim dhe me pak ne Ultesiren Shkodrane ne afersi te Dobraçit. Ne harten gjeologjike shenohen (Qh). Ndertohen kryesishte nga material argjilor, suargjilor te nderthurur me "linza" raore dhe rralle zhavore. Kane trashesi te ndryshme nga rreth 100m ne ultesiren Shkodrane dhe 30 m ne fushen e Nenshkodres.

F - Dherat me veti speciale Ne harte ngjyrosen me ngjyre kafe.

Kryesisht torfa dhe suargjila torfike (T): Perhapen kryesisht ne fushen e Mbishkodres gjate brigjeve te liqenit te Shkodres dhe fushen e Velipojes nga Viluni deri ne brigjet e Bunes. Ne harten gjeologjike shenohen (Qh). Ndertohen kryesishte nga material argjilor, suargjilor te nderthurur me material torfik (organogjen bimor). Kane trashesi te ndryshme nga 10 m deri ne 30 m.

3.1.3.2 Vetitë fiziko - mekanike (gjeoteknike)

Të dhënat gjeoteknike janë nxjerrë nga literatura e studimeve gjeologo - inxhinierike të realizuara në territorin e qarkut të Shkodrës si dhe nga literatura (Myrto R. etj.1991, Allkja S. 1995, Demi n. 1995, Gjovreku L. 2006).

Më poshtë po japim vetitë e 6 grupimeve të ndryshme litologjike:

- Shkëmbinj të fortë
- Shkëmbinj mesatar
- Shkëmbinj të dobët
- Dhera pa kohëzion
- Dhera me kohëzion
- Dhera me veti speciale

Shkëmbinjte e fortë kanë rezistencë në shtypje $> 500 \text{ kg/cm}^2$. Këta shkëmbinj, në shumë raste janë të shkatërruar nga fenomenet e ndrydhjeve tektonike dhe paraqiten me shumë çarje. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Gëlqerorët (G): Jane shkëmbinj kompakte masive deri pllakore. Ne ta eshte prezent fenomeni i karstezimit, kryesisht eshte i perhapur karsti i çarjeve i drejtimit vertikal dhe te kombinuar me fenomenin e mbushjeve te tyre me material kryesisht çimento

karbonatike që vjen nga tretja kimike e gelqeroreve dhe me pak material argjiloro – humusor që vjen nga shpatet duke levizur nën veprimin e ujërave rrjedhës siperfaqësore nëntokësore. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha vëllimore $\gamma = 2.2 - 2.6 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 1 - 25 \%$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh $500 - 1100 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 3 \cdot 10^5 \text{ bar}$
- Koeficienti i Puasonit $\nu = 0.15 - 0.3$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Gëlqerorët silicorë (Gsi): Edhe këta, si gelqeroret, janë shkëmbinj kompakte, kryesisht pllakore, por nuk mungojnë rastet kur kemi ndërthurje të shtresave gelqerore me ato silicore, ose kur shkëmbinjtë me pamje silicore shfaqen brenda gelqeroreve në forme të linxave. Në këta shkëmbinj, në përgjithësi nuk gjëhen përhapje fenomenit i karstizimit. Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

- Pesha volumore $\gamma = 2.6 - 3.0 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 1 - 10 \%$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh $500 - 1000 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 10^5 - 3 \cdot 10^5 \text{ bar}$
- Koeficienti i Puasonit $\nu = 0.15 - 0.35$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë mesatarë kanë rezistencë në shtypje $50 - 500 \text{ kg/cm}^2$. Mund të jenë masiv ose kombinime shtresash me veti gjeoteknike krejt të ndryshme. Për këtë arsye vetitë e tyre janë jo stabile dhe të ndryshueshme në sipërfaqe edhe në distanca shumë të vogla. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Konglomerate dhe ranore të kugërremte (Kl) zënë një sipërfaqe të kufizuar dhe kanë përberje heterogjene. Përfaqësohen nga konglomerate, ranore dhe silicore. Parametrat gjeoteknikë janë:

- Pesha volumore $\gamma = 1.9 - 2.3 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 10 - 40 \%$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh $< 500 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 5 \cdot 10^4 - 6 \cdot 10^5 \text{ bar}$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma 3-6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë efuzivo-sedimentarë (Es). Përfaqësohen kryesisht nga diabaze të ndërthurur nga rreshtë argjilosilicore të kuqe. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Pesha volumore $\gamma = 2.0 - 2.4 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 15 - 50 \%$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore Rsh $< 500 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 5 \cdot 10^4 - 6 \cdot 10^5 \text{ bar}$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma 3-6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë flishore dhe me pamje flishore (Fl): Zënë një pjesë të konsiderueshme të territorit të qarkut. Në zona të ndryshme shkëmbinjtë flishore dhe ata me pamje

flishore, kanë moshe të ndryshme litologjike dhe perberje po ashtu të ndryshme. E perbashketa e tyre është nderthurja ritmike midis perberesve litologjike argjilore, alevrolitore dhe ranore (me rralle edhe brekçe ofiolitike). Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Pesha volumore $\gamma = 1.95 - 2.2 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 30 - 65 \%$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} < 500 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 5 \cdot 10^4 \div 6 \cdot 10^5 \text{ bar}$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma 2.4 \div 3.2 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë mollasik ranoro - konglomeratike (Mrk): Perfaqesohen nga konglomerate, ranore dhe me pak argjila. Zene sipërfaqe të kufizuar në forme pullash dhe rralle në forme brezash.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Pesha volumore $\gamma = 1.85 \div 2.0 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 10 - 50 \%$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} < 500 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 5 \cdot 10^4 \div 6 \cdot 10^5 \text{ bar}$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma 3 \div 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë e dobët kanë rezistencë në shtypje $< 50 \text{ kg/cm}^2$. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Serpentinitet (Ms) Janë shkëmbinj të perpunuar dhe millonitizuar. Kontaktojnë tektonikisht me shkëmbinjtë rrethues. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Pesha volumore $\gamma = 1.75 - 1.95 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 20 - 50 \%$
- Rezistenca në shtypje njëboshtore $R_{sh} < 50 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit $E = 100 - 200 \text{ bar}$
- Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 14^\circ - 18^\circ$
- Kohezioni $c = 0.15 - 0.35 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma = 1.80 - 2.0 \text{ kg/cm}^2$

Dherat pa kohezion ($c=0$).

Zhavorre e popla me origjinë aluviale dhe proluviale (P): Ndertohej kryesisht nga zhavorre me nderfutje të “ndershtresave” ranore dhe me pak argjilore në menyre të shregullt si në planin horizontal ashtu edhe në prerje nga copra të shkëmbinjeve rrethues të pa perpunuar plotësisht të perzier me pak material argjilor. Kanë veti të larta filtruese. Madhesia e coprave të tyre është tepër heterogjene dhe kanë trashësi 2-15 m. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Pesha volumore në gjendje natyrale $\gamma = 2.4 - 2.9 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 30 - 80 \%$
- Këndi i fërkimit të brendshëm $\varphi = 18^\circ - 28^\circ$
- Kohëzioni $c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$

- Moduli i elasticitetit $E = 200 - 300 \text{ kg/cm}^2$
- Koeficienti i filtrimit $K > 50 \text{ litër/24orë}$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma = 1.8 - 6.0 \text{ kg/cm}^2$

Rërat (R): Kane përhapje në forme rripash dhe në vetvete nënkuptojnë depozitime aluviale (Qh) me granulometri të ndryshueshme pranë liqenit të Shkodrës dhe depozitime detare (Qh) të quajtura rera të plazheve në Velipojë dhe Rrjollë. Mund të jenë rera nga kokrrizmadh deri kokrriz imet deri në shterrë me trashësi nga 2-20 m. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Peshë volumore në gjendje natyrore $\gamma = 2.4 - 2.9 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 30 - 80 \%$
- Këndi i fërkimit të brendshëm $\phi = 18^\circ - 28^\circ$
- Kohëzioni $c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i deformacionit $E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$
- Koeficienti i filtrimit $K > 20 \text{ litër/24orë}$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma = 1.8 - 3.0 \text{ kg/cm}^2$

Dherat me kohezion

Kryesisht suargjila të perziera me material zhavoror (Szh): Përhapen kryesisht në fushën e Nenshkodrës nga Berdica dhe Stajka, në veri-verilindje deri në Velipojë (Luarze) në jug -jugperëndim dhe me pak në Ultesirën Shkodrane në afërsi të Dobërçit. Në hartën gjeologjike shënohen (Qh). Ndërtohen kryesisht nga material argjilor, suargjilor të nderthurur me "linza" raore dhe rrallë zhavorë. Kane trashësi të ndryshme nga rreth 100m në Ultesirën Shkodrane dhe 30 m në fushën e Nenshkodrës. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Peshë volumore $\gamma = 1.4 - 1.8 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 35 - 75 \%$
- Këndi i fërkimit të brendshëm $\phi = 18^\circ - 28^\circ$
- Kohëzioni $c = 0.15 - 0.35 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i deformacionit $E = 50 - 200 \text{ kg/cm}^2$
- Koeficienti i filtrimit $K < 1 \text{ litër/24orë}$
- Ngarkesa e lejuar $\sigma = 1.6 - 3.0 \text{ kg/cm}^2$

Dhera me veti speciale Janë depozitime terrigjene që kërkojnë një nderhyrje të specifikuar për të kryer ndertime.

Kryesisht torfa dhe suargjila torfike (T): Përhapen kryesisht në fushën e Mbishkodrës gjatë brigjeve të liqenit të Shkodrës dhe fushën e Velipojës, nga Viluni deri në brigjet e Bunës. Në hartën gjeologjike shënohen (Qh). Ndërtohen kryesisht nga material argjilor, suargjilor të nderthurur me material torfik (organogjen bimor). Kane trashësi të ndryshme nga 10m deri në 30m. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

- Peshë vëllimore $\gamma = 2.1 - 2.3 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti $n = 15 - 55\%$
- Moduli i deformacionit $E = 50 - 200 \text{ kg/cm}^2$
- Këndi i fërkimit të brendshëm $\phi = 16^\circ - 22^\circ$

- | | |
|---------------------------|--------------------------------------|
| • Kohezioni | $c = 0.15 - 0.35 \text{ kg/cm}^2$ |
| • Koeficienti i filtrimit | $K < 1 \text{ litër/24orë}$ |
| • Ngarkesa e lejuar | $\sigma = 1.2 - 2.0 \text{ kg/cm}^2$ |

3.1.3.3 *Përfundime dhe Rekomandime*

- Të dhënat e mësipërme bëjnë një pasqyrim makro të kushteve gjeologo inxhinierike të territorit të Bashkisë Vau-Dejës dhe shërbejnë si orientimin për planifikimin urban.
- Vetitë fiziko-mekanike të paraqitura më sipër mund të përdoren vetëm për ndërtime të vogla (magazina etj., që nuk rezikojnë jetën e banorëve), por jo të merren si të mirëqena për hartimin e projekteve për objekte banimi. Në këto raste është i domosdoshëm studimi gjeologjik i sheshit të ndërtimit.
- Është e domosdoshme të kontrollohet gjendja e shtretërve të lumenjve mbi të cilët ushtrohet aktivitet për shfrytëzim inertesh dhe të vlerësohet funksionimi i argjinaturave ekzistuese.
- Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet në zonat me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës, duhet të vlerësojë gjendjen aktuale të fenomeneve të rrezikut si dhe mundësinë e masave mbrojtëse për eliminimin e plotë apo mosavancimin e mëtejshëm të këtij fenomeni.
- Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen në sektorin me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik duhet të japin me saktësi shkallën e zhvillimit të fenomenit si dhe të llogarisin saktë masat mbrojtëse që duhet të merren.
- Dëmtimi i akseve rrugore nacionale, të kategorisë së dytë e të tretë, i veprave sociale apo banesave, kërkon studime imediate për marrjen e masave mbrojtëse ndaj fenomenit të rrëshqitjeve dhe është e domosdoshme që gjeologu të jetë prezent në zbatimin e masave mbrojtëse të dhëna në studimet gjeologjiko – inxhinierike përkatëse.
- Përfundimisht theksojmë se pjesëmarrja e specialistëve gjeologë në zyrat e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, është e domosdoshme dhe e rëndësishme.

3.1.4 Hidrogjeologjia dhe hidrologjia;

3.1.4.1 *Hidrogjeologjia dhe basenet*

Për studimin e situatës hidrogjeologjike të Qarkut të Shkodrës, është bërë interpretimi i të dhënave hidrogjeologjike të marra nga harta hidrogjeologjike e Shqipërisë.

Nga pikëpamja hidrogjeologjike, territori i Shqipërisë ndahet në disa zona: zona e përhapjes së shkëmbinjve të shkrifët porozë, e shkëmbinjve karbonatikë, e shkëmbinjve molasikë, e shkëmbinjve magmatikë, e shkëmbinjve flishoidalë dhe flishorë, e shkëmbinjve metamorfikë dhe e shkëmbinjve evaporitë.

Për shkak të relievit të larmishëm që ndodhet në territorin e qarkut Shkodër, kemi shpërhapjen e shkëmbinjve me veti të mira kolektore (zhavorrë, gëlqerorë), si dhe shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh (argjila, flish, gipse). Bazuar në të dhënat e Hartës Hidrogjelogjike të Shqipërisë kemi disa lloje akuiferësh prezent në zonë:

- Me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri shumë të lartë/të lartë (rërë + zhavorr, rërë + zhavorr + surargjila). Këto lloje shkëmbinjsh janë të shpërhapur kryesisht në pjesën perëndimore të territorit. Veçanërisht në zonën pranë liqenit si dhe në zonat përgjatë shtretërve të lumenjve. Rezervat ujore që ndodhen në këto lloje shkëmbinjsh, kanë rëndësi të madhe pasi shërbejnë edhe për furnizimin me ujë të qendrave të banimit, për industri dhe për ujëjitje.
- Me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare/të ulët (argjila + rërë + surargjila). Këto lloje shkëmbinjsh kanë një përhapje të kufizuar në territorin e qarkut. Gjenden kryesisht pranë zonave bregdetare dhe liqenore. Përfaqësohen me depozitimet proluviale të konuseve të derdhjes dhe nga koluvionet shpatore me çimentim të dobët.
- Me porozitet çarje-karst dhe ujëpërcjellshmëri tepër të ndryshueshme, shumë e lartë/shumë e ulët (gëlqerorë, dolomite). Shpërhapja e tyre është në të gjithë territorin e Bashkisë, megjithatë më e theksuar bëhet në pjesën veriore të saj. Ujërat karstike shfrytëzohen kryesisht me anën e burimeve. Në pjesët e zbuluara të gëlqerorëve karstike ujërat nëntokësorë kanë një cilësi të mirë, janë të ëmbël me një mineralizim të përgjithshëm 0.2 - 0.4 g/l. Në pjesët ku këto ujëra ndodhen më në thellësi dhe janë të mbuluar nga depozitime flishore dhe molasike, shpesh janë termominerale të ngopura me H_2S .
- Me porozitet çarjesh dhe ujëpërcjellshmëri të ndryshueshme, mesatare/e ulët. (shkëmbinj magmatikë, metamorfikë). Shpërhapja e tyre është shumë e vogël në territorin e qarkut.




Fig. 21: Harta hidrogeologjike e qarkut Shkodër - Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Gjithashtu nga harta hidrogeologjike vihet re që të shpërhapur në territorin e qarkut ka edhe jo akuiferë:

Shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh (argjila, flish, gipse). Këto lloje shkëmbinjsh janë të përhapur në të gjithë territorin e Bashkisë, veçanërisht në pjesën veri-lindore. Burimet që dalin nga këto lloje shkëmbinjsh kanë prurje të vogël, 0.01 - 0.1 l/s, për shkak se kanë çashmëri dhe porozitet të ulët si dhe shkallë të lartë çimentimi.

Pjesa më e madhe e burimeve që gjenden në zonë janë të vegjël (1 - 10 l/s) dhe mesatarë (10 - 100 l/s), megjithatë në disa zona të caktuara, veçanërisht aty ku

akuiferët janë porozë dhe kanë ujëpërcjellshmëri të lartë, vihet re prezenca e burimeve të mëdhenj me prurje mesatare 100 - 1000 l/s.

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizorë dhe karstikë, vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë/të lartë, dhe paraqesin rëndësi të madhe në furnizimin e qendrave të mëdha të banuara me ujë të pijshëm.

Në Dobraç shfrytëzohen me puse shpimi një sasi uji me prurje totale 1000 - 1100 l/sek.

Shpime të tjera që shfrytëzohen për furnizimin e fshatrave me ujë si më poshtë:

- Stacioni i pompimit të Bërdicës (100 l/sek, 2 shpime);
- Stacioni i pompimit të Bushatit ($Q = 2$ l/sek).;
- Stacioni i pompimit të Bahçallëkut ($Q = 100$ l/sek);
- Stacioni i pompimit të Dajçit ($Q = 11$ l/sek);
- Stacioni i pompimit të Oblikës ($Q = 2$ l/sek);
- Shpime të tjerë ($Q = 80 - 100$ l/sek).

Sasia e përgjithëshme e ujit që shfrytëzohet nga pellgu i Shkodrës është rreth 1200 - 1300 l/s. Koeficienti i shfrytëzimit të pellgut kuaternar varion nga 0.33 në 0.50. Nga të dhënat e studimeve të mëparshme të relacioneve janë marrë debitet e puseve.

Nga këto studime rezulton se nga shpimet me vetëderdhje dhe me stacione pompimi të veçanta apo ujësjellësa, merren nga fusha e NënShkodrës afërsisht 900 - 1000 l/s. Këtu përfshihen edhe burimet në zonën e studimit, që dalin nga gëlqerorët që janë të lidhura me reshjet atmosferike, kurse nga zona e Zadrimës merren afërsisht 300 l/s me gjithë burimet për rreth. Nga kjo sasi uji që merret hyjnë:

- $Q = 100$ l/s që merren nga stacionet e pompimit të zonës NënShkodrës (aktualisht disa prej tyre janë jashtë funksioni);
- $Q = 300$ l/s merren nga privatët me puse shpimi dhe puse fshati edhe për vaditje,
- $Q = 50$ l/s merren nga burimet.
- Gjithsej: $Q = 450$ l/s.

Qarku ka resurse ujore të mëdha të cilat janë të lidhura kryesisht me akuiferet aluvialë dhe karbonatikë.

- Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët) e ujëmbajtje shumë të lartë/të lartë;
- Akuiferet me ujëpërcjellshmëri shumë të lartë/të lartë lidhen me depozitimet e zhavoreve dhe zhureve me madhësi të ndryshme, të cilat formojnë horizonte ujëmbajtëse pa presion dhe që kanë përhapje të gjerë në të gjithë zonën e Shkodrës. Akuiferët janë të pasur me resurse ujore nëntokësore dhe shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm të komunitetit.

Prurja totale e këtyre dy akuifereve është rreth 1050 l/s ($Q = 1000$ l/s + 50 l/s), prurje e cila shfrytëzohet për që ujësjellësat e fshatrave, me sipërfaqe shtrirjeje rreth 391 km².

- Akuiferët me porozitet poro/çarje. Në qark ato kanë përhapje të kufizuar dhe të shpërndarë në hartë dhe shtrihen në një sipërfaqe rreth 228.04 km², Prurjet e puseve janë 0.2 - 1 l/s, ndërsa prurjet specifike variojnë $q = 0.07 - 1$ l/s/m.
- Akuiferët e çarë dhe karstikë. Tipi i këtij akuiferi ka përhapjen më të gjerë në qarkun e Shkodrës dhe shtrihen në një sipërfaqe prej 1189 km². Në zonat karstike koeficienti mesatar i infiltrimit të dobishëm shkon deri në 0.5 - 0.6.
- Akuiferët me çarje zenë një sipërfaqen rreth 762 km² dhe ndërtohen nga shkëmbinj magmatikë e metamorfikë dhe që shtrihen kryesisht në territorin e Pukës. Për këtë kompleks interes paraqet vetëm masivi i Krrabit ku ndodhen burime me debite që variojnë nga 5 në 25 l/s.

Menaxhimi integruar i resurseve ujore në qark kërkon një vendimmarrje në nivele të ndryshme qeverisje, metodologji shkencore të përparuara për ruajtjen e bilancit sasior dhe cilësor të ujërave. Është më se e nevojshme që të bëhen studime më të detajuara të shkallëve më të mëdha për nevojat të furnizimit me ujë të komuniteteve në kuadër të bashkisë si njësi vendore.

3.1.4.2 Akuiferi i Nënshkodrës

Ka një përhapje mjaft të gjerë në luginat dhe fushat e formuara nga lumenjtë Drini e Buna. Në jug ky akuifer kufizohet me fushën e Zadrimës, ndërsa në veri me akuiferin e Mbishkodrës. Ai shtrihet në gjithë pjesën e ulët fushore dhe është formuar me aktivitetin akumulativ të materialit të shkrifët aluvional të depozitimeve kuaternare të lumenjve Buna e Drin. Akuiferi përbëhet nga shtresa të fuqishme zhavorresh e zhuresh me veti të larta filtruese, të cilat grumbullojnë sasira të konsiderushme rezervash të ujrave nëntoksore të freskëta.

Zhavorret e zhuret ujëmbajtëse dominojnë në prerje dhe zenë 60-80 % të saj. Trashësitë e shtresave luhaten nga 5-10 deri 60m e në zona të veçanta edhe më tepër.

Mbulesa subrërore lëviz nga 2-3m deri 25-30m. Në zonën e Mjedës, Kaç-Naraçit e Stajkës, zhavorret dalin në sipërfaqe të tokës. Mbulesa subrërore subargjilore rritet nga veriu në jug dhe nga lindja drejt perëndimit, si dhe në drejtim të rrjedhjeve të lumenjeve Buna e Drin.

Ujrat nëntoksore të zhavorre të këtyre luginave aluviale kanë lidhje të mira hidraulike, me ujrat sipërfaqësore të lumenjeve Buna e Drin, prandaj janë të pasura dhe përmbajnë rezerva të konsiderushme, gjëe cila është vërtetuar nga shpimet e kryera.

Në pjesën lindore e veriore të këtij pellgu, ujërat nëntokësore janë pa presion, ndërsa në sektorët jugorë e perëndimorë, si rezultat i rritjes së mbulesës subrërore e subargjilore dhe si rezultat i pozicionit hipsometrik më të lartë të zonës së ushqimit, ato fitojnë presion dhe në disa zona shpimet kanë dhënë ujë me vetrrjedhje si në Trush të Poshtëm, Pistull, Paçram, Gocaj etj. Megjithatë nivelet e ujërave nëntokësore, në pjesën më të madhe të akuiferit janë nën sipërfaqen e tokës, por jo në thellësi të madhe si në zonën e Mbishkodrës.

Nivelet luhaten nga 1.0 m deri 3-3.5 m, rrallë shkojnë deri 5.0 m nën sipërfaqen e tokës. Luhatjet e niveleve lidhen drejt përsëdrejti me regjimin hidrogeologjik të lumenjeve Buna e Drini, çka vërteton edhe marrëdhëniet e mira hidraulike të tyre në ujërat nëntokësore. Ujëdhënia dhe ujëpërshkueshmëria e zhavoreve është shumë e lartë në përgjithësi, megjithatë ka edhe zona të kufizuara me vlera mesatare e të vogla.

Koeficientët e filtrimit luhaten nga 30-50 m/ditë dhe prurjet specifike nga 5-10 lit/sek/m, në zonat e ekstremeve perëndimore, jugperëndimore e jugore të pellgut deri në 400-700 m/ditë dhe 100-150 lit/sek/m respektivisht në pjesën më të madhe të tij e sidomos në sektorët më afër lumenjeve Buna e Drini. Në shpimet e kryera në afërsi të Bahçallëkut në Dajç të Bregut të Bunës, Shirqe, në Trush të Poshtëm, Bërdicë, Melgush, Kozmaç, Stojkë, Mjedë, Qendër Bushat, etj. koeficientët e filtrimit luhaten nga 100-150 m/ditë deri 400 - 750 m/ditë, ndërsa prurjet specifike nga 40-60 lit/sek/m, deri 100-150 lit/sek/m, e në puse të veçantë edhe më tepër.

Ushqimin kryesor ujërat nëntokësore e marrin nga lumenjtë Buna e Drin dhe pjesërisht nga rreshjet atmosferike, në seksionet ku zhavoret dalin në sipërfaqe të tokës. Përsa i përket përbërjes fiziko kimike të ujërave të zonës Mbishkodrës, mund të themi se kemi të bëjmë me ujëra me veti fiziko-kimike të mira.

Mineralizimi i përgjithshëm lëkundet nga 0.17 gr/l në 0.5 gr/l. Mbetjet e thata më të vogla takohen si në pjesën lindore të zonës, ashtu edhe atë perëndimore në afërsi të liqenit, ndërsa më të mëdhatë në pjesën qendrore në fshatin Omaraj. Fortësitë më të vogla takohen në afërsi të lumit Kiri dhe liqenit të Shkodrës, ndërsa më të mëdhatë në pjesën veri dhe veriperëndimore të zonës.

Ujërat nëntokësore të këtij pellgu janë në përgjithësi të freskta dhe veti të mira fiziko-kimike, temperaturë nga 12 -16°C, mineralizim të përgjithshëm nga 0.2 deri 0.5 gr/l. Në disa sektorë mineralizimi arrin deri 0.7 gr/lit vetëm në një zonë të Barbullushit kemi Mp mbi 1gr/l. Fortësia e përgjithëshme lëviz nga 7 deri 20 gradë gjermane. Me mineralizim dhe fortësi më të vogël janë ujërat në pjesën lindore të pellgut dhe afër lumenjeve Buna e Drin.

Në drejtimin perëndimor, duke filluar prej fshatit Pentar e deri në derdhjen e lumit Buna në detin Adriatik dhe në të gjithë zonën e Velipojës, ujërat nëntokësore janë nën ndikimin e intruzionit të detit dhe janë të kripur. Mineralizimi i përgjithshëm shkon nga 2 gr/l deri në 16 gr/l në bregdetin e Adriatikut.

Nga punimet e kryera deri tani, del qartë se zonat më me perspektivë dhe më të pasura me ujëra nëntokësore, janë ato të krahut të majtë të rrjedhjes së lumit Buna, duke filluar prej urës së Bahçallëkut dhe deri në Dajç të Bregut të Bunës, me një front prej 8-10 km dhe në të dy krahët e lumit Drin prej Shkodrës e deri në Mjedë, me front 18-20 km (për të dy krahët së bashku).

3.1.4.3 *Akuiferi i fushës së Zadrimës*

Akuiferi është formuar me aktivitetin grumbullues të materialit të shkrifët aluvional të lumenjeve Drin e Gjadër. Ai nuk është shumë i pasur me ujëra nëntokësorë, pasi vetë depozitimet aluviale në fushën e Zadrimës janë të kufizuara në shtrirje dhe kanë trashësi të vogël. Trashësia e depozitimeve aluviale të kuaternarit nuk e kalon madhësinë 25-30 m në fushë dhe deri në 50 m, në zonat afër lumenjeve. Edhe shtresat ujëmbartëse zhavorore kanë trashësi të vogël 2-3 m, dhe nuk takohen kudo në shtrirje. Një farë interesi paraqesin vetëm sektorë të vecantë të kufizuar në afërsi të lumenjve si në Mabë, Dajç.

Në zonën e Mabës e të Dajçit janë takuar zhavorë ujëmbajtës, me trashësi deri 20 m dhe me ujëdhënie e ujëpërshkueshmëri deri diku të lartë. Në këta sektorë koeficienti i filtrimit arrin nga 35 deri 60 m/ditë, ndërsa prurja specifike 5-14 lit/sek/m.

Në lindje këto zhavorë kontaktojnë me formacionet rrënjësore, siç janë gëlqerorët e karstëzuar të Triasikut, Jurasikut dhe Kretakut. Rolin kryesor në ushqimin e këtij akuiferi e luajnë drenimet e ujërave nëntokësore që dalin nga formacionet rrënjësore dhe infiltrimet nga përrenjtë Rrjoll, Vrakë dhe Kir.

3.1.4.4 *Resurset dinamike të ujërave nëntokësore*

Në shfrytëzimin racional të çdo pellgu ujëmbajtës, sidomos për perspektivën ku pritet marrja e sasive më të mëdha uji, rëndësi merr vlerësimi i resurseve, resurset dinamike (Q_{din}), që kalojnë prerjen tërthore të rrjedhjes në njësinë e kohës. Mbi bazën e krahasimit të tyre përcaktohet dhe bilanci ujqor i shtresës ujëmbajtëse të zhavorreve.

3.1.4.5 *Resurset e shfrytëzueshme të ujërave në Pellgun e Qarkut të Shkodrës*

Ujërat nëntokësore të zhavorreve ujëmbajtëse në pellgun e Qarkut të Shkodrës janë kapur me një numër të madh shpimesh. Sikurse është përmendur edhe më sipër, shpimet shfrytëzojnë horizontin e zhavorreve, që përmbajnë ujëra të ëmbla të pijshëm. Këto shpime ndodhen në disa zona;

Zona e Liqenit të Shkodrës, Dobraç e lindje, zona e ish-ndërmarrjes zooteknike, si edhe zonat e tjera më në lindje e aftësisë ujëdhënëse (gjithmonë me shpime), ku merren nga 80 - 100 l/s në zonën e Dobraçit deri në 10 - 15 l/sek më në lindje. Në veri të Dobraçit, duke u spostuar më në lindje për shkak të trashësisë së reduktuar (prerje efektive më e vogël), debitet janë mbi 5 l/s, në Dragoç, Vrakë, Gril, Grunjë e më në veri.

Zona tjetër me perspektivë është pa dyshim kontakti i karbonateve me depozitimet e kuaternarit në gjithë gjatësinë Shkodër - Demiraj, ku karbonatet shkarkojnë me intensitet për shkak të nivelit më të ulët të këtij kontakti në raport me nivelin e ujërave nëntokësore të zhavorreve.

3.1.4.6 Rrjedhja e ujërave nëntokësore (Resurset dinamike)

Rrjedhja e ujërave nëntokësore ose resurset dinamike formohet për llogari të rrjedhjes së ujërave nëntokësore të infiltruar nga karbonatet që qarkojnë gjithë krahun lindor të Pellgut Shkodër. Për llogaritjen e resurseve dinamike, është llogaritur sipërfaqja mesatare tërthore e zhavorreve, e cila rezulton rreth 572.500 m², koeficienti mesatar i filtrimit (m/d), që në pusët e Dobraçit rezulton rreth 150 m/d, si dhe gradienti hidraulik që rezulton në vlerën 0.005 m/m. Gjithë kjo sasi uji kuptohet se vjen nga infiltrimi i ujit nga karbonatet në zhavorret e kuaternarit në gjithë gjatësinë e kontaktit të këtyre formacioneve. Nga përlllogaritjet e pellgut ujëndarës të tyre, i cili rezulton me një sipërfaqe rreth 270 x 10⁶ m², dhe koeficientit të filtrimit të reshjeve në gëlqeror, i cili pranohet rreth 0.6, rezulton që nga 2000 m/m shi në vit filtrojnë në gëlqeror 1200 m/m ose 1.2 m/vit.

Infiltrimi i dobishëm në gjendje ekuilibri të bilancit, pra sasia e ujit që infiltron në masiv (I_w) rezulton:

$$I_w = S \times I = 270 \times 10^6 \times 1.2 \text{ m/d} = 7.13 \text{ m}^3/\text{s} \text{ ose } 7.130 \text{ l/s.}$$

Nga sa shihet nga përlllogaritjet, sasia e ujit që futet në zhavorret e kuaternarit në raport me atë që del dhe shkarkon në liqen, është rreth 1.000 l/sek më shumë.

Nga pellgu ujëmbajtës sot për sot merren rreth 1.100 l/sek (ujësjellësi Shkodër + bashkitë në këtë pellg).

Nga sa shikohet sot për sot shfrytëzohen rreth 18 - 20 % e aftësisë rrjedhëse të pellgut. Sasia e ujit që shkarkohet nga gëlqerorët duhet marrë me rezervë për faktin se kërkon studime e llogari më të sakta, pasi ajo përbën rreth 2 % të sasisë që shkarkon Buna nga liqeni (320 m³/s).

Në këto kushte, kuptohet që infiltrimi në gëlqerorë mund të jetë më i madh, por mungesa e studimeve në këtë drejtim nuk lejon të bëhen llogari të sakta. Në përgjithësi, nga sa shihet, kapaciteti ujëdhënës i pellgut nuk mund të jetë më i madh se 6 m³/sek. Në rast se do të rriteshin sasitë e ujit në shfrytëzim, do të ndodhte devijimi i rrjedhjes së ujërave nga drejtimi i tanishëm PL në drejtimin LP (liqeni – zhavorre të pellgut, një fenomen tepër i dëmshëm). Resurset dinamike për fushën NënShkodër - Zadrinë janë për llogari të filtrimit të ujit nga lumi Drin dhe Buna me një front ushqimi prej 20 km, trashësi të shtresës së zhavorreve prej 10 - 60 m, $K = 100 - 150 \text{ m/d}$ dhe $i = 0.002$.

Prurja nëntokësore natyrore (Q_w), e përcaktuar me formulën Darcy rezulton rreth 600 l/s në pjesën e profilit në bregun e Bunës dhe 400 l/s për bregun e lumit Drin, pra rreth 1.000 l/s.

3.1.4.7 Hidrografia dhe cilësia e ujërave sipërfaqësore

Lumi Drin

Drini është lumi më i gjatë i trojeve shqiptare me 160 kilometra gjatësi. Ai derdhet në Detin Adriatik, afër Lezhës dhe në lumin e Bunës, degë që u formua pas një përmbysteje në shekullin XIX.



Fig. 22: Baseni ujëmbledhës i lumit Drin

Drini formohet afër qytetit të Kukësit me bashkimin e dy degëve kryesore të tij:

- Drini i Bardhë që buron afër Pejës, Kosovë, nga Malet e Zhlebit, e më pas përshkon lugun e Dukagjinit dhe derdhet në liqenin e Fierzës;
- Drini i Zi që buron në Strugë, Republika e Maqedonisë, nga pjesa veriore e Liqenit të Ohrit, i cili siç dihet furnizohet me ujë nga Liqeni i Prespës, duke marrë edhe disa degë si p.sh. Radikën (Treva e Dibrës).

Degët kryesore të Drinit janë lumi i Shalës, lumi Valbona nga Alpet Shqiptare, Drini i Bardhë në Kosovë dhe Drini i Zi në Maqedoni. Në pjesën fundore Drini derdhet në lumin Kir, i cili buron nga Dukagjini, e pastaj bashkë derdhen në Bunë.

Drini i madh është shumë i gjerë dhe sjell një sasi të madhe uji ($330 - 340 \text{ m}^3/\text{s}$), i dyti për nga kapaciteti pas Bunës, por ky i fundit, duke qenë i shkurtër, disa harta e shënojnë si liqen. Pas Vaut të Dejës, krahu i gjatë shkon drejt jugut për nga Bushati, Maba, Gjadri, Lezha. Në jug të Lezhës hyn në një zonë moçalore e më tej derdhet në Adriatik.

Nga Kukësi, Drini rrjedh në Shqipërinë veriore, së pari nga Hasi, në vazhdim, dhe është kthyer në një zinxhir liqenesh artificiale (i Fierzës, i Komanit dhe i Vaut të Dejës), që furnizojnë me ujë tre hidrocentralet e mëdha. Prurja mesatare vjetore e Drinit arrin $352 \text{ m}^3/\text{sek}$, kurse maksimalja e regjistruar është mbi $5.100 \text{ m}^3/\text{sek}$. Duke kaluar në fshatrat Sipas, Msi dhe Fierzë, e mandej, pasi mbërrin në krahinën e Dukagjinit, ai

shkon drejt jugut, kalon nga Apripë e Gurit, Toplanë, Dushman, Koman, Vjerdhë, Mazrrek, Rragam, dhe Pale Lalej. Në Vaun e Dejës, hyn në ultësirat e NënShkodrës dhe ndahet në dy krahë: një që derdhet në gjirin e Drinit në Adriatik në jug-perëndim të Lezhës, dhe tjetri që derdhet në lumin Kir e më tej në Bunë afër Kalasë së Shkodrës. Edhe pse është dega më e shkurtër prej 15 km, kjo ndarje që derdhet në Bunë quhet Drini i Madh, sepse bie më shumë ujë se krahja tjetër që derdhet drejtpërdrejt në det. Drini i Madh gjithashtu derdhet në det, por ka ndryshuar rrjedhën e vet pas një përmbytjeje të madhe në vitin 1858 duke ardhur drejt Shkodrës.

Lumi i Gjadrit

Lumi i Gjadrit është degë e majtë e Drinit, që shtrihet në perëndim të rrethit të Pukës e në verilindje të rrethit të Lezhës. Ka gjatësi 40.5 km, sipërfaqe 199 km² dhe lartësi mesatare 422 m. Fillon nga shpatet veriperëndimore të Bjeshkëve të Tërbunit. Në pjesën e sipërme të rrjedhjes, ka formuar një luginë tipike me shpate shumë të pjerrëta e fund të ngushtë. Që nga Kalivaçi e deri në Hajmel, lugina merr pamjen e një pellgu. Gjadhri, pasi mbledh ujërat e pjesës veriperëndimore të përroit të Dibrës dhe atij të Kakrit, kthen në veriperëndim dhe derdhet në Drin.

Cilësia e ujërave të lumit Drinit

Lumi Drin monitorohet nga AKMP në dy stacione: Topojan dhe Bahçallëk.

Stacioni i Topojanit jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujit të Drinit të bashkuar: Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, ndërsa monitorimi i stacionit në Bahçallëk jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujërave para derdhjes në detin Adriatik.

Në mënyrë periodike kryhet kampionizimi i ujit dhe kryerja e 8 analizave kimike në dy periudha të vitit: prill dhe tetor.

Temperatura e ujit për lumin Drin varion 23.2 – 24.1 °C në fazën e parë (muaji prill) deri në 16.4 °C në fazën e dytë të monitorimit në muajin tetor.

pH i ujit për lumin Drin varion nga 7.74 – 8.56 respektivisht për stacionet në Urën e Topojanit dhe Bahçallëk. Ndryshimet stinore nuk e kalojnë vlerën 1.0 (0.15, 0.37 dhe 0.82). Sipas vlerave limite të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU), normës për mjedis ujor acid dhe alkaline, ujërat e lumit Drin kanë gjendje të mirë. Ata janë neutrale (*pH* = 6.5 - 9.0).

Alkaliniteti - Nga matjet e kryera gjatë periudhës vjetore, vërehet se vlerat luhaten nga 123 -140 mol/l në fazën e parë dhe 128 - 143 mol/l në fazën e dytë sipas stacioneve, respektivisht Ura e Bahçallëkut dhe Ura e Topojanit. Luhatjet stinore janë të ulta, nga 0 – 5 mol/l. Rritja e alkalinitetit në fazën e dytë shoqërohet me rritjen e *pH* dhe të lëndëve të tretura në ujë.

Përcjellshmëria elektrike - Luhatet në vlerat 277 - 285 µS/cm respektivisht Ura e Bahçallëkut dhe Ura e Topojanit. Luhatjet stinore janë të ulta 2 – 7 - 9 e deri 49 µS/cm në urën e Topojanit. Në normat europiane nuk jepen kufij të cilësisë së ujërave për përcjellshmërinë elektrike. Megjithatë shihet se vlerat e marra në këtë fazë janë të ulta.

Përmbajtja e oksigjenit të tretur në lumin Drin varion në vlerat 7.33 – 8.86 mg/l. Luhatjet sezonale të oksigjenit janë të ulëta, rreth 0.8 mg/l. Uljet e përmbajtjes së oksigjenit në

fazën e dytë lidhen me shkarkimet e mbetjeve si dhe pikën kritike në prurjet e lumit. Lumi klasifikohet në gjendje shumë të mirë për nivelet e oksigjenit.

Vlerat e përmbajtjes së NKO_5 kanë luhajtje të vogla si dhe vlera të ulëta nga 0.59 në 1.02 mg/l për stacionet e lumit Drin, duke u klasifikuar në gjendje shumë të mirë, ku $\text{NKO}_5 \leq 2$ mg/l. Vihet re një rritje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve, prurjeve si dhe me shkarkimet max si pasojë e turizmit në periudhën e verës.

Vlerat e përmbajtjes të nevojës kimike për oksigjen NKO luhatet në 0.44 - 0.8 mg/l në fazën e parë dhe 0.8 – 0.36 mg/l për fazën e dytë. Luhajtjet sezonale janë të lehta.

Përmbajtja e fosforit total luhatet në vlerat 0.02 – 0.19 mg/l, duke u klasifikuar në gjendje shumë të mirë, ku $P_t < 0.1$ mg/l.

Amonia ku është tregues i ndotjes bakteriale të ujërave. Në stacionet e lumit Drin, gjatë monitorimit të vitit 2015, në fazën e parë nuk është takuar prania e amoniakut në ndryshim nga faza e dytë ku përqendrimi i amoniakut luhatet në vlerat 0.03 – 0.05 mg/l, si pasojë e ndikimit të shkarkimeve të ndryshme. Stacionet paraqesin të njëjtën ecuri nga faza në fazë me tendencë rritje pasi dhe periudha e marrjes së kampioneve, ka përkuar me minimumin e periudhës ujëpaktë. Sipas standardit për ujërat e ëmbla, ujërat e lumit Drin klasifikohen si të cilësisë shumë të mirë.

Vlerat e përmbajtjes së nitrateve luhaten nga 0.3 - 0.8 - 2.0 mg/l për stacionet e lumit Drin. Ujërat e lumit Drin janë të gjendjes së mirë deri në të moderuar. Lumi Drin është nën ndikimin e shkarkimeve urbane të qytetit të Shkodrës dhe zonave përreth.

Vlerat e përmbajtjes së nitriteve luhaten nga 0 - 0.02 - 0.05 mg/l. Sipas vlerave limite të përcaktuara nga DKU, ujërat e lumit Drin i përkasin gjendjes shumë të mirë.

Lëndët pezull kanë luhajtje të vogla si dhe vlera të ulëta nga 1.4 në 10.8 mg/l për të dy stacionet e lumit Drin. Luhajtjet sezonale janë relativisht të ulta. Vihet re një ulje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve.

Burimi i të dhënave: Raporti i gjendjes së mjedisit, AKMP 2015

3.1.5 Zonimi makrosizmik dhe në varësi të rëndësisë, zonimi mikrosizmik;

3.1.5.1 Hyrje

Vlerësimi i rrezikut sizmik të rajoneve të ndryshme të prekur nga tërmetet, është bërë një drejtim i preferuar i sizmologjisë kryesisht gjatë tre-katër dekadave të fundit. Në vitin 1979, pas një pune relativisht të gjatë u realizua studimi “Rajonizimi Sizmik i Republikës së Shqipërisë” së bashku me hartën përkatse në shkallën 1:500.000 (Sulstarova, Koçiaj, Aliaj, 1980), e cila u miratua me VKM Nr.371 dt. 20.12.1979. Që nga ajo kohë e në vazhdim Harta e Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë në shkallën 1:500.000 është pjesë integrale e Kushteve Teknike të Projektmeve e Ndërtimeve Antisizmike – KTP N2-1989.

Harta e Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë paraqet efektin maksimal sipëfaqësor të pritshëm për kushte mesatare trualli, të shprehur në intensitetin bazë të përcaktuar

sipas shkallës MSK-1964. Intensiteti bazë është konsideruar si intensiteti maksimal i vrojtueshëm në një pikë të dhënë për një periudhë kohore të caktuar në të ardhmen.

Në Hartën e Rajonizimit Sizmik të Shqipërisë janë dalluar tre kategori zonash: zonat me intensitet bazë të lëkundjeve VIII, VII e VI ballë; brënda zonave VIII ballëshe për kushte të këqia trualli, të përmendura më lart, janë dalluar zona me intensitet të pritshëm IX ballë si në Vlorë, në afërsi të Lushnjës, në Durrës, në Korçë, në Pogradec, në Gollobordë e në Shkodër (kufijtë e këtyre zonave paraqiten me izovija të ndërprera).

Në vitet '90, me zhvillimin teorik të analizës së rrezikut sizmik dhe mundësitë kompjuterike, në Shqipëri u realizuan një sërë analizash të rrezikut sizmik duke përdorur si përqasjen deterministike ashtu dhe atë probabilitare.

Në vitet 1998-2003, në kuadrin e projektit të NATO-s "Sizmotektonika dhe rreziku sizmik i Shqipërisë", në bashkëpunim me Departamentin e Gjeofizikës të Universitetit Aristotel të Selanikut, u realizua për herë të parë një analizë e plotë e rrezikut sizmik të vendit duke përdorur metodën probabilitare.

Gjithashtu vitet e fundit është botuar materiali teknik "Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri"¹, në të cilin përfshihet përvoja mbi 40 vjeçare e studimeve në fushën e sizmologjisë, jepen përfundime të arritura nëpërmjet debatit shkencor e hulumtimit të thellë dhe kulmohet me formën më të plotë të rrezikut sizmik të vendit, një dokumentacion me rëndësi praktike për ndërtimet në Shqipëri. Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë (2010) duhet të shërbejë si bazë për kodin e ri antisizmik të ndërtimeve në vendin tonë.

Për vlerësimin e potencialit sizmik të territorit të Bashkisë të Vau-Dejës është përdorur metoda probabilitare. Për llogaritjen probabilitare të rrezikut sizmik të Shqipërisë kemi aplikuar metodologjinë Cornell-McGuire (McGuire, 1993)². Sizmiciteti i vendit tonë është karakterizuar nëpërmjet modelit të zonave të burimeve sizmike.

Sipas EC 8, strukturat në rajonet sizmike duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të kënaqin këto dy kërkesa themelore:

- Kërkesa e mos-shëmbjes, dhe
- Kërkesa e kufizimit të dëmtimeve.

Pra, për të plotësuar këto dy kërkesa të Eurokodit 8, llogaritjet e rrezikut sizmik të Shqipërisë janë kryer për dy nivele probabiliteti:

- 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (10%/50), ose 0,0021 në vit, që i korespondon një tërmeti me periodë përsëritje 475 vjet, dhe
- 10% probabilitet tejkalimi në 10 vjet (10%/10), ose 0,0105 në vit, që i korespondon një tërmeti me periodë përsëritje 95 vjet.

Pra, në llogaritjet e rrezikut sizmik për truall shkëmbor, shpejtimi (akseleracioni) maksimal i truallit - PGA si dhe shpejtimit spektrale - SA për shuarje 5 % përcaktohen

¹ Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri" Sh. Aliaj, S. Koçiu, Betim Muço, Eduard Sulstarova, 2010, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

² Për këtë qëllim është përdorur softi EZ-FRISK 7.12, produkt i Risk Engineering Inc.Colorado, USA

për dy perioda të përsëritjes të tërmeteve: 475 e 95 vjet, për të cilat ndërtohen edhe hartat përkatëse të rrezikut sizmik. Bazuar në këtë metodikë është bërë edhe vlerësimi i rrezikut sizmik të territorit të Bashkisë të Vau Dejës që paraqitet në vijim.

3.1.5.2 Sizmiciteti i Shqipërisë dhe veçanërisht i territorit të bashkisë të Vau-Dejës

Në zonimin sizmik mbarëbotëror, Shqipëria zë vend në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është ndër me aktive ne botë. Në këtë brez, pjesa më aktive nga pikpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon (34-43° N; 18-30°E), ndodh të paktën një tërmet me $M > 6.5$ (Papazachos, 1989).

Shqipëria është një ndër vendet më sizmoaktive në Evropë. Shumica e tërmeteve të fortë ndodhin në 3 breza sizmike mirë të përcaktuar, si vijon (shih figurën në vijim):

- Brezi tërmetor Adriatiko-Jonik në buzën lindore të mikroplakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje;
- Brezi tërmetor Peshkopi-Korçë me shtrirje veri-jug, dhe
- Brezi tërmetor Lushnjë-Elbasan-Dibër me shtrirje veri-lindore³.

Epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive ⁴

Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M \leq 5.0$), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Përgjithësisht tërmetet e Shqipërisë dhe rajoneve përreth kanë vatra të cekta, thellësia e të cilave shkon nga 10-25 km.

Territori i Bashkisë Vau-Dejës zë vend në shtrirje përgjatë të brezit tërmetor Adriatiko-Jonik, tërmetet e fuqishëm të të cilit kanë kushtëzuar potencilain sizmik të saj. Më poshtë po japim përshkrime të shkurtëra për disa nga tërmetet më të fortë që kanë goditur Shqipërinë nga rajoni i Durrësit deri në Shkodër e nga deti Adriatik në kufirin lindor; tërmetet që kanë influencë më të drejtpërdrejtë me Bashkinë Vau Dejës.

³ Sulstarova etj., 1980; Aliaj, 2003b

⁴ Sh. Aliaj, 1988.




Fig. 23: Harta e epiqëndrave të tërmetejeve karakteristike⁵

3.1.5.3 Tërmetet e vitit 1905 (Tërmetet e Shkodrës)

Përfaqësojnë një nga seritë më të mëdha të tërmetejeve të fortë të zonës së Shkodrës. Intensiteti i lartë, numri i madh i pasgoditjeve, pasojat e goditjes kryesore dhe pasgoditjeve më të forta kanë qënë objekt i shumë studimeve sizmologjike⁶.

Goditja më e fortë ka ndodhur në 1 qershor 1905. Magnituda e këtij tërmeti është përcaktuar $M_S=6.6$; dhe intensitet mbi 9 balle; shkaktoi dëmtime të rënda në njerëz dhe pasuri në Shkodër dhe fshatrat përreth (veçanërisht në fshatrat në jug- perëndim të Shkodrës). Janë shkatëruar plotësisht rreth 1500 shtëpi banimi vetëm në qytetin e Shkodrës; të gjitha shtëpitë e tjera të këtij qyteti u dëmtuan rëndë; u demtua edhe kalaja e Rozafës.

⁵ Nga Aliaj, 1979

⁶ S. Koçiaj e E.Sulstarova, 1980




Fig. 24: Harta e izoseistëve të tërmetit të 1 Qershorit 1905

Ky tërmet shkaktoi rreth 200 të vdekur dhe 500 të plagosur. Lëkundjet e këtij tërmeti në pjesën më të madhe të territorit të bashkisë Vau-Dejës janë vlerësuar me intensitet 8 ballë (shih figurën më sipër).

3.1.5.4 Tërmeti i 18 Dhjetorit 1926

Në dhjetor të vitit 1926 Durrësi dhe rajonet rreth tij u goditën nga një seri tërmetesh shumë të fortë. Goditja e parë e fortë ndodhi më 16 dhjetor; ajo u pasua nga goditje të tjera të forta më 17 dhjetor. Më 17 dhjetor, ndodhi një goditje e fortë, e cila u pasua nga një goditje më e fuqishme që demtoi Durrësin, Shijakun e Ishmin; u shkatërruan dhe u dëmtuan shumë shtëpi. Kjo goditje kishte magnitudë $M_s=5.8$; ajo u shoqërua me shumë goditje të tjera. Me 18 dhjetor u regjistrua një goditje tjetër me magnitudë $M_s=6.2$. Kjo goditje shkatërroi e dëmtoi shumë rëndë shumë godina në Durrës, Kavajë e Shijak se dhe në fshatrat rreth tyre. Në shkallën e dëmtimit padyshim kanë influencuar dhe goditjet e forta që paraprinë atë. Në Kavajë u dëmtuan rëndë të gjitha shtëpitë dhe u këputën minaret e xhamive. Midis Durrësit e Shijakut pati dukuri të lëngëzimit të truallit të shfaqura me shatërvane me ujë të nxehtë e sulfur dhe pseudovullkane balte, rere e ujë.

Tërmeti u ndje shumë fort në Tiranë ku populli doli në panik nga shtëpitë; u ndje fort në Shkodër, Berat, Lushnjë, Elbasan. Në Itali u ndje 5 ballë në Pulja; ndërsa në Greqi 4 ballë në Janinë e Korfuz. Intensiteti i tërmetit është vlerësuar 9 ballë të shkallës MSK-1964, Ky tërmet është shoqëruar nga shumë pasgoditje të cilat vazhuan edhe gjatë vitit 1927.

Intensiteti i këtij tërmeti në zonën e Bashkisë Vau-Dejës ka qenë deri 7 ballë të shkallës MSK-1964 (shih figurën në vijim).



Fig. 25: Harta e izosejsteve të tërmetit të 17 dhjetorit 1926

3.1.5.5 Tërmeti i 30 Nëntorit 1967

Tërmeti i 30 Nëntorit 1967 pati një magnitudë $M_S=6.6$ dhe intensitet 9 balle dhe dëmtoi rëndë rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit si dhe një pjesë të territorit të Maqedonisë perëndimore. Në rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit nga ky tërmet u prekën 13 lokalitete me 177 fshatra, vdiqën 12 veta dhe u plagosën 174 të tjerë.




Fig. 26: Harta e izoseisteve të tërmetit të 30 Nëntorit 1967

Viktima në njerëz pati edhe në territorin e Maqedonisë Perendimore. Ky tërmet është shoqëruar nga më shumë se 1200 pasgoditje. Ky tërmet është ndjerë në zonën e Bashkisë Vau-Dejës si një lëkundje 5-6 ballëshe (figura më sipër).

3.1.5.6 Tërmeti i 15 Prillit 1979

Tërmeti i 15 Prillit 1979 (tërmeti i zones kufitare Shqiperi-Mali i Zi), është një nga më të fortët që ka goditur gadishullin e Ballkanit gjatë shekullit të XX-të. Magnituda e tij është llogaritur $M_s=7.2$ dhe intensiteti në epiqendrë është vlerësuar 9-10 ballë të shkallës MSK-1964. Epiqendra e këtij tërmeti është në bregdetin Adriatik, pranë Petrovacit, në Mal të Zi. Shumë paragoditje e kanë paraprirë këtë tërmet rreth dy javë para goditjes kryesore të 15 Prillit, kurse pasgoditjet vazhduan për rreth 9 muaj. Pasgoditja më e fortë është ajo e 24 Majit 1979, me magnitudë $M_s=6.3$. Intensiteti i këtij tërmeti në epiqendrë është 8 ballë (MSK-64). Goditja kryesore e 15 Prillit shkaktoi 35 të vdekur dhe 382 të plagosur në Shqipëri. Më shumë se 100.000 banorë (shumica në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës, përfshi një pjesë të territorit të bashkisë Vau Dejës) mbetën pa shtëpi. U shkatëruan pothuajse plotësisht 17.122 shtëpi banimi dhe objekte social-kulturore. Dëmet më të mëdha në njerëz dhe të mira materiale u shkaktuan në bregdetin Malazez. Tërmeti i 15 Prillit 1979 u ndie fort në të gjithë territorin e Shqipërisë. Lëkundjet e këtij tërmeti shkaktuan dëmtime edhe në rrethin e Krujës; intensiteti i lëkundjeve në Bashkinë Vau-Dejës ka arritur 8 ballë (figura më poshtë).



Fig. 27: Harta e izoseisteve të tërmetit të 15 Prillit 1979

3.1.5.7 Vendosja gjeologjike e neotektonike krahinore

Orogjeni shqiptar, pjesa më jug-perendimore e pllakës Euroaziatike, konvergjent me mikroplakën e Adrias, ndahet në dy treva me regjim tektonik ndryshëm: treva e jashtme me regjim shtypës, që përfshin pjesën bregdetare të tij, ku zë vend zona e Bashkisë Vau-Dejës, dhe treva e brendëshme me regjim zgjerues, që zë vend në brendësi të vendit.

Katër njësitë e mëdha neotektonike janë shënuar në hartë me numra: 1. Njësia e brendëshme, 2. Njësia e jashtme (02: sektorët detar të saj), 3. Ultësira anësore Pranadriatike (03: sektori detar i saj), 04. Platforma në detet Adriatik e Jon (04a: Platforma Apuliane, 04b: Baseni Shqiptar) (figura në vijim).




Fig. 28: Harta e zonimit neotektonik (Pliocen-Kuaternar) të Shqipërisë

Si periudhë neotektonike është pranuar ajo Pliocen-Kuaternare që i korespondon ngritjes së fuqishme e progresive në rajonin Mesdhetar në përgjithësi, dhe në Shqipëri në veçanti . Fillimi i periudhës neotektonike shënohet qysh në Pliocen me tektonikën në zgjerim që kapi trevën e brendëshme dhe krijoi atje struktura horst-grabenore. Fusha e sotme e sforcimeve tektonike është studjuar mirë nëpërmjet aplikimit të metodës mikrotektonike dhe zgjidhjeve të mekanizmit fokal të tërmeteve . Boshti mesatar i shtypjes në trevën e jashtme ka orientim VL-JP (azimut mesatar 225°),

ndërsa boshti mesatar i tërheqjes në trevën e brendëshme është VVP-JJL (azimut mesatar 340°). Balli i orogjenit Shqiptar pritet e spostohet, nga jugu në veri, nga shkëputjet e tipit shtytës Ishulli Othon-Dhërmi (α), Gjiri i Ariut-Dukat (β), veriu i Ishullit të Sazanit (γ), dhe Gjiri i Drinit-Lezhë (δ).

Zona ku zë vend Bashkia Vau-Dejës përfshin një pjesë të Ultësirës Pranadriatike, dhe një pjesë të zonës Kruja, terrenet e të cilave janë kapur fuqishëm nga lëvizjet shtypëse pas-Pliocenike.

3.1.5.8 Zona sizmoaktive joniko-adriatike - bashkia e Vau Dejës

Sizmotektonika analizon lidhjen midis shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive dhe tërmeteve të gjeneruar prej tyre. Epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive (Aliaj, 1988).

Në hartën sizmotektonike të Shqipërisë janë paraqitur shkëputjet aktive me tipin e deformacionit dhe kronologjinë e aktivitetit të tyre, epiqendrat e tërmeteve sipas magnitudës, si dhe izovijat e intensiteteve maksimale të vrojtuar (Fig. 3.22).

Dy zona gjatësore dhe dy zona tërthore të shkëputjeve aktive evidentohen mire në orogjenin Shqiptar, si vijon:

- Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbihipëse me shtrirje VP deri afersisht VVP,
- Zona Peshkopi-Korçë e shkëputjeve normale grabenore me shtrirje V-J,
- Zona Shkodër-Tropojë e shkëputjeve normale me shtrirje VL,
- Zona Elbasan-Dibër e shkëputjeve normale me shtrirje VL.

Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbihipëse ku zë vend Bashkia e Vau-Dejës është zona më e gjatë, që ndiqet për shumë qindra km përgjatë bregdetit Adriatik e Jonian, edhe jasht territorit tonë, dhe ndahet në tre segmente nëpërmjet tërthoreve Shkodër-Pejë pranë Vau Dejës dhe Vlorë-Tepelenë, si vijon:

- Segmenti verior me shtrirje perendimore-veriperendimore përmban shkëputje para-Pliocenike mbihipëse në shtypje të pastër të zonës Kruja (Dalmate).
- Segmenti qendror me shtrirje veriore deri veri-veriperendimore përbëhet nga shkëputje pas-Pliocenike mbihipëse në shtypje oblike të Ultësirës Pranadriatike dhe te zones Kruja. Pikërisht këtu zë vend bashkia Vau Dejës.
- Segmenti jugor me shtrirje VP përbëhet nga shkëputje para-Pliocenike mbihipëse në shtypje të pastër kryesisht të zonës Jonike.

Zonat e shkëputjeve aktive janë pikërisht zonat sizmoaktive (zonat ku gjenerohen herë pas here tërmetet), të konfirmuara nga fakti se epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive.




Fig. 29: Harta sizmotektonike e Shqipërisë

Në hartën sizmotektonike përvijohen qartë zonat e shkëputjeve kryesore sizmoaktive në Shqipëri me potencialin e pritshëm sizmik. Dy nga zonat e shkëputjeve sizmoaktive gjatësore: Joniko-Adriatike dhe Peshkopi-Korçë (zona sizmoaktive e Drinit, siç quhet ndryshe), dhe zona e shkëputjeve tërthore Lushnjë-Elbasan-Dibër paraqesin zonat sizmoaktive me potencialin sizmik më të lartë (shih figurën më sipër).

Zona e Bashkisë Vau-Dejës, që bën pjesë në zonën sizmoaktive Joniko-Adriatike, vlerësohet me potencial sizmik me magnitudë 6.0-7.0 ballë shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64.

3.1.5.9 Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i bashkisë Vau-Dejës

Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i zonës ku zë vend Bashkia e Vau-Dejës është bazuar në studimin e rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë, i botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitin 2011.

Vlerat e shpejtit maksimal të truallit - PGA janë llogaritur për truall shkëmbor, për dy nivele probabiliteti:

- 10 % probabilitet tejkalimi në 10 vjet
- 10 % probabilitet tejkalimi në 50 vjet

(koha e ekspozimit ose e jetëgjatësisë ekonomike), që u korespondojnë dy periodave të përsëritjes të tërmeteve: 95 vjet dhe 475 vjet, në përputhje të plotë me EC 8).

Rezultatet e rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë janë llogaritur me relacionin e shuarjes të lëkundjeve të forta të Sadigh etj., për zonat perendimore të burimeve sizmike me rregjim shtypës dhe me relacionin e Spudich etj., për zonat lindore me rregjim zgjerues, dhe janë paraqitur në hartat e rrezikut sizmik.




Fig. 30: Harta e PGA për Vau Dejës në truall shkëmbor, me RP 475 vjet


Në Hartën e Rrezikut Sizmik probabilitar për periodë përsëritje 475 vjet (shih figurën më sipër), konstatohet që vlerat e shpejtit maksimal të truallit - PGA shkojnë nga 0.4g në pjesën perendimore deri në 0.22g në skajin veri-lindor të bashkisë.

Nga vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik i Bashkisë Vau-Dejës, i kryer për truall shkëmbor dhe për probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periodë përsëritje të tërmeteve, janë përfutur parametrat e rrezikut sizmik të paraqitura në tabelën në vijim. Vlerat e shpejtit maksimal të truallit – PGA (mesatar) për periodë përsëritje 475 vjet në truall shkëmbor në territorin e Bashkisë të Vau-Dejës variojnë nga 0.251 g në Temal, në 0.389 g në Bushat që është dhe zona me rrezikun më të lartë.

Tabela 9: Vlerat e rrezikut sizmik: PGA e SA (g) për Bashkinë Vau Dejës

Bashkia Vau Dejës Njësitë Administrative	PGA (g)	PGA (g)	PGA (g) mesatare	
	minimal	maksimal	10%/50vjet	10%/10vjet
Bushat	0.357	0.402	0.389	0.215
Vau Dejës	0.268	0.375	0.317	0.190
Vig-Mnelë	0.289	0.364	0.331	0.167
Hajmel	0.349	0.385	0.370	0.199
Temal	0.226	0.266	0.251	0.145
Shllak	0.250	0.288	0.264	0.145
Shënim: Kjo tabelë jep vlerat e rrezikut sizmik (PGA) për Bashkinë Vau Dejës me probabilitet 10%/10 vjet (95 vjet periudhë përsëritje) dhe 10%/50 vjet (475 vjet periudhë përsëritje) në truall				

PGA mesatare sipas njësive administrative

**Fig. 31: Paraqitje grafike e rrezikut sizmik për njësitë administrative**

Këto vlera të parametrave të rrezikut sizmik kanë rëndësi praktike për ndërtimet në secilën Njësi Administrative të bashkisë Vau Dejës dhe mund të përdoren nga inxhinierët e ndërtimit për projektimin e ndërtesave. Gjithsesi ato mbeten vlera referencë për objektet shumë katëshe dhe ato të rëndësishme të veçantë, pasi në këto raste është i domosdoshëm një vlerësim i detajuar sizmik dhe konsiderimi i amplifikimit nga depozitimet (studimi gjeologjik i truallit).

3.1.5.10 Përfundime dhe rekomandime

Nga studimi për vlerësimin e rrezikut sizmik të Bashkisë Vau-Dejës, nxjerrim këto përfundime dhe rekomandime:

Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i territorit të bashkisë të Vau-Dejës, është kryer duke u bazuar në metodologjinë probabilitare të rrezikut sizmik për Shqipërinë, që jepet në punimin shkencor “Sizmiciteti, Sizmotektonika dhe Vlerësimi i rrezikut Sizmik në Shqipëri”, i botuar në vitin 2010 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe i përgatitur nga Profs. Shyqyri Aliaj, Siasi Koçiu, Betim Muço e Eduard Sulstarova. Vlerat e shpejtimit (akseleracionit) maksimal horizontal të truallit - PGA janë llogaritur

për truall shkëmbor, për dy nivele probabiliteti: 10 % probabilitet tejkalimi në 10 vjet dhe 10 % probabilitet tejkalimi në 50 vjet (koha e ekspozimit ose e jetëgjatësisë ekonomike), që u korespondojnë dy periodave të përsëritjes të tërmeteve: 95 vjet dhe 475 vjet, në përputhje të plotë me Eurokodin 8.

Për bashkinë Vau-Dejës, si kudo në Shqipëri, rekomandohet të merren në konsideratë rezultatet e parametrave të rrezikut sizmik për probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periodë përsëritje të tërmeteve, çka dëshmohet nga studimet për rrezikun nga tërmetet në Shqipëri, ku një tërmet me magnitudë 7.0 ballë shkalla Rihter (tërmeti më i fortë i mundshëm në Shqipëri) mund të përsëritet çdo 500 vjet.

Zona e Bashkisë Vau-Dejes edhe në të ardhmen pritet të preket nga tërmete të fortë me magnitudë 6.0-7.0 ballë shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64.

Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit – PGA për periodë përsëritje 475 vjet në truall shkëmbor në territorin e bashkisë Vau-Deës variojnë nga 0.251 g në Temal, në 0.389 g në Bushat (shih Tabelën).

Vlerat e parametrave të rrezikut sizmik të paraqitura në kanë rëndësi praktike për ndërtimet në bashkinë Vau Dejës dhe duhet të merren në konsideratë për zhvillimin urban të saj, në veçanti për ndërtimet e ardhshme, por edhe për vlerësimin e vulnerabilitetit të strukturave ekzistuese (kryesisht ato me karakter publik-social, si spitale, shkolla etj.).

3.1.6 Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike

Bashkia e Vaut të Dejës, përfshin në juridiksionin e saj një territor mjaft të gjerë dhe të pasur me objekte të trashëgimisë kulturore, të shpallura me status “monument kulture” si dhe objekte të tjera me vlerë pa status.

Objekte të Trashëgimisë Kulturore të shpallura me status “Monument Kulture” :

- Kalaja e Sapës, shek. VII p.e.s., vendndodhja Nënshat
- Kalaja e Vigut, shek. I, vendndodhja Vig.
- Zona Arkeologjike “A” dhe “B” e Vendbanimit të Komanit shek.I vendndodhja Koman
- Varrezat e Lashta të Komanit, shek.VI-IX, vendndodhja Koman.
- Kalaja e Dalmacës, shek. V / VIII-IX, vendndodhja Koman
- Kisha e Shën Mërisë, shek.VIII, vendndodhja Vau Dejës.
- Kalaja e Vau Dejës, shek. XIV, vendndodhja Vau Dejës
- Rrënojat e Kishës së Shën Markut, shek.VIII-IX, vendndodhja Vau Dejës.
- Kalaja e Shurdhahut, shek. XI, vendndodhja Hajmel
- Kompleksi Ndre Mjeda dhe Zona Mbrojtëse, shek. XX, vendndodhja Kukël

Pjesa më e madhe e këtyre vlerave të trashëgimisë kulturore për shkak të rrethanave historike, kanë meritur deri në ditët tona në gjendje rrënojë, ardhur si pasojë e shkatërrimeve të bëra nga pushtuesit osman. Njoftimet më të vjetra edhe pse të pakta për këto monumente, gjenden ndër burime historike të periudhës mesjetare. Në këto

dokumente ka të dhëna me mjaft vlerë për numrin dhe vendndodhjen e monumenteve, madhësinë dhe mënyrën e ndërtimit të tyre. Studimet e para të arkitekturës së këtyre ndërtimeve janë të fundit të shekullit XIX, nga konsulli i atëhershëm austriak në Shkodër Teodor Ippen.

Gjatë luftërave për nënshtrimin e Ilirisë dhe Epirit romakët u dogjën dhe u shkatërruan një numër i madh qytetesh të fortifikuar dhe kështjellash. Në shekujt e parë të erës sonë vihet re një ndërprerje e veprimtarisë fortifikuese që përkon me të ashtuquajturën “paqe romake”, por më tej për të përballuar dyndjet e “barbarëve” dhe lëvizjet e brendshme, ajo rinis sërish. Veprimtaria e ndërtimit të fortifikimeve në periudhën e vonë antike fillon nga fundi i shek. III dhe fillimi i shek. IV.

Ndërtimet e kultit të Shqipërisë së Veriut, në drejtim të arkitekturës së tyre paraqesin një sërë veçantish të kushtëzuara nga lidhja gjithnjë e peshkopatave të kësaj zone me kishën e Perëndimit. Në këto rrethana, kemi krijimin e trajtave të veçanta, të kushtëzuara nga influencat arkitekturale të Bizantit apo perëndimit.

Mangësitë e burimeve të shkruara nga Mesjeta e hareshme shqiptare ndikuan që t'u jepej përparësi kërkimeve arkeologjike shqiptare si një nga mundësitë parësore për të ndriçuar këtë periudhë të hershme ku ndërthuren tre kultura të ndryshme të të gjithë trevës së Veriut, Malësisë, Mirditës dhe Zadrimës.

KALAJA E SAPËS

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin R.U.SH. Nr. 6, datë 15.01.1963.

Koordinatat Gjeografike: 41°56'37.00"N 19°40'2.93"E

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Kala. Shek. VII p.e.s.

Njësia administrative Hajmel, vendndodhja: Nënshat

Përdorimi : Kala. DRKK Shkodër.




Fig. 32: Pamje nga Kalaja e Sapës

Pozita gjeografike.

Qyteti ngrihej në brendësi të malit të Shën Mëhillit (sot mali i Nënshatit) në një tarracë natyrore rreth 30 m pa mbërritur në majën e malit, duke i dhënë një mbrojtje të sigurt ndaj sulmeve.

Të dhëna historike.

Dioqeza e Sapës ka një histori 950 vjeçare dhe ajo ndodhej brenda qytetit me të njëjtin emër i cili ishte dhe i fortifikuar. Pikërisht ky sistem mbrojtës njihej si Kalaja e Sapës. Të dhënat e para për këtë qytet i kemi nga Annuali i Selisë së Shenjtë që në vitin 1062. Me rënien e perandorisë bizantine nën sundimin e feudalëve latin në vitin 1204, në territoret e Shqipërisë së mesme e të veriut krijohen një serë peshkopatash të reja të lidhura me perëndimin katolik, ku ato të veriut lidhen nëpërmjet kryepeshkopatës së Tivarit. Kështu kemi themelimin e peshkopatës së Sapës në vitin 1291 e cila njihet nga burimet historike dhe si një fortifikim. Prej tyre mësojmë se selia e peshkopatës së Sapës ndodhej në malin e lartë të mbiemëruar dhe mali i Shën Mëhillit nga emri i katedrales së saj. Sistemi mbrojtës i kësaj peshkopate njihej si Kalaja e Sapës, ku vendndodhja e saj transmetohej dhe nga relacionet e udhëtarëve prej shekulli XVII e këtej.

Me interes të veçantë është e dhëna e peshkopit të Sapës së Zadrimës, Frang Bardhit në relacionin e tij mbi gjendjen në Zadrimë dërguar Romës në vitin 1641, sipas së cilës në këtë vend bashkëbanuan dikur zotërinjtë Dukagjinës me peshkopin e Zadrimës.

Arkitektura dhe teknika e ndërtimit.

Kalaja e ardhur në gjendje rrënojë, bashkë me rrënojat e qytetit brenda saj, ngihet në lartësinë 580 m mbi nivelin e detit tashmë mes një vegjetacioni të dendur dhe të vështirë për tu evidentuar. Porta nga ana jugore ruan vetëm portikun. Në terren vërehen përqendrimet e qeramikës mesjetare të fragmentuar. Mbetjet e murit rrethues janë të përmasave të mëdha në ndryshim nga pjesa e sipërme ku përdoren gurë të vegjël të lidhur mes tyre me llaç. Kjo ndërthurje në kohë, me lëkundje të influencave dhe të administratës kishtare lindore dhe perëndimore ndikoi dhe në arkitekturën e kishave të kësaj krahine. Në lartësinë 30-40 cm ruhen ende disa struktura banimi, si dhe në lindje pjesë të strukturës së kishës së Shën Mëhillit. Kjo periudhë për studiuesit e arkitekturës së kultit: mesjeta e hershme, përbën një periudhë ku mungojnë dëshmitë e drejtpërdrejta për monumentet.

Ndërhyrjet restauruese.

Nuk është bërë asnjë ndërhyrje restauruese si në drejtim të monumentit ashtu dhe të mjedisit rrethues.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrimi nga vegjetacioni i bimësisë për hapjen e shtegut dhe evidentimin e sitit. Gjithashtu propozohet konservim dhe konsolidim i kreut të mureve për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të tyre, si dhe mundësia e vendosjes së sinjalistikës orientuese dhe informuese në lidhje me këtë monument dhe objektet e tjera në zonë.

Infrastruktura.

Kalaja e Sapës ndodhet në rrugën Lezhë - Vau Dejës. Rruga automobilistike për të shkuar në objekt është në gjendje të keqe dhe paraqet nevojën e ndërhyrjes.

Turizmi.

Vendndodhja e Kalasë së Sapës në një tarracë natyrore rreth 30 m pa mbërritur në majën e malit të Shën Mëhillit (sot mali i Nënshatit), krijon mundësi të mira për zhvillimin e turizmit malor në këtë zonë.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- *Të futet në planet e saj, rikonstruksioni i rrugës që të çon te kalaja.*
- *Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e bimësisë rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij si një mundësi kjo, e njohjes së vlerave të objektit.*
- *Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.*
- *Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.*

KALAJA E VIGUT

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin Nr. 586, datë 17.03.1948/Nr. 4874, datë 23.09.1971, aprovuar me Ligjin Nr. 609, datë 24.05.1948

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Kala. Shek. I.

Njësia administrative: Vig-Mnelë, vendndodhja: Vig.

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.



Fig. 33: Pamje nga Kalaja e Vigut

Pozita gjeografike.

Kalaja e Vigut është një ndër tri kalatë (castrumet) ushtarake romake në territorin shqiptar. Gjendët në një kryqëzim rrugësh antike mes Lezhës e Mirditës. Ajo është një kështjellë ushtarake dhe me funksion ekonomik ku një veçori e saj është dhe komunikimi si rezultat i kontrollit të vijave të qarkullimit gjë që faktohet me pozicionimin e vendosjes së saj në nyjet kryesore të lëvizjes.

Kalaja e Vigut ndodhet në terren të rrafshët në luginën e lumit Gjadër , në vendin ku bashkohet lumi i Vomës me lumin e Gjadrit në kuotën 151. Në veri kufizohet me lumin Gjadër dhe në perëndim e jug me zallishten e këtij lumi.

Të dhëna historike.

Kalaja fushore romake, siç janë edhe disa të tjera të tilla në Shqiperi, në atë kohe ishte pjesë e rrugëve të rëndësishme tregtare që kalonin përmes këtij kryqëzimi Shkodër - Orosh dhe Lezhë - Pukë - Prizren. Ajo mendohet të jetë ngritur diku mes fundit të shekullit të tretë dhe fillimit të atij të katërt siç zbulon eksperti dhe studiuesi i njohur i fortifikimeve, profesor Gjerak Karaiskaj.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Kalaja e Vigut ka një sipërfaqe 0.6 ha dhe formë trapezi të çrregullt me mure 2.20 m të gjerë të punuar me teknikën e muraturës së përzier. Në gjendjen e sotme, kalaja vjen në formë rrënojë me mure pothuaj gjatë gjithë perimetrit të saj të ngritura në lartësitë që variojnë 0.5 m-2.5 m ku dallohet mjaft qartë teknika e ndërtimit të mureve.

Teknika e ndërtimit të mureve karakterizohet me përdorimin e gurëve të zallit të lidhura me llaç, fugaturat e gjëra mes mureve kanë të vendosura copa tjegullash ose tullash për të mbushur boshllëqet. Kështjella përforcohet prej 12 kullash të fuqishme: drejtkëndëshe në meset, me ballë të lakuar në hyrjet dhe në formë freskoreje në anët e mureve.

Në zonën e Kalasë së Vigut , pranë varrezave ndodhen një kishë e vjetër, ku thuhet se ka shërbyer Ndre Mjeda.

Ndërhyrja restauruese.

Gjatë viteve 1980-1985 është ndërhyrë me punime mirëmbajtjeje në kala. Janë kryer punime si konsolidim të mureve. Prej vitesh tashmë, një pjesë të kalasë vazhdojnë ta marrin prurjet e përroit të Vomës dhe lumi të Gjadrit që kalojnë shpesh në këtë vend sidomos gjatë periudhës së dimrit. Një pjese muresh kanë rënë, të tjerët po gërryhen gjithnjë e më shumë.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale Shkodër është propozuar planifikimi i fondeve për ndërhyrje në restaurimin, konsolidimin e mureve si dhe marrja e masave ndaluese si rezultat i gërryerjeve të lumenjve.

Infrastruktura.

Rruga drejt fshatit Vig, është rreth 99 km nga Tirana. Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është pjesërisht e keqe dhe duhet ndërhyrë në infrastrukturën e saj.

Turizmi.

Kalaja e Vigut shihet si një potencial për zhvillimin e turizmit në këtë zonë duke përmirësuar dukshëm infrastrukturën e rrugës, restaurimin e monumentit si dhe ndërhyrjen në mjedisin rrethues.

Banorët tregojnë se hera-herës vijnë edhe turistë shqiptarë e të huaj, ngrenë kampingje e qëndrojnë këtu disa ditë. Në kushtet e një situate tjetër Kalaja e Vigut do

të ishte një resurs i jashtëzakonshëm për fshatin që sot është tkurrur nga 300 shtëpi në vetëm rreth 35 të tilla.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- *Të futet në planet e saj, rikonstruksioni i rrugës që të çon te kalaja.*
- *Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e bimësisë së mjedisit rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij si një mundësi e mirë kjo për njohjen dhe promovimin e vlerave të monumentit.*
- *Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.*
- *Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.*

ZONA ARKEOLOGJIKE “A” dhe “B” E VENDBANIMIT TE KOMANIT (DALMANJA E VJETER) DHE RREGULLORJA E ADMINISTRIMIT

Monument kulture kat. I, shpallur me V.K.M. Nr. 786, datë 22.09.2015

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Vendbanim; Shek. I.

Njësia administrative: Temal, vendndodhja: Koman.

Përdorimi: Zonë arkeologjike. DRKK Shkodër.

Pozita gjeografike.

Komani, i cili ndodhet rreth 32 kilometër në lindje të qytetit të Vaut të Dejës, është një zonë e thellë malore mes Pukës, Tropojës dhe Shkodrës ku ndodhet hidrocentrali i Komanit si dhe fshati me të njëjtin emër.

Të dhëna historike.

Vendbanimi i Komanit i ka dhënë emër një qytetërimi të tërë mesjetar në Ballkanin Perëndimor, ku pothuajse e gjithë shtrirja përkon në territorin shqiptar. Për ti paraprirë studimit është ndërtuar një projekt i madh arkeologjik që do të zgjasë me vite pikërisht për zbulimin e këtij vendbanimi të rrallë. Zbulimet tregojnë se bëhet fjalë për një qendër të shtrirë minimumi në 35 ha më një vitalitet ndërtimor dhe dendësi banimi të jashtëzakonshme të paktën përgjatë 1000 viteve.



Fig. 34: Zona arkeologjike A dhe B

Rregullorja e Administrimit.

Qeveria shqiptare ka shpallur zonat e vendbanimit të Komanit, si zona arkeologjike. “Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 30, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave vendosi: 1. Shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër), sipas hartës dhe koordinatave gjeografike bashkëlidhur këtij vendimi. 2. Miratimin e rregullores “Për administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër)”, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi”, thotë vendimi.

Me këtë akt, qeveria zyrtarizon mbrojtjen sipas ligjit të këtij vendbanimi, shumë i rëndësishëm për historinë e antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme në Shqipëri. Komani si vendbanim, i ka dhënë emrin Kulturës së Komanit, përdorur nga historiografia shqiptare dhe arkeologjia, si përkufizues i hipotezës së kalimit nga ilirët tek arbrit. Në zonën arkeologjike “A”, të Vendbanimit të Komanit (Dalmacija e Vjetër), lejohet: rikonstruksioni i rrugëve dhe punimet për rrjetet e infrastrukturës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, në vazhdim “KKA”, dhe nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në vazhdim “KKR”.

Restaurimi e konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e formave të testimit, të përcaktuara me vendim të KKA-së, projektet kërkimore shkencore, të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKA-ja dhe KKR-ja. Konstruksionet, të cilat vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme). Projekti për këto ndërhyrje miratohet nga KKA dhe KKR. Në zonën arkeologjike “B”, të Vendbanimit të Komanit lejohen zhvillimet ndërtimore, pas miratimit me shkrim nga KKA dhe KKR. Punime zhvillimore, vetëm pas kryerjes së formave të testimit. Format e testimit përcaktohen nga KKA-ja. Për çdo ndërhyrje në zonën arkeologjike “B” subjekti ndërtues i interesuar duhet të marrë konfirmimin nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, në vazhdim “DRKK”, përgjegjëse për Vendbanimin e Komanit

VARREZAT E LASHTA TE KOMANIT.

Monument kulture kat.I, shpallur me Vendimin e R.U.Sh. Nr.6, datë 15.01.1963

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Banesa; Shek. VI-IX

Fshati: Koman . Njësia administrative: Temal.

Përdorimi: Rrënoja varrezash. DRKK Shkodër.




Fig. 35: Pamje nga Varrezat e Komanit

Pozita gjeografike.

Varrezat e Lashta të Komanit nga emri i fshatit ku ndodhen, ndryshe njihen dhe si Kultura e Komanit. Ato shtrihen në një kodër të lartë 586 m mbi nivelin e detit, në pjesën më të butë të saj me drejtimin Lindje - Perëndim. Varrezat përfshijnë një sipërfaqe prej 1 ha dhe deri më sot janë gërmuar dhe nxjerrë në dritë mbi 150 varre.

Të dhëna historike.

Kjo varreze u gërmua për herë të parë në vitin 1898 nga Degrand e më pas në vitin 1902 nga Han dhe T.Ippen. Interesi për këtë kulturë u shtua edhe gjatë gjysmës së parë të shek. XX, gjë që duket nga numri i shumtë i studiuesve, që u morën me interpretimin e lëndës arkeologjike të grumbulluar nga zbulimet e bëra në varrezën e Komanit (S.Reinah, T.Ipen, P.Treger, Fr.Nopça, L.Ugolini, L.Rei, H.Bule, D.Mustili, M.Garasanin, J.Kovaçević, J.Koroshec etj.). Edhe pse gjatë gjysmës së parë të shek. XX u bënë kërkime e studime të shumta rreth kulturës së Komanit, problemet themelore të saj mbeten të pazgjidhura.

Kultura arbërore daton në dy faza, e para nga shekulli i VI deri në atë të VIII pas Krishtit, është faza kur gjithë territori Ilirisë së asaj kohe ishte i krishterë. Kjo është faza kur gjithë Iliria e asaj kohe kishte marrëdhënie administrative me Bizantin dhe Romën, pra kemi një miksazh të disa kulturave që kalojnë në territorin e Shqipërisë. Faza e dytë lidhet me shekujt IX dhe XIII-XIV dhe është koha kur territoret tona kanë qenë të pushtuar nga Bullgarët, por këtu vërejmë elemente të fortë të krishterë, që tregon në mënyrë të qartë për prezencën e kësaj kulture dhe për lidhjet e saj me trashëgiminë kulturore arbërore.

Punimet e gërmimit.

Pas vitit 1944 filluan dhe kërkimet e rregullta arkeologjike në kala, ku u zbulua për herë të parë varreza që përmban trashëgiminë kulturore të asaj që u quajt kultura arbërore.

Zbulimi i një sërë vendbanimeve prej guri, përdorimi i metalit, ndërtimi i shumë kishave dhe varrimet e të vdekurve të cilat kryheshin me veshje e stoli, si dhe gjetja e monedhave, flasin qartë për zhvillim ekonomik tejet të lulëzuar, një zhvillim i cili nuk është hasur më parë në asnjë vendbanim të hershëm në Shqipëri, e madje as në Ballkanin Perëndimor.

Ndërkohe një fushatë e gjerë gërmimesh nga arkeologë shqiptar, janë zhvilluar gjatë viteve 1956, 1962, 1978-1979, 1986. Ne bazë të gjetjeve dhe inventarëve të varreve kjo varrezë daton mes shek. VI-IX.

KALAJA E DALMACES

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin R.U.SH. Nr.6, datë 15.01.1963.

Koordinatat Gjeografike: 42° 5'35.58"N, 19°49'44.84"E

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Fortifikime; Tipologjia: Kala. Shek. V- VIII-IX.

Njësia administrative: Temal, vendndodhja: Koman.

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.

Pozita gjeografike.

Kalaja e Dalmacës ndodhet në majë të malit, 600 m mbi nivelin e detit brenda zonës së banuar. Siti shtrihet në një territor që ka një sipërfaqe prej 2 ha dhe përbëhet nga

niveli i mesëm i habitatit dhe ai i poshtëm. Siti shtrihet pothuajse paralel në vijë ajrore me nekropolin e vendbanimit.



Fig. 36: Pamje nga Kalaja e Dalmacës

Të dhëna historike.

Kalaja e Dalmacës u gjurmua për herë të parë nga konsulli francez në Shkoder Degrand në 1899. Gërmimet e para aty u bënë nga albaniologu i njohur J.Han.

Kalaja e Dalmacës i përket zonës së Komanit ku falë zbulimeve arkeologjike me tepër vlerë të këtyre ditëve të fundit, po klasifikohet si qendra e qytetërimit të Shqipërisë në Mesjetën e hershme.

Zona po kthehet në një pikë referimi për studimin e qytetërimit të Ballkanit Perëndimor kontinental në periudhën e Mesjetës së hershme, atyre që quhen shekujt e errët të historisë. Sipas arkeologëve, zbulimet dëshmojnë për herë të parë një informacion të mjaftueshëm për atë periudhë të qytetërimit.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Në kalanë e Dalmacës, shohim nivelin e mesëm të vendbanimit i cili ka në përbërje të tij dhe zonën më intensive të gërmuar deri më sot. Ky nivel përfaqëson një zonë të dendur ndërtimesh të dokumentuara dhe një seri të konsiderueshme muresh e strukturash. Si fazë e parë e nivelit të mesëm të vendbanimit është fundi i periudhës antike. Ky vendbanim zë një sipërfaqe prej 105 m². Muret ruhen në lartësinë nga 0,60 m deri në 1,20 m.

Niveli i poshtëm i vendbanimit zë një sipërfaqe prej 230 m². Muret ruhen deri në lartësinë 1,42 m. Trashësia e tyre shkon në 60 cm. Këto mure janë të punuar mirë me llac dhe të fugatuar në mënyrë të rregullt. Ky nivel i vendbanimit mendohet të jetë më i voni ose i fundit, që shkon aty mes shekujve VIII-XII.

Zbulimi i një sërë vendbanimeve prej guri, përdorimi i metalit, ndërtimi i shumë kishave dhe varrimet e të vdekurve të cilat kryheshin me veshje e stoli, si dhe gjetja e monedhave, flasin qartë për zhvillim ekonomik tejet të lulëzuar, një zhvillim i cili nuk është hasur më parë në asnjë vendbanim të hershëm në Shqipëri, e madje as në Ballkanin Perëndimor.

Punimet e gërmimit.

Gërmimet në kalanë e Dalmacës në vitet e fundit janë financuar nga Ministria e Jashtme Franceze. Gërmimet kanë nisur prej disa vitesh. Veç disa monedhave të shekullit XI janë zbuluar shtëpi prej guri, objekte metali dhe një territor me rreth një mijë varreza. E gjithë sipërfaqja me banesa mendohet të jetë rreth 20 hektarë. Fakti që këtu ndodhen pesë kisha si dhe ndërtimet e gjetura që ruajnë teknikën romake të ndërtimit, flasin se këtu ka qenë një qytetërim tepër i lulëzuar në Mesjetën e hershme. Mendohet që në Koman të ketë qenë qendra e zhvillimit ekonomik dhe kulturor jo vetëm e Shqipërisë, por edhe e Ballkanit Perëndimor.

Prezenca e toponimeve të katër kishave në kalanë e Dalmacës në Koman, si ajo e Shën Gjergjit, Zonja e Mirë, Shën Mëhillit dhe e Shën Nikollit, tregon jo vetëm për shtrirjen e madhe të këtij qytetërimi, por dhe zhvillimin kulturor e kishtar të zonës, që njihej si krahina e Pultit të Sipërm. Zona e Pultit të Sipërm, që korrespondon me kalanë e Dalmacës, në bazë të fakteve dhe toponimeve të mbledhura ka qenë një ndër qendrat më të mëdha të krishterimit. Pamja nga ku gjenden rrënojat është madhështore. Nga njëra anë shihet rrugëtimi i Drinit që vjen nga malet e larta të Tropojës dhe vazhdon rrugën drejt Shkodrës, ndërsa nga ana tjetër malet.

Tani ky rajon po kthehet në një referencë për studiuesit dhe arkeologët, sepse jep informacion të bollshëm dhe me tepër vlerë për periudhën e errët të historisë që ka mungesë të plotë informacioni. Kjo zonë ka vlera të rralla arkeologjike dhe historike dhe puna do vazhdojë edhe në vitet në vijim. Për gjithë këto vlera, kjo zonë duhet të ruhet nga shteti, në të ardhmen pasi është një thesar për qytetërimin e Mesjetës.

Ndërhyrja restauruese.

Në këtë objekt nuk është kryer në vite, asnjë punim të karakterit restaurues të monumentit ashtu dhe punime me karakter konservues e konsolidues të muraturave si dhe të mirëmbajtës të mjedisit rrethues.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrim nga vegjetacioni, konservim dhe restaurim muresh. Hapje shtegu dhe vendosje e sinjalistikës orientuese.

Infrastruktura.

Nuk ka rrugë automobilistike për të shkuar deri te monumenti.

Turizmi.

Sot ky vendbanim historik, Kalaja e Dalmacës e ndodhur në majë të malit, 600 m mbi nivelin e detit brenda zonës së banuar, me shumë rrënoja të objekteve të së kaluarës, duhet të shfrytëzohet për turizëm kulturor dhe historik. Vendndodhja e tij në një peizazh të bukur natyror, në luginën e Liqenit të Komanit, i shton mundësitë për t'u vizituar nga turistët sidomos në periudhën verore.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- Të ndërtohet rruga që të çon te monumenti.

- *Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e mjedisit rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij të cilat gjenden në formë rrënojash.*

KALAJA E VAUT TE DEJES

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin Nr. 586, datë 17.03.1948/Nr. 4874, datë 23.09.1971, aprovuar me Ligjin Nr. 609, datë 24.05.1948

Koordinatat Gjeografike: 42° 0'46.85"N, 19°37'25.86"E

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia; Kala. Shek. XIV

Njësia administrative: Vau Dejës, vendndodhja: Vau Dejës.

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.




Fig. 37: Pamje nga Kalaja e Vaut të Dejës

Pozita gjeografike.

Kalaja e Vaut të Dejës ndodhet 18 km në jug-lindje të Shkodrës, në anën e majtë të grykës ku Drini del nga malet e derdhet në fushë në kuotën 206. Ajo ndodhet mbi një kodër shkëmbore rreth 120 m mbi nivelin e detit dhe përfshin të gjithë terrenin brenda mureve dhe jashtë duke u kufizuar nga veriu me lumin Drin, nga lindja me arat e punuara, nga jugu te Qafa dhe në perëndim deri te shtëpia e parë. Pozicioni i saj strategjik, krijon mundësinë e kontrollit të gjithë fushës së Zadrimës dhe rrugët kryesore që vinin nga Shkodra dhe Lezha të cilat bashkoheshin te dogana e Danjës.

Të dhëna historike.

Kalaja e Vau Dejës përmendet në dokumentet e shek. XII, kur ajo ishte një qendër episkopale dhe një nga qendrat më të rëndësishme të kohës që kontrollonte rrugën Shkodër-Prizren.

Gjatë viteve 1980` të shekullit të fundit janë bërë disa gërmime arkeologjike që tregojnë vendndodhjen e sundimtarëve të familjes Zaharia. Kjo familje luante një rol të rëndësishëm në ngjarjet që i përkasin periudhës së Skenderbeut. Sipas dokumenteve veneciane kjo kala është ndërtuar në vitin 1400.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Kalaja mesjetare ishte pjesë e një sistemi fortifikimi të luginës së Shkodrës dhe luginës së Drinit. Teknika e ndërtimit të mureve të kalasë së Dejës, respekton përgjithësisht teknikat e kalave mesjetare, me gurë të përmasave të vogla, të skuadruara dhe të punuara me kujdes. Gurët lidhen mes tyre me llaç duke ruajtur linjat e rregullta.

Ndërhyrjet restauruese.

Në vitin 2009 është organizuar një ekspeditë njohjeje në zonën Vau Dejës pranë Kalasë së Vau Dejës.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët. Fugatim dhe konservim muresh kryesisht në kreun e tyre.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është e keqe.

Turizmi.

Kalaja e Vaut të Dejës e ndodhur vetëm 18 km larg qytetit të Shkodrës, e vendosur mbi një kodër shkëmbore rreth 120 m mbi nivelin e detit, është një mundësi shumë e mirë e zhvillimit të turizmit malor në këtë zonë.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- *Të futet në planet e saj, rikonstruksioni i rrugës që të çon te kalaja.*
- *Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspeditave për pastrimin e bimësisë rreth e qark monumentit, hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij si një mundësi kjo e njohjes së vlerave të monumentit.*
- *Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.*
- *Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.*
- *Të kërkohet pranë ASHA aplikimi i fondeve për ekspedita gjurmimi në zonë.*

KISHA E SHEN MERISE

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin R.U.SH. Nr.6, datë 15.01.1963.

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Objekt kulti-kishë; Tipologjia: Kishë. Shek. VIII.

Njësia administrative: Vau Dejës, vendndodhja: Vau Dejës.

Përdorimi: Objekt kulti-kishë. DRKK Shkodër.



Fig. 38: Pamje nga Kisha e Shën Mërisë (përpara shembjes)

Pozita gjeografike

Kjo kishë është ndërtuar në këmbë të malit të Dejës ku ndodhen rrënojat e qytezës dhe fortesës mesjetare të Danjës, që për herë të parë përmendet si qendër peshkopale në vitin 361.

Të dhëna historike.

Sipas Marlin Barletit, në kishën e vogël të ndodhur në krah të kishës së madhe, Selisë Ipeshkvore, Gjergj Kastriot Skënderbeu ka pranuar Sakramentin e martesës. Këto dy kishat u hodhën në erë me dinamit në vitin 1967 në kuadrin e luftës kundër fesë duke shkaktuar një humbje të madhe të vlerave të trashëgimisë sonë kombëtare. Kisha e Shën Mërisë mendohet se është ndërtuar nga mbretëresha Helene.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Kisha e Shën Mërisë së Vaut të Dejës paraqiste një kishë një nefshe me planimetri drejtkëndëshe dhe absidë rrethore në anën lindore. Në kishë hyhej nga porta e vetme e saj e vendosur në anën perëndimore. Muret e kishës ishin të ndërtuar me gurë gëlqeror të gdhendur të lidhur me llaç gëlqereje me fuga të holla. Brendësia e kishës paraqiste një vëllim mbuluar me qemer cilindrikë me prerje harqesh të mprehtë, që mbështeteshin në një sistem harqesh mbajtës, harqesh të verbër dhe pilastrash. Me ritmin e tyre kjo tërësi pilastrash dhe harqesh me një qëndrueshmëri statike, përcaktonte dhe organizimin hapësinor të brendësisë së kishës e ndriçuar nga gjashtë dritare dhe e mbuluar me çati dyujse me tjegulla vendi.

Kisha kishte pësuar ndërtime në faza të ndryshme. Nga ndërtimi i parë që ruhej, ishte dritarja nga lindja e faqes jugore. Ajo ishte e ndërtuar me mermer të bardhë, pragu i saj zbukurohej me motive bimore të stilizuara dhe përbënte një dëshmi me vlerë për zbukurimet e përdorura në kishë dhe shijen arkitekturore të ndërtuesve të saj.

Formulimi arkitektonik i anës së jashtme të kishës paraqiste interes dhe vlera. Ajo shquhej për një ndërtim mjaft kompakt e simetrik, me përpjesëtimet e goditura karakteristike të elementeve arkitektonik si muret e rrafshëta, dritaret e vogla, pilastrat dhe harkadat e harqet. Tiparet dalluese të kishës si në trajtimin e pamjeve të jashtme ashtu dhe në organizimin dhe trajtimin e brendësisë të saj, janë karakteristike për arkitekturën romanike-gotike të ndërtuar në vendit tonë.

Kisha e Shën Mërisë është plotësisht e prishur, në vitin 1967 ajo është shkatërruar me dinamit në kuadrin e luftës kundër fesë. Pranë këtij objekti, nga ana e bashkëfshatarëve dhe diasporës është ndërtuar një kishë e re me tendencën e ripërtëritjes së kishës së vjetër.

Ndërhyrjet restauruese

Kisha është propozuar nga IMK të hiqet nga lista e monumenteve të kulturës.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrim nga vegjetacioni dhe ndërhyrje drenazhuese në mbetjet e themeleve të kishës së vjetër.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është e keqe.

Turizmi

Në kuadrin e Konkursit “Arkitektët e rinj për Zhvillimin Urban”, i organizuar nga Ministria e Zhvillimit Urban në vitin 2015 janë hedhur idetë e para për zbatimin e projekteve në terren siç është rasti i rindërtimit të Kishës së Shën Mërisë së Vaut të Dejës.

Ideja e projektit nis me rrugëtimin e Shën Palit në tokën Ilire, ndaj lidhet ngushtë me origjinën e hershme të Kishës Apostolike Shqiptare. Propozohet një vlerësim monumental i rrënojave të kishës, pa fshehur kishën e re të ndërtuar aty pranë në vitet '90.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- *Të futet në planet e saj, rikonstruksioni i rrugës që të çon te kisha.*
- *Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e mjedisit rreth e qark monumentit, hapjen e shtigjeve për qarkullimin pranë monumentit duke shërbyer kështu me njohjen e vlerave të objektit dhe historinë e zonës.*
- *Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.*
- *Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.*

RRENOJAT E KISHES SE SHEN MARKUT NE KALANE E VAUT TË DEJES

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin e M.A.K. Nr. 786, datë 05.11.1984

Koordinatat Gjeografike: 42° 0'46.31"N, 19°37'27.33"E

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Objekt kulti-kishë; Tipologjia: Kishë. Shek. VIII-XV.

Njësia administrative: Vau Dejës, vendndodhja: Vau Dejës.

Përdorimi: Objekt kulti-kishë. DRKK Shkodër.



Fig. 39: Pamje nga Kisha e Shën Markut

Pozita gjeografike

Kisha e Shën Markut ndodhet në majën e malit të Dejës buzë murit lindor rrethues të kalasë së Vaut të Dejës, qyteza e dikurshme e Danjës.

Të dhëna historike.

Kisha përmendet së pari në dokumentacionin historik në vitin 1400. Kështu Gjergj Bardhi në vizitën e tij të viteve 1631-1632, flet për ripërtëritjen e kishës në atë periudhë. Kjo kishë është e lidhur me gojëdhënën se e ka ndërtuar Skënderbeu si kujtim për fitoret e tij ndaj venecianëve për kalanë e Danjës. Thuhet të gjitha burimet historike, deri vonë, deri në shekullin XX, përmendin dy gjëra të rëndësishme të qytezës mesjetare: kështjellën që i ishte blatur Shën Markut, shenjtit mbrojtës të Venedikut dhe kisha e Shën Mërisë, një kishë që dukej se ishte ndërtuar në shekullin XIV, duket e vetmja me stil gotik në krejt Ballkanin.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Kisha e Shën Markut është një monument kulture me një arkitekturë të veçantë në zonën e Veriut. Monumenti ruhet me muret tërësisht në këmbë dhe pa çati. Ai paraqet në plan një drejtkëndësh të zgjatur me absidën rrethore në anën e lindore. Në kishë hyhet nga dy dyer. Njëra ndodhet në anën perëndimore e mbuluar me arkitra prej gurësh sipas një harku të ulët dhe tjetra në anën lindore, një derë e vogël e mbuluar me hark gjysme rrethor.

Ndërtesa u është nënshtruar disa rindërtimeve në kohë, të cilat në vija të përgjithshme mund të dallohen për nga ndryshimet në teknikën e ndërtimit. Muri lindor me absidën i takon ndërtimit të parë, ndërtuar me gurë të çrregullt lidhur me shumë llaç gëlqeror e mbushës rëre të trashë ku mbizotërojnë grimcat me ngjyrë të errët. Po ashtu i kësaj periudhe duhet të jetë dhe muri perëndimor i mbështetur shkëmbit deri në gjysmën e

lartësisë së tij. Fundit të shek. XIV dhe fillimit të shek. XV që është faza e dytë, duhet ti takojë përdorimi i teknikës së gurëve të skuadruar në faqen veriore, rreshtuar drejt e lidhur me llaç dhe me fugaturë të rregullt. Po i kësaj faze duhet të jetë dhe rindërtimi i portës kryesore.

Ndërhyrjet restauruese.

Në vitin 2006 janë kryer punime restaurimi të karakterit mirëmbajtës në pamjet e jashtme të kishës si punime rivlerësime dhe lysterje të fasadave. Po ashtu janë kryer punime në sistemin e jashtëm të monumentit.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: ndërhyrje restauruese në fugat e muraturës së kishës në anën e pasme të absidës.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është e keqe.

Turizmi.

Në rrënojat e Kishës së Shën Markut, në fshatin Skuraj si rezultat i gërmimeve arkeologjike kanë dalë varre të vjetra, që tregojnë hershmërinë e këtyre vendbanimeve. Gërmimet dhe studimet e mëtejshme në këtë zonë krijojnë kushte të favorshme për vlerësimin e trashëgimisë kulturore në këtë zonë.

Në kuadrin e projektit “Arkitektët e rinj për Zhvillimin Urban”, i organizuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, në vitin 2015, janë hedhur idetë e para për zbatimin e projekteve në terren siç është rasti i rindërtimit të Rrënojave të Kishës së Shën Markut.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- Të futet në planet e saj, rikonstruksioni i rrugës që të çon te kalaja.
- Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspeditave për pastrimin e mjedisit rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij.
- Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.
- Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.

KALAJA E SHURDHAHUT

Monument kulture kat. I, aprovuar me Ligjin Nr. 609, datë 24.05.1948 me Vendimin Nr. 586, 4874 datë 17.03.1948, datë 23.09.1971

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Fortifikim; Tipologjia: Kala. Shek. XI.

Fshati: Nënshat . Komuna: Hajmel.

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.



Fig. 40: Pamje nga Kalaja e Shurdhahut

Pozita gjeografike.

Kalaja e Shurdhahut, ngrihet mbi një kodër shkëmbore në bregun e djathtë të lumit Drin, rreth 8 km në jug të qytetit të Shkodrës. Dikur kjo kodër lidhej nëpërmjet një qafe të ulët me vargun e kodrave që shtriheshin në bregun jugor të këtij lumi, por me krijimin e liqenit artificial të hidrocentralit të Vaut të Dejës, kodra e Shurdhahut u kthye në ishull. Në gërmadhat e kësaj kalaje ndodhej dikur qyteti i Sardës, i cili përmendet shpesh në dokumentet mesjetare të kohës.

Të dhëna historike.

Lulëzimin më të madh qyteti i Sardës (Shurdhahu) e pati në shek. XI. Rreth viteve 1184 ai u pushtua nga Serbët, më vonë ka qenë nën juridiksionin e familjes feudale shqiptare të Dukagjinëve dhe më 1491 u pushtua nga turqit. Në këtë periudhë qyteti pëson një rënie të vazhdueshme deri sa, pas shek. XVII, emri i tij nuk përmendet më. Dikur Sarda një qytezë gjithë gjallëri përbri lumit Drin, si një gadishull strategjik, ishte një pikë ndërlidhëse me rrugën e vjetër Gjakovë – Shkodër – Ulqin. Sarda është një nga zonat më të rëndësishme arkeologjike dhe historike ku ndërthuren tre kultura të ndryshme të të gjithë trevës së Veriut, Malësisë, Mirditës dhe Zadrimës.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Muret mbrojtëse e ndajnë qytetin në dy pjesë: në qytetin e sipërm që zë majën e kodrës dhe në të poshtmin që zë shpatin e saj nga veriu, lindja dhe jugu. Si muri rrethues i sipërm ashtu dhe ai i poshtëm janë pajisur me kulla që kanë formën e germës U,

trekëndëshe dhe katërkëndëshe të vendosura jo në distanca të barabarta. Krejt kalaja e Shurdhahut rrethon një sipërfaqe prej 4.7 ha. Gjithsejt ruhen dy hyrje, njëra që të fut në qytetin e poshtëm dhe tjetra në të sipërmin. Që të dyja hyrjet mbrohen nga dy kulla anësore në formën e shkronjës U, të vendosura pranë njëra tjetrës. Kullat e Shurdhahut në përgjithësi janë të vogla dhe me mure të hollë 0.60-0.70 m, muri rrethues nuk e kalon gjerësinë 0.90 m. Njëra nga kullat që ruhet mirë arrin lartësinë 5 m.

Muret, harqet dhe elementet e tjerë të fortifikimit janë ndërtuar me gurë pa u forcuar me breza druri dhe pa përdorime tullash. Kullat kanë qenë të pajisura me frëngji. Një veçori e kullave të Shurdhahut, sidomos e atyre në formë U –je , është se ato lidhen me murin rrethues vetëm në pjesën e poshtme.

Ndërhyrja restauruese.

Gjatë viteve 1978-1980 është ndërhyrë me punime mirëmbajtjeje në kala. Janë kryer punime plotësuese të mureve dhe konsolidim të tyre. Po ashtu janë bërë punime në mjedisin përreth.

Nga ana e DRKK Shkodër në bashkëveprim me kooperacionin austro-zvicerian dhe shoqatën “Sarda” , krahas nivelimit dhe sistemimit të terrenit janë bërë dhe hapjet e shtigjeve udhëzuese për të vizituar monumentet e shumtë në këtë zonë, të cilat i shtojnë vlerat kalasë së Shurdhahut.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Ndërhyrje në restaurimin dhe konsolidimin e mureve.

Infrastruktura.

Në monument shkohet nëpërmjet liqenit të Vau Dejës. Nuk ka linjë detare të rregullt direkt për këtë monument, po rruga devijon për në vendqëndrimin e duhur.

Turizmi.

Ishulli i Shurdhahut është kthyer në një destinacion interesant dhe në një pikë të rëndësishme turistike. Uji i liqenit, malet dhe kodrat përreth me gjelbërimin e tyre gjithëvjetor krijojnë një peizazh me bukuri të rrallë, duke i dhënë këtij ishulli vlera të mëdha ekoturistike.

Këtu përveç vizitoreve të shumtë vendas dhe të huaj me ardhjen e pranverës vijnë për ta vizituar nxënësit dhe studentët të cilët njihen me vlerat kulturore, historike dhe arkeologjike, njihen me vlerat mjedisore, ku të gjitha në kompleks përbëjnë një perlë turistike.

Jo shumë larg nga ishulli i Shurdhahut ndodhet vendlindja e shkrimtarit dhe albanologut të madh i vlerësuar me titullin “Nderi i Kombit” Martin Camaj.

Prej vitesh në këtë vend zhvillohen veprimtari të shumta kulturore dhe turistike nga Shoqata “Sarda”, e cila ka krijuar tradita për shumë aktivitete duke promovuar vlerat ekoturistike të kësaj treve.

- *Festivali Folklorik me nxënësit e shkollave tetëvjeçare të gjithë trevës së veriut në çdo 3 vjet.*

- *Konkursi i fjalës artistike për çmimin “Martin Camaj” me të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të Qarkut Shkodër çdo vjet.*
- *Garat e kanotazhit në liqen me të rinj nga gjithë trevat Shqiptare.*
- *Në bashkëpunim me komunitetin fetar është krijuar traditë, organizimi i festës popullore të 15 gushtit ku marrin pjesë me mijëra të rinj.*
- *Konkursi i zënies së peshkut me grep etj.*
- *Organizimi i guidave me grupe të ndryshme turistike vendas dhe të huaj.*

KOMPLEKSI NDRE MJEDA DHE ZONA MBROJTESE

Monument kulture kat. II, shpallur me Vendimin M.T.K.R.S. Nr.53, datë 22.02.2012.

Zona Mbrojtëse: 41S53”58”N19

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Kompleks; Tipologjia: Kishë-Qelë; Shek.XX 1906-1913

Njësi administrative: Bushat, vend ndodhje: Kukël.

Përdorimi Kishë-Qelë. DRKK Shkodër.



Fig. 41: Pamje nga Kompleksi Ndre Mjeda

Pozita gjeografike

Kompleksi “Ndre Mjeda” ndodhet në fshatin Kukël diku ndërmjet Lezhës dhe Shkodrës i cili shtrihet në fushën e Zadrimës deri në shpatin e këndejmë të malit të Kakarriqit. Fshati është një zonë fushore mjaft e gjelbëruar me bimësi të shumtë e banesa për qark, me burime ujore ku pranë kompleksit kalon dhe një kanal uji. Kompleksi është i ngjitur pak në shpat prej ku “lahet” me shikim krejt fusha.

Të dhëna historike.

Kompleksi “Ndre Mjeda” i ndodhur në fshatin Kukël, njihet që si Cucculi qysh në mesjetë. Ai lidhet ngushtë me figurën e Dom Ndre Mjedës, njeri prej personazheve më të rëndësishëm të kulturës shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX, njeri prej protagonistëve më të zellshëm të saj, kontribuues i spikatur i ruajtjes dhe shpërndarjes

së identitetit tonë kombëtar. Rreth tridhjetë vite të jetës së vet kreative ai i kaloi në Kukël dhe kjo ka qenë një shtysë e arsyeshme për ta kthyer këtë vend në një pikë nderimi e pelegrinazhi për Mjedën dhe veprën e tij në dobi të kombit.

Pikërisht në Kukël famullitari shkroi e lëvroi lirikat dhe tingëllimat e tij perla të letërsisë shqipe. Si poemat “Andra e Jetës”, “Lissus”, “Shkodra”. Po ashtu shkroi librat e gjuhës shqipe për nxënësit: aty ka vijuar të këmbëjë korrespondencën me Gustav Majerin e albanologë e gjuhëtarë, e miq të tij evropianë. Banonte e shërbente atje me petkun e meshtarit dhe përgjatë viteve 1921-1924 kur qe deputet i parlamentit të parë shqiptar.

Arkitektura dhe teknika e ndërtimit.

Në vitin 1906 është projektuar dhe ka nisur ndërtimi i Kompleksit, fillimisht ai i Kishës dhe më pas ai i Qelës që kanë përfunduar në vitin 1913 prej famullitarit të atëhershëm të katundit, Dom Ndre Mjeda. Kompleksi është unik në llojin e tij në Shqipëri. Banesa është e ndërtuar sipas stilit neoklasik, me mur guri dhe e mbuluar me çati me konstruksion druri e tjegulla vendi. Të bie në sy përkujdesja në trajtimin e jashtëm arkitektonik si të kishës ashtu dhe të qelës.

Në brendësinë e tyre, si në Kishë ashtu edhe në shtëpinë e Dom Ndre Mjedës ndodhen shumë simbole me të cilat poeti ka dashur të tregoj ngjarjet historike të kohës si dhe veprimtarinë e tij të shumëanëshme.

Ndërhyrja restauruese.

Me shpalljen e kompleksit “monument kulture” dhe realizimin e procesit të restaurimit, në sajë të punës këmbëngulëse të famullitarit Dom Nikë Ukgjini, të mbështetur financiarisht nga Arqipeshkvia e Shkodrës, komuna e Bushatit si dhe nga një numër i madh dashamirësish e dhuruesish me kompleksin muzeor “Ndre Mjeda”, u arrit që Kukli të përjetojë një periudhë përtëritjeje të vërtetë.

Në këtë objekt në vitin 2014 janë kryer punime restaurim në kishë dhe në qelë. Në vitin 2016 janë kryer punime në dy mjediset ndihmëse, pjesë të kompleksit si dhe në mjedisin rrethues. Restaurimit ju nënshtrua dhe tavolina 100 vjeçare e punës së Dom Ndre Mjedës si një objekt origjinal, përfaqësues i asaj periudhe.

Nga ana e DRKK Shkodër: Propozohet mirëmbajtja e vazhdueshme e kompleksit.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt dhe gjendja e saj është shumë e mirë.

Turizmi.

Kisha e vjetër dhe qela e Ndre Mjedës, krahas plotësimit të shërbesave dhe funksioneve meshtarë janë shndërruar tashmë në një kompleks arkitekturor e muzeor, sa tërheqës për nga forma aq të pasur dhe nga përmbajtja. Në qendër të këtij kompleksi me shikimin e çliruar mbi hapësirën e Zadrimës, ngrihet skulptura monumentale e Ndre Mjedës në formën e një kambane që duket se mbledh gjithë tingujt e fushës e ua kthen njerëzve si dikur poeti tingëllimat e tij harmonike. Statuja e Mjedës është zemra e këtij kompleksi, i cili tashmë është kthyer në një pikëtakim të rëndësishëm festash, kremtimesh e veprimtarish kulturore. Çdo 1 gusht që përkon me

datën e lindjes së Ndre Mjedës, aktorë të shumtë kulturorë nga Shkodra, Lezha, Kosova e troje të tjera shqiptare, mbledhen në këtë vend për të kremtuar “Ditët e Mjedës”. Nuk mungojnë emigrantët e shumtë që kthehen në vendlindje për të mos humbur rastin e një takimi të përvitshëm me miqtë dhe me gjërat e shtrenjta të vendlindjes. Kukli po kthehet dita ditës në një vend pelegrinazhi kulturor, kryefjala e të cilit mbetet Ndre Mjeda, ajo figurë që në vetëdijen kolektive përfaqëson njëherazi meshtarin, atdhetarin dhe poetin.

3.1.6.1 Vlerësimi i Trashëgimisë Kulturore të zonës dhe Turizmi.

Bashkia e Vau Dejës, zotëron një zonë të pasur me objekte të Trashëgimisë Kulturore. Kjo zonë i përket një treve të rëndësishme historike, arkeologjike dhe kulturore jo vetëm për qytetin e Shkodrës dhe të Vau Dejsit por për mbarë vendin tonë.

Gjatë 40 vjetëve të fundit të shek. XX në sajë të gërmimeve dhe kërkimeve sistematike në varrezat e qyteteve dhe në qytezat e hershme mesjetare të kësaj zone, si në Kalanë e Dalmacës, dhe zonën e qytetërimit të lashtë të Komanit, u grumbullua një lëndë e pasur dhe e larmishme arkeologjike, mbi bazën e së cilës u ndriçuan çështjet më kryesore të mesjetës së hershme. Kultura e Komanit u bë pika e referimit për shumë probleme; ajo u vu në themel të argumentimit të tezës së autoktonisë së shqiptarëve. Ndaj është e nevojshme të njihemi hollësisht me kulturën e Komanit, me historikun e zbulimit të saj, me tiparet e kësaj kulture, me datimin e saj, me marrëdhëniet me kulturat e tjera, me përkatësinë etnike dhe me thelbin historik të kulturës arbërore të Komanit, ndoshta unike dhe në rrafshin ballkanik.

Gjithashtu qyteti i Sardës, sot Shurdhahu, ku ndodhet Kalaja e Shurdhahut, është një nga zonat më të rëndësishme arkeologjike dhe historike ku ndërthuren tre kultura të ndryshme të të gjithë trevës së Veriut: Malësisë, Mirditës dhe Zadrimës ku ndodhen mjaft objekte të së kaluarës si kisha, ndërtime kulturore apo fragmente ndërtesash të ardhura deri në ditët tona në formë rrënojash.

Një pjesë e konsiderueshme e objekteve të trashëgimisë kulturore të ndodhura në juridiksionin e Bashkisë së Vau Dejës, për shkak të pozicionit të tyre gjeografik të ndodhur përqark liqenit artificial të Vau Dejës si dhe kalimit gjatë lumit të Drinit, janë mjaft të favorizuar nga pasazhi i kombinuar mal e det duke i shtuar vlerat e tyre historiko-arkitektoniko-kulturore.

Ky koncept është bërë i njohur në Konventën Evropiane për Peizazhin, Firence 2000 në të cilën shteti shqiptar është në proces aderimi. Në këtë kuadër termi peizazh kulturor është adoptuar dhe në draft ligjin “Për trashëgiminë Kulturore” i cili është në proces hartimi nën drejtimin e MK’së.

Duke e parë problemin e vlerësimit të trashëgimisë kulturore, mbi bazën e një njohjeje më të thellë e më të studiuar me qëllimin e popullarizimit dhe trashëgimit të saj brezave të ardhshëm, dalin mjaft angazhime dhe përparësi për tu realizuar nga institucione përkatëse të fushës.

Padyshim, angazhimet dhe përparësitë kryesore i takojnë Bashkisë së Vau Dejës e cila i ka në territorin e saj këto vlera të trashëgimisë kulturore e parë kjo dhe në

aspektin e rritjes së potencialit kulturor-turistik të zonës së saj, si një kontribut me vlerë në ruajtjen, propagandimin dhe trashëgimin e tyre.

- **Në kuadër të rekomandimeve të zhvillimit të zonës**, Bashkia duhet të përcaktojë përparësitë e trajtimit dhe restaurimit të monumenteve. Për këtë duhet së pari, të planifikojë, të hartojë dhe të miratojë planet e rikonstruksionit apo ndërtimit të plotë të rrugëve aksesit dhe jo të asfaltuara që të çojnë në destinacion.
- **Në kuadër të restaurimit të monumenteve**, të kërkohet nga IMK fonde për restaurimin, konservimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës të zonës.
- **Peizazhi historiko-kulturor i monumenteve** është një koncept i ri në sistemin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore materiale. Ky raport i vlerave historike me arkitekturën e monumentit duhet të motivojë organizimin e ekspeditave me nxënësit e shkollave fillore e të mesme të zonave përkatëse për pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve rreth e qark monumenteve.
- **Në kuadrin e turizmit të integruar**, liqeni i Vau Dejës si dhe lumi i Drinit afrojnë resurse të mira për lundrim gjatë gjithë gjatësisë së tyre me traget apo varka si një mundësi e njohjes dhe e vlerësimit të pasazhit që afron kjo zonë me bukuri të rrallë.
- **Për një rritje të fluksit të turistëve si dhe vizitoreve vendas**, duhet të shtohen tragetet si dhe të vendosen linja të reja në funksion të vendndodhjes së monumenteve.
- **Në kuadrin e popullarizimit dhe propagandimit të vlerave të monumenteve** mund të organizohen pranë tyre, tematika të ndryshme, aktivitete kulturore e sportive.
- **Në kuadër të vizitueshmërisë së monumenteve**, duhet të plotësohen sinjalistikat e plota rrugore si dhe tabelat orientuese drejt monumentit. Po ashtu të hartohen guida turistiko-kulturore për objektet me vlera të zonës.

Duke vlerësuar objektet e shumta të dala gjatë gjurmimeve apo të ndodhura në gjendje rrënojë, pa status “monument kulture”, të cilat më ekzistencën dhe njëherazi historinë e tyre, plotësojnë vlerat e trashëgimisë materiale kulturore në kësaj zonë, të hartohet nga specialistët e Bashkisë së Vau Dejës një material, ku ti kërkohet IMK si dhe ASHA, të studiojnë mundësinë e shpalljes së zonave të reja arkeologjike apo objekte me status “monument kulture”.

Për të realizuar gjithë këto objektiva, padyshim duhen fonde të cilat mund të sigurohen pjesërisht nëpërmjet institucioneve përkatëse shtetërore si dhe nga donacione të ndryshme, mbi bazën e projekteve konkrete të miratuara nga instancat përkatëse në zbatim të legjislacionit dhe rregulloreve të miratuara.

3.2 Analiza mjedisore

3.2.1 Burimet natyrore

Burimet natyrore, flora dhe fauna, zënë vendin kryesor në mjedisin ku jetojmë. Duke qenë se Shqipëria ka një larmi relievi, të klimës e mikroklimës, kjo larmi ka favorizuar rritjen e një game të gjerë bimësh dhe specimesh shtazore. Vlerësohet se rreth 30 % e të gjithë florës europiane është e pranishme në Shqipëri, ndërsa pyjet e larta janë strehë për komunitetet e kafshëve të egra, si dhe për komunitetet karakteristike të shpendëve të lidhur me pyjet e virgjër.

Shqipëria është një urë kalimi e rëndësishme e migracionit floristik dhe faunistik, sidomos të disa shpendëve dhe insekteve. Njohja e biodiversitetit në territorin e Shqipërisë është ende e pamjaftueshme. Grupe të tëra të botës bimore dhe shtazore janë ende të panjohura e të pastudiara. Edhe për grupet e studiara relativisht mirë, ende nuk është arritur njohja e plotë e pasurive llojore.

3.2.1.1 Flora dhe fauna

Territori i Bashkisë Vau-Dejës është i ndërthurur dhe është pjesë e këtij areali, ku janë të gjitha kushtet për zhvillimin e faunës dhe të florës mjaft të larmishme, për ruajtjen e të cilës duhet të kujdeset e të kontribuojë i gjithë komuniteti.

Në këtë territor, takohen një sërë ekosistemesh si ato ujore, shkurre mesdhetare përherë të blerta dhe gjetherënëse, pyje gjethegjerë e halorë dhe të përziera, livadhe e kullota.

Fauna

Sipas studimeve dhe monitorimeve të institucioneve të ndryshme shkencore dhe akademike, për sa u përket shpendëve, mund të thuhet se këta përbëjnë një pjesë të konsiderueshme me vlera për llojet e ekosisteme të cilat takohen brenda këtij territori.

Në ujërat e ekosistemeve ujore (lumenjve dhe liqeneve) kemi një shumëllojshmëri të popullatave të peshqve ku si më me vlera mund evidentohen këto lloje kryesore: Krapë (*Cyprinus carpio*), Ngjala (*Anguilla anguilla*), Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*).

Në llojet që përmendem më sipër, duhet të theksojmë se Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*), është specie e rrezikuar dhe duhet që të merret në mbrojtje.

Shpendët dhe gjitarët, janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit tonë. Në ekosistemet pyjore të territorit të bashkisë Vau-Dejës, rriten dhe strehohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë. Në kafshët më të rralla dhe që janë me statusin e llojeve të keqësuar apo në rrezik zhdukjeje mund të përmenden: Derri i egër (*Sus scrofa*) dhe Macja e egër (*Felis silvestris*).

Por përveç këtyre, takohen edhe gjitarë të mëdhenj si: Ujku (*Canis lupus*), Çakalli (*Canis aureus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes faina Elx.*), Zardafi (*Martes martes L.*), Baldosa (*Meles meles*), Qelbësi (*Mustela putorius L.*), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Lepuri i egër (*Lepus Capensis*), Nuselala (*Mustela nivalis*), Lundërza (*Lutra lutra*), Rriqebulli (*Lynx*), etj.

Ndërsa në llojet e rralla të shpendëve që kanë këto statuse dhe që hasen në pyjet e rajonit tonë janë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*), Kumuria (*Streptopelia decaocto*), Skifteri (*Accipiter nisus*), Gakthi (*Botaurus stelboris*), Shkaba (*Gyps fulvus*), Gjeraqina (*Accipiter gentilis*), Huta me kalca (*Butea lagopus*).

Gjithashtu, takohen dhe një sërë zvarranikësh, ku për vlera të veçanta përmendim, nepërkën me briërë (*Vipera amodytes*), Bolla leopard (*Eiapha situla*), etj.

Probleme mjedisore të lidhura me biodiversitetin, florën e faunën

Flora dhe fauna janë të kërcënuara si pasojë e keqmenaxhimit të biodiversitetit, florës dhe faunës dhe lidhen së pari me densitetin e lartë të popullsisë dhe lëvizjet demografike të dy dekadave të fundit. Çështjet në vijim janë identifikuar si shqetësime strategjike në planin lokal:

- Humbje dhe fragmentim të habitateve;
- Dëmtim, varfërim, dhe degradim të ekosistemeve dhe habitateve;
- Shqetësim, persekutim i kafshëve të egra në natyrë;
- Zhdukje llojesh të rrezikuara apo kërcënim për zhdukje;
- Prishje të specieve autoktone dhe erozion gjenetik;
- Fragmentizim masiv i ekosistemeve dhe humbje habitatesh për specie të rëndësishme faunistike;
- Humbje direkte e habitateve si pasojë e përmytjeve dhe erozionit.

Duke qenë se në fund të fundit, thelbin e termit biodiversitet e përbëjnë llojet, habitatet dhe ekosistemet, kriteret e përdorura për t'u mbajtur në konsideratë, pa dyshim nxisin nevojën e mbrojtjes dhe sigurimit të mbijetesës së atyre më të kërcënuarave dhe që kanë rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kriteret kryesore të cilat duhen mbajtur më në konsideratë janë si më poshtë:

- Lloje dhe habitate të kërcënuara në mënyrë kritike me rëndësi globale, rajonale e kombëtare;
- Habitata/ekosisteme që shquhen për endemizëm apo biodiversitet të lartë;
- Habitata ose lloje në rrezik zhdukje të pakthyeshme;
- Habitata ose lloje, ruajtja dhe menaxhimi i përshtatshëm i të cilëve do të rezultonte me përfitime ekonomike dhe edukative lokale apo kombëtare;
- Lloje ose habitate të kërcënuara nga tregtia apo praktikatat e papërshtatshme, të cilat mund të kontrollohen nëpërmjet rregullimit të politikave.

3.2.1.2 Pyjet dhe kullotat

Mjediset pyjore

Në sistemin natyror përfshihen edhe pyjet dhe kullotat që zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhistike.

Ekosistemet pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik për prodhimin e lëndës drusore dhe druve të zjarrit, punësimin në zonën rurale, në shërbimet mjedisore si reduktimi i dioksidit të karbonit (pasi thithet nga pemët nëpërmjet procesit të fotosintezës ku gjatë rritjes depozitohet në dru, lëvore, gjethe e rrënjë), zbutja e ndryshimeve klimatike, mbrojtja e tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet. Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë. Në kuadër të protokollit të Kiotos ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet kanë rënë dakord të luftojnë efektin sere nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektiv arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kredite karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni.

Duke u bazuar në ndarjen e re territoriale dhe në ligjin për administrimin e pyjeve dhe kullotave, rezulton se pjesa më e madhe e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të territorit të Bashkisë Vau-Dejës janë nën administrimin e saj.

Me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, Bashkisë Vau-Dejës i është transferuar një sipërfaqe e konsiderueshme prej rreth 28.465 ha, nga e cila:

- Sipërfaqe pyjore 18.478.22 ha;
- Sipërfaqe kullosore 2.349 ha;
- Sipërfaqe djerrë, joproduktive dhe bimësi pyjore 7.581.01 ha.

Përsa i takon diversitetit biologjik, mund të thuhet se territori i Bashkisë Vau-Dejës është mjaft i pasur në lloje bimësh dhe drurësh pyjorë që gjejnë kushte të përshtatshme për rritje e zhvillim, që nga 30 e deri në lartësinë 1.800 m mbi nivelin e detit. Ato janë natyrale dhe të kultivuara.

Grupet kryesore të llojeve të drurëve janë:

- Llojet halore, 2.319.6 ha;
- Llojet fletor, 16.158.62 ha.

Në grupin e parë bëjnë pjesë:

Pisha e butë (*Pinus pinea*), Pisha e egër (*Pinus halepensis*), Pisha e zezë (*Pinus nigra*), Pisha radiata (*Pinus radiata*), Selvia (*Cupressus sempervirens*), Hartina (*Pinus sylvestris*), etj.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë:

Lisi (*Quercus pubescens*), Bunga (*Quercus Petraea*), Qarri (*Quercus cerris*), Ilqja (*Quercus ilex*), Akacia, Plepi i bardhë (*Populus alba*), Plepi i zi (*Populus nigra*), Shelgjet (*Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix fragilis*), Shkozat (*Carpinus betulus* dhe *Carpinus orientalis*), Frashëri gjethengushtë (*Fraxinus angustifolia*), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus*), Gështenja (*Castanea sativa*), Arra (*Juglans regia*), Lajthia (*Corylus avellana*), Bliri (*Tilia ophisinalis*), Panja (*Acer platanoides*), Rrapi (*Pistacia orientalis*), Verri (*Alnus cortex*), Verri i zi (*Alnus glutinosa*), Dafina (*Laurus nobilis*), Bushi (*Buxus sempervirens*), Shqopa (*Erica arborea*), Mareja (*Arbutus unedo*), Thana (*Cornus mas*), Shqeme (*Rus coriaria*), etj.

Shpërndarja në bazë të sipërfaqes për speciet kryesore pyjore jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 10: Shpërndarja e sipërfaqes për llojet kryesore pyjore. Burimi: (Drejtoria e Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Bujqësisë, Bashkia Vau-Dejës)

Nr.	Lloji	Sipërfaqja (ha)
1.	Dushk	7.756.71
2.	Pisha e zezë	568.05
3.	Ah	3.210.65
4.	Shkozë	2.460.18
5.	Mare	741
6.	Pishë mesdhetare	1.751.55
7.	Lajthi	13.5
8.	Gështenjë	455.55
9.	Shqopë	374.97
10.	Panjë	5.5
11.	Akacie	59
12.	Frashër	482.7
13.	Bimësi pyjore	245.35
14.	Bli	30.7
15.	Shkurre	568.16
16.	Të tjera	
	Totali	18.723.57

Në kushtet e terrenit të pjerrët në zonën malore, pyjet janë faktori kryesor i mbrojtjes së tokës nga rrëshqitjet dhe erozioni, mbrojtjen e brigjeve të lumenjve dhe vijës bregdetare për mbrojtjen nga ndryshimet morfologjike.

Gjithashtu sipërfaqet pyjore dhe kullosore të Bashkisë Vau-Dejës, janë mjaft të pasura edhe me një grup tjetër të rëndësishëm sikurse janë bimët mjekësore, eterovajore e tanifere si: Trëndafili i egër (*Rosa canina*), Agulicja (*Primula veris*), Trumza (*Saturea montana*), Zhumbrica (*Thimus spergillum*), Çikorja (*Cichorium intybus*), Grami (*Cynodon dactylon*), Barpate (*Polygonum aviculare*), Thundërmushkë (*Tussilago farfara*), Luleshtrydhe (*Fragaria vesca*), Netulla (*Verbascum thapsiforme*), Njëmijëfletëshi (*Aquillea miliefolium*), Lulekuqja (*Papaver rhoeas*), Sherebela (*Salvia officinalis*), Lisna (*Thymus longicaulis*), Mjedra (*Rubus idoeus*), Xina (*Pistacia lentiscus*), Bari i gjarpërit (*Teucrium chamaedrys*), Zogela (*Frangula alnus*), Shpendra (*Helleborus edours*), Gjuhëusja (*Ononis spinosa*), Lulebasani (*Hypericum perforatum*), Rigoni i kuq (*Origanum vulgare*), Veronika mjekësore, (*Veronica officinalis*), Boronica (*Vaccinium myrtillus*), Xherrokulli (*Colchicum autumnale*), Murrizi (*Crataegus monogyna*), Gjineshtra (*Spartium junceum*), Driza (*Paliuris aculeatus*), Rrushkulli (*Ruscus aculeatus*), Vjeshtull lisi (*Viscum album*), Salepi (*Orchis mascula*), Bliri, Dëllinjat, Hithra (*Urtica dioica*), etj.

Mjedisi i kullotave

Kullotat natyrore përbëjnë bazën e të ushqyerit të bagëtive dhe për këtë arsye në periudhën komuniste, u ndoq një politikë shkatërruese e hapjes së tokave të reja e mishëruar në parullën

“T’u qepemi kodrave e maleve e t’i bëjmë ato pjellore si dhe fushat”. Kjo gjë i solli një dëm të jashtëzakonshëm fondit pyjor dhe kullosor në Shqipëri, duke prekur dhe dëmtuar rëndë një ansambël të vërtetë kullosor natyror. Qindra e mijëra ha pyje,

kullota, livadhe e muzha me florë shekullore të mrekullueshme u shkatërruan duke u kthyer në mënyrë krejt të papërshtatshme, në sipërfaqe të kultivuara me bimë të ndryshme bujqësore.

Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau-Dejës, sipas të dhënave të marra nga Kadastra e Fondit Pyjor dhe Kullosor, kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 2.349 ha, e cila sipas periudhës të shfrytëzimit të tyre jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11: Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau-Dejës

Tipi i kullotës	Sipërfaqja (ha)
Dimërore	779.6
Verore	1.569.4
Totali	2.349

Sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e situatës aktuale. Njësitë Administrative nevojitet që nëpërmjet planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave t'u ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha ku ka aktivitete të punimeve pyjore. Njësitë Administrative, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drurëve të lartë, mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

Probleme mjedisore dhe të menaxhimit të pyjeve

- Inventarizimi i pyjeve dhe kullotave dhe pasqyrimi i gjendjes reale të tyre;
- Hartimi i planeve të reja për menaxhimin e të gjithë fondin pyjor dhe kullosor bashkiak;
- Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave pranë Z.V.R.P.P Shkodër;
- Dëmtime të pyjeve nga prerjet e paligjshme dhe zjarret;
- Mungesa e punimeve përmirësuese të pyjeve në zonat me bimësi të dëmtuar;
- Mungesa e mbjelljeve të reja në zonat e zhveshura;
- Mungesa e planifikimit të sipërfaqeve të cilat mund të shfrytëzohen për dru zjarri;
- Mbetjet urbane të shpërndara në tokat pyjore duke shkaktuar ndotje të tokës dhe të ujërave;
- Mungesa e punimeve përmirësuese në sipërfaqet kullosore, ku mbrojtja nga erozioni i kullotave kërkon disa punime shtesë me qëllim që të garantohet kapaciteti maksimal kullosor;
- Mungesë e planifikimit të sistemimeve malore në pellgjet ujëmbledhës malorë.

Rekomandime

Për të rritur cilësinë e shërbimeve të ekosistemeve pyjore dhe kullosore deri në vitin 2020 mund të propozohet:

- Të pyllëzohen sipërfaqet e pyjeve të prera e të djegura në rreth 3.100 ha;
- Të ndërhyet me punime përmirësuese në 6.200 ha, këto të shpërndara në ekonomitë pyjore Gjadër-Mnelë, Vig, Gomsiqe, Bushat, Shllak 1, Shllak 2, Toplanë, Karmë;

- Krijimi i një fidanishteje për prodhimin e fidanave pyjore me lloje të zonës;
- Përmirësimi i rreth 2.349 ha kullota me taban të cekët;
- Ndërhyrje emergjente me investime në ndërtimin dhe riparimin e pritave malore për frenimin e erozionit të tokës, në përrrenjtë e ekonomive pyjore Hajmel-Nenshat, Gomsiqe, Karmë, Gjadër-Mnelë, Vig, Shllak të cilët kanë një regjim rrjedhjeje të rrëmbyeshëm.

Këto propozime mbështeten në objektivat e PKK për pyjet:

- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe kullosore;
- Gjithëpërfshirja e aktorëve lokalë në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori;
- Vendosja e skemave për pagesa në ekosistem;
- Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;
- Të arrihet transpozimi i plotë (100 %) i legjislacionit evropian në fushën e pyjeve;
- Mbulimi 100 % me plane mbarështimi për të gjitha ekonomitë pyjore në nivel kombëtar;
- Ulja me 40 % të prerjeve të paligjshmeve të fondit pyjor;
- Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të sipërfaqeve të djegura si dhe rehabilitimi i kullotave me mbjellje foragjerë e drusore në masën deri 15 % të sipërfaqes pyjore dhe kullosore deri në vitin 2020;
- Parandalimi i gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullosore në 25 % të sipërfaqes deri në 2020.

3.2.1.3 Rezervatet

Një nga resurset më të rëndësishme të bashkisë Vau-Dejës është sipërfaqja e konsiderueshme ujore. Si rrjedhojë sektori i peshkimit paraqet mundësi mjaft të mëdha zhvillimi, e parë kjo në aspektin e aftësive ushqyese të këtij baseni dhe sipërfaqen e madhe të tij. Mjafton të përdoren praktikët e viteve 1980-1990, ku me një shfrytëzim mesatar është arritur një rendiment prej 50 ton në vit.

Për sektorin e rritjes së peshkut (akuakulturën), në Vau-Dejës ekziston një ekonomi rritje peshku, e cila vite më parë ka prodhuar rasat peshku për popullimin e ujërave të liqeneve si dhe peshk për konsum. Në liqenin e Vaut-Dejës është ndërtuar një rezervat peshku.



Fig. 42: Rezervat peshku, liqeni i Vau-Dejës

Në këto liqene hasen edhe një sërë problematikash. Peshkimi i theksuar dhe abuziv deri me lëndë plasëse e helmuese, e theksuar kjo metodë peshkimi në Vau-Dejën dhe Koman, ka cenuar si rezervat ashtu edhe strukturën peshkore.

Në liqenet e Vau-Dejës dhe Komanit vazhdon peshkimi i pakontrolluar i cili cenon qëndrueshmërinë e prodhimit të peshkut si dhe zvogëlon rezervën e tij. Shfaqja e peshqve grabitqarë si luçioperka dhe perka, struktura e prodhimit po pëson ndryshime të theksuara në liqenin e Vau-Dejës.

3.2.2 Sipërfaqet ujore

Liqeni i Vau-Dejës

E veçantë për Bashkinë Vau-Dejës është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vau-Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vau-Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën gjithashtu zonën të prekur nga përmbytjet.



Fig. 43: Liqeni i Vau-Dejës

Hidrocentrali i Vau-Dejës është hidrocentrali i parë që është ndërtuar mbi lumin Drin, në rrjedhën e poshtme të tij, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës. Duke qenë se ai është hidrocentrali më i poshtëm me digë dhe liqen në kaskadën e Drinit, rëndësia e tij, përveç prodhimit të energjisë elektrike, lidhet edhe me ndikimin që luan liqeni i Vau-Dejës në Ultësirën e Nënshkodrës. Shkarkimet e ujit nga ky liqen kanë ndikim kryesor në përmbytjet që ndodhin në pellgun liqeni i Shkodrës - lumi i Bunës, si edhe në Ultësirën e Lezhës dhe Shkodrës.



Fig. 44: HEC i Vau-Dejës

Punimet për ndërtimin e hidrocentralit filluan në vitin 1967 dhe përfunduan në vitin 1971. HEC-i i Vau-Dejës është i tipit me digë dhe liqen. Për krijimin e liqenit, janë ndërtuar tri diga të veçanta:

- Diga e Qyrsaqit, me lartësi 46.4 m dhe gjatësi 440 m, e tipit pjesërisht gravitacionale prej betoni dhe pjesërisht me mbushje me material lokal prej formacioni gëlqeror. Në pjesën prej betoni të digës janë vendosur 4 shkarkues sipërfaqësorë me porta radiale, si dhe vepra e marrjes me dy porta me segmente, nga të cilat dalin 5 tubacionet e prurjes së ujit në agregatet e centralit. Kapaciteti maksimal i shkarkuesve është 3.500 m³/s, ndërsa kapaciteti i përpunimit të ujit është 4 x 113 m³/s.
- Diga e Zadejës, me lartësi 60 m dhe gjatësi 390 m është e tipit me mbushje me material vendi prej formacioni gëlqeror. Në këtë digë ndodhet edhe një shkarkues me tunel dhe portë me segmente me kapacitet 3.200 m³/s.
- Diga e Rragamit me një lartësi 34 m dhe gjatësi 320 m. Kjo digë është e tipit me mbushje me material vendi prej formacioni gëlqeror dhe flish. Në këtë digë nuk ndodhen vepra hidrike, ajo shërben vetën si barrierë për mbajtjen e ujit.

Vëllimi maksimal i liqenit të Vau-Dejës është 500 milion m³, sipërfaqja e tij 25 km² dhe ai ngjitet nga gryka e Vau-Dejës për rreth 27 km në luginën e lumit Drin, deri në afërsi të hidrocentralit të Komanit. Niveli maksimal i lejuar i ujit në liqen është 76 m m.n.d, ndërsa niveli minimal i operimit është 61 m m.n.d. Vëllimi aktiv i liqenit është 263 milion m³ ujë.

HEC-i i Vau-Dejës është parashikuar si vepër e klasit të parë përse i përket rrezikshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore. Diga është projektuar për një prurje maksimale llogaritëse në periudhën e reshjeve 1 herë në 10.000 vjet (10.000 m³/s). Aftësia maksimale e shkarkuese e HEC-it është 7.500 m³/s në kuotën 76 m.

Zhvillimi i turizmit natyror është një mundësi e rritjes ekonomike të kësaj zone, pasi në liqenin e Vau-Dejës gjenden kështjella dhe kisha ndër më të vjetrat në Ballkan, të cilat ende sot mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Liqeni i Vau-Dejës mund të kthehet gjithashtu në një burim të rëndësishëm turistik, në rast se rikthehet transporti për qëllime turistike nga Vau-Dejës deri në Koman.

Liqeni i Komanit

Liqeni i Komanit, i cili ndodhet 30 km larg qytetit të Shkodrës, është formuar nga ujëmbledhësi i lumit Drin, ku është ngritur hidrocentrali i Komanit me fuqi të instaluar 4 x 150 MW. Liqeni ka sipërfaqe 12 km², gjatësi 34.5 km dhe gjerësi 50 - 60 m. Rreth liqenit lartësohen male të pyllëzuara me lartësi 1000 - 1200 m mbi nivelin e detit. Ky rajon, veç vlerës turistike, ruan edhe vlera historike. Aty pranë ndodhet fshati Koman, ku është zbuluar një varrezë e shekullit 6 - 8 p.K., e cila lidhet me kulturën e shoqërisë së hershme shqiptare. Mungesa e një organizimi, qoftë prej autoriteteve lokale, qoftë prej agjensive turistike, e ka lënë krejtësisht në hije shfrytëzimin turistik të kësaj zone me potenciale të fuqishme, që po të shfrytëzoheshin edhe në mënyrë të pjesshme, do të ndikonin drejtpërdrejt në të ardhurat ekonomike të të gjithë zonës.




Fig. 45: Diga e Komanit

HEC-i i Komanit është hidrocentrali i dytë dhe më i fuqishmi i kaskadës së lumit Drin. Për nga fuqia e instaluar, pozicioni dhe vëllimi i rezervuarit, ky HEC luan rol kyç për prodhimin dhe shfrytëzimin e të gjithë kaskadës. HEC-i i Komanit është hidrocentrali me kapacitetin e prodhimit më të lartë në Shqipëri.

Punimet për ndërtimin e tij filluan në vitin 1980. Turbina e parë filloi punën në vitin 1985, ndërsa me kapacitet të plotë, HEC-i filloi punën në vitin 1988.

Hidrocentrali është i tipit me liqen dhe rezervuar. Diga është e tipit me mbushje me gurë dhe ekran betoni të armuar. Ajo ka një lartësi prej 133 m dhe gjatësi 290 m. Kjo digë është ndër 10 digat më të larta të këtij lloji në Europë. Vëllimi total i saj arrin në 5 milion m^3 . Vëllimi i rezervuarit të krijuar prej saj është jo shumë i madh, rreth 500 milion m^3 ujë, ndërsa vëllimi i dobishëm është rreth 90 milion m^3 ujë (kuota 169.0 - 176.0 m m.n.d). Vëllimi i vogël i rezervuarit, si dhe shkarkimet e shpejta të reshjeve nga Alpet dhe malësia e Pukës, bën të nevojshëm një monitorim dinamik të situatës hidrike dhe një operim proaktiv të HEC-it në përputhje me zhvillimet e kushteve hidrometeorologjike të pellgut ujëmbledhës specifik të Komanit.

HEC-i i Komanit është parashikuar si vepër e klasit të parë për sa i përket rrezikshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore. Diga e Komanit është projektuar për një prurje maksimale llogaritëse në periudhën e reshjeve 1 herë në 1.000 vjet ($7.245 m^3/s$) dhe për prurje maksimale kontrolluese në periudhën e reshjeve 1 herë në 10.000 vjet ($10.560 m^3/s$).

Shkarkimi i prurjeve në Koman është parashikuar të realizohet nëpërmjet tuneleve të shkarkimit; tuneli 3 me kapacitet mbi $1.800 m^3/s$ dhe tuneli 4 me kapacitet mbi $1.600 m^3/s$. Kapaciteti total i shkarkimit në kuotën 176 m është $3.400 m^3/s$. Për kalimin e ujit nga liqeni në central është ndërtuar sistemi i marrjes, i cili, nëpërmjet dy tuneleve, përcjell ujin nga portali i marrjes drejt kullave të ekuilibrit, dhe prej këtej, drejt 4 turbinave në ndërtesën e centralit me ndihmën e tubacioneve përkatëse. Kapaciteti përcjellës i sistemit është $720 m^3/s$.



Fig. 46: Liqeni i Komanit

Prodhimi vjetor i Komanit arrin në 1.800 GWh mesatarisht, i cili përbën rreth 45 % të prodhimit të kaskadës.

3.2.3 Pasuritë minerare

Shqipëria është një vend i pasur me burime të mineraleve të ndryshme. Zbulimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i tyre, përbën një aktivitet të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Tradicionalisht, pas vitit 1944, industria nxjerrëse dhe e përpunimit të mineraleve si kromi, bakri, hekuri, qymyrguri, ka siguruar të ardhura të konsiderueshme.

Zhvillimi i industrisë minerare ka kaluar në tri faza:

1. Faza e parë përfshin periudhën e paraçlirimit, deri në vitin 1945. Kjo fazë lidhet me dy ngjarje të rëndësishme për industrinë minerare. Në vitin 1922, u përpilua Harta Gjeologjike e Shqipërisë, e para e këtij lloji në Ballkan. Në vitin 1929, u hartua dhe miratua Ligji Minerar i Mbretërisë Shqiptare, i pari në Shqipëri, mbi bazën e të cilit filloi puna për zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve.
2. Faza e dytë përfshin periudhën e pasçlirimit deri në vitin 1994, vit në të cilin u miratua "Ligji minerar i Shqipërisë", me asistencën e Bankës Botërore. Në këtë fazë, 1945-1994, aktiviteti minerar ishte i centralizuar, në dorën e shtetit totalitar dhe organizimi ishte në formën e ndërmarrjeve shtetërore.
3. Faza e tretë përfshin periudhën mbas vitit 1944 deri në ditët e sotme. Në këtë fazë minierat u privatizuan totalisht dhe aktualisht nuk ka asnjë minierë në aktivitet, ku të jetë pronar shteti.

Depozitat minerare të Shqipërisë përfshijnë krom, bakër, hekur-nikel, gur gëlqeror, ranor, asfalt dhe bitum natyral, gur gëlqeror dekorativ dhe gur ranor masiv dekorativ.

Kjo e fundit kryesisht fokusohet në prodhimin e kromit, bakrit, hekurit, nikelit, bitumit dhe mineraleve inerte që shërbejnë si lëndë e parë në industrinë e ndërtimit.




Fig. 47: Harta e pasurive minerale, qarku Shkodër, viti 2014 (Burimi: Shërbim gjeologjik Shqiptar).

Në bashkinë e Vau-Dejës gjenden disa depozitime mineralesh metalorë dhe jometalorë. Nga depozitimet e metaleve përmendim bakrin, zhivën, kurse metalet jometalorë që gjenden në bashkinë e Vau-Dejës janë magnezi, argjila, dolomitë etj.

Depozitimit të bakrit vihen re në pjesën veri-lindore të bashkisë, në kufi me bashkinë e Pukës. Siç duket edhe nga harta, në Koman gjenden dy pika, konkretisht të depozitimeve të bakrit dhe të zhivës.

Në njësinë administrative të Shllakut, dhe konkretisht në malin e Gzhoprës vihen re depozitime të mineralit jometalor të magnezit.

Në njësinë administrative të Bushatit, në kodrat e Zefjanës gjenden dy pika të depozitimit të argjilës, përkatësisht në Bushat dhe në Melgushë. Kurse në afërsi të Fshatit të Ri gjenden depozitime të dolomitëve.

Në bashkinë e Vau-Dejës ka funksionuar edhe fabrika e pasurimit të bakrit në Mjedë, e cila është mbyllur në vitin 2005 me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 30, datë 13.1.2005.




Fig. 48: Harta gjeomjedisore, qarku Shkodër, viti 2014 (Burimi: Shërbim gjeologjik Shqiptar).

Përveç fabrikës së pasurimit të bakrit në bashkinë e Vau-Dejës kanë funksionuar edhe një sërë minierash. Përmendim minierën e nxjerrjes së zhivës në Koman, atë të nxjerrjes së magnezit në njësinë administrative të Shllakut, minierën e nxjerrjes së bakrit në Vigë. Të gjitha këto miniera aktualisht nuk funksionojnë. Të vetmet miniera që vazhdojnë të funksionojnë janë dy miniera për nxjerrjen e bakrit në Karma.

Aktualisht janë disa subjekte që kanë leje minerare aktive për shfrytëzimin e disa zonave në bashkinë e Vau-Dejës. Në Karmë janë dhënë dy leje, njëra prej të cilave për shfrytëzim të shisteve argjilore, tjetra për kërkim-zbulim të mineralit të bakrit. Në Bushat dhe në Melgushë janë dhënë leje për shfrytëzim të karrierave të argjilës, dhe në Fshatin e Ri për shfrytëzimin e gurëve gëlqeror.

3.2.4 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, ndodhen disa monumente të natyrës të cilët kanë një rëndësi të veçantë për vlerat e tyre historike, shkencore, estetike dhe turistike. Sipas klasifikimit të IUCN, këto monumente bëjnë pjesë në kategorinë e III dhe të V të zonave të mbrojtura.

Në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër i karakteristikave kryesore të tyre:

- Zona e Mbrojtur Lumi i Bunës-Velipojë (peizazh i mbrojtur)

Peizazh Ujor Tokësor i Mbrojtur Lumi Buna-Velipojë bën pjesën e Kategorisë V të zonave të mbrojtura.

P.U.T.M Lumi Buna-Velipojë u shpall me V.K.M 682 datë 2.11.2005 dhe ka një sipërfaqë prej 23 027 ha.

Kufijtë e zonës përfshijnë:

Në Veri: Grykëderdhja e lumit Buna, përgjatë rrjedhjës së lumit Buna deri te pika e bashkimit me lumin Drin, kalon pranë Kosmaçit, Kuçit, argjinaturës, kodra e Vukatanës (48.0 m), në argjinaturë, pranë urës së Drinit deri te maja Kalaja Xhedatit (217.0 m);

Në Lindje: Maja Kalaja Xhedatit (217.0 m), vazhdon në krah të rrugës automobilistike Bushat-Barbullush, në kanalën kullues (Pekesenës), pranë fshatit Ranxë, përgjatë rrugës së Fshatit të Ri, anës kodrës, përgjatë argjinaturës, me vijën ndarëse të kodrave me fushën e Torrovicës deri te kuota 107.0 m;

Në Jug: Kuota 107.0 m (4381470.11L/4636550.15V), kuotat 339.0 m, 386.0 m, 384.0 m, 332.0 m deri te pika me koordinata (4379344.18L/4633806.87V);

Në Perëndim: Pika me koordinata (4379344.18L/4633806.87V), gjatë vijës bregdetare të detit Adriatik deri te Grykëderdhja e lumit Buna.

Rruget që të dërgojnë në destinacion janë: Shkodër Velipojë, Shkodër Dajç-Velipojë, Shkodër Bushat-Mali Jushit Velipojë, Lumi Buna Grykë derdhja në det me rrugë ujore.



Fig. 49: Pamje ajrore e peizazhit të mbrojtur

Flora e Fauna: Lumi ndërkufitar dhe kënetat e Domnit është një zonë e rëndësishme për shpendët. Përmes lumit realizohet migrimi i disa lloje peshqish, si blinit (*Acipenser sturio*). Në këtë zonë takohet dhe arra e ujit (*Trapa natans*). Ndër gjitarët veçojmë llojin globalisht të kërcënuar lundërzën (*Lutra lutra*). ZM ndërkufitare dhe një nga IBA-t (Zonë e Rëndësishme për Shpendët) më të rëndësishme të vendit. Zonë me bimësi tipike mesdhetare, dhe zonë e arealit të llojit pothuaj në zhdukje të rrënjës (*Quercus robur*). Në zonë takohen lloje kafshësh të një rëndësie Evropiane si *Phalacrocorax pygmeus*, *Lutra lutra* dhe çakalli (*Canis aureus*). Një lagune me vlera, në mënyrë të veçantë për avifaunën ujore, sidomos për llojet migratore dimëronjës, një pjesë e të cilëve mbrohen nga konventa e Bonit.




Fig. 50: Harta e PUTM në bashkinë Vau-Dejës

- Fusha e Liqethit

Ndodhet në kreshtë të malit të Cukalit, 1.200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Lekgegaj, Njësia Administrative Shllak e rrethit të Shkodrës. Përbën një gropë glacio-karstike, të formuar në kryqëzimin e shkëputjeve tektonike dhe të modeluar nga karsti. Është e gjatë 1.3 km, e gjerë deri në 1.000 m. Ka formën e një erashke, me disa forma më të vogla karstike. Në fundin e saj ka çakullime e bimësi barishtore dhe formohet një liqen i vogël gjatë shkrirjes së borës. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike), didaktike dhe turistike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale qyteti i Shkodrës – Cukal.

- Fragment i thyerjes tektonike Shkodër - Pejë

Është ndër thyerjet më të mëdha tektonike në truallin shqiptar, që përshkon territorin nga Shkodra në perëndim deri në Pejë (Kosovë) në lindje. Përgjatë saj bëhet kontakti verior tektonik i shkëmbinjve ofiolitike të zonës tektonike “ Mirdita ” me flishin e paleogenit (Pg 1-2) të zonës tjetër tektonike të “ Krastë – Cukalit ”. Për shkak të riaktivizimit të saj, rigjenerohen shpesh tërmete të fuqishëm. Në planin tektonik ka shumë vizime horizontale, të cilat janë rezultat i shtytjeve të djathta të thyerjes Shkodër – Pejë. Shprehja më e qartë e kësaj thyerjeje është në fshatin Karmë të Pukës. Ai është një monument gjeologjik (gjeomonument) me vlera të mëdha shkencore, gjeologjike e gjeomorfologjike. Vizitohet duke ndjekur rrugën automobilistike Vau-Dejës – Koman.

- Shpella e Malagjisë

Ndodhet në afërsi të fshatit Malagji të rrethit të Shkodrës, në faqen verilindore të malit të Cukalit; në lartësinë 1.300 m mbi nivelin e detit. Është 180 m e gjatë, përbëhet nga disa galeri, që ndërthuren me hapësira më të gjera dhe puse të shumtë dhe mjaft të thellë; ka liqene të vegjël dhe konkrecione të shumta. Gjendja e saj është mjaft mirë e ruajtur, por rrezikohet nga banorët vendas dhe pseudospeleologët e huaj.

Ka vlera shkencore, didaktike dhe turistike. Për të vajtur tek kjo shpellë, duhet të merret rruga automobilistike Shkodër - Cukal dhe pastaj të vazhdohet më këmbë në drejtim të shpatit verilindor të Cukalit.




Fig. 51: Shpella e Malagjisë

Burimi: AKZM

3.2.5 Landfill-i i Bushatit

Landfill-i i Bushatit ndodhet rreth 13 km në jug të qytetit të Shkodrës, rreth 2.5 km në lindje të fshatit Bushat dhe rreth 1.5 km në lindje të fshatit Shkjezë.

Rreth 1 km në lindje të tij, ndodhet një numër i kufizuar banesash të veçuara të fshatit Paçram. Disa kodrina të buta me lartësi rreth 60 - 70 m mund të ndajnë këto shtëpi nga landfill-i.

Landfill-i është i vendosur në një terren kodrinor që ngrihet në pjesën qendrore të fushës së Zadrimës. Kodrat kanë orientim veri-perëndim dhe jug-lindje. Më me saktësi, ai shtrihet në një "depresion" të ngjashëm me një amfiteatër, i cili hapet drejt jug-perëndimit, në drejtim të fushave të kultivuara.



Fig. 52: Pamje nga landfill-i i Bushatit

Në landfill depozitohen mbetjet urbane të të gjitha llojeve dhe një listë e hollësishme e tyre është dhënë në dokumentin fillestar të këtij landfilli. Nuk lejohen të depozitohen mbetjet spitalore, bateri dhe akumulatorë, vajra industriale dhe mbetje të tjera të përcaktuara si të rrezikshme nga legjislacioni mjedisor.

Praktika e operimit parashikon mbajtjen e statistikave të rregullta që lidhen me sasinë e mbetjeve dhe origjinën e tyre, datën e hyrjes në venddepozitim, inspektimin vizual të tyre në momentin e shkarkimit, si dhe verifikimin e dokumentacionit kur transporti i tyre bëhet nga të tretë.

Ujërat e ndotura dhe ujërat e tjera të mbledhura trajtohen në një impiant teknikisht të përshtatshëm me qëllim që të garantohen shkarkime në përputhje me normativat e lejuara. Llumi i krijuar nga pastrimi i liksiviateve kthehet në masën e mbetjeve në venddepozitim.

Ndikimet kryesore dhe më problematike gjatë fazës operative sipas raportit të VNM, parashikohen:

- Erozioni: Territori ku është ndërtuar venddepozitimi i mbetjeve urbane i nënshtrohet faktorëve gërryes. Për shkak të përbërjes së formacioneve dhe morfologjisë, relievi i objektit është relativisht i ekspozuar ndaj proceseve erozive. Trashësia e mbulesës dhe infiltrimi sipërfaqësor i ujërave, në kohë shirash intensive, bëjnë që të ketë premisa zhvillimi të erozionit. Shirat e rrëmbyeshëm mund të sjellin edhe gërryerje të skarpatës dhe grumbullimin e formacioneve argjilore dhe alevrolitore. Për këtë, në projektin teknik janë parashikuar masat e nevojshme për evitimin e këtij fenomeni. Ndërtimi i një kanali mbi objekt për mbledhjen e ujërave gjatë reshjeve ndihmon jo vetëm në drejtim të erozionit, por edhe për të pakësuar në minimumin e mundshëm sasinë e ujërave nga reshjet që infiltrojnë në objekt dhe formojnë liksiviatet.

- Erërat e pakëndshme që janë karakteristike e venddepozitimeve të mbetjeve urbane. Projekti parashikon mbulimin ditor me materiale të përshtatshme të venddepozitimit dhe djegien e biogazit për të minimizuar, ndër të tjera, edhe erërat e pakëndshme që gjenerohen.

Edhe pse vendi ndodhet në një zonë ku predominon argjila, janë realizuar edhe barriera artificiale, si realizimi i shtresave të argjilës me trashësi 1 m, me përshkueshmëri më të vogël se 1×10^{-7} cm/s dhe përdorimi i bentonitit gjeosintetik me papërshkueshmëri të barasvlershëm me ato të garantuara nga shtresat argjilore artificiale të sipërpërmendura. Kjo ka krijuar mundësinë për të kompensuar deficitet eventuale të përshkueshmërisë hidraulike. Si në pjesën fundore, ashtu edhe në paretet e venddepozitimit, garantohet një përshkueshmëri hidraulike $\leq 1 \times 10^{-7}$ cm/s, trashësi ≥ 1 m, siç përcaktohet edhe nga Direktiva e Bashkimit European 1999/31/ KE në lidhje me shkarkimet e mbetjeve.

Për më tepër, është shtuar edhe një sistem barriere artificiale në pjesën fundore dhe në parete, një membranë PEAD (polietilen me densitet të lartë) me spesor 2,5 mm, ashtu siç kërkohet edhe nga normativa e sipërpërmendur.

Përsa i përket mbledhjes dhe trajtimit të liksivateve të formuara nga mbetjet, është parashikuar në brendësi të basenit (në afërsi të pjesës fundore të venddepozitimit) një shtresë drenuese me spesor rreth 50 cm, e përbërë nga material inert, dhe një rrjet grumbullimi (i përbërë nga tubacione PEAD me vrima) i cili dërgon liksivatet e formuara nga venddepozitimi drejt pusit të grumbullimit në vendin e caktuar në brendësi të venddepozitimit. Me pas liksivatet në brendësi të pusit dërgohen me pompë drejt impiantit të trajtimit. Sasia ditore e tyre është mesatarisht $50 \text{ m}^3/\text{ditë}$.

VKM nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”, nuk parashikon limite të lejuara për tregues të shkarkimeve nga impiante që trajtojnë ujërat e ndotura të venddepozitimeve urbane. Për këtë arsye, janë pranuar limitet e lejuara italiane për shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë.

3.2.6 Rreziqet mjedisore si pasojë e pranisë së landfill-it

Duke qenë se procesi i eliminimit të mbetjeve të ngurta urbane, në disa raste mund të afektojë shëndetin publik, rezulton e domosdoshme vendosja e një sistemi korrekt kontrolli dhe parandalimi me karakter higjieno-sanitar lidhur me operacionet që zhvillohen në landfill.

Për rrjedhojë, është e nevojshme që të evitohet transferimi i ndotjes nga një sektor në tjetrin në territor duke eliminuar vektorët e përhapjes së ndotjes mjedisore.

Aspekti sanitar duhet të përfshijë të gjithë sektorët fizikë, kimikë, biologjikë të cilët mund të kenë ndikim mbi shëndetin njerëzor dhe që bëhet shkaktar i një përkeqësimi të mirëqenies psikofizike dhe sociale.

Kur mbetjet grumbullohen në landfill, ndodhin transformime të natyrës kimiko-biologjike, të cilët kanë si produkte lëndë të ngurta, të lëngëta dhe të gazta. Metalet e

rëndë pësojnë një oksidim, ndërsa lënda organike dhe inorganike atakohen nga flora bakteriale e larmishme, në varësi të kushteve në të cilat ndodhet landfill-i. Likxiviatet që prodhohen gjatë fermentimit, përmbajnë kryesisht acide organike.

Reaksionet kimike që lidhen me materialin e depozituar në landfill, janë të lidhura me dy faza:

- Faza aerobike, e cila karakterizohet nga prania e gazit karbonik, ujit dhe nitrateve;
- Faza anaerobike, ku përveç ujit dhe gazit karbonik, formohet metan, amoniak, azot, acide organike, gas sulfhidrik, etj.

Gazi metan mund të formojë me ajrin përzierje shpërthyes, ndërsa gazi karbonik, duke formuar acidin karbonik, mund të ndikojë në mineralizimin e ujërave nëntokësore. Duke qenë se reaksionet e oksidimit janë ekzotermike, në brendësi të landfill-it mund të gjenerohet një sasi nxehtësie, e tillë që mund të çojë në një rritje të konsiderueshme të temperaturës edhe në sipërfaqe. Kjo është më e dukshme sidomos në zonat e rrafshëta ku komprimimi është më i madh. Skarpatet e landfill-it, të cilat përgjithësisht mbulohen me material evakuimi, paraqesin kryesisht probleme erozioni.

Si përfundim, rreziqet potencialisht të gjenerueshme nga prania e një landfill-i mund të përmbliken si më poshtë vijon:

- Ndotje atmosferike: djegia e mbetjeve të ngurta mund të gjenerojë një emetim të substancave ndotëse të padëshiruara (si pluhura, NO_x , SO_x , acid klorhidrik, hidrokarbure, etj.) të dëmshme për shëndetin. Ekziston gjithashtu problemi i përhapjes së erërave të krijuara nga dekompozimi i substancave organike ose nga proceset fiziko-kimike: procese të tilla mund të kufizohen duke përcaktuar pozicionin më të përshtatshëm të landfill-it në raport me drejtimin e erës. Përgjithësisht, përdoren barriera erëthyese të tipit fiks (pemë, etj) ose të lëvizshëm, të cilat kufizojnë efektin eolik të shpërhapjes.
- Shpërthimi i zjarreve: për shkak të shkëndijave ose flakëve të prodhuara nga mjetet mekanike që operojnë në landfill, nga pakujdesia e vetë personelit, ose nga prania e materialeve të ndezshëm në mbetjet (p.sh thëngjij) mund të lindë një djegie e gazeve të djegshëm të prodhuar në landfill (metan, etj). Më tej, për shkak të një kompaktimi të paktë të materialit, i cili ka si pasojë praninë e oksigjenit në boshllëqet, mund të krijohet rreziku i vetëndezjes së gazeve të djegshëm të prodhuar nga fermentimi i mbetjeve. Për këtë arsye, duhen përdorur teknologji të përshtatshme për kryerjen e kontroleve të vazhduar të landfill-it për të sinjalizuar praninë e mundshme të fenomeneve të vetëndezjes.
- Ndotje ujore: rreziku i përhapjes në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore i substancave toksike ose mikroorganizmave patogjenë që ndeshet shpesh në mbetjet, nxjerr një problematikë sanitare, edhe përsa i përket zinxhirit ushqimor.

- Përhapja e agjentëve patogjenë: landfill-i i mbetjeve urbane, të cilat janë të pasura me lëndë organike, përbën një habitat ideal për kafshët potencialisht mbartëse të sëmundjeve infektive. Brejtësit, zogjtë dhe insektet janë ndër frekuentuesit më të zakonshëm të landfill-eve. Po ashtu, si pasojë e pranisë së vendstrehimeve të brejtësve, funksioni i strukturave të papërshkueshme dhe i mbulesës mund të cenohet, duke çuar në krijimin e rrugëve preferenciale të infiltrimit të ujërave atmosferike ose të daljes së liksivateve.

Impakti negativ i një landfill-i, nga pikëpamja higjieno-sanitare, nuk ka të bëjë vetëm me aspektin toksikologjik, por me të gjitha lidhjet që ekzistojnë midis mjedisit human, truallit, ajrit dhe ujit.

Për të vlerësuar një impakt të tillë, duhen vlerësuar shumë parametra mjedisorë, të cilët në varësi të referimit (tipit të mbetjeve ose mjedisit pritës) mund të ndahen në dy grupe:

- Parametra që lidhen me mbetjen: këtu bëhet fjalë për toksicitetin ndaj njeriut, ndaj jetës ujore, ndaj qëndrueshmërisë, bioakumulimit mjedisor dhe tretshmërisë në mjedise ujore;
- Parametra që lidhen me mjedisin: përhapja në mjedis e substancave toksike është funksion invers i ngarkesës bakteriale të truallit, i ngarkesës aktive dhe pranisë së agjentëve kompleksues, ndërsa është drejtpërdrejt e lidhur me përcjellshmërinë, me shpejtësinë e infiltrimit, porozitetin, *pH* dhe potencialin e oksido-reduktimit.

3.3 Përdorimi ekzistues i tokës; Aktivitetet dhe ndikimet e tyre

3.3.1 Ndarja në 5 sisteme bazë

Në këtë kapitull bëhet një pasqyrë e gjendjes ekzistuese e territorit, sipas koncepteve të ndarjes në pesë sisteme territorial bazë, që dalin nga përcaktimet e kuadrit ligjor për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit⁷. Sa më sipër, me sistem territorial duhet të kuptojmë:

“Sistem territorial është bashkësia e një sërë përbërësish territorialë, të ndërruarur dhe bashkëveprues me njëri-tjetrin, të cilët formojnë një tërësi”

Referuar këtij kuadri ligjor, njësitë e qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahen në sisteme territoriale, si më poshtë:

- Sistemi urban (UB);
- Sistemi natyror (N);
- Sistemi bujqësor (B);
- Sistemi ujor (U);

⁷ Përcaktimet kryesore për sistemet territorial jepen në Nenin 73, VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”

- Sistemi infrastrukturor (IN).

Bazuar në këto sisteme, ekspertët multi-disiplinar të angazhuar në hartimin e PPV-së hedhin bazat e analizës metabolike⁸, me qëllim që të ofrojnë qasjet e duhura strategjike për zhvillimin e territorit. Këto sisteme organizohen në marrëdhënie mes qendrave, korridoreve dhe zonave, mbi bazën e të cilave do të detajohet dokumenti i PPV-së. Duhet theksuar fakti që ndarja në sisteme territoriale bazë nuk është vetëm përcaktim për përdorimin e tokës (land-use), por edhe mundësi për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në përputhje me karakteristikat primare të sistemeve.

Duhet pasur parasysh që analiza metabolike (në planifikimin e territorit), nuk është më' një term teorik i përdorur nga studiuesit e kësaj fushe, por një kërkesë ligjore në procesin e planifikimit. Përmes saj, pesë sistemet bazë analizohen, jo si të veçantë, por në ndërveprim me njëri-tjetrin dhe nëpërmjet një hulumtimi multi-disiplinar arrihen të përcaktohen "pikat e ekuilibrit" të një zhvillimi të qëndrueshëm. Më konkretisht, më mbivendosjen dhe ndërthurjen e këtyre sistemeve, zbulohen ato pika (apo çeshtje) strategjike që lidhen direkt me sfidat dhe mundësitë e zhvillimit.

Tabela 12: Sipërfaqet e sistemeve

Sistemi i përdorimit të tokës	ha	%
Sistemi natyror	32675.86	65.9
Sistemi ujqor	2187.18	4.4
Sistemi bujqësor	11689.54	23.6
Sistemi urban	3044.47	6.1
Sistemi infrastrukturor	1.15	0.002
Total	49598.2	100

Duke marrë në konsideratë hierarkinë e instrumentave të planifikimit, në vijim, përshkrimi i secilit sistem bazë për territorin e Bashkisë Vau-Dejës do të jepet i gërshetuar edhe me parashikimet kryesore që vijnë nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe Planet Ndërsektoriale, në lidhje me territorin e kësaj bashkie.

Për të realizuar një skenar të integruar e të qëndrueshëm urban propozohet një model i cili ndan e më pas studion ndërveprimin e sistemeve të zhvilluara në territor. Siç përmendet në dokumentin e Draft PPK, vizioni dhe realizimi i objektivave të një zhvillimi të qëndrueshëm arrihet duke iu referuar analizës së sistemeve territoriale.

3.3.2 Kategoritë e përdorimit të tokës

Bazuar në përcaktimet e VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", kategoritë bazë të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të janë 14 dhe vendosen brenda çdo sistemi të territorit në përputhje me këtë rregullore

⁸ Kuptimi i "Metabolizmit" si model jepet në Nenin 2 të VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"

dhe legjislacionin në fuqi. Pikërisht këto kategori, përcaktojnë karakteristikat e territorit për nga specifika e përdorimit dhe mundësojnë një lexim të hollësishëm të kontekstit.

- Përdorimi “banim”, me kod “A”, i cili përfshin zona dhe objekte ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit, edhe në rast se janë të klasifikuara nga legjislacioni për monumentet e kulturës ose të tilla që janë në funksion të banimit;
- Përdorimi “industri dhe ekonomi”, me kod “IE”, ku përfshihen të gjitha llojet e industrive sipas legjislacionit të posaçëm, nxjerrje dhe përpunim mineralesh e materialesh ndërtimi, parqe industriale dhe logjistike, inkubatorë biznesi dhe të përziera industriale dhe ekonomike për sa kohë që qëllimi kryesor i funksionit të tyre nuk janë shërbimet dhe aktivitete ekonomike bujqësore sipas kësaj rregulloreje;
- Përdorimi “bujqësi”, me kod “B”, për qëllim bujqësor sipas legjislacionit të posaçëm, përfshirë aktivitetet ndihmëse dhe në funksion të drejtpërdrejtë të bujqësisë, përveç banesave dhe rrugëve;
- Përdorimi “shërbime”, me kod “S”, territore dhe struktura për shërbime tregtare, zyra dhe qendra biznesi;
- Përdorimi i veçantë, me kod “V”, varrezat dhe çdo territor apo strukturë që nuk përfshihet në kategoritë e tjera bazë;
- Përdorimi “ujëra”, me kod “U”, të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ujërat;
- Përdorimi “toka natyrore”, me kod “N”, sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin, biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme;
- Përdorimi “trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike”, me kod “M”, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm, përveç atyre që banohen;
- Përdorimi “zona ushtarake”, me kod “ZU”, territore dhe objekte të klasifikuara si të tilla në territor apo në legjislacionin e posaçëm;
- Përdorimi “institucione”, me kod “IS”, administrata dhe struktura shtetërore, pavarësisht nivelit, të sistemit gjyqësor, bankat, mediet, institucione të mbrojtjes civile dhe kombëtare veç atyre që përfshihen në kategoritë e tjera, të shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit social, të shoqërisë civile, sistemi i burgjeve dhe institucione fetare;
- Përdorimi “aktivitete sociale dhe rekreative”, me kod “AR”, aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, përfshirë ato sportive, sipas legjislacionit të posaçëm;
- Përdorimi “arsim”, me kod “AS”, sipas legjislacionit të posaçëm;
- Përdorimi “shëndetësi”, me kod “SH”, sipas legjislacionit të posaçëm;
- Përdorimi “infrastruktura”, me kod “IN”, të gjitha pjesët e infrastrukturave për transportin, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimin me ujë, naftën dhe gazin, biokarburantet, komunikimin elektronik, furnizimin me energji elektrike, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rrëshqitja dhe mbrojtjen kundër zjarrit, sipas legjislacionit të posaçëm

Bazuar në përcaktimet e mësipërme do të hartohen propozimet e PPV të bashkisë Vau-Dejës duke specifikuar kategoritë përkatëse të përdorimit të tokës për secilin

sistem. Gjithashtu, këto kategori, janë edhe elementët bazë mbi të cilët është lexuar konteksti ekzistues duke identifikuar gjendjen aktuale të territorit.

Mbështetur në karakteristikat e territorit të bashkisë Vau-Dejës, vërehet se pjesa më e madhe e tij (mbi 60%) i përket kategorisë së përdorimit “toka natyrore”, ku mbizotëron karakteri mjedisor, biodiversiteti, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme. Pikërisht mjedisi dhe natyra përbëjnë edhe një nga asetet më të mëdha territoriale për zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin.

Një tjetër kategori përdorimi i tokës, është përdorimi “bujqësi”, që zhvillohet në mbi 20% të territorit. Bujqësia përfaqëson komponentin tjetër mjaft të rëndësishëm të territorit të bashkisë që thekson karakterin rural si dhe garanton zhvillimin ekonomik dhe rritjen e qëndrueshme.

Përdorimi “ujëra”, zë një zë mjaft të rëndësishëm në hierarkinë e përdorimit të tokës duke evidentuar burimet e shumta hidrike si mundësi për zhvillimin e bujqësisë, peshkimit dhe turizmit. Për nga shtrirja në territor, kjo kategori është e përafërt me kategorinë “banim” duke evidentuar shkallën e ulët të urbanizimit dhe pasuritë e mëdha ujore të bashkisë.

Megjithëse e kufizuar në shtrirje, kategoria e përdorimit të tokës “infrastrukturë”, sidomos infrastruktura energjetike dhe HEC-et, janë të një rëndësie të jashtëzakonshme në nivel kombëtar. Këto asete energjetike e kthejnë territorin në një zonë me potenciale mjaft të larta zhvillimi në të ardhmen, jo vetëm si prodhuese dhe furnizuese me energji elektrike, por edhe si një territor ku mund të zhvillohet turizmi i veprave madhore të infrastrukturës.

Në vijim paraqitet analiza e territorit referuar sistemeve territoriale dhe përdorimit ekzistues të tokës.

3.3.3 Sistemi urban

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër.

Për objektivat që sistemi urban rekomandon sipas PPK do të kishim prodhimin e politikave të fokusuara në zhvillim policentrik, densifikim dhe gjithëpërfshirje.

Për të zbutur pabarazinë e krijuar, Sistemi Urban sipas planit kombëtar propozon:

- Hierarkizimin e qendrave
- Profilizimin e tyre në akomodimin e sektorëve ekonomikë të përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.
- Rajonizimin, ose bazat për zhvillim rajonal i shprehur në bashkimin funksional të qendrave urbane primare dhe të specializuara.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, në varësi të statusit aktual dhe të propozuar të qendrave urbane, me qëllim sigurimin e zhvillimit të territorit në përputhje me Vizionin e planit, propozon ndërhyrje konsoliduese, përforcuese, rigjeneruese, kooperuese dhe fuqizuese për qendrat urbane. Plani kombëtar për sistemin urban propozon:

- Zhvillim hapësinor policentrik dhe një marrëdhënie të rë urbane - rurale;
- Kontroll i ekspansionit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara, duke promovuar densifikimin në vend të shperhapjes urbane;
- Akses më të mire në një infrastrukturë multimodale, e cila është jo vetëm më e efektshme, por edhe miqësore ndaj mjedisit;
- Funksione mikse dhe komplementare;
- Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban në vecanti i ujit, energjisë dhe mbetjeve;
- Konservim dhe zhvillim të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.

Politika që udhëheq strukturën e propozuar të sistemit urban është krijimi dhe forcimi i qyteteve dinamike, tërheqës dhe konkurrues në rajone të urbanizuara.

Qyteti i Vaut të Dejës përcaktohet në PPK si qendër urbane terciare. Këto qendra përmbajnë funksione dhe shërbime bazë si psh.:

- Funksionet ekonomike dhe të vendbanimeve,
- Funksionet e tregtisë me pakicë,
- Funksionet kulturore dhe të rekreacionit,
- Funksionet administrative,
- Funksionet arsimore shkolla të mesme, shkolla profesionale,
- Funksionet shëndetësore dhe të perkujdesjes sociale.

Gjithë qendrat e tjera urbane të bashkisë bëjnë pjesë në kategorinë Lokalitete.

Lokalitete janë konsideruar qendra të vogla të banuara me karakter rural. Në përgjithësi lokalitetet janë fshatra, të cilat janë njësia më e vogël e organizimit territorial.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 5, Dt. 29.12.2014, “për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, sistemi urban për Bashkinë Vau-Dejës është identifikuar në hartën në vijim.

Më konkretisht, nga ekspertët GIS që u morën me evidentimin e situatës reale të urbanizimit, rezulton që rreth 25% e numrit të përgjithshëm të objekteve mungojnë në databazën e Vendimit të KKT nr.5, dt.29.12.2014.

Zhvillimi i qendrave urbane është bërë ndër vite duke u ndikuar nga elementët e fortë territorialë dhe nga proceset historike dhe zhvillimore. Qyteti i Vaut të Dejës është një vijmësi e qytetit të Danjës i cili ka lulëzuar në shekujt XI – XV dhe që së bashku me qytetin e Sardës (Shurdhahu) u zhvilluan në terriore strategjike e me burime të bollshme natyrore. Pikërisht ky pozicion i favorshëm gjeografik në kryqëzimin e rrugëve kryesore në veriun e vendit, si dhe burimet e pasura hidrike, toka pjellore, natyra e virgjër dhe vlerat historike e kulturore e bëjnë Vaun e Dejës të jetë një pikë me potencial strategjik dhe atraktive për zhvillimin ekonomik.

Qendrat rurale janë zhvilluar sipas aksesit në infrastrukturën bujqësore. Kryesisht janë të zhvilluara territoret në zonën fushore të bashkisë që përkon me zonat qendrore, perëndimore dhe jugore. Këtu toka bujqësore është e një cilësie të mirë, terreni i favorshëm dhe burimet hidrike të pranishme.

Tendencat e zhvillimit janë në zgjerimin e zonave urbane, herë me ndërtime informale dhe ndërtime në toka bujqësore dhe herë me intensifikim brenda strukturës aktuale. Në dy dekadat e fundit, intensifikimi i ndërtimit në zonat urbane dhe ndërtimi në mënyrë të pakontrolluar, kanë dëmtuar peizazhin e zonave urbane dhe atyre me potencial turistik.




Fig. 53: Harta e zonave të urbanizuara të miratuara sipas VKM Nr. 5, Dt. 29.12.2014 për Bashkinë Vau-Dejës

Zhvillimi i ndërtimeve përgjatë akseve rrugore është një karakteristikë e territorit të bashkisë. Kjo ndodh për shkak të aksesit të kufizuar në infrastrukturë që kanë zonat periferike. Sidomos në aksin Tiranë - Shkodër ky zhvillim konsiderohet mjaft problematik pasi infrastruktura rrugore është bërë e rrezikshme për shkak të pranisë së aktiviteteve ekonomike të vendosura në të dy anët e rrugës dhe lëvizjes që imponojnë ato.

3.3.3.1 Qendrat e Banuara

Një element përbërës i sistemit urban janë qendrat e banuara. Në total qendrat e banuara përbehen nga qendrat urbane, ato rurale dhe zonat tranzitore/informale.

Për territorin e Bashkisë Krujë kemi 48 qendra të banuara nga të cila 47 fshatra dhe 1 qytet. Qendrat kryesore të banuara urbane janë:

- Qendra urbane e banuar Vau-Dejës
- Qendra urbane e banuar Bushat (megjithëse klasifikohet si fshat, Bushati ka numrin më të madh të popullsisë dhe aktivitetin më intensiv ekonomik, duke u kthyer në një qytezë)

Qendrat rurale janë 46 dhe janë shpërndarë në 6 njësi administrative si më poshtë:

- Zona rurale e banuar njësi administrative Bushat: 13 fshatra
- Zona rurale e banuar njësi administrative Hajmel: 5 fshatra
- Zona rurale e banuar njësi administrative Shllak: 7 fshatra
- Zona rurale e banuar njësi administrative Temal: 10 fshatra
- Zona rurale e banuar njësi administrative Vau-Dejës: 8 fshatra
- Zona rurale e banuar njësi administrative Vig-Mnelë: 3 fshatra

Struktura e ndërtuar ndahet në dy tipologji të qarta. Lagjet periferike dhe zonat rurale mbizotërohen nga struktura pikësore, të tipit banesë njëfamiljare, me lartësi të ulet, 1-2-3 kate, të vendosura në distance nga njera tjetra dhe me oborre përreth që varijonë nga zona në zonë. Struktura hapësinore e vendbanimeve rurale në këtë treve është përgjithësisht e shpërhapur në territor në formë njollash, grupe shtëpish, përveç zonave më të përqëndruara që përbëjnë qendrat historike të fshatrave.

Ndërkaq në qytetin e Vaut të Dejës dhe disi më pak në fshatrat e ndërtuara pas viteve '50 shfaqen ndërtimet e tipit gjatësor, me lartësi deri në 4 - 5 kate.

Cilësia dhe kushtet e ndërtesave varen drejtpërsëdrejti nga koha e ndërtimit të tyre. Objektet e ndërtuara mes viteve '50 – '90, sidomos kur janë rezidenca banimi kolektive janë degraduar nga koha dhe mungesa e mirëmbajtjes. Ndërtimet e reja janë në gjendje më të mirë duke gjykuar nga pamja e jashtme, por lënë mjaft për të dëshiruar, qoftë nga paraqitja arkitektonike, qoftë nga formulimi urban, vendosja karshi zonës dhe objekteve përreth, respektimi i kushteve dhe normave urbane. Për t'u parë ndoshta në një fazë më të avancuar do të ishin kushtet inxhinierike të ndërtimit, niveli i sigurisë ndaj tërmeteve, masa për mbrojtjen nga zjarri etj.

Në vijim paraqitet një inventar i ndërtesave publike dhe shërbimeve për 6 njësitë administrative.

Tabela 13: Inventar i ndërtesave publike (Bashkia Vau-Dejës)

	Vau-Dejës	Bushat	Hajmel	Vig-Mnelë	Shllak	Temal
Spital	-	-	-	-	-	-
Shtëpi lindjeje	-	-	-	-	-	-
Poliklinikë / qendër shëndetsore	6	14	5	3*	2	1
Kopësht / çerdhe	9	15	6	1	-	-
Shkolla 9 vjeçare	5	9	5	4	3	4
Shkolla të mesme	2	1	2	-	-	-
Stadium	-	-	-	-	-	-

* Shënim: në njësinë administrative Vig-Mnelë vetëm një qendër shëndetësore është funksionale

3.3.3.2 Zonat industriale

Komponenti tjetër përbërës i sistemit urban janë zonat industriale. Në vitet e fundit vihet re një rritje e numrit të aktiviteteve në territor, sidomos në zonat qendrore me akses më të lehtë pranë rrugës kombëtare Tiranë – Hani i Hotit.

Territori i bashkisë Vau-Dejës, megjithëse karakterizohet nga një zhvillim kryesisht rural me në fokus prodhimin bujqësor dhe blegtoral, ka prezencë edhe të industrisë së lehtë dhe agroushqimore, të cilat janë prezentë në territor në trajtën e sipërmarrjeve të vogla që shpeshherë kanë trajtat e bizneseve familiare.

Paçka se të dhënat e sakta nuk janë vënë ende në dispozicion nga bashkia, konstatohet prania e një seri biznesesh dhe industrish me perspektivë zhvillimi si: prodhim inertesh, punishte duralumini, prodhime mermeri, prodhime druri, fabrikë plastike, fabrika mielli, fabrikë bluarje, prodhim fidanësh, ferma blegtorale, serra, baxho, sallameri, kantina, punishte vaji, etj.

Pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve ekonomike dhe industriale janë të vendosura në njësitë kryesore Bushat dhe Vau-Dejës. Hartat e bashkëngjitura këtij raporti ilustrojnë vendndodhjen e aktiviteteve sipas njohjes së deritanishme të territorit që ka mundur të bëjë konsulenti.

3.3.4 Analiza e zhvillimit hapësinor dhe tipologjik

Konsulenti ka analizuar me kujdes Sistemin Urban duke u bazuar në cilësitë dhe kushtet e ndërtesave dhe të territorit, si një pikënisje për zhvillimin e rigjenerimit, përtëritjes dhe/ose planet e rizhvillimit. Strukturat ekzistuese të ndërtuara janë identifikuar identifikohen në bazë të uniformitetit të tipologjisë dhe vëllimit të banesave, shpërndarjes së tyre hapësinore në njësi, rrjetit rrugor, skemës së hapësirave publike dhe parametrat e vëllimit të strukturave (lartësia, mbulimi etj.).

Për të bërë këtë analizë na vijnë në ndihmë hartat e mbivendosura të analizës tipologjike dhe hapësinore. Siç vihet re prej tyre, qendrat e banuara karakterizhen në përgjithsi nga një lartësi e ulët dhe mesatare, me tendencë zhvillimi linear, përgjatë akseve kryesore rrugore. Në aspektin hapësinor dallohen pesë tipologji zhvillimi.

- Zhvillimi rrezor, përgjithsisht në qedrat e vjetra të banuara ku qendra e vjetër rurale shërben si qendër rreth të cilës zhvillohet njësia në kohë.

- Zhvillimi linear, tipik për zhvillimet e kohëve të fundit, rrjedhojë edhe e nevojës për afërsi fizike me arteriet e komunikacionit. Kjo formë zhvillimi vihet re kryesisht në të gjitha zonat urbane të zhvilluara përgjatë aksit kombëtare dhe lokale të lëvizjes dhe infrastrukturës rrugore.
- Zhvillimi tërthor, si një ndërthurje e dy formave më sipër, shfaqet më së shumti në strukturat e shpërndara në ultësirën perëndimore, në qendrat ruarale të bashkisë.
- Zhvillim kuadratik, si një ndër format e zhvillimit të territorit ku vendosja e ndërtesave i bindet një rrjeti kuadratik rrugor. Kryesisht ky zhvillim haset në qendrat e reja urbane të zhvilluara përmes një procesi urbanizimi.
- Zhvillim i çrregullt, që karakterizohet nga shpërhapja në territor e ndërtimeve pa ndonjë kriter specifik dhe që haset kryesisht në zonat periferike apo territoret bujqësore larg infrastrukturës bazë.

Tipologjitë hapsinore paraqiten të përmbledhura në figurën në vijim. Një përshkrim më i hollësishëm i shpërndarjes së tyre në territor, bëhet në hartën U-I-26 të Tipologjisë Hapësinore.




Fig. 54: Tipologjitë hapsinore

Hapësira publike konceptohet si e tillë gati vetëm në Vau-Dejës, me objekte, hapësira dhe zona të gjelbra që formulojnë karakterin urban. Proçesi i mbushjes së hapësirës së ndërmjetme, me disa përjashtime të vogla, për fat të mire nuk ka ndodhur deri tani dhe ekzistojnë mundësi të mira për të ngritur cilësinë e jetës me menaxhimin dhe trajtimin e duhur. Gjithësesi, mbetet ende shumë për të bërë në krijimin e një infrastrukture publike në nivel të kënaqshëm për një qendër të mirëfilltë urbane.

Elementi kryesor i zhvillimit të qytetit të Vau-Dejës mbetet hidrocentrali, i cili ka qenë ndër burimet kryesore të punësimit dhe zhvillimit për territorin. Gjithësesi, duke vlerësuar asetet territoriale, qyteti ka potencialet për një zhvillim afatgjatë të turizmit dhe industrive të lehta e atyre bujqësore.

Gjithë objektet publike si shkolla, qendra shëndetësore, qendra njësisish administrative, stacione hekurudhore, nënstacione elektrike, stacione pompimi, qendra ushtarake, varreza etj, janë identifikuar dhe përditësuar në hartat e gjendjes ekzistuese për territorin e bashkisë.

Struktura e ndërtuar

Pavarësisht zhvillimit linear apo rrezor, struktura e ndërtuar ndahet në dy tipologji të qarta. Lagjet periferike dhe zonat rurale mbizotërohen nga struktura pikësore, të tipit banesë njëfamiljare, me lartësi të ulët, 1-2-3 kate. të vendosura në distance nga njera tjetra dhe me oborre përreth që varijonë nga zona në zonë. përveç kësaj të përbashkëte, duket se pak uniformitet ka në volumetrinë dhe paraqitjen e këtyre ndërtesave, duke mos krijuar ndonjë ansambël me vlera arkitektonike apo urbane, por duke ruajtur ligjshmëritë e kaosit. Më interesante në këtë aspekt shfaqen ndërtimet në fshatrat e hershëm dhe të thellë të bashkisë, ku tipologjitë janë më të ngjashme dhe me një strukturë rurale më të qartë.

Ndërkaq tek tuk në qytet dhe më rrallë në fshatrat e ndërtuara pas viteve '50 shfaqen ndërtimet e tipit gjatësor, me lartësi 4, 5 kate.

Cilësia dhe kushtet e ndërtesave varen drejtpërsëdrejti nga koha e ndërtimit të tyre. Objektet e ndërtuara mes viteve '50 – '90, sidomos kur janë rezidenca banimi kolektive janë degraduar nga koha dhe mungesa e mirëmbajtjes. Ndërtimet e reja janë në gjendje më të mirë duke gjykuar nga pamja e jashtme, por lënë mjaft për të dëshiruar, qoftë nga paraqitja arkitektonike, qoftë nga formulimi urban, vendosja karshi zonës dhe objekteve përreth, respektimi i kushteve dhe normave urbane. Për t'u parë ndoshta në një fazë më të avancuar do të ishin kushtet inxhinierike të ndërtimit, niveli i sigurisë ndaj tërmeteve, masa për mbrojtjen nga zjarri etj.

3.3.5 Lidhja me infrastrukturën kombëtare

Sistemi urban i bashkisë Vau-Dejës lidhet mirë me rrjetin e infrastrukturës kombëtare. Në territorin e tij kalojnë akse të rëndësishme që mundësojnë lidhje të shpejtë me rajonin Shkodër-Lezhë si dhe me kryeqytetin. Nga ana tjetër zhvillimi përgjithsisht linear i sistemit urban, pikërisht përgjatë akseve rrugore të rëndësishme, pavarësisht problemeve që sjell, mundëson gjithsesi një akses të mirë në rrjetin rrugor kombëtar.

Qendrat e banuara tradicionale janë kryesisht në zona fushore me rrjet të përshtatshëm rrugor. Pavarësisht gjendjes së rrugëve, për të cilën do flasim më vonë, sistemi urban, edhe përse u përket fshatrave dhe zonave të shpërhapura dhe me dendësi të ulët, është i lidhur mjaftueshëm me rrjetin rrugor.

Aksesi i lehtë në rrugën kombëtare Tiranë - Shkodër, kanë bërë që njësi si Bushati, Vau-Dejës dhe Hajmeli të kenë zhvillim sidomos në zonat fushore. Braktisje e vendbanive të thella në njësitë administrative Shllak e Temal lidhet përsëri me aksesin e kufizuar në infrastrukturën kombëtare e lokale dhe sidomos në atë rrugore. Duhet theksuar se në një pjesë të vendbanimeve aksesin kryhet përmes transportit të kombinuar ujë-rrugë.

Lidhja me rrjetin hekurudhor bëhet përmes stacionit të Mjedës dhe Hajmelit. Megjithatë linja hekurudhore është tejte e amortizuar dhe thuajse jashtë shërbimi, potenciali i zhvillimit bazuar edhe në direktivat e PPK mbetet i lartë.

Nga ana tjetër me problematike shfaqet situata në rrjetin e infrastrukturës së shërbimeve. Si do të shpjegohet më hollësi më tej, lidhja me rrjetin kryesor elektrik funksionon mirë, por shpërndarja e rrjetit të energjisë në zonat periferike ka mangësi të dukshme.

Çështjet e mësipërme janë trajtuar më gjerësisht në pikat në vijim dhe konkretisht në analizën e Sistemit Infrastrukturor.

3.3.6 Sistemi natyror

Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë” në përputhje me legjislacionin e posaçëm. Është detyrë primare e PPV-së të promovojë dhe mundësojë aksesin e zonave me karakteristika natyrore e peisazhistike. Menaxhimi inteligjent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore siguron ruajtjen e identitetit dhe diversitetit kulturor përballë rritjes e globalizimit . Në të njëjtën kohë i bën aktive dhe kontribuese në rritjen ekonomike të zonës duke i riaktivizuar si asete nëpërmjet përmirësimit të arritshmërisë së përshtatshme të tyre.

Procesi i planifikimit dhe i zhvillimit në territore natyrore, si dhe ndryshimi i kategorisë përkatëse bazë të përdorimit të tokës në kategori të tjera rregullohet nga legjislacioni i posaçëm për pyjet dhe shërbimin pyjor, për tokën, për turizmin, për kullotat dhe livadhet, për menaxhimin e rezervave ujore dhe për mjedisin.

Përdorimi i tokës si pasojë e rritjes dhe zhvillimit, ka bërë që njëkohësisht të humbasin vazhdimisht sipërfaqe të lira së bashku me funksionet e tyre në ndihmë të ekosistemeve natyrore dhe mbrojtjen e klimës, çlodhjen, si edhe funksionet e tyre të kapacitetit ekonomik për pylltarinë dhe bujqësinë, prodhimin e energjisë së rinovueshme, si edhe mbrojtjen e burimeve të nëntokës së zonave përkatëse. Prandaj në kushtet e një zhvillimi të qëndrueshëm, mbindërtimi, shfrytëzimi i nëntokës për kanalizime e themele dhe fragmentimi i hapësirës së lirë, si edhe në mënyrë të veçantë shfrytëzimi i burimeve natyrore të parinovueshme, duhet të mbahet në një nivel sa më të ulët të jetë e mundur.

Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë”. Në terma të përgjithshëm PPK, në shkallë territori vendi për sistemin natyror rekomandon politika që stimulojnë rritjen e zonave të mbrojtura, promovimin dhe lehtësimin e aksesit të tyre.

Objektivi madhor i PPK-se është: zhvillim i qëndrueshem i sistemit natyror. Ky objektivi synohet të arrihet nepermjet politikave të mëposhtme:

- Rritja e përgjegjesise kombëtare e ndërkombëtare për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, duke kombinuar konceptet e qëndrueshmërisë dhe administrimit të mirë;
- Mbrojtja dhe rritja e zonave të mbrojtura natyrore; krijimi i një sistemi të qëndrueshëm e komunikativ mjedisor;
- Rritja e rolit të mjedisit në zhvillimin ekonomik të vendit; integrimi i sistemit natyror në vlerën ekonomike të sektorëve të zhvillimit;
- Rritja e rolit të mjedisit në cilesine e jetës urbane përmes promovimit dhe krijimit të aksesit të përshtatshëm ndaj zonave natyrore.

Udhëzimet për territoret sipas karakteristikave urbane jepen në vijim.

Në lokalitete (kooperim dhe përforcim):

- Zhvillimi urban duhet inkurajuar brenda zonave të urbanizuara që shfrytëzon infrastrukturen ekzistuese të ndërtuar;
- Toka me karakteristika të mira pjellore, por që nuk mund të perdoren më për bujqësi duhet të pyllëzohen aty ku është e mundur. Kjo do të rriste mundësitë ekonomike të zonës për shfrytëzim të lëndës drusore ose për përmirësim të peizazhit natyror dhe rritjen e atraksioneve turistike;
- Në tokat me karakteristika jo të mira bujqësore inkurajohet përdorimi i tyre për parqe fotovoltaike apo eolike sidomos për zonat pranë stacioneve dhe rrjetit ekzistues elektrik;
- Në tokat me shfrytëzim intensiv të bujqësisë rekomandohet ripërdorimi i mbetjeve bujqësore për gjenerimin e energjisë elektrike. Kjo do të mundësonte zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe mbrojtjen e cilësisë së rrjedhave ujore nga shpërhapja e mbetjeve bujqësore;
- Promovimi i rrjedhave ujore për sportet dhe aktivitetet ujore.

Në qendrat urbane terciare (konsolidim dhe fuqizim):

- Parandalimi i shpërhapjes urbane;
- Ndalimi ku është e mundur dhe reduktimi i humbjes së tokës bujqësore dhe tokës së lire natyrore për shkak të përdorimit urban;
- Mbrojtja e karakteristikave të peizazhit rural dhe minimizimi i fragmentimit të tij, duke ruajtur sa më qartë diferencat karakteristike midis peizazhit urban dhe atij rural;
- Krijimi i infrastruktures së gjelber për qytetet, që do t'i mundësojnë banorëve akses në zonat natyrore dhe në aktivitetet rekreative që do të zhvillohen në to;

- Ruajtja dhe aty ku është e mundur shtimi i zonave të mbrojtura mjedisore dhe biodiversitetit në to;
- Mbrojtja e objekteve dhe strukturave ndërtimore me vlera karakteristike të peizazhit të traditës historike e kulturore.

Në qendrat urbane terciare (rigjenerim):

- Mjedisi si produkt turistik që terheq vizitorët nga cilësia e peizazhit natyror, historiko - kulturor dhe biodiversitetit, si edhe nga një gamë e gjerë mundësish për zhvillimin e aktiviteteve natyrore;
- Tërheqja e sipërmarrjeve dhe njerëzve që karakterizohen nga aftësi dhe një spektër i gjerë ekspertize teknike dhe intelektuale, për të cilët jetesa në qytete të vogla ku garantohet cilësia mjedisore, i mundëson atyre cilësine e jetës që ata kërkojnë;
- Zhvillimi i avancuar i infrastruktures së komunikimit, e cila mund të sigurojë zgjerimin e shkallës së aktiviteteve ekonomike si dhe të sipërmarrjeve të vendosura në një vend të caktuar.

Përqasja e PPK për këtë sistem shprehet nëpërmjet dy koncepteve: Promovim dhe Akses. Në këtë kuader disa nga propozimet janë:

- Rritje të zonave natyrore nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura dhe korridoreve lidhëse natyrore përgjatë luginave të lumenjve;
- Shtimi i tri parqeve kombëtare në rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura:
 - Parku i Bunës
 - Parku i Alpeve
 - Parku i Vjosës

Gjithashtu, propozohet që në rrjetin e zonave të mbrojtura të shtohet edhe rrjeti Emerald.

- Krijimi i hapësirave rekreative dhe atraksioneve natyrore përgjatë luginave të lumenjve;
- Futja e rrjetit kombëtar të bicikletave, i cili akseson dhe përshkon zonat natyrore dhe ato të trashëgimise historike e kulturore;
- Projekte ripyllëzimi dhe rigjenerimi në zonat e degraduara nga dukuri natyrore si erozioni dhe përmytjet, por edhe nga aktivitetit njerëzor.

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, ndodhen disa monumente të natyrës të cilët kanë një rëndësi të veçantë për vlerat e tyre historike, shkencore, estetike dhe turistike. Këto monumente janë:

- Fusha e Liqethit
- Fragment i thyerjes tektonike Shkodër - Pejë
- Shpella e Malagjisë

Megjithëse zonat e mbrojtura janë të pakta në numër dhe sipërfaqe, sistemi paraqet një seri të jashtëzakonshme vlerash dhe potencialesh për tu pasur parasysh për mbrojtje apo shfrytëzim për qëllime turistike. Përveç pjesës që preket nga parku i Alpeve (parashikuar në PPK), Liqeni i Vaut të Dejës dhe ai i Komanit paraqesin peizazhe tepër interesante që meritojnë një status të veçantë.

Në sistemin natyror përfshihen edhe pyjet dhe kullotat që zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhistike.

Ekosistemet pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik për prodhimin e lëndës drusore dhe druve të zjarrit, punësimin në zonën rurale, në shërbimet mjedisore si reduktimi i dioksidit të karbonit (pasi thithet nga pemët nëpërmjet procesit të fotosintezës ku gjatë rritjes depozitohet në dru, lëvore, gjethe e rrënjë), zbutja e ndryshimeve klimatike, mbrojtja e tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet. Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë. Në kuadër të protokollit të Kiotos ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet kanë rënë dakord të luftojnë efektin sere nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektiv arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kredite karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni.

Duke u bazuar në ndarjen e re territoriale dhe në ligjin për administrimin e pyjeve dhe kullotave, rezulton se pjesa më e madhe e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të territorit të Bashkisë Vau-Dejës janë nën administrimin e saj.

Me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, Bashkisë Vau-Dejës i është transferuar një sipërfaqe e konsiderueshme prej rreth 28.465 ha, nga e cila:

- Sipërfaqe pyjore 18.478.22 ha;
- Sipërfaqe kullosore 2.349 ha;
- Sipërfaqe djerrë, joproductive dhe bimësi pyjore 7.581.01 ha.

Përsa i takon diversitetit biologjik, mund të thuhet se territori i Bashkisë Vau-Dejës është mjaft i pasur në lloje bimësh dhe drurësh pyjorë që gjejnë kushte të përshtatshme për rritje e zhvillim, që nga 30 e deri në lartësinë 1.800 m mbi nivelin e detit. Ato janë natyrale dhe të kultivuara.

Grupet kryesore të llojeve të drurëve janë:

- Llojet halore, 2.319.6 ha;
- Llojet fletor, 16.158.62 ha.

Në kushtet e terrenit të pjerrët në zonën malore, pyjet janë faktori kryesor i mbrojtjes së tokës nga rrëshqitjet dhe erozioni, mbrojtjen e brigjeve të lumenjve dhe vijës bregdetare për mbrojtjen nga ndryshimet morfologjike.

Gjithashtu sipërfaqet pyjore dhe kullosore të Bashkisë Vau-Dejës, janë mjaft të pasura edhe me një grup tjetër të rëndësishëm sikurse janë bimët mjekësore, eterovajore e tanifere.

Kullotat natyrore përbëjnë bazën e të ushqyerit të bagëtive dhe për këtë arsye në periudhën komuniste, u ndoq një politikë shkatërruese e hapjes së tokave të reja e mishëruar në parullën

“T’u qepemi kodrave e maleve e t’i bëjmë ato pjellore si dhe fushat”. Kjo gjë i solli një dëm të jashtëzakonshëm fondit pyjor dhe kullësor në Shqipëri, duke prekur dhe dëmtuar rëndë një ansambël të vërtetë kullësor natyror. Qindra e mijëra ha pyje, kullota, livadhe e muzha me florë shekullore të mrekullueshme u shkatërruan duke u kthyer në mënyrë krejt të papërshtatshme, në sipërfaqe të kultivuara me bimë të ndryshme bujqësore.

3.3.7 Sistemi Bujqësor

Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë”. Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njerëzore, për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor. Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitete e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Zhvillimi dhe ndërtimi në zona bujqësore kryhen sipas dokumenteve të planifikimit dhe legjislacionit të posaçëm për tokën bujqësore. Çdo dokument i përgjithshëm ose sektorial planifikimi që parashikon edhe ndryshim të kategorisë së përdorimit të tokës nga bujqësi në përdorime të tjera dhe anasjellas shoqërohet, sipas rastit, me aktet përkatëse të ndryshimit sipas legjislacionit të posaçëm.

Objektivi i PPK për sistemin bujqësor është: Eficiencë për një sektor bujqësor konkurrues

Disa nga politikat që mbështet Plani Kombëtar në këtë drejtim janë:

- Ruajtje
- Konsolidim
- Modernizim

Vendosja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim - grumbullim - përpunim - tregtim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.

Ulja e kostos dhe rritja e cilësisë nëpërmjet investimeve në:

- teknologjinë e prodhimit për modernizimin e saj;
- investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale vaditëse – kulluese, etj.

Integrim dhe bashkëpunim me sektorët e tjerë të ekonomisë:

- Bujqësi - turizëm, ku veçantia e sektorit turistik shqiptar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.
- Bujqësi - transport, ku infrastruktura e transportit i shërben rritjes së eficiencës së rrjetit bujqësor në grumbullimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.

- Bujqësi - energji, ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme.

Krijimi i qendrave/poleve bujqësore dhe profilizimi i këtyre të fundit bazuar në traditën e kultivimit të kulturave vendore.

Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqiptarë.

- Bimë Mjekësore
- Pemë frutore arrore
- Ullinj dhe Vreshta
- Perime karakteristike të vendit
- Produkteve bujqësore të përpunuara

Mekanizimi i sektorit bujqësor mbetet ende një sfidë për t'u përballur në vitet në vazhdim. Ndër faktorët kryesorë të cilët shkaktojnë mosfunksionim të mirë të sistemit bujqësor mund të përmenden:

- Shpërndarja dhe fragmentarizimi i tokës Bujqësore
- Lëvizjet demografike dhe ulja e fuqisë punëtore
- Ndërtimet informale

Përmbytjet dhe amortizimi infrastrukturor (sistemi i ujitjes - kullimit)

3.3.7.1 Toka bujqësore

Duke bërë një vlerësim nga ana gjeografike, është lumi Drin (pellgu ujëmbledhës i HEC Vau Dejës) ai që ndan zonën fushore kodrinore me atë malore në bashkinë Vau-Dejës. Njësitë administrative në jug të lumit Drin, (Vau Dejës, Hajmel, Vigmnellë dhe Bushat) janë territore fushore kodrinore, ndërsa ato në veri (Shllaku dhe Temali) kanë kryesisht karakter malorë. Tre njësitë fushore të bashkisë përfaqësojnë mbi 90% të tokës bujqësore. Ato shtrihen kryesisht në terrene fushore dhe vetëm 15-20% e sipërfaqes zihet nga kodra të buta pjesërisht të sistemuara.

Nisur nga të dhënat që disponojmë nga studimi për bonitetin e tokave të realizuar në vitet '80, në tabelën më poshtë jepen të dhënat për vlerësimin e tokës bujqësore sipas këtij studimi dhe të ndare sipas njësive administrative:

Tabela 14: Toka bujqësore në Bashkinë Vau-Dejës

Njësitë administrative	Sip. Tokë bujqësore (ha)	Boniteti								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Vau-Dejës	1165	-	-	7	295	645.8	25.6	91.6	100	-
Bushat	6502	-	-	2345	2733	70	993	361	-	-
Hajmel	2282	-	-	-	1901	381	-	-	-	-
Vigmnelë	528	-	-	-	-	-	60	468	-	-
Shllak - Temal	630	-	-	-	-	80	350	200	-	-
Total	11107	-	-	2352	4929	80	410	668	100	-
Shënim: Te dhënat janë marrë nga zyra e kadastrës pranë këshillit të qarkut Shkodër. Dy njësitë malore (Shllak dhe Temal) janë paraqitur se bashku										

Siç konstatohet edhe nga të dhënat e mësipërme, Bashkia Vau-Dejës ka 11107 hektarë tokë bujqësore. Bushati përfaqëson njësinë administrative që ka sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore, ndaj kjo zonë është e njohur për prodhimtarinë e lartë bujqësore (60% e tokës e bujqësore të bashkisë gjendet në Bushat). Ullishtat dhe vreshtat janë tendencë zhvillimi e kohëve të fundit dhe sipërfaqja më e madhe e tyre gjendet kryesisht në Hajmel, Vau Dejes e Bushat ndersa zhvillimi dhe kultivimi i perimeve ne sera eshte shume i perhapur ne Bushat, kryesisht ne fshatin Kosmac.

Sipas studimeve agro-pedologjike të kryera në vitet 1975-77, nga pikëpamja e gjenezës së tokës (sipas disa të dhënave që disponojmë kryesisht në zonën fushore të Bushatit), 45% e tokave klasifikohen livadhore aluvionale karbonate; 41% livadhore të kafenjta karbonate; 8% livadhore të hinjta kafe dhe të hinjta kafe ndërsa pjesa tjetër të kafenjta malore dhe një pakicë livadhore moçalike me njolla glej.

Nga pikëpamja e përbërjes mekanike, tokat klasifikohen si më poshtë:

- Subargjilore të renda 24%
- Subargjilore të mesme 39 %
- Subargjilore të lehta 37%

Ndërsa, gga thellësia e horizontit të punueshëm, tokat klasifikohen:

- Toka të thella 88%
- Toka të mesme 7%
- Toka të cekta 5%

Sipas studimit agro-kimik, studim i bërë në vitet 77-80, rezulton që këto toka janë përgjithësisht të mesme drejt të pasura me azot dhe fosfor dhe shumica e tyre të pasura me potas.

Në zonat malore, tokat paraqiten të varfra drejt të mesme me makro-elementet kimik (Azot, Fosfor Potas), me perberje mekanike të mesme, ku gjendja e sistemit të shumë për të dëshiruar.




Fig. 55: Sistemi bujqësor, bashkia Vau Dejës

Në pjesën fushore të njësisë administrative Vig-Mnelë, funksionojnë aktivitete të vogla prodhuese bujqësore dhe blegtorale. Si pasojë e copëzimit të tokës bujqësore në fillim të viteve '90 (ligji Nr. 7501), dhe mungesës të një sistemi të mirëfilltë informacioni për shfrytëzimin e tokës, administrata nuk disponon të dhëna lidhur me sipërfaqen reale të tokës bujqësore që punohet dhe për numrin e ekonomive bujqësore të krijuara. Produktet bujqësore janë kryesisht drithërat dhe foragjeret për blegtorinë. Pas viteve '90, si pasojë e ri-futjes në shfrytëzim të ekonomive private, ka një rritje të numrit të krerëve të bagëtive në të gjithë territorin.

Para viteve nëntëdhjetë, në sipërfaqet e tokave bujqësore të kësaj zone u kryen mjaft investime: bonifikim, ujitje, drenazhim me tuba qeramike, vepra arti etj. të cilat kanë qenë të zbatuara mirë dhe efikase; nga ana tjetër popullsia ka qenë e mirë shpërndarë në territor, me forca pune të mjaftueshme, për të përballuar bujqësinë e asaj kohe, gjysmë të mekanizuar. Këto faktor kanë favorizuar shumë rezultatet pozitive të arritura në prodhimet bujqësore dhe blegtorale, kjo dhe për faktin që këto fusha janë pjesë e fushave pjellore të Nënshkodrës dhe Zadrimës.

3.3.7.2 *Prodhimet bujqësore*

Toka, klima dhe përvoja e fermerëve në këtë Bashki janë të tilla që favorizojnë kultivim të larmishëm të të gjitha kulturave bujqësore, si: drithërat, foragjeret perimet e të gjitha llojeve, patate e fasule, kultura industriale si duhan, lule dielli, oriz, sojë, fruta, rrush, ullinj etj.

Në tabelën më poshtë jepen sasia e prodhimeve (në ton), sipas kulturave të bujqësore në bashkinë Vau Dejës.

Tabela 15: Prodhime bujqësore (në ton) për vitin 2016

Njësitë administrative	Grurë	Misër	Perime gjithsej	Patate	Fasule	Foragjere gjithsej	Fruta	Ullinj	Rrush
Vau-Dejës	531	2310	2086	396	44	13630	425	95	260
Bushat	1634	10624	22012	425	219	121183	1130	94	569
Hajmel	1264	2471	1109	473	28	24276	311	36	500
Vig-Mnelë	42	184	103	310	18	1800	109	15	67
Shllak	-	138	133	160	-	700	67	-	25
Temal	-	35	260	205	-	450	89	-	53
Total (në ton)	3471	15762	25703	1969	309	162039	2131	240	1474
Shënim: Të dhënat u morën nga bashkia Vau-Dejës, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtës së Konsumatorit									

Në këtë larmi kulturash, fermerët kanë gjetur vetë një farë specializimi në prodhim. Fshati Kosmaç është specializuar kryesisht në prodhimin e perimeve në sera dhe fushë të hapur si dhe në pemtari. Në të gjithë zonat kodrinore është përfaqësuar kryesisht kultivimi i vreshtave dhe ullinjve. Rreth 40% e sipërfaqes së tokës vihet në dispozicion të blegtorisë.

Gjithashtu në këtë zonë egziston mundësia e kultivimit të orizit ku përveç eksperiencës së fermerëve, tokat janë të përshtatshme dhe nuk mungon uji; njëkohësisht janë zona që nuk permbyten (si në Hajmel në fshatin e Dheut të Lehtë, në Bushat në fshatrat Barbullush, Kukël, Plezhë, Shkjezë, Rranza etj.). Në vitin 1976, për herë të parë në këto zona, kanë hyrë me sukses teknologjitë e njesive të mekanizuara në kultivimin e orizit dhe të misrit nëpërmjet kompanisë FIAT AGRI, si dhe metodat e kultivimit të orizit në "ORIZORE SHUMEVJECARE" sipas teknologjisë kineze.

Njesitë malore Shllak dhe Temal kultivojnë më shumë perimet e thata (qepe e hudhra), patate, pemtari dhe një pjesë e tokës përdoret për shërbimet e blegtorisë. Egziston përvoja e prodhimit të: farës hibride duhani, farës hibride misri, farës jonxhes, tërfilit, etj. Me shumë interes parqitet një studim i Këshillit të Qarkut Shkoder i vitit 2010 në kuadrin e një plani strategjik për ish-komunën e Hajmelit për mbjelljen e 150 ha shega në 6 fshatra me nga 25 ha në bllok secili, konkretisht: Nënshati, Pistulli, Pacrami, Hajmeli, Mjeda, Vig-Mnela. Për këtë qëllim egzistojnë planimetritë dhe informacioni i nevojshëm për çdo fshat. Bashkia duhet të konsiderojë këtë studim dhe të kërkojë ndihmën e Ministrisë së Bujqësisë për zbatimin e tij, nëpërmjet AZHBR-se.

Në tabelën më poshtë jepen të dhënat për sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme në vitin 2016. Po të krahasojmë fondin e tokës bujqësore para viteve '90 me fondin e tokës së mbjellur sot, kanë ndodhur ndryshime të mëdha të cilat nuk janë pasqyruar në librat dhe hartat kadastrale. Konkretisht mbillen 1853 ha me pak se ato të studiura në vitin 1980 për bonitetin e tokave.

Tabela 16: Prodhime bujqësore (në ton) për vitin 2016

Njësia Admin.	Toka Bujqësore (Ha)	Mbledhje faktike në vitin 2016/ha						
		Gruri	Misër	Perime	Patate	Fasule	Foragjere	Pemtoje. etj.
Vau Dejes	1103	118	308	94	12	20	408	143
Bushat	6027	455	1328	682	17	115	3301	129
Hajmel	1808	316	355	54	15	14	843	214
Vig-Mnela	178	11	23	6	3	3	72	60
Shllak	80	-	25	11	8	-	26	10
Temal	76	-	35	8	10	-	18	5
TOTALI	9272	900	2074	855	65	152	4668	561
Shenim: Të dhënat janë marrë në DBU Shkodër.								

3.3.7.3 Rrjeti i kanaleve vaditëse dhe kulluese

Siç u përmend dhe në fillim të këtij paragrafi, mungesa e mirëmbajtjes e kanaleve kulluese ka shkaktuar amortizimin e tyre si rezultat i depozitimeve aluvionale. Përmbytjet e vazhdueshme të tokës bujqësore ndikojnë akoma më tepër në amortizimin e tyre, pasi transportojnë materiale të ngurta (kryesisht aluvione) në kanalet kulluese, të cilat nuk arrijnë të kryejnë drenazhimin e tokave bujqësore dhe bëhen shkaktare të përmbytjeve të tjera. Shkaktarë të këtij cikli janë dëmtimet në veprat mbrojtëse të lumit Drin si rezultat i ndërhyrjeve abuzive gjatë viteve të tranzicionit. Përmbytjet e vazhdueshme ndikojnë gjithashtu edhe në shtimin e veprimtarive erozive në tokat bujqësore. Vlen të theksohet që me përfundimin e punimeve të ndërtimit të hidrocentralit të Ashtës dhe veprave mbrojtëse, është ulur rreziku i përmbytjeve nga shtrati i lumit Drin. Megjithatë gjatë sezonit të shirave, tokat bujqësore paraqesin probleme në kullim.

Pas miratimit të Reformës Territoriale Administrative, në kuadër të decentralizimit të disa shërbimeve, bashkive të reja i kalon në menaxhim një pjesë e madhe e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese. Konkretisht bazuar në VKM Nr. 1107, dt. 30.12.2015 "Për krijimin e bordeve rajonale të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë" dhe VKM Nr. 1108, dt. 30.12.2015 "Për transferimin, nga MBZHRAU të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", skema e kanaleve të vaditje-kullimit menaxhohet:

- Kanalet parësore nga Bordi Rajonal i Kullimit Lezhë (që mbulon qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës)

- Kanalet dytësore dhe tretësore nga bashkia Vau-Dejës.

Duke vlerësuar kuadrin ligjor aktualisht në fuqi, konstatohet që pjesa më e madhe e kësaj infrastrukture, në funksion të sistemit bujqësor, tashmë ka kaluar në kompetencat e pushtetit lokal. Konteksti zhvillimor i bashkisë Vau-Dejës, rrit ndjeshëm përgjegjësinë që duhet të ketë stafi i bashkisë për këtë sektor në përgjithësi dhe gjithashtu bën të domosdoshëm hartimin e një plani të qartë ndërhyrjesh, shoqëruar me buxhetin përkatës, me qëllim përmirësimin dhe vënien në efikasitet të plotë të gjithë infrastrukturës të kanaleve të ujitjes dhe kullimit.

Në tabelat e mëposhtme jepet një informacion i detajuar, për secilën njësi administrative fushore të bashkisë Vau-Dejës, për kanalet kulluese dhe vaditëse. Përveç emërimit, gjatësisë dhe sipërfaqes që shërbejnë, në dy kolonat e fundit është vendosur edhe viti kur është bërë pastrimi (mirëmbajtja) e fundit dhe komente të ndryshme që përshkruajnë gjendjen e kanaleve.

Shqyrtimi dhe analiza e këtij informacioni jep një pasqyrë të qartë për jo vetëm për gjendjen aktuale të infrastrukturës vaditëse-kulluese, por mund të shërbejë edhe për planifikimin e fondeve (nga strukturat qendrore apo lokale) për ndërhyrjet për pastrim.

Tabela 17: Kanalet e I-rë kullues ne pronësi te Bordit Rajonal te Kullimit

Njesia admin.	Nr.i kanali t	Emertimi i kanalit	Gjatesia (ml)	Sip.(ha)	Viti pastrimit	Komente
Vau Dejes	KK-1	Naraç-Suk-Hajmel-Pistull	1700	256	2005	
		Kanali I peshkimit	3600	155	2000	
Shuma			5300	411		
Hajmel		Gjader-Drini I Vjeter	35000	2250	2016	Pa pastruar 4 Km
	KK-1	Hajmel-Pistull	4000	350	2003	
Shuma			39000	2600		
Bushat	KK-1	Ura Gjo Lulit-Kukel	14000	1080	2000	
	KK-2	Kanali Peksenes	9500	870	2001	
	KKK-3	Kanali I Orizit	12000		2001	
	KKK-4	Kanali I Kolagjinit	11000		2001	
		Vija e Drinit te Vjeter	12600	870		35 vite pa u pastruar
Shuma			59100			
Totali			103400			

Tabela 18: Kanalet e II-të kullues në pronësi te bashkisë Vau Dejës

Njesia admin.	Nr.i kanalit	Emertimi i kanalit	Gjatesia (ml)	Sip.(ha)	Viti pastrimit	Komente
Vau-Dejes	KK-15	Shelqet	2600	80,3	1985	
	KK-16	Narac	1300	48,4	1985	
	KK-17	Kace	700	24,7	1985	
	KK-18	Shelqet	1800	54	1985	

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Njesia admin.	Nr.i kanalit	Emertimi i kanalit	Gjatesia (ml)	Sip.(ha)	Viti pastrimit	Komente
	KK-19	Kace	700	45,1	1985	
	KK-20	Shelqet	1800	36,2	1985	
	KK-22	Mjede-Narac	1200	30	2012	
	KK-23	Kace	600	38	2012	
	KK-24	Mjede	1300	46,8	2012	
	KK-26	Narac	1800	54,8	2012	
	KK-27	Kanali I ujerave te larta	950		2012	
	KK-72	Gline-Kace	1900	75,6	2012	
Shuma			16650	533,9		
Hajmel	KK 14-1	Rruga Pistull-Pacram	3000	82		
	KK-14	Pistull-Dheu i lehte	2600	70		
	KK-13	Ruga Dheu i lehte-Dragush	2800	110		
	KK-12	Dheu i lehte-Kroni i Dragushe	1800	177		
	KK-11	Shtepia e Zef Dedes Koterr	1400	74		
	KK-5	Fushaxhi-Koterr	1000	60		
	KK-6	Koterr-Hekurudhe	1450	36		
	KK-81	Kanal I Ujerave te Larta	1200	57		
	KK-41	Hekurudha	600	40		
	KK-42	Hekurudha	400	21		
	KK-22	Nenshat	1500	83		
	KK-31	Nenshat	1600	202		
	KK-21	Nenshat	1300	85		
	KK-25	Nenshat	5000	40		
	KK 22-2	Nenshat	1300	65		
Shuma			26950	1202		
Bushat	K 2 K-20	Kukel	800		2002	
	K 2 K-19	Barbullush-Kukel	2600		2011	
	K 2 K-18	Barbullush-Kukel	2300		2005	
	K 2 k -17	Barbullush-Hoten	3600		2002	
	K 2 K-16	Barbullush-Hoten	2100		2011	
	K 2 K-15	Barbullush-Mali i Jushit	2200		2011	
	K 2 K-14	Barbullush-Mali i Jushit	2200		2011	
	K 2 K-13	Mali i Jushit-Rranxa	2600		2011	
	K 2 K-12	Mali i Jushit-Rranxa	3000		2011	
	K 2 K-11	Rranxa-Fshati i Ri	3800		2009	
	K 2 K-21	Rranxa-Konaj	4500		2011	
	K 2 K-22	Melgushë-Konaj	4500		2011	
	K 2 K-7	Melgushë-Bushat	3200		2010	
	K 2 K-71	Ashtë-Kone	5200		2003	
	K 2 K-4	Ashtë	1000		2003	
	K 2 K-72	Kosmaç-Melgushë	2800		2009	
	K 2 K-73	Kosmaç-Melgushë	2000		2011	
	K 2 K-74	Kosmaç-Bushat	1300		2009	

Njesia admin.	Nr.i kanalit	Emertimi i kanalit	Gjatesia (ml)	Sip.(ha)	Viti pastrimit	Komente
	K 2 K-75	Kosmaç-Bushat	1300		2009	
	K 2 K-89	Kosmaç-Plezhe	4400		2010	
	K 2 K-88	Stajke-Plezhe	2200		2011	
	K 2 K-87	Stajke-Plezhe	1500		2001	
	K 2 K-85/2	Plezhe-Shkjeze	3400		2015	
	K 2 K-85	Shkjeze	1500		2011	
	K 2 K-85/1	Shkjeze	2100		2011	
	K 2 K-75/1	Stajke-Ashte	3600		2009	
	K 2 K-83	Barbullush	2000		2001	
	K 2 K-84		1000		2001	
	K 2 K-20/1	Fshati i Ri-Mali i Jushit	2400		2002	
	K 2 K	Rranxa	1400		2009	
	K 2 K-33	Rruga e Velipojes	4000		2013	
Shuma			80500			
TOTAL 3 Njësitë Administrative			124100			

Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje e gjatësive të kanaleve kulluese (në km) për njësitë administrative Vau-Dejës, Hajmel dhe Bushat. Aty përfshihen dhe të dhënat për kanalet tretësore për të cilat nuk ka emërtime specifike. Gjithsesi sqarojmë që në aneksin e hartave që shoqërojnë dokumentin e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, në një hartë të veçantë, është paraqitur grafikiht pozicioni dhe emërtimi përkatës i gjithë rrjetit të kanaleve kulluese.

Tabela 19: Përmbledhëse e kanaleve kullues të bashkisë Vau Dejës (në km)

Njesia administrative	Kanale të I-rë	Kanale të II-të	Kanale të III-të	Shuma
Vau-Dejes	5,3	16,6	56	77,9
Hajmel	39	27	124	190
Bushat	59,1	80,5	310	449,6
Bashkia (totali)	103,4	124,1	490	717,5

Nga të dhënat e tabelave të mësipërme konstatohet që ndërhyrjet për pastrim dhe mirëmbajtje të kanaleve kulluese janë kryer kryesisht në njësinë administrative Bushat dhe Vau Dejës, pas vitit 2010. Për njësinë Hajmel nuk ekzistojnë të dhëna të sakta për punimet e kryera por nga kontaktet e me specialistë tregohet që përveç disa rasteve, në përgjithësi nuk ka pasur pastrim të kanaleve.

Gjithashtu nuk ka evidencë të qartë mbi gjendjen e kanaleve që nuk janë pastruar 10 vitet e fundit. Në vijim, e njëjta strukturë të dhënash, jepet për kanalet vaditës të bashkisë Vau-Dejës.

Tabela 20: Kanalet parësor të ujitjes në pronësi të Bordit Rajonal të Kullimit

Njesia admin	Nr.i kanalit	Emërtimi i kanalit	Gjatesia (ml)	Siperfaqja qe ujit (ha)	Gjendja e Kanalit
Vau-Dejës	K.U	Mjede-Sifoni-Dheu i Lehtë	4000	350	e rregullt
	K.U	Shelqet-Pistull	3100	300	pjeserisht e rregullt
	K.U	Naraç-Mjedë-Kace	1000	300	pjeserisht e rregullt
Shuma			8100	950	
Hajmel	SH.U 4/1	Mjedë-Kotërr	7000	1010	
	SH.U 4/2	Stacioni Nënshat		150	jashte funksionit
	SH.U 4/3	Shelqet-Pistull	2200	590	
Shuma			9200	1600	
Bushat	KU 1	Mjedë-121-Kukel	19000		Pastruar ne 1998
	KU 2	121-168-Konej	7250		Pastruar ne 2002
Shuma			26250		
TOTAL			43550		

Tabela 21: Kanalet parësor të ujitjes në pronësi të Bashkisë

Njesia admin	Nr.i kanalit	Emërtimi i kanalit	Gjatesia (ml)	Siperfaqja qe ujit (ha)	Gjendja e Kanalit
Vau-Dejes	KU 2	Mjedë	3600	85	Jashte funksionit
	KU 3	Mjedë	4800	83	pjeserisht i rregullt
	KU 4	Mjedë	1700	144	pjeserisht i rregullt
	KU 5	Mjedë	1427	54	e rregullt
	KU 6	Mjedë	1100	82	Jashte funksionit
	KU 7	Naraç	2400	80	pjeserisht i rregullt
	KU 8	Shelqet	1200	34	Jashte funksionit
	KU 10	Shelqet	2700	120	pjeserisht i rregullt
	KU 11		1450	89	Jashte funksionit
	KU 12		900	58	pjeserisht i rregullt
	KU 13		1000	49	pjeserisht i rregullt
Shuma			22277	878	
Hajmel	KU 2	Pistull-Dheu i Lehte Shtepia A.Metit	2200	81	
	KU 3	Rruga Dheut te Lehte KK Lezhe	2200	111	
	KU 4	Stalla-Kroni Dragushes	2600	174	
	KU 5	Bahcja Zef Dedes-Koterr	1100	60	
	KU 6	Rruga Kovaç-KK-1	1100	27	
	KU 7	Tubi Koterr	500	14	
	KU 8	Bregu i Gjadrit	800	20	
	KU 9	Paralel KK i Il-te -1	1400	53	
	KU 10	Paralel KK i Il-te -22-1-7	1400	52	
	KU 12	Paralel KK i Il-te -22-1-2	1400	81	
Shuma			14700	673	

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

Njesia admin	Nr.i kanalit	Emërtimi i kanalit	Gjatesia (ml)	Siperfaqja qe ujit (ha)	Gjendja e Kanalit
Bushat	K2 U-1	Stajkë	2500		
	K2 U-2	Stajkë	2000		
	K2 U-3	Stajkë	1200		
	K2 U-1/1	Kosmaç Argjinatura e Drinit	1600		
	K2 U-9	Barbullush-Mandija	2200		
	K2U-89/1	Kosmaç Argjinatura e Drinit	1200		
	K2U-3/1	Kosmaç-Bushat	1000		
	K2U-3/2	Kosmaç-Bushat	1000		
	K2U-3/3	Kosmaç-Bushat	1200		
	K2U-3/4	Kosmaç-Bushat	1200		
	K2U-3/5	Kosmaç-Bushat	1100		
	K2U-23/3	Melgushë-Konej	5600		
	K2U-23/1	Melgushë-Konej-Rranxa	5100		
	KU 24	Rranxa	5600		
	KU 25	Rranxa-Mali i Jushit	4000		
	KU 25/1	Bushat-Rranxa	3000		
	KU 11	Rranxa -Mali i Jushit	2700		
	K2U-12	Rranxa -Mali i Jushit	3200		
	K2U-13	Barbullush-Mali i Jushit	1900		
	K2U-14	Barbullush-Mali i Jushit	1900		
	K2U-15	Barbullush-Hoten	2100		
	K2U-16	Barbullush	1600		
	K2U-17	Barbullush	2600		
	K2U-18	Barbullush	1200		
	K2U-19	Kukel	800		
	K2U-85/2	Shkjeze	1500		
	K2U-85/3	Shkjeze	1400		
	K2U-20/1	Barbullush	1200		
	K2U-24/1	Fshati i Ri	2800		
	K2U-23/2	Rranxa	5500		
	K2U-231	Rranxa-Bushat	6900		
	K2U-32/3	Rranxa-Bushat	4800		
	K2U 24/1	Melgushe-Rranxa	4700		
	K2U 83	Barbullush	1400		
Shuma			87700		
TOTAL			124677		

Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje e gjatësive të kanaleve vaditës (në km) për njësitë administrative Vau-Dejës, Hajmel dhe Bushat. Aty përfshihen dhe të dhënat për kanalet tretësore për të cilat nuk ka emërtime specifike.

Tabela 22: Përmbledhëse e kanaleve vaditës të bashkisë Vau Dejës (në km)

Njesia administrative	Kanale të I-rë	Kanale të II-të	Kanale të III-të	Shuma
Vau-Dejes	8.1	22.3	56	86.4
Hajmel	9.2	14.7	136	159.9
Bushat	26.3	87.7	280	394.0
Bashkia (totali)	43,6	124,7	472	640.3

Ndersa në tabelën në vijim jepet një shumatore e kanaleve ujitëse dhe kullues për bashkinë Vau Dejës.

Tabela 23: Përmbledhëse e kanaleve ujitës dhe kullues (në km)

Kanalet	Kanale të I-rë	Kanale të II-të	Kanale të III-të	Shuma
Kanale kullues	103	124	490	717
Kanale vadites	44	124	472	640
Bashkia (totali)	177	248	962	1357

Pajisja e njësive administrative fushore me hartat e kanaleve ujites dhe kullues si dhe ato kadastrale, shoqëruar me librat e kanaleve dhe ato kadastral ndikon direkt në mundësinë e evidentimit të gjendjes së çdo kanali dhe caktimin e radhës së ndërhyrjeve sipas emergjences që ato paraqesin.

Siç vihet re nga të dhënat e mësipërme, pavarsisht disa ndërhyrjeve në vitet e fundit përsëri gjendja e infrastrukturës vaditëse-kulluese ka mjaft nevojë për t'u kthyer në gjendjen efektive. Mirëmbajtja e këtij sistemi është bazike për zhvillimin e bujqesisë dhe korrigjimi gabimeve të ndodhura në periudhën e tranzicionit duhet të jetë prioriteti kryesor në investimet e bashkisë, si për investimet nga grandit ashtu edhe për investimet me fondet e veta (lokale). Si rrjedhim bashkia duhet të hartojë sa më parë projektet dhe të caktojë ndërhyrjet prioritare për të permiresuar sa më shpejt gjendjen e rëndë të krijuar ndër vite.

Emergjencë primare e lidhur me ujitjen, jo vetëm për bashkinë Vau Dejës por që ndikon edhe për bashkinë Lezhë është mbilartësimi i bankinave të kanalit ujites kryesor që fillon në Mjedë dhe deri te sifoni i njësisë Hajmel. Është detyrë e Bordit të Kullimit Lezhë dhe njëkohësisht e Bashkisë Vau Dejes për projektimin e kësaj ndërhyrje që përbën një emergjencë për sistemin e ujitjes.

Gjithashtu përse i përket kanaleve tretësore duhet të vlerësohen skema nxitëse që përfshijnë vetë fermerët në pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, për seksionet respektive që u takojnë. Një mundësi është që bashkia të sigurojë mjetet e nevojshme (eskavatorë) ndërsa fermerët të përballojnë shpenzimet e kostos (karburant, punëtori, etj.). Për zbatimin e kësaj detyre duhet që administrata e bashkisë të hartojë dhe t'i paraqesë Keshillit Bashkiak një projekt-vendim ku të ligjerojë përgjegjësinë e gjithsecilit për realizimin e kësaj detyre duke evidentuar faktin që sistemi i ujitjes dhe

vaditjes funksionon dhe kur ai është efektiv në tërësinë e tij (mos pastrimi i një segmenti sjell probleme dhe ndikon gjithë skemën e ujitjes apo kullimit).

Së fundmi, nga sa referohet edhe nga specialistët dhe ekspertët e bashkisë Vau Dejës, zhvendosja e Drejtorisë së Bordit të Kullimit Rajonal nga Shkodra në Lezhë ka sjellë problemet e veta përse i përket menaxhimit të këtij sektori. Duke konsideruar aspektin hidrografik, zonën e Shkodrës përfshi bashkinë Vau Dejës nuk e lidhë asgjë me Lezhën për kullimin, e aq më pak përse i përket skemës së ujitjes. Pavarësisht këtij fakti është i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë i bashkisë me administratën e Bordit të Kullimit rajonal për zgjidhjen e problematikave të ndryshme. Edhe pse jo te propozohet domosdoshmeria e vendosjes së Bordit të Kullimit në Qarkun e Shkodrës.

3.3.7.4 Analiza e sistemit bujqësor

Po të krahasojmë fondin e tokës bujqësore para viteve '90 me fondin e tokës të mbjellur sot, konstatohen ndryshime të mëdha të cilat kanë ardhë si rrjedhojë e mjaft faktorëve dhe të cilat nuk janë pasqyruar në librat dhe hartat kadastrale. Në tabelën më poshtë, për secilën njësi administrative është bërë një krahasim mes të dhënave të viteve '80 dhe atyre të vitit 2016.

Tabela 24: Të dhëna për sipërfaqet bujqësore

Njësia Admin.	Toka Bujqësore (Ha)		Koef. Shfryt. (%)
	Viti 1980	Viti 2016	
Vau Dejës	1165	1103	94%
Bushat	6502	6027	93%
Hajmel	2282	1808	79%
Vig-Mnela	528	178	34%
Shllak	630	80	25%
Temal		76	25%
TOTALI	11107	9272	83%
Shenim: Të dhënat janë marrë në DBU Shkodër.			

Nga këto të dhëna konstatohet që sipërfaqja e tokës që kultivohet është zvogluar ndjeshëm, dhe në shumë raste toka ka ndryshuar totalisht destinacion. Ky ndryshim ka ndodhë më shumë në zonat kodrinore dhe malore, kryesisht në sipërfaqet e mbjella me pemtore, por një ndikim të ndjeshëm ka edhe zhvillimi urban kaotik kryesisht në anë të akseve rrugore dhe në periferite të fshatrave.

Problematikë është gjendja në Shllak e Temal ku toka shfrytëzohet 25%, në Vig-Mnelë ku toka shfrytëzohet 34%, ndërsa në njësitë fushore konstatohet një përqindje e lartë shfrytëzimi: në Hajmel 79%, në Bushat 93% dhe në Vau Dejës 94%.

Një gjëndje e tillë është shqetësuese dhe bën të domosdoshëm verifikimin dhe evidentimin e ketyre ndryshimeve, në mënyrë që mbasi të pasqyrohet gjithçka, të vendoset për planin e masave që duhen ndërmarrë dhe për zonat prioritare që kërkojnë ndërhyrje. Për kryerjen e këtij procesi, në nivel njësie administrative, duhen

ngritur grupe pune që të rilevojnë gjendjen ekzistuese dhe të reflektojnë ndryshimet kadastrale.

Pavarsisht produktivitetit të lartë dhe kushteve klimatike shumë të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, territori i kësaj bashkie është përballur vitet e fundit edhe me problemet e përmbytjes që po ndodhin rregullisht pothuajse çdo vit, duke i shkaktuar mjaft dëme këtij sektori. Ky rrezik natyror ka shkaktuar uljen e prodhimit të tokave bujqësore, duke i bërë ato më pak pjellore dhe në disa raste dhe dekurajimin e fermerëve për të kultivuar atë. Ne vitet 2010-2011 janë përmbytur disa herë të gjitha tokat bujqësore të fushave Trush, Dajç, Bushat, Barbullush të shtrira deri në kuoten 6m mbi nivelin e detit. Me mijra hektarë tokë bujqësore ne zonat më pjellore të Nën Shkodres. Nga studimet e bëra që në vitet e ndërtimit të digave në kaskadën e Drinit dihet që sistemi ujqor i Lumit Drin, Gjadër dhe Bunë duke përfshirë dhe Liqenin e Shkodrës përbëjnë një sistem ekuilibri të paqëndrueshëm dhe që duhet monitoruar dhe kontrolluar nga disa sektor (kryesisht rregjimi i shkarkimeve të HEC në periudhën me rreshje të shumta), si dhe vazhdimin e ndërtimit të disa argjinaturave që mungojnë në zonën e Nën-Shkodres

Ndër faktorët kryesorë që evidentojnë bujqësinë si sektorin kryesor zhvillimor për bashkinë janë:

- Fusha e Zadrimës e njohur për prodhimtarinë e lartë bujqësore;
- Toka bujqësore në përgjithësi me përbërje të lartë humusi dhe kripëra të shumta minerale që ndihmojnë në rritjen dhe përmirësimin e prodhimtarisë bujqësore;
- Pasuritë e shumta ujore që ka zona;
- Potenciale të konsiderueshme njerëzore, ku përmendim një numër të lartë agronomësh si dhe shkolla profesionale bujqësore që edukojnë të rinjtë dhe thellojnë më tej asistencën ndaj fermerëve.

Nga një vlerësim i bërë së fundmi⁹, në varësi të sezonit, rreth 65-85% e popullsisë së bashkisë janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, fakt ky që tregon rëndësinë dhe vëmendjen që duhet të ketë bashkia në përcaktimin e prioriteteve përsa i përket këtij sektori.

Ndër problematikat kryesore që vuan sektori i bujqësisë dhe blegtorisë janë:

- Mungesa e mirëmbajtjes-pastrimit të sistemit të vaditjes dhe kullimit;
- Përmbytjet periodike;
- Erozioni i tokave bujqësore;
- Urbanizimi kaotik pranë akseve të transportit rrugor dhe ndotjet që sjell ky urbanizim nga mungesa e trajtimit të urjave të ndotura dhe industriale.
- Fragmentarizimi i tokës si rezultat i privatizimit të tokës bujqësore;
- Si rezultat i fragmentarizimit përdorimi i teknologjive bashkohore në punimin e tokës është i papërbalueshëm nga fermerët;
- Lëvizjet e popullsisë dhe mungesa e angazhimit dhe interesit nga brezi i ri.

⁹ Plani Operacional i Zhvillimit Vendor, bashkia Vau Dejës

- Mungesa e strukturave (magazinuese dhe frigoriferike) për grumbullim, përpunim dhe tregëtim të produkteve bujqësore të shpërndara në territor;
- Mungesa e mbështetjes financiare (kredive lehtësuese)
- Përdorim i pakontrolluar, nga ekspertët e fushës, i plehrave kimikë rrezikon të shkaktojë probleme ndotje të konsiderueshme;
- Varrezat e makinave në parcelat e tokës bujqësore mund të ndikojnë në fertilitetin e gjithë zonës përreth.

Privatizimi i tokës bujqësore, që u bë me anë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, parashikonte ngritjen e komisioneve vendore për ndarjen e tokës bujqësore. Kjo ndarje u bë duke u bazuar në sasinë e tokës bujqësore (ha) dhe numrin e popullsisë që kishte secila njësi administrative në atë kohë. Kështu si rezultat i këtij procesi, në bashkinë Vau-Dejës rezulton që madhësia e parcelave varion nga 2000m²/frymë deri në 3800 m²/frymë. Kjo ndarje e tokës dhe mungesa e organizimit në fermave kolektive përbën një problem serioz në efikasitetin e përdorimit dhe rendimin e prodhimit. Kështu që zona dominohet nga një numër i madh fermash me sipërfaqe të vogël (mesatarisht 1.1 ha), të përbëra mesatarisht nga 4.4 parcela . Këto shifra tregojnë që iniciativat për formimin e fermave kolektive mungojnë, dhe kjo gjë ndodh vetëm në nivel njësie familjare (bashkimi i 4 parcelave në një fermë).

3.3.8 Sistemi Ujor

Sistemi ujor është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë”.

Procesi i planifikimit dhe zhvillimit në territore, që i përkasin kategorisë bazë të përdorimit “Ujëra dhe ligatina” rregullohet sipas legjislacionit të posaçëm dhe konventave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Shqipëria.

Çdo zhvillim në brigjet ujore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm dhe kjo rregullore. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Menaxhimi shkencor i ujit dhe energjisë ka qenë dhe mbetet një moment thelbësor me pasoja të rëndësishme për të sotmen dhe mirëqenien e brezave të ardhshëm. Bashkimi Evropian ngulmon, që rritja ekonomike nuk duhet të kondicionohet me përdorimin intensiv të burimeve në përgjithësi e sidomos të atyre ujore e energjetike në veçanti. Kjo duhet të kompensohet me zhvillimet në teknologji efektive për ruajtjen e bilanceve të përdorimeve të tyre me kërkesat në rritje të nevojave jetike për to: të

ruajtjes dhe të rigjenerimit të tyre. Rekomandohet që raportet aktuale midis rritjes ekonomike, konsumimit të resurseve ujore e energjetike dhe prodhimit të mbetjeve të ndryshojnë në mënyrë thelbësore. Zhvillimi ekonomik duhet të shoqërohet me përdorimin racional e të qëndrueshëm të burimeve të ujit dhe energjisë, me prodhimin e sasive të kufizuara të mbetjeve, duke ruajtur biodiversitetin, ekosistemet dhe mënjnauar transformimin e mjedisit në djerrinë.

Rekomandimet e PPK për këtë sistem fokusohen në:

- Shfrytëzim racional i ujërave duke ruajtur balancën e abstragim/rimbushje të akuifereve;
- Kontrolli i aktiviteteve të paligjshme;
- Investime në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive mbi burimet ujore dhe në veçanti të shtresave gjeologjike dhe kufijve të akuifereve;
- Shfrytëzim i qëndrueshëm i ujërave nëntokësore, duke përfshirë këtu edhe shpimet e pakontrolluara;
- Ruajtja e ujëmbledhësve nga precipitime të shirave për përdorim bujqësor.
- Eliminimi i ndotjeve të ujit nga burime të ndryshme.

Propozimet e PPK për sistemin ujqor janë:

Politikat e densifikimit të zhvillimit urban dhe korridoret natyrore përgjate luginave te lumenjve jane politikat primare qe Plani Kombëtar sjell në ndihme të këtij sistemi.

Në mbrojtje të Sistemit Ujqor, PPK vendos:

VIJËN BLU e cila ka për qëllim:

- Per rrjedhat lumore, rigjenerimi i korridoreve natyrore qe shoqerojne rrjedhen e tyre.
- Njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror te territorit qe shtrihet nga vija bregdetare deri ne kreshten e brezit te pare kodrinor malor.
- Të mbrojtë resurset ujore nga përdorimi i papërshtatshëm si

Shfrytëzim intensiv i inerteve te lumit,

Vend-depozitime të mbetjeve urbane

Aktivitet bujqësor e industrial i konsiderueshëm.

Territori i Bashkisë Vau-Dejës karakterizohet nga burime ujore të konsiderueshme, si lumenj, liqene, rezervuare dhe përrenj. Liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës përbën sipërfaqen më të madhe ujore. Në territorin e bashkisë kalojnë lumi Drin dhe Gjadër. Gjithashtu në territorin e kësaj bashkie, ndodhet dhe një rezervuar me sipërfaqe 2.500 ha, i cili ndodhet në Vaun e Dejës. Për shkak të këtyre potencialeve të jashtëzakonshme ujore, Vau-Dejës përfaqëson edhe fashën kombëtare energjetike të vendit tonë me tre liqenet (Vau-Dejës, Fierzë, Koman).

Burimet e shumta ujore të territorit të bashkisë, ngrenë me të madhe edhe rëndësinë e menaxhimit të tyre duke marrë parasysh regjimin e çrregullt të ujit në këtë zonë. Për

më tepër, rastet e përmytjeve të viteve jo shumë të largëta të ndodhura në zonë kërkojnë vëmendje për çështjen e menaxhimit të burimeve ujore.

Kjo vijë arrin në 21 km dhe përfaqëson një zonë mjaft të pasur për nga ana e biodiversitetit, me një faunë dhe florë shumë të pasur. Megjithatë, për shkak të presionit të madh të aktivitetit njerëzor, pasuritë natyrore biologjike në territor, siç është rasti i liqenit, rrezikon të humbë vlerat e veta. Ndaj shpallja “ Zonë e Mbrojtur ” e vijës së Liqenit të Vaut të Dejës, do të ndihmonte në menaxhimin më të mirë të kësaj pasurie dhe si rrjedhim në ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave natyrore. Mirëmenaxhimi i burimeve natyrore krijon mundësi të shumta për rritjen ekonomike të zonës. Pyllëzimi i malit Zefjanë në Bushat është një mundësi e mirë për ta kthyer në një park natyror me perspektivë për zhvillimin e turizmit. Inisiativa të tilla do të rrisin avantazhet konkurruese të territorit, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e turizmit.

3.3.9 Sistemi Infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor (IN) përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë”.

Me formulimin e kërkesave të aksesueshmërisë për qendrat kryesore dhe sekondare duhet të garantohet roli qendror i tyre dhe të sigurohet cilësia e qendrave prioritare si pika spirancë në hapësirën dhe mobilitetin e njerëzve për sa i përket ofrimit të shërbimeve publike. Më tej, hierarkizimi i rolit të këtyre qendrave, kërkon vendosjen e prioriteteve lidhur me sigurimin, zgjerimin, dhe sipas rastit ngritjen e rrjeteve dhe korridoreve të reja infrastrukture dhe mirëfunksionimin e tyre.

Objektivi i PPK është integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmërisë së vendit dhe një shpërndarje e balancuar e flukseve.

Politikat e propozuara lidhen me organizimin e territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

Për transportin objektivi principal është zhvillimi i tipit multimodale dhe miqësor ndaj ambientit.

Në vijim janë paraqitur të dhëna bazë për secilën nga infrastrukturat kryesore që i përkasin territorit të Bashkisë Vau-Dejës.

3.3.9.1 Transporti rrugor

Territorin e Bashkisë Vau-Dejës e përshkojnë 87.43km rrugë kombëtare, 37.7km rrugë rurale dhe 176.3km rrugë të brendshme. Këtu kalon korridori kryesor që lidh Tiranën me Shkodrën e më tej me Malin e Zi (Tiranë – Hani i Hotit, aksi i vjetër 11.1km dhe Tiranë – Hani i Hotit, aksi i ri 7.5km).

Në vijim, për akset kombëtare, janë paraqitur në formë të detajuar informacionet bazë (gjatësi, gjerësi dhe kategori) për secilin segment që është pjesë e këtij rrjeti rrugor.

Tabela 25: Inventari ARRSH (Bashkia Vau-Dejës)

Nr. i rrugës	Emërtimi i Aksit Rrugor	Gjatësia L(km)	Gjerësia B(m)	Kategoria
1	Tiranë – Hani i Hotit (aksi i vjetër)	11.1		
1/6	Bisht Jugë	11.1	7	C
	Krye Bushat			
1	Tiranë – Hani i Hotit (aksi i ri)	7.5		
1/6	Mabë (Useku)	7.5	7	C
	Beltojë			
5	Shkodër – Kukës (Morinë)	17.8		
	Ura Spatharë	3.20	6.0	C
	Mjedë			
	Mjedë	2.50	6.0	
	Laç Vau Dejës			
	Laç Vau Dejës	12.10	6.0	
	Qafë Qelë			
25	Qafë Laç - Koman	34.13		
	Q.Laç (Kthesa Q.Qele)	18.20	6.0	C
	Karme			
	Karme	15.50	6.0	
	Koman			
	Koman	0.43	6.0	
	Sheshi i Tragetit			
28	Melgushë (K/Rr.Nr.1) – Mjedë	7.1		
	K/Bushat (Melgushë K/Rr.Nr.1)	7.1	6.0	C
	Mjedë (degëzim Shkodër)			
29	Balldre - Bushat (Rranxa)	9.8		
	Reparti Ushtarak	1.20	5.5	C
	Degëzim Kukel			
	Degëzim Kukel	0.60	5.5	
	Degëzim Gjadër			
	Degëzim Gjadër	4.20	5.5	
	Barbullush Qendër			
	Barbullush Qendër	3.80	5.5	
	Rranxa K/Rr.Nr.1 (e vjetër)			
TOTALI PËR BASHKINË VAU-DEJËS		87.43	KM	

Në vijim jepen disa imazhe nga akset kombëtare në bashkinë e Vau-Dejës.



Fig. 56: Aksi Tiranë – Hani i Hotit (Aksi i ri)

Ky është aksi më i rëndësishëm kombëtar që kalon në bashkinë e Vau-Dejës. Ai është pjesë e korridorit lidhës Veri-Jug. Aktualisht kjo është një rrugë e kategorisë C, nën administrimin dhe mirëmbajtjen e ARRSH-së. Rruga paraqitet në gjendje të mirë dhe e pajisur me sinjalistikën e nevojshme.



Fig. 57: Aksi Tiranë – Hani i Hotit (Aksi i vjetër)

Edhe aksi i vjetër Tiranë – Hani i Hotit është rrugë e kategorisë C, nën administrimin e ARRSH-së. Shtresat asfaltike paraqiten në gjendje të mirë, në segmente të caktuar kërkohet plotësimi me sinjalistikën e nevojshme vertikale dhe horizontale.



Fig. 58: Aksi Shkodër-Kukës

Një aks tjetër i rëndësishëm në territorin e Vau-Dejës është aksi rrugor Shkodër-Kukës. Kjo është edhe arteria kryesore me të cilën lidhen disa rrugë të brendshme të fshatrave të bashkisë. Rruga ka shtresa asfaltike në gjendje të mirë, kërkon plotësim me sinjalistikë vertikale dhe horizontale në segmente të caktuara të saj, rruga është nën administrimin dhe mirëmbajtjen e ARRSH-së.



Fig. 59: Aksi Balldre-Bushat

Ky është një aks tjetër kombëtar nën administrimin e ARRSH-së që lidh dy qendrat Bushatin dhe Rranxën me njësinë administrative të Balldrenit në bashkinë e Lezhës. Kjo është një rrugë e kategorisë C, në gjendje relativisht të mirë, por që kërkon plotësimin me sinjalistikën e nevojshme horizontale dhe vertikale.



Fig. 60: Aksi Mjedë-Melgush

Aksi Mjedë-Melgush është një aks kombëtar që shërben si segment lidhës për aksin e ri Tiranë – Hani i Hotit me aksin Shkodër – Kukës. Në nivel bashkie, ky aks lidh disa qendra të banuara të bashkisë së Vau-Dejës. Është rrugë e kategorisë C, në gjendje relativisht të mirë, kërkon plotësimin me sinjalistikë vertikale dhe horizontale.



Fig. 61: Aksi Qafë-Laç – Koman

Ky është një aks tjetër kombëtar në territorin e bashkisë së Vau-Dejës. Shtresat asfaltike të kësaj rruge paraqiten në gjendje jo të mirë. Duke qenë se është pjesë e

një itinerari të rëndësishëm turistik i cili ndërthur transportin rrugor me atë lumor (me traget) del shumë e domosdoshme rikonstruksioni i këtij segmenti rrugor.




Fig. 62: Harta e rrugëve, Bashkia Vau-Dejës

Rrugët rurale si dhe të brendshmet janë ato që shfaqin më shumë probleme. Vlen të përmenden njësitë administrative Vig-Mnelë, Shllak dhe Temal në të cilat vihet re një mungesë e theksuar e infrastrukturës rrugore. Në këto njësi thuajse të gjitha rrugët janë të paasfaltuara duke e bërë të vështirë aksesin në disa prej fshatrave. Njësia administrative e Temalit nuk mund të aksesohet ndryshe veçse nëpërmjet transportit ujor.

Më e mirë paraqitet situata në rrugët e njësive Hajmel, Bushat dhe Vau-Dejës. Edhe këtu ka akse rrugore të pa asfaltuara por kjo nuk krijon problem në lidhjen e qendrave të banuara. Në Hajmel janë dy akse rrugore që kërkojnë ndërhyrje urgjente: Pistull-Paçram-Superstradë dhe Hajmel-Gurragji-Naraç. Në Bushat kërkojnë vëmendje kryesisht rrugët e lagjeve.

Më poshtë jepet një tabelë me inventarin e rrugëve rurale në bashkinë e Vau-Dejës sipas VKM Nr. 915, datë 11.11.2015.

Tabela 26: Inventari rrugëve rurale (Bashkia Vau-Dejës)

Nr. i rrugës	Emërtimi i Aksit Rrugor	Gjatësia L(km)	Kategoria
1	Muri i Turkut - Shllak	12	F
2	Degëzim Vau Dejës - Krajn	1.2	F
3	Ura e Gjadrit – Qendër Komuna Vig	6.8	F
4	Qendër Komuna Vig Mnelë - Kalivaç	9.5	F
5	Degëzim Asfalt - Shelqet - Hajmel	8.2	F
TOTAL		37.7	Km

Një informacion tjetër më i detajuar mbi rrugët rurale dhe të brendshme për çdo njësi administrative jepet në tabelën e mëposhtëm (sipas Plani Operacional i Zhvillimit Vendor Bashkia Vau-Dejës Mars, 2016).

Tabela 27: Inventari rrugëve rurale sipas njësive administrative

Njësiti administrative	Rrugë rurale (km)		Rrugë të brendshme (km)	
	Asfaltuar	E paasfaltuar	Asfaltuar	E paasfaltuar
Bushat	37.9	30.2	41.1	71.9
Vig Mnelë	-	25	-	-
Temal	2.5	3.4	-	-
Shllak	-	-	-	-
Hajmel	14.2	9.2	1.2	25
Vau-Dejës	8.3	10.4	3.8	33.3
Gjithsej	62.9	78.2	46.1	130.2

3.3.9.2 Transporti ujqor i brendshëm

Në territorin e bashkisë së Vau-Dejës ekziston dhe transporti ujqor i brendshëm siç është ai në liqenin artificial të Vau-Dejës dhe Komanit. Të krijuar nga digat e hidrocentraleve si rregullatorë të furnizimit me ujë të këtyre hidrocentraleve të kaskadës së Drinit, liqenet shërbejnë edhe si nje lidhëse mes vendbanimeve të rretheve Kukës, Tropojë, Has dhe Pukë me një korridor lundrimi ujqor me traget dhe mjete të tjera ujqore.

Në liqenin e Vau-Dejës nuk ka linja të rregullta transporti por shfrytëzohet në mënyrë individuale nga banorët e zonës dhe nga turisë në periudha të veçanta. Zakonisht lëvizin mjete të vogla ujqore jo në formën e linjave të rregullta tragetesh.

Në liqenin e Komanit ekzistojnë disa linja trageti me orare dhe kapacitet të ndryshme që përdoren rregullisht, si nga turistët ashtu edhe nga banorët e zonës. Dy janë linjat më të shpeshta që funksionojnë nga e hëna në të diele. Një prej tyre ka kapacitet më të madh, me të mund të transportohet çdo mjet si minibusa, fugona, kamper, vetura, motoçikleta etj., duke përjashtuar kategorinë e mjeteve super të rënda. Ky traget nisat përditë nga Komani në orën 09:00 dhe mbërrin në liqenin e Fierzës në orën 11:30,

kurse nga liqeni i Fierzës niset në orën 13:00 dhe mbërrin në liqenin e Komanit në orën 15:30.

Mjeti tjetër është i përmasave më të vogla, ai kryen transportin e pasagjerëve dhe të motoçikletave. Kjo anije niset çdo ditë nga Fierza në orën 06:00 të mëngjesit dhe mbërrin në orën 08:30, dhe kthehet po brenda ditës sërish në liqenin e Fierzës, duke u nisur nga Komani në orën 09:00 dhe mbërrin në orën 11:30. Ky mjet bën ndalesa të herë pas herë në bazë të kërkesave të banorëve dhe udhëtarëve.



Fig. 63: Transporti ujor në linjën Koman - Fierzë

Përveç këtyre dy linjave ekziston dhe një trageti i përmasave më të mëdha. Ai është mjaft i preferuar edhe nga turistët. Në çdo udhëtim mund të akomodohen me komoditet 250 person, 170 prej të cilëve me ulëse. Gjithashtu ai ka kapacitet të transportojë edhe 21 kamionë dhe 20 autovetura ose vetëm 60 autovetura.

3.3.9.3 Hekurudha

Bashkia Vau-Dejës është aksesuar për herë të parë nëpërmjet hekurudhës në vitin 1981 kur u përrua segmenti Lezhë-Shkodër. Pas vitit 1990 vëllimi i trafikut hekurudhor pati një rënie të ndjeshme ashtu si në të gjitha vendet e Europës Lindore. Kjo ndodhi për disa arsye si p.sh, për shkak të liberalizimit dhe privatizimit të transportit rrugor, importi masiv i autoveturave, përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës rrugore, konkurrenca me kompanitë private të autobusëve etj.



Fig. 64: Foto historike e stacionit hekurudhor Mjedë (Burimi: AQTN)

Në territorin e bashkisë së Vau-Dejës kalojnë gjithsej 11.82 km hekurudhë të linjës Durrës – Hani i Hotit. Stacioni i kësaj linje në territorin e bashkisë është në fshatin Mjedë të njësisë së Vau-Dejës. Vitet e fundit është shtuar dhe një stacion në fshatin Hajmel që ka funksionuar si stacion pasagjerësh ashtu edhe si stacion mallrash. Aktualisht funksionon vetëm si stacion mallrash. Në dhjetor të 2016 ka përfunduar studimi i fizibilitetit për modernizimin e linjës hekurudhore Durrës- kufiri me Malin e Zi (<http://www.transporti.gov.al>) pjesë e së cilës është edhe segmenti që kalon në bashkinë e Vau-Dejës.

3.3.9.4 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Furnizimi me ujë të pijshëm

Të përgjithshme

Bashkia Vaut-Dejës, pavarësisht burimeve të shumta ujore, ende nuk garanton mbulim tërësor të territorit më këtë shërbim publik. 19 rrjete sistemi të ujësjellësve operojnë gjithsej në bashki, ku vetëm 9 operojnë në Bushat, që përfaqëson edhe njësinë administrative që paraqitet më mirë me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës. Nga 19 rrjetet e ujësjellësit, 13 prej tyre janë me rrjete me ngritje mekanike, pra që kanë edhe sistemet përkatëse të pompimit (respektivisht 15 sisteme pompimi). 5 rrjete ujësjellësi janë me rrjedhje të lirë, çka do të thotë se janë sisteme me kosto të reduktuara të funksionimit. Vetëm 4 prej tyre, funksionojnë në njësinë administrative Shllak. Këto sisteme ujësjellësi favorizohen nga natyra kodrinore e zonës.

Një pjesë e konsiderueshme e familjeve në fshatra sigurojnë ujin e pijshëm nëpërmjet burimeve natyrore (krua) si dhe nëpërmjet përdorimit të puseve. Problematik mbetet furnizimi me ujë higjienikisht të pastër për 24 orë të familjeve në zonën urbane të Vaut të Dejës. Kjo zonë ka një numër të madh të familjeve, që aktualisht nuk u sigurohet ujë i pijshëm nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit.

Gjendja ekzistuese

Në asetet e UK sh.a Vau-Dejës, si elementë të sistemeve të furnizimit me ujë bëjnë pjesë:

- Katër rezervuarë rregullues me kapacitet përkatësisht 500, 200, 100 dhe 50 m³;
- Tre stacione pompimi;
- Linjat e dërgimit të ujit nga stacionet e pompimit për në rezervuarë (linjat e jashtme), rrjeti i tubacioneve shpërndarës të ujit nga rezervuarët për tek konsumatori, pajisjet elektromekanike, elektrike, rakorderitë hidraulike, pusetat, saraçineskat, pus-shpimet, etj.

Furnizimi i rezervuarëve me kapacitet 500 m³ dhe 200 m³, kryhet nga një stacion pompimi i ndërtuar në vitin 1980 dhe i rikonstruktuar në vitin 2012. Stacioni përbëhet nga 4 pompa, secila me kapacitet 108 l/min, dy prej të cilave janë jashtë funksionit.

Dy stacionet e tjera, të ndërtuara në vitin 1966, aktualisht janë jashtë funksionit.

Rezervuarët e ujit janë prej betoni të armuar dhe guri. Dy prej tyre (100 dhe 50 m³) janë jashtë funksionit.

Rrjeti i linjave të jashtme, magjstralët dhe rrjeti shpërndarës i tubacioneve të ujit, janë realizuar me tubacion çeliku që varion nga Ø 300 - 70 mm me një gjatësi totale prej 21.350 ml, si dhe me tuba zinkato 2 "deri ¾ ", me një gjatësi prej 10.950 ml.

Tubacionet janë shtrirë përgjatë bankinave të segmenteve rrugore, në mënyrë që të furnizojnë një numër sa më të madh banesash për një gjatësi sa më të shkurtër. Në përbërje të rrjetit janë edhe 8 puseta kontrolli me dimensione 1.5 x 1.5 x 1.5 m, si dhe 24 saraçineska për kontrollin e fluksit. Numri i kontatorëve për abonentët është 738.



Fig. 65: Vendndodhja e stacioneve të pompimit (majtas: jashtë funksionit; djathtas: në funksionim)

Kanalizimet e ujërave të përdorura

Përgjithësisht, rrjeti i KUP paraqet infrastrukturën publike më kritike në bashki. Ky sistem është pothuajse inekzistent. Shifrat në këtë shërbim përfaqësohen vetëm nga 7.5 km rrjet kryesor në Bushat, nga i cili përfitojnë 1.100 familje. Ndërsa në Hajmel, për shkak të iniciativës së vetë banorëve, është ndërtuar rrjeti sekondar i KUP me gjatësi 0.5 km, që ka përfshirë 378 familje përfituese.

Metoda kryesore e evakuimit të ujërave të përdorura, në kushtet e mungesës së infrastrukturës së KUP, janë përdorimi i gropave septike, të cilat ndikojnë negativisht në parametrat mjedisorë.

Në këto kushte, prioritet për ndërtimin e rrjeteve të ujërave të përdorura dhe pastrimin e tyre, mbeten zonat urbane në Vau-Dejës, që përfaqësojnë përqendrimet më mjaftueshme të popullsisë për investime në infrastrukturë të tillë.

- Njësia Administrative Vau-Dejës

Rrjeti i furnizimit me ujë për qytetin Vau-Dejës është ndërtuar që në vitin 1964. Ndërrhyrjet për rehabilitimin e tij datojnë në vitet 1995 dhe 2006. Gjatë ndërhyrjes së fundit është kryer rikonstruksioni i rrjetit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, por aktualisht vetëm 20 % e këtij rrjeti është në funksion.

Vepra e marrjes ndodhet në Laç, brenda territorit të qytetit. Prurjet që merren nga pushtimi janë përkatësisht 45 l/sek (minimale) dhe 75 l/sek (maksimale).

Linja e jashtme e ujësjellësit është e përbërë kryesisht prej tub çeliku, me gjatësi 19.8 km, dhe tub zinkato me gjatësi 14.1 km. Diametri i kësaj linje varion nga 1 " deri 200 mm.

Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit në Vau-Dejës, prurja e të cilit, në varësi të sezonit, varion nga 50 - 70 l/sek.

Aktualisht sistemi ka në përbërjen e vet katër rezervuarë, me kapacitetet përkatëse, siç është përmendur më sipër.

Përsa u përket linjave shpërndarëse, ato janë të përbëra kryesisht prej tub çeliku, me diametër 76 - 133 mm, dhe tub zinkato, me diametër 1/2 - 2 ".

Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin deri në 2.066 m³, ndërsa çmimi i faturimit varion në varësi të subjektit: 20 ALL/m³ për familjarët, 80 ALL/m³ për institucionet dhe subjektet private.

Sasia e ujit të faturuar është rreth 2.440 m³/muaj për abonentët të pajisur me matësa uji dhe 11.200 m³/muaj për abonentët pa matësa (*à forfait*), pra rreth 22 % e sasisë së prodhuar.

Sasia e inkasimeve arrin 269.000 ALL në muaj. Numri i abonentëve me kontratë të miratuar nga ERU është 976, ndërsa nuk ka sisteme individuale të furnizimit me ujë.

Lidhur me cilësinë e ujit të shpërndarë, çdo muaj kryhen analizat rutinë nga ana e DRSH dhe nuk ka pasur probleme të cilësisë.

Kohëzgjatja mesatare ditore e furnizimit me ujë është 9 orë.

- Njësia Administrative Bushat

Rrjeti i furnizimit me ujë për qytetin e Bushatit është ndërtuar që në vitin 1998. Deri më sot nuk ka pasur asnjë ndërhyrje rehabilitimi.

Linja e jashtme e ujësjellësit është e përbërë kryesisht prej tub polietileni, me gjatësi 8.424 ml.

Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit, prurja e të cilit është rreth 30 m³/h.

Rregullimi i prurjes ditore bëhet nga rezervuari rregullues në kuotën 300 m.

Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin në 300 - 360 m³/ditë, ndërsa sasia e ujit të faturuar është 60 % (6.480 m³/muaj, 272.160 ALL/muaj).

Çmimi (tarifa) i faturimit është 42 ALL/m³ për të gjitha subjektet. Sasia e inkasimeve është 40 % e ujit të faturuar, rreth 108.864 ALL/muaj.

Numri i abonentëve të lidhur me sistemin e centralizuar është 265, ndërsa nuk ka sisteme individuale të furnizimit me ujë.

Lidhur me cilësinë e ujit të shpërndarë, çdo muaj kryhen analizat rutinë nga ana e DRSH dhe nuk ka pasur probleme të cilësisë.

Kohëzgjatja mesatare ditore e furnizimit me ujë është 12 orë.

Si problem kryesor në funksionimin e sistemit evidentohet gjendja e amortizuar e pompave në stacionin e pompimit.

- Njësia Administrative Hajmel

Aktualisht në territorin e kësaj njësie funksionon vetëm një rrjet ujësjellësi që është ai që furnizon një pjesë të fshatrave të njësisë administrative, ndërkohë që disa fshatra furnizohen nga pusët private. Rrjeti i ujësjellësit të njësisë është ndërtuar në vitin 1995, është rikonstruktuar në vitin 2009 dhe mbulon vetëm një pjesë të territorit të Hajmelit, ndërkohë që një pjesë e mirë e tij furnizohet me ujë nga pusët private. Problematikë mbetet mungesa e një sistemi të filtrimit të ujërave.

Me gjithë investimin e kryer, UK sh.a Vau-Dejës nuk ka kapacitete të mjaftueshme për furnizimin me ujë të të gjithë territorit të njësisë.

3.3.9.5 Furnizimi me energji elektrike

Të dhëna të përgjithshme

Bashkia e Vau-Dejës bën pjesë në Qarkun e Shkodrës, me distance 20 km nga Shkodra, 92 km nga Tirana dhe 81 km nga Airoporti i Rinasit. Ajo ka një sipërfaqe prej 468 km² ku 10 465 ha janë tokë bujqësore. Bashkia e Vau-Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë-Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë.

Ajo përbëhet nga 6 njësi administrative me një popullsi prej 49 399 banorë, përkatësisht: Vau-Dejës me 12 669 banorë, Bushat me 23 834 banorë, Vig-Mnelë me 2 177 banorë, Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë.

Bashkia e re ka nën administrimin e saj qytetin Vaut-Dejës, 47 fshatra dhe zgjerohet në 5 komuna.

Aktiviteti kryesor ekonomik është bazuar ne bujqësi dhe blegtori, biznesi i vogël dhe shërbimet.

Vau-Dejës gjithashtu ka një zhvillim në sektorin e prodhimit te energjisë, me hidrocentralin e Vaut të Dejës, të Komanit, me HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2.

Ne bashkinë e Vau te Dejës ndodhet dhe Landfilli rajonal i bushtat Bushatit ,si pike grumbullimi dhe përpunimi i mbetjeve për rajonin Shkodër-Lezhe.

Furnizimi me energji elektrike ne TL

Vau-Dejes furnizohet me energji elektrike nga nenstacioni 220/110/6KV. Shërbimi i furnizimit është i vazhdueshëm gjatë 24 orëve për qytetarët dhe bizneset (me përjashtim te rasteve te vecanta*).




Fig. 66: Harta energjetike e rajonit

Nestacioni furnizohet nga hidrocentrali i Vaut të Dejes. Azhornimet e ketij hidrocentrali dhe nestacionit kan qene te shpeshta, por jo duke bere ndryshime thebesore ne kapacitet prodhues dhe transmetues per konsumatorët e rrethinave.

Ky HEC rezervon hapsira per rritje te rendimentit dhe kapacitetit prodhues. Rezervat jane konkrete bazuar ne kapacitetin perpunues te rezervave hidrike dhe mundesise per shetesa te hidrogjenjatoreve elektrik dhe rritjen e kapacitetit te atyre ekzistues.




Fig. 67: Pasqyre permblledhese e HEC V.Dejës

Persa i përket perspektives për ndërtim te veprave te reja per prodhimin e energjisë elektrike duhet thënë dhe duke u bazuar dhe ne studimet e divizionit te prodhimit KESH, qe ndërtimi i HEC-ve te tjerë midis HEC Ashta 1&2 nuk është e mundur për arsye teknike. Shtimi i HEC-eve te tjerë do te ndërhynte ne regjimin e punës se Ashta 1&2, për shkak te devijimit dhe kushtëzimit te kapaciteve hidrogeneruese.




Fig. 68: Rrjeti energjetik rajonal




Fig. 69: Skema e rrjetit prodhues te energjise elektrike, rajoni V. Dejes

Furnizimi me energji elektrike TM

Ndersa gjendja ekzistuese e furnizimit me energji elektrike te zones eshte duke u permirsuar. Ketu ben pjese rinovimi i rrjetit te ri 20KV ne Bushat. Linje e cila furnizohet nga nenstacioni i Shkodres.

Persa i perket zonave te tjera, Vig-Mnelë, Hajmel, Temal, Shllak, rrjeti ekzistues TM vazhdon te jete 6KV dhe tejet i amortizuar.

Per shkak te nivelit te tensionit aktual 6kV, linjave ajrore te ngarkuara, cilesia e furnizimit me energji deri ne gabinat elektrike. Vihen re humbjet te tensionit ne TM qe ne momente piku kalojne 10% ΔU problem qe i shtohet dhe humbjeve te tensionit ne TU.

Po keshtu problemet e mesiperme kane dhe anen negative te tyre te cilat jane humbjet teknike ne rrjet. Keto humbje qe llogariten rreth 22% kane dhe koston financiare te tyre.

Gjendja aktuale e linjave ajrore paraqiten ne kushte te keqia dhe jashte normave te sigurimit teknik. Ne shume pjese te trakteve te linjave vihen re kurora te bimesish qe kalojne distacen e sigurise me linjat elektrike, gjithashtu godina banimi shume afer me keto linja, shtylla te dala nga qendra e rendeses si dhe izolator te shumellojshem per te cilat karekteristikat teknike elektrike dhe mekanike jane te ndryshme.

Kapacitet energjitike te zones kane kapacitetet e duhura per furnizimin me energji si nga nenstacioni i Shkodres (i cili tashme eshte kthyer ne anen sekondare ne 20KV) ashtu dhe nga nestacioni i Vaut të Dejës, megjithse ky i fundit duhet te ndryshoj tensionin ne sekondar.

Investimet do te prekin jo vetem pjesen gjeneruese te rrjetit por edhe ndryshimin e linjave ekzistuese 6KV ne 20KV.

Pjese e ketyre investimeve duhet te jene dhe kabinat elektrike dhe sjellja ne parametra standarte sipas normave ne fuqi nga OSHEE.

Furnizimi me energji elektrike TU

Ashtu si dhe rrjeti ne TM dhe rrjeti elektrik ne TU eshte tejet i amortizuar dhe i ngarkuar. Shumica e ketyre linjave perbehen nga linja ajrore me percjelles alumini te shveshur.

Pergjat trakteve te ketyre linjave vihen re lidhje dhe degezime jash kushteve teknike si dhe perdorimi i materjaleve rrethanore apo produkte te pa standartizuara per te tilla rrjete.

Probleme kryesore hasin zonat periferike, sic u tha dhe mesiper, duke nisur qe nga humbjet e TM ne transmetim deri ne kabine elektrike. Shtimi i konsumatoreve ka cuar ne nje mbi ngakese te ketyre kabinave. Demtimet elektrike te transformatoreve nga faktore elektrik nuk kane qene te ralla.

Mos standartizimi i rrjetit transmetues ne TU here pas here eshte bere dhe burim aksidentesh dhe nderhyrjesh te pa ligjshme ne rrjet.

Vihet re diversitet tipologjie produktesh që perbejne rrjetin shperndares duke nisur që nga standarti shqiptar (pjesë që ka ngelur nga rrjeti i trasheguar), produkte të standartizuara nga Europa lindore si dhe produkte EC. Xhuntimet dhe nderhyrjet në linja janë jashtë kushteve teknike në kontakt me agjentet atmosferik.

Ndricimi publik Rrugor

Vau-Dejës është në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm, zone me potencial të jashtëzakonshëm turistik. Si e tillë ndriçimi i ambjenteve publike të qytetit kthehet në një domosdoshmëri. Pjesa më e madhe e lagjeve të zones aktualisht janë të ndriçuara, por teknologjia e përdorur le për të dëshiruar pasi ky sistem ndricimi konsumon dhe ndikon në ndotje mjedisore. Ndriçimi nuk është i kënaqshëm dhe kostoja e mirëmbatjes është relativisht e lartë.

Integrimi i ndriçimit LED është pjesë përbërëse e të gjithë procesit që ka të bëjë me zhvillimin e realizimin e sukseshëm të të gjitha objektivave strategjike për këtë qytet. Kostot e faturave elektrike që Bashkia paguan për ndriçimin e qytetit janë të larta, dhe ky investim do ketë një kthim tepër të lartë duke konsideruar uljen e ndjeshme të këtyre kostove.

Ndriçimi LED lidhet jo vetëm me zhvillimin bashkëkohor infrastrukturor të qytetit, por dhe atë ekonomik, me peisazhin e zhvillimin miqësor me mjedisin. Nëpërmjet këtij projekti synohet të zëvendësohen llambat ekzistuese me llamba të reja të teknologjisë LED, të cilat sigurojnë një ndriçim më të mirë, kursejnë energji në mënyrë të konsiderueshme dhe kanë një jetëgjatësi më të lartë. Ky investim do ketë një kthim tepër të shpejtë duke konsideruar uljen e ndjeshme të kostove.

Rrjeti shperndares elektrik ne zonen e qytetit

Pjesë e zonave në zhvillim turistik, pervec atij agroturistik eshte dhe zona e liqenit.

Si shtyqe për zhvillim është dhe elektrifikimi në mënyrë kostante dhe të sigurtë i këtyre zonave.

Rrjeti Telefonik

Në këto zone ushtrojnë aktivitetin të telefonisë fikse (Albtelekom sh.a) dhe asaj të lëvizëshme, nëpërmjet operatorëve, T-Mobile, Vodafone, Eagle Mobile dhe Plus.

Për sejcilën zonë turistike të vendoset një ambient “P.T”, ku të parashikohet çentral telefonik me kapacitetin e nevojshëm për furnizimin e abonentëve të zonës. Në ambientet publike të vendosen kabina telefonike me kartë.

Rrjeti shpërndarës i telefonisë të realizohet me linjë kabllorë telefonie, futur në tubo plasmasi shtrirë në transhe përgjat trotuarit, në zonat ku nuk mundësohet kalimi në trotuar të kalohet në linja ajrore fiksuar me tirant.

3.3.9.6 Mbledhja dhe menaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel të ulët. Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta urbane kryhet në pjesën më të madhe të qyteteve.

Riciklimi kryhet për një pjesë shumë të vogël të mbetjeve. Metoda më e përdorur e asgjësimit të mbetjeve është hedhja e tyre. Në vend nuk ka landfille të ndertuara sic duhet. Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nuk kryhet në zonat rurale dhe në qytetet e vogla. Asgjësimi i pjesës më të madhe të mbetjeve në këtë zonë bëhet duke i hedhur neper kanale, lugina apo anash rrugëve dhe pasi bëhet pastrimi i rrugëve ato hidhen në vendet tjera dhe së fundmi edhe në rrjedhat e ujerave. Nuk ekziston një sistem për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve të rrezikshme (familjare dhe tregtare). Riciklimi i mbetjeve është në një nivel të dobët.

Aktualisht shërbimi i pastrimit në bashkinë Vau-Dejës është një shërbim në nivele të kënaqshëm dhe përbën praktikë të mirë për vendin tonë. Shërbimi i pastrimit ofrohet nëpërmjet instrumentit të bashkëpunimit ndërvendor, instrument i konsoliduar mes disa njësive vendore në rajon që përpara reformës territoriale. Ndërkomunalja e Zadrimës lehtëson ofrimin e shërbimit për një pjesë të madhe të territorit të bashkisë Vau-Dejës. Mbetjet organike, bimore apo shtazore, kompostohen pranë shtëpive me qëllim ripërdorimin e tyre për pleh për kulturat bujqësore, ndërsa mbetjet inerte depozitohen në vendpozitime të caktuara. Një organizim i tillë ka ulur ndjeshëm kostot e depozitimit dhe transportimit të mbetjeve.

Megjithatë, ende ky shërbim nuk ofrohet në të gjithë territorin, si në Temal e Shllak. Sfidë mbetet që një organizim i tillë të ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë, të paktën në qendrat urbane të dy njësive më të largëta.

Aktualisht, në territorin e bashkisë, në Bushat, gjendet edhe landfilli i grumbullimit të mbetjeve urbane, që ka një periudhë shërbimi për 20 vjet. Tashmë që bashkitë kanë territor më të gjerë dhe popullsi më të madhe, mund të krijohen premiset e duhura që ky landfill të përdoret në kapacitetin e tij të plotë.

3.4 Analiza e vlerësimeve demografike

Bashkia Vau Dejës, e përbërë nga 6 njësi administrative që shtrihen në 468 km², është një pjesë përbërëse e qarkut Shkodër. Sipas të dhënave të Censurit 2011, popullsia e bashkisë Vau-Dejës (duke përfshirë të gjitha njësitë administrative të saj) rezulton në 30 438 banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrit të gjendjes civile të vitit 2015, rezultojnë 49 399 banorë. Mbi bazën e këtyre të dhënave llogaritet dendësia 65 banorë/km² sipas Censurit, ndërsa sipas Regjistrit të gjendjes civile dendësia është 105.6 banorë/km².

Njësitë administrative të Bushatit dhe Vau Dejës kanë numrin më të lartë të popullsisë rezidente për njësi. Vetëm në Bushat jeton 48% e popullsisë së bashkisë, ndërsa popullsia që jeton në Bushat dhe Vau Dejës përbën 73% të popullsisë totale të bashkisë. Katër njësitë e tjera administrative kanë numër shumë të vogël të popullsisë; popullsia totale e tyre përbën vetëm 27% të popullsisë së bashkisë.

Tabela 28: Të dhënat e popullsisë

Njësia Administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnelë	Total
Popullsia Census 2011	14 149	4 430	671	1 562	8 117	1 509	30 438
Popullsia Census 2011 në %	46.48	14.55	2.2	5.13	26.67	4.96	100
Dendësia e përafërt e popullsisë sipas censusit (banorë/km ²)	140	118	11	14	90	21	65
Popullsia Gjendja Civile 2015	23 834	6 300	1 899	2 520	12 669	2 177	49 399
Popullsia Gjendja Civile 2015 në %	48.25	12.75	3.84	5.1	25.65	4.41	100
Dendësia e përafërt e popullsisë sipas gjendjes civile (banorë/km ²)	240	200	26	26	128	30	105.6
Diferenca e popullsisë midis dy të dhënave	9 685	1 870	1 228	958	4 552	668	18 901

Arsyetja e paraqitjes së të dhënave të ndryshme nga INSTAT-i dhe Regjistri i gjendjes civile janë lëvizjet brenda vendit pas vitit '89, të cilat nuk shoqëroheshin gjithmonë me procedurat e regjistrimit në Regjistrin e gjendjes civile të zonës ku vendoseshin. Gjithashtu, edhe dukuria e emigracionit ndikon në mosparaqitjen e gjendjes reale të popullsisë.

Tabela 29: Ndryshimi i popullsisë (INSTAT)

Njësia Administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnelë
Popullsia Census 2011	14 149	4 430	671	1 562	8 117	1 509
Ndryshimi i popullsisë 1989 – 2011 në %	-38.2	-12.4	-78.3	-98.7	-84.9	-59.3
Ndryshimi i popullsisë 2001 – 2011 në %	-17.7	-18.2	-44.7	-8.3	-13.9	-52

Duke studiuar shifrat e lëvizjes së popullsisë në 3 censuset e fundit vihet re që popullsia ka pasur një rënie të vazhdueshme me tendencë ngadalësimi në vitet e fundit. Më konkretisht:

Njësia administrative Bushat, në periudhën 1989-2011 ka njohur një humbje popullsie prej 38.2 %. Ky largim ka qenë me ritme të larta në periudhën 1989-2001 dhe ka vijuar por me ritme më të ngadalta në periudhën 2001-2011. Kjo tregon një konsolidim të kësaj njësie që gradualisht po zhvillohet.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për njësine administrative Vau-Dejës ku reduktimi i popullsisë ka qenë mjaft i madh (84.9%) por që është frenuar ndjeshëm (13.9%) në periudhën 2001-2011. Duhet thënë se Qyteti Vau-Dejës është tkurrur ndjeshëm duke u shndërruar nga qendra më e rëndësishme ndër 6 njësitë, në një njësi me popullsi më të vogël se Bushati që ende ka statusin e qendrës rurale.

Ndryshe nga dy të parat, Hajmeli po njeh rritje të largimit të popullsisë, gjë që duhet analizuar hollësisht gjatë hartimit të strategjisë territoriale.

Njësitë Shllak Temal dhe Vig-Mnelë, për shkak të gjeografisë së vështirë të territorit por edhe për shkak të mungesës së investime kanë pësuar reduktim të vazhdueshëm të popullsisë. Këtu numri i popullsisë të mbetur është mjaft i vogël dhe kryesisht ka mbetur vetëm pjesa e banorëve që e kanë të pamundur për tu zhvendosur.

Rënia e popullsisë në periudhën 1989-2001 ka rezultuar mesatarisht rreth 13.2% në vit, me një lëvizje të përgjithshme prej -82% (rreth 17 000 banorë).

Rënia e popullsisë në periudhën 2001-2011 ka rezultuar mesatarisht rreth 2.23% në vit, me një lëvizje të përgjithshme prej -20% (rreth 7 600 banorë).

Referuar në të dhënat e INSTAT mbi qarkun Shkodër, vihet re një vijimësi e rënies së popullsisë në periudhën 2015-2016 me -1.37%

Bazuar në të njëjtat të dhëna mbi qarkun Shkodër, vihet re një vijimësi e rënies së popullsisë gjatë vitit të fundit (2016-2017) me -1.07%

Duke analizuar trendët e mësipërme vihet re se largimi nga territori i popullsisë është një fenomen në rënie të vazhduar, çka dëshmon konsolidimin në tërësi të bashkisë në kontekstin e zhvillimit të përgjithshëm. Pritshmëritë janë që edhe për disa vite rënia e popullsisë të vijojë e më pas të kemi stabilizim, ndoshta dhe rritje brenda një harku 15 vjeçar.

Bazuar në të dhënat e Regjistrat Civil për periudhën 15 vjeçare (2000-2015) popullsia lokale është rritur me 6.7% (mesatarisht 0.43% në vit). Rritja më e madhe ka ndodhur përgjatë viteve 2005-2010, ndërsa gjatë viteve 2010-2015 reflektohet një rritje mesatare prej 0.07% në vit.

Katër njësitë administrative (Bushat, Vau-Dejës, Hajmel dhe Shllak) karakterizohen nga trend pozitiv në rritjen e popullsisë. Këtu vihet re një rritje konstante dhe e vazhduar në Hajmel dhe rritje të vazhduara me tendencë ngadalësimi vitet e fundit në Bushat e Vau-Dejës. Këto tendenca lidhen më fenomenin e migrimit të brendshëm nga zonat rurale të largëta drejt zonave urbane.

Në njësitë Vig-Mnelë dhe Temal vihet re një trend negativ. Popullsia e Vig-Mnelë në këtë periudhë është reduktura me 778 banorë dhe ky reduktim ka qenë më evident në periudhën 2010-2015.

Tabela 30: Popullsia 2000-2015 (Bashkia Vau-Dejës)

Njësitë administrative	Viti 2000	Viti 2005	Viti 2010	Viti 2015	Diferenca 2000-2015	Shtesa e pop. 2000-2015 %
Bushat	21 425	22 332	23 454	23 834	2 409	11.24
Vig Mnelë	2 495	2 450	2 421	1 717	-778	-31.18
Temal	2 530	2 460	2 389	2 520	-10	-0.4
Shllak	1 783	1 553	1 767	1 899	116	6.51
Hajmel	6 050	6 227	6 541	6 760	700	11.6
Vau-Dejes	12 033	12 312	12 660	12 669	636	5.29
Total	46 316	47 334	49 232	49 399	3 083	6.66

Megjithëse këto të dhëna kundërshtojnë ato të INSTAT, fenomeni është i shpjegueshëm përmes dukurisë të emigrimit që ka vijuar të jetë intensiv ndërkohë që popullsia fiktive në regjistrin e gjendjes civile rritet.

Gjithësesi nëse i referohemi të dy trendëve njëherazi, shifrat e popullsisë janë drejt stabilizimit dhe në rast vijimësie të zhvillimit të territorit do të kemi një popullsi konstante me tendencë për rritje natyrore me ritme të ulëta.

Tëkuptuarit e dinamikës së popullsisë mbetet tregues i rëndësishëm për zhvillimet në të tre nivelet, lokal, rajonal dhe kombëtar. Treguesit e lindshmërisë dhe vdekshmërisë përbëjnë faktorët bazë për të vlerësuar trendin e popullsisë. Për vendin tonë, migrimi i brendshëm dhe emigrimi, përbëjnë faktorë shumë të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë për të kuptuar ndryshimet demografike ndër vite, që në fund të fundit përkthehen në transformime të forta hapësinore.

Migrimi i brendshëm ka ndodhur nga zonat periferike drejt qendrave urbane dhe zonave me akses kundrejt infrastrukturës. Frenimi i zhvendosjeve masive të popullsisë në rang vendi në fundin e viteve '90 solli edhe reduktimin e popullsisë së ardhur nga zonat e thella. Në përmbledhje mund të themi se Bashkia Vau-Dejës ka tendencë për reduktim të lehtë të numrit të popullsisë në vitet e ardhshme ndonëse ky reduktim është me ritmet më të ulëta në 27 vitet e fundit. Edhe për një periudhë disaveqare, parashikohet të vazhdojnë lëvizjet e brendshme të popullsisë nga zonat e thella drejt qendrave ekonomike, atyre të shërbimeve dhe infrastrukturës.

Për sa i përket strukturës së popullsisë, përveç migrimit, ulja e lindshmërisë dhe vdekshmëria kanë ndikim të rëndësishëm. Sipas të dhënave të INSTAT-it, 21.6% e popullsisë është nën moshën 15 vjeç dhe 12.6% është mbi moshën 65 vjeç (INSTAT, Popullsia dhe dinamika e saj në Shqipëri). Këto të dhëna tregojnë që grupi i popullsisë aktive 15-64 vjeç zë përqindjen më të madhe. Koeficienti i varësisë (numri i personave nën 14 vjeç dhe mbi 65 vjeç, përkundëjt numrit të personave në moshë aktive 15-64 vjeç) shprehur në përqindje është 52.02, shifër kjo lehtësisht më e lartë se niveli kombëtar (47.1%). Kjo nënkupton një rritje të barrës së personave të varur brenda njësive ekonomike familjare. Ndikim në këtë shifër ka edhe emigrimi i një pjese të popullsisë në moshë aktive.

Tabela 31: Përbërja e popullsisë 2011 (INSTAT)

Njësia Administrative	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Nr i familjeve	Pjesëtar për familje
Popullsia	30438	15181	15257	7424	4.1

Nga tabela e mësipërme, vihet re që raporti meshkuj/femra në Bashkinë Vau-Dejës është në përqindje të përafërta, pra raporti gjinor është me vlerë të ulët. Familjet përbëhen me mesatarisht nga 4.1 pjesëtar, shifër kjo e përafërt me mesataren e vendit.

Për qarkun e Shkodrës, ky koeficient (raporti i lindjeve për 1000 banor të një territori, në një vit të dhënë) për vitin 2015, sikurse duket nga grafiku i mëposhtëm, është më i ulët sesa mesatarja kombëtare e lindjeve.




Fig. 70: Koefficienti bruto i lindjeve (INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2016)

3.4.1 Lëvizjet natyrore dhe hapsinore

Nga analiza e të dhënave të INSTAT në 22 vite ('89-'11), del se popullsia është në rënie, mesatarisht me rreth 2.23 % në vit dhe kjo është një dukuri me perspektivë zvogëlimi. Shtesa natyrore e popullsisë deri në vitet 90' ka qënë e lartë falë politikave sociale dhe ritmeve të larta të lindshmërisë të shoqëruara nga ulja e vazhdueshme e treguesve të vdekshmërisë. Pas viteve '90 vihet re një ulje e ndjeshme e nivelit të lindjeve. Shkak kryesor është migracioni i theksuar për moshën 20-35 vjeçare, ndryshimi i mentalitetit dhe ndryshimi i nevojës për krahë pune në bujqësi.

Lëvizja hapësinore e popullsisë karakterizohet nga dy forma tradicionale të saj: migracioni i brendshëm dhe emigracioni jashtë kufinjve të vendit. Kjo lëvizje e popullsisë dhe të gjitha hapat e zhvillimit ekonomik të zonës me ulje-ngritjet e saj, janë reflektuar dhe në punësimin e familjeve me grup-moshë aktive.

Gjithashtu mbas viteve 90' ka ndikuar dhe lëvizja e lirë e njerëzve për t'u punësuar në rrethinat më të zhvilluara brenda vendit, sidomos në qytetet e mëdha dhe në rajonin Tiranë-Durrës. Kjo u shoqërua me lëvizje të ndjeshme të popullsisë me prurje nga zonat e thella që u zhvendosën drejt Shkodrës dhe Lezhës. Lëvizje ka pasur edhe brenda territorit të bashkisë, ku banorët e zonave të thella janë spostuar kryesisht në Bushat, Hajmel, Vaun e Dejës dhe në terriore me akses të lehtë në aksin kombëtar Tiranë – Shkodër. Ky fenomen ka qënë dhe vazhdon të jetë aktiv. Ka lëvizje të njerëzve nga fshatrat e thella, drejt fshatrave të cilat janë më pranë zonave me përparësi urbane dhe nga qendrat e vogla urbane, drejt qyteteve më të mëdha, që ofrojnë më shumë mundësi punësimi dhe jete sociale.

Vau - Dejës, si gati gjithë Shqipëria, ka më shumë se 20 vjet që është përfshirë nga eksodi i orientuar drejt qyteteve, zonave fushore dhe jashtë kufirit të Shqipërisë. Kjo ka të bëjë sa me burimet e pakëta natyrore (në disa njësi), apo me pamundësinë e shfrytëzimit të tyre si duhet, aq edhe me shkallën e ulët të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të disa territoreve. Banorët janë në kërkim të një jete më të mirë, veçanërisht për fëmijët e tyre, mundësive të rritjes së prodhimit bujqësor, mundësive më të mira për punësim e për shanse më të favorshme. Infrastruktura e sotme: rrugët, rrjeti elektrik dhe ai ujësjellës, shkolla, qendrat shëndetësore, qendrat kulturore dhe argëtuese, janë zhvilluar në mënyrë jo të njërajtshme në territorin e vendit, duke krijuar diferenca të ndjeshme dhe nevojën e natyrshme për migrim.

3.4.2 Projeksionet

Aktualisht lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale apo të thella drejt qyteteve dhe zonave fushore e bregdetare, për Bashkinë Vau-Dejës, nuk janë duke u stabilizuar dhe pjesa më e madhe e zonave të banuara po shkojnë drejt konsolidimit. Rol pozitiv në këtë aspekt luan dhe procesi i legalizimit të ndërtimeve informale në rang vendi.

Projeksioni i popullsisë u bë duke tentuar një vijë të mesme mes të dhënave të INSTAT-it dhe atyre nga regjistri civil i Bashkisë Vau-Dejës. Përtej vlerësimit të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migrimit ndërkombëtar, problemi i projeksioneve mbetet një detyrë e vështirë për parashikimet e të ardhmes.

Hipotezat për lidhjen e të dhënave u konceptuan në tre variante, si e lartë, e mesme dhe e ulët. Në hipotezën e mesme normat e lëvizjes u konsideruan konstante dhe si mesatare mes të dhënave të INSTAT-it nga 2007-2011 (që ata e konsiderojnë normë e mesme) dhe të dhënave nga Bashkia për po këto vite.

Nje element shtytës për këtë kombinim ka qënë edhe poicioni strategjik i Bashkisë, prane qendrave të mëdha urbane të veriut, fushës së zadrimes dhe burimeve ujore (Drini, Liqeni i Vaut të Dejës, Liqeni i Shkodrës, Velipoja). Mendojmë që lëvizjet e brendshme do e favorizojnë disi Vaun e Dejës, duke bërë të ngjashëm me Shkodrën dhe Lezhën, po sigurisht jo më të njëjtin ritëm rritjeje.

Në hartimin e projeksioneve u analizua edhe tendenca e zhvillimit të territorit dhe lëvizjet demografike sidomos ato të 25 viteve të fundit. Nisur nga luhatjet e popullsisë sipas fazave të zhvillimit, mendohet se skenarët e pritshëm të ndryshimit të popullsisë janë në varësi të zhvillimit ekonomik të vendit në përgjithësi dhe bashkisë në veçanti.

- Në rastin e një zhvillimi apo rritjeje ekonomike, popullsia mbetet e njëjtë ose pëson një rritje të lehtë
- Në rastin e një regresioni ekonomik popullata ka prirjen të tkurret e të zhvendoset në qendra me aktivitet më të lartë ekonomik

Pavarësisht të dhënave kontradiktore për popullsinë, duke u nisur edhe nga elementë të tërthortë tregues (femrat në moshë fertile: 49.37%) dhe analiza të treguesve, si konkluzion mund të themi se në një skenar zhvillimi, rritja e popullsisë prej 0.15% në vit mendohet reale, e qëndrueshme dhe pjesë e një modeli të besueshëm, si rrjedhim,

popullisa e Bashkisë Vau-Dejës, në vitet 2030 do të jetë mes 31,200 dhe 50 500 banorësh, me një mesatare të pranueshme prej 41,000 banorësh.

3.5 Aspektet sociale dhe ekonomike

3.5.1 Profilet ekonomike

Konteksti ekonomik i Bashkisë përfaqësohet nga një ekonomi mikse, me prirje në disa sektorë si bujqësia, blegtoria, shërbimet, dhe industria energjitike. Megjithatë, ekonomia lokale dominohet nga bujqësia dhe është një ekonomi tipike rurale. Bujqësia përbën drejtimin kryesor ekonomik të popullatës (me një peshë specifike të vreshtarisë dhe frutikulturës) si dhe blegtoria. Industria energjitike dhe potencialet ekzistuese të erës dhe të ujit ofrojnë mundësi reale të rritjes ekonomike lokale dhe rajonale. Këto dy sektorë paraqesin edhe burimet më të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik lokal dhe në planin rajonal marrin një domethënie të veçantë.


Në sektorin e bujqësisë janë të përfshirë 65-85% e të punësuarve, ndërsa sektori energjistik punëson më shumë se 5% të forcës punëtore. Tabela më poshtë tregon profilin ekonomik të çdo njësie dhe interpretimet përkatëse. .

Tabela 32: Profili ekonomik i njësive administrative

Njësitë administrative	Profili ekonomik	Detaje
Bushat	Njësi vendore bujqësore mikse fushore	Bujqësia midis 65-84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%
Vig Mnelë	Njësi vendore bujqësore malore	Bujqësia >84% Sipërfaqja e pjerrët >45%
Temal	Njësi vendore bujqësore malore	Bujqësia >84% Sipërfaqja e pjerrët >45%
Shllak	Njësi vendore bujqësore malore	Bujqësia >84% Sipërfaqja e pjerrët >45%
Hajmel	Njësi vendore bujqësore mikse fushore	Bujqësia midis 65-84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%
Vau-Dejës	Njësi vendore jo-urbane me drejtim minerar ose energjistik	Minierat ose energjia > 5%

Tre njësitë administrative të bashkisë janë njësi vendore bujqësore malore. Pra, 84% e të punësuarve merren me bujqësi dhe më shumë se 45% e sipërfaqes së territorit ka pjerrësi më të madhe se 13,5 gradë.

Tabela 33: Terreni dhe topografia



Njesite administrative	Fushë (ha)	Kodër (ha)	Mal (ha)
Bushat	5.915	50	-
Vig Mnelë	170	230	-
Temal	-	-	1.108
Shllak	-	-	298
Hajmel	1.851	381	-
Vau-Dejës	971	30	101
Total	8907	691	1507

Vetëm dy njësi vendore janë bujqësore mikse fushore, pra bujqësia përfshin 65-84% të të punësuarave dhe më pak se 45% e sipërfaqes së territorit ka pjerrësi më të madhe se 13,5 gradë.

Vetëm një njësi vendore me drejtim minerar/energjitik. Të punësuarit në sektorin minerar/energjitik janë më shumë se 5%.

Bashkia e Vau Dejës ka një sërë avantazhesh që krijojnë kushtet ideale për një zhvillim ekonomik dhe mirëqenie të popullatës lokale. Bushati dhe qyteti i Vau Dejës përfaqësojnë qendrat zhvillimore të bashkisë dhe më gjerë për shkak të potencialeve të tyre për zhvillim. E ndodhur në rrugët kryesore që lidhin vendin tonë me vendet fqinje dhe që shërbejnë si rrugë kalimi mes vendeve fqinje (Itali, Mal i Zi, Kosovë), si dhe e shtrirë gjeografikisht mes dy qendrave më të zhvilluara të veriut të vendit (Shkodrës dhe Lezhës) i japin bashkisë Vau-Dejës avantazh konkurrues në krahasim me qendra të tjera më të vogla të veriut.

Përveç këtij avantazhi gjeografik të bashkisë, zhvillimi ekonomik është lehtësuar dhe mbështetet edhe nga infrastruktura e përmirësuar rrugore, ku përmendim autostradën kombëtare Tiranë-Shkodër, që kalon përmes kësaj zone si dhe përkatësisht tre rrugë rajonale që lidhin qytetin e Shkodrës me qytetin e Lezhës, të cilat janë të një niveli të mirë. Linja hekurudhore kombëtare Tiranë-Shkodër që kalon në territorin e bashkisë, ndonëse në gjendje të amortizuar, mbetet një potencial i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, sidomos në aspektin e transportit hekurudhor të mallrave. Kjo linjë është edhe e vetmja linjë hekurudhore që lidh Shqipërinë me vendet e tjera.

Bazuar në akumulimet e sipërmarrjeve ekonomike dhe në tendencat e sotme të zhvillimit, Bushati dhe Vau-Dejës përcaktohen si dy qendrat e zhvillimit ekonomik bashkisë. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik i njësive të tjera më të vogla administrative si Vig Mnele, Hajmel, Temal dhe Shllak paraqitet i ndërlidhur dhe i ndërvlarur me zhvillimin e dy qendrave Bushat dhe Vau-Dejës. Vig Mnele, Hajmel, Temal dhe Shllak duhet të forcojnë kapacitetet e tyre prodhuese në bujqësi dhe blegtori, të cilat do të jenë furnizuesit e industrisë agropërpunuese që parashikohet të marrë hov zhvillimi në Bushat dhe Vau e Dejës.

3.5.2 Sektori i Bujqësisë

Sektori i bujqësisë është kontribuesi më i madh në ekonominë e rajonit. Pavarsisht se ky sektor mbetet jo i mirë-menaxhuar, rreth 80% e popullsisë në bashkinë Vau Dejës jeton në fshat dhe merret kryesisht me bujqësi. Fshatarët përdorin tokën kryesisht për të plotësuar nevojat e përditshme; vetëm disa prej tyre përdorin sera. Gjatë 25 viteve të fundit, kryesisht nga mungesa e mirëmbajtjes, ky sistem u dëmtua duke ulur ndjeshëm dhe nivelin e prodhimit. Vlen të theksohet që investimet e viteve të fundit në pastrimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi (vaditës-kullues) janë shenja premtuese për rigjenerimin e sektorit të bujqësisë.

Tabela 34: Fermat në Bashkinë Vau Dejës

Njësitë administrative	Ferma gjithsej	Ferma Bujqësore		Ferma Blegtorale	
		Nr.	Ha	Nr.	Nr. Krerë
Vau-Dejës	2803	1823	1132	980	426
Bushat	8746	4996	6502	3750	3414
Hajmel	2137	1187	1848	950	832
Vig-Mnelë	1210	771	183	430	60
Shllak	1064	659	101	405	25
Temal	1121	821	116	300	18
Total	17081	10257	9882	6815	4775
Burimi: Fermat Bujqësore dhe Blegtorale në Shqipëri - Q.T.T.B. Fushë Krujë (botim i vitit 2014)					

Në tabelën në vijim janë paraqitur në formë të detajuar të dhënat për fermat bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Vau-Dejës.

Ndër faktorët kryesorë që favorizojnë bujqësinë si sektor prioritar për bashkinë Vau Dejës janë: fusha e Zadrimesë e njohur për prodhimtarinë e lartë bujqësore; sipërfaqe e konsiderueshme e tokës bujqësore ndodhet nën ujë; pasuritë e shumta ujore; potenciale të konsiderueshme njerëzore, ku përmendim një numër të lartë agronomësh si dhe shkolla profesionale bujqësore që edukojnë të rinjtë dhe thellojnë më tej asistencën ndaj fermerëve.

Struktura e tokës bujqësore përfaqësohet nga 81% fushë, 13% malore dhe 6% kondrinore. Bushati shtrihet në territor fushor, Vau-Dejës kryesisht fushor, Hajmeli fushor-kodrinor, Temali dhe Shllaku janë territore plotësisht malore, Vig Mnel është fushor-kodrinor (kodrinore në më shumë se gjysma e territorit). Vetë struktura e tokës ka kushtëzuar edhe zhvillimin e bujqësisë, ku nga prodhimtaria e lartë bujqësore identifikohen qartë Bushati dhe Vau-Dejës.

Bushati përfaqëson njësinë që ka sipërfaqen më të madhe të tokës arrë ndaj ajo është e njohur për prodhimtarinë e lartë bujqësore, 45% e tokës e arrë të bashkisë gjendet në Bushat. Ullishtet dhe vreshtat janë tendencë e kohëve të fundit dhe sipërfaqja më e madhe e tyre gjendet në Hajmel.

Bashkia ka sipërfaqe të jashtëzakonshme me pyje dhe kullota; 36,062 ha pyje, të lokalizuara kryesisht në Shllak (28% e sipërfaqes pyjore) dhe Vau-Dejës (24% e

sipërfaqes pyjore). Vig Mnelë ka sipërfaqen më të madhe të kullotave (315) që favorizon zhvillimin e blegtorisë, dhe 24% e tyre gjendet në Bushat.

Këtyre dy drejtimeve kryesore të ekonomisë, ju shtohen disa sektorë me potencial zhvillimi për rritje të shpejtë ekonomike por që aktualisht mbeten të pazhvilluara. Këtu përmendim industrinë agropërpunuese dhe agroturizmin.

Tabela 35: Të dhëna për fermat bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Vau Dejës

Ferma bujqësore																	
Nr.	Njësia Administrative	Ferma Bujqësore gjithsej		Ferma me Bime Arash		Ferma me Bime Foragjere		Ferma me Perime ne Sera		Ferma me drejtim Frutikulturë		Ferma me drejtim Vreshta		Ferma me drejtim Ullishte		Ferma me Bime Aromatike Mleksore	
		Nr	ha	Nr	ha	Nr	ha	Nr	ha	Nr	ha	Nr	ha	Nr	ha	Nr	ha
1	Vau Dejës	1823	1132	1650	960.8	980	426	8	0.8	21	14.5	28	32.4	85	89	0	0
2	Bushat	4996	6504	4400	5886	3950	3414	190	46	25	12.5	19	12.8	22	15	1	0.8
3	Hajmel	1187	1848	1010	1584	950	832	2	0.2	16	15.5	52	66.1	104	105	0	0
4	Vig-Mnelë	771	183	500	119	430	60	0	0	4	8.9	0	0	54	42	0	0
5	Shllak	659	101	470	69	405	25	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Temal	821	116	515	71	414	18	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total		10257	9884	8545	8690	7129	4775	200	47	66	51.4	99	111.3	265	251	1	0.8
Ferma blegtorale																	
Nr.	Njësia Administrative	Ferma me gjedh		Ferma me të leshta		Fermame të Dhirta		Ferma me Shpend		Ferma me Derra Majmërie		Ferma me Derra riprodhimi		Ferma me Njëthundrakë		Ferma me bletë	
		Nr. fermave	Nr. Krehëve	Nr. fermave	Nr. Krehëve	Nr. fermave	Nr. Krehëve	Nr. fermave	Nr. Krehëve	Nr. fermave	Nr. Krehëve	Nr. fermave	Nr. Krehëve	Nr. fermave	Nr. Krehëve	Nr. fermave	Nr. Koshereve
1	Vau Dejës	980	2340	176	2020	58	2500	3	4000	1446	1800	35	150	54	60	29	530
2	Bushat	3750	5500	250	3800	60	750	43	7000	1706	7500	205	450	450	500	165	200
3	Hajmel	950	2015	40	1500	54	1300	2	220	1254	6130	100	294	25	30	14	450
4	Vig-Mnelë	430	450	30	1300	45	2100	0	0	731	1285	13	27	22	25	11	500
5	Shllak	405	450	100	1000	226	1600	0	0	268	300	10	10	35	35	29	350
6	Temal	300	290	150	100	170	1100	0	0	439	600	10	20	28	30	190	500
		6815	11045	746	9720	613	9350	48	11220	5844	17615	373	951	614	680	438	2530

Njësitë administrative të Temalit dhe Shllakut, duke u gjendur në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës, ndodhen të veçuara me pjesën tjetër të bashkisë. Për më tepër që lidhja historike me bashkinë e re nuk ka qenë e fortë. Për sa i përket zhvillimit ekonomik, këto njësi nuk janë po kaq të avantazuara sa njësitë e tjera të bashkisë për të nxitur një zhvillim ekonomik lokal. Infrastruktura tepër e dobët rrugore që lidh këto njësi me zonën më të afërt urbane dhe mungesa e tokave bujqësore ka ndikuar negativisht në zhvillimin lokal. Aksesit i ulët në shërbimet bazë në këto komunitete, dhe aksesit i vështirë në tregjet lokale e bën popullatën e Temalit dhe Shllakut me mundësira shumë të kufizuara për të diversifikuar ekonominë lokale. Bujqësia dhe agroturizmi mbeten mundësitë e vetme për aktivitet ekonomik.

Problematika dhe rekomandime:

I. Kanalet e kullimit

Aktualisht një pjesë e kanaleve të kullimit të ujerave është amortizuar për shkak të permbytjeve të shumta në zone që sjellin vazhdimisht inerte. Është e nevojshme një ndërhyrje e vazhdueshme për të pastruar kanalet e para pasi inefikasiteti i tyre sjell në pamundësi të përdorimit të kanaleve të dyta dhe të treta.

II. Disiplinimi i burimeve ujore

Mungesa e një strukture të disiplinuar të kanalizimit të burimeve ujore ka sjellë shpesh permbytje të tokave gjë që i bën të pashfrytëzueshme për bujqësinë. Rreth 10% e tokave në Bushat janë djerre ose toka që permbyten. Disiplinimi i ujerave do të bente këto toka të shfrytëzueshme duke rritur në këtë mënyrë ndjeshëm prodhueshmërinë dhe të ardhurat.

III. Mungesa e infrastrukturës rrugore

Nëqoftesë në njësitë administrative Bushat dhe Vau-Dejës infrastruktura rrugore është e amortizuar, në njësitë e tjera administrative, ajo mungon. Mungesa e infrastrukturës dekurajon thellësisht iniciativën individuale për të rritur prodhimin bujqësor dhe kanalizimin e tij në zonat me dendësi më të madhe popullore.

IV. Pikat e magazinimit

Mungesa e një sktrakturë magazinimi të prodhimeve bujqësore sjell një inefficiencë në shfrytëzimin e potencialeve bujqësore në zone. Në njësinë administrative Bushat kjo është shumë e rëndësishme për shkak të zerit të rëndësishëm që ze bujqësia në aktivitetin ekonomik të njësisë.

V. Shfrytëzimi i sinergjive (kooperativat)

Parcelizimi i tokave në lote të vogla, numri i madh i subjekteve që operojnë individualisht në treg dhe mungesa e një organizimi të tyre për të rritur efikasitetin sjell një konkurrueshmëri të ulët në treg si në krahasim me operatorët vendas ashtu edhe në eksport. Bashkimi i operatorëve në njësi të mirëfillta ekonomike që kanë qëllim uljen e kostove duke përdorur struktura të përbashkëta dhe rritjen e konkurrueshmërisë në treg është një zgjidhje alternative për të dalë nga një situatë në të cilën potenciali është i pashfrytëzuar akoma.

VI. Informaliteti

Shfrytëzimi individual dhe informal i tokës për bujqësi sjell në ulje të prodhueshmërisë, në ulje të të ardhurave të bashkësisë nga bujqësia me anë të taksave, në një pashfrytëzueshmëri të nevojave të eksportit si dhe në pamundësi të shfrytëzimit të politikave, qeveritare dhe jo, me anë të granteve dhe subvencioneve. Kujtojmë që subjektet duhet të jenë të regjistruar, të kenë një historik formal në aktivitetin bujqësor dhe të hartojnë një plan biznesi afat shkurtër/mesëm për të marrë pjesë në konkursin, qeveritar dhe jo, për shpërndarjen e granteve dhe shfrytëzimin e politikave subventive.

VII. Informacioni

Në kuadër të rritjes së sektorit të bujqësisë është e nevojshme një ndërhyrje informative në të gjitha nivelet. Këto duhet të kenë qëllimin e ndërgjegjësimit të operatorëve për një bashkëpunim të frytshëm me njëri-tjetrin por edhe atë të një orientimi nga ana e administratës të operatorëve duke i informuar mbi politikën mbështetëse në bujqësi, duke i ndihmuar në procesin e mbledhjes së informacionit, dhe në procesin e aplikimit për grante dhe subvencione.

3.5.3 Zhvillimi i Blegtorisë

Blegtoria përbën drejtimin tjetër kryesor (komplementar me bujqësinë) të zhvillimit ekonomik të bashkisë Vau Dejës. Fermerët sigurojnë të ardhura të konsiderueshme nga shitja e mishit si dhe nga qumështi dhe nënproduktet e tij.

Mbarështimi i bagëtive merr rëndësi për fermerët e rajonit pasi mishi dhe nënproduktet e qumështit, sidomos djathi i Zadrimës, janë dy nga shumë produktet blegtorale lokale të njohura tashmë në tregjet lokale dhe kombëtare. Mbarështimi i bagëtive ka interes për fermerët për shkak të kërkesave gjithnjë në rritje për mish vici. Në rajonin e Zadrimës kryesisht mbarështohen shpendët (ku mund të përmendet gjeli i detit) dhe gjedhët.

Në fshatrat e zonës së Zadrimës derri është kafshë shtëpiake mjaft e përhapur. Në rajon ka një traditë të mirë në rritjen e tyre të cilët përdoren për prodhim mishi. Në rajon ka disa komplekse të grumbullimit dhe shitjes së mishit si dhe linja të përpunimit të qumështit, të cilat ofrojnë kushtet të mira teknologjike dhe të higjenes.

Struktura e pasur e tokës (tokë arrë, pyje, kullota e livadhe etj.) në njësitë administrative të Bashkisë, kushtëzon edhe zhvillimin e blegtorisë. Mbarështimi i bagëtive përbën bashkë me bujqësinë aktivitetin kryesor ekonomik për popullatën lokale, sepse nga shitja e produkteve blegtorale si mish, qumështi, vezët dhe produktet e tjera sigurojnë të ardhura. Shitja e mishit dhe kërkesa në rritje përherë në treg e djathit (djathi i Zadrimës tashmë është i njohur në tregjet lokale dhe kombëtare) rrisin interesin e fermerëve për të mbarështuar bagëti. Zona është e njohur për mbarështimin e shpendëve, sidomos e gjelit të detit. 41% e numrit të shpendëve mbarështohen në Bushat. Edhe Vau-Dejës dhe Hajmel mbarështojnë numër të konsiderueshëm shpendësh. Te tre këto njësi administrative mbarështojnë pothuajse 70% të numrit total të shpendëve për Vaun e Dejës.

Tabela 36: Numri i krerëve në blegtori

Të imta		Gjedhë	Shpendë
Dele	Dhi		
14.478	15.224	16.748	202.400

Të dhënat e tabelës më sipër tregojnë numrin total të krerëve në Bashkinë Vau-Dejës. Cdo njësi administrative sipas vetive të terrenit, zë një peshë specifike në numrin total të krerëve. Bushat dhe Vau-Dejës përfaqësojnë territoret që kanë edhe numrin më të madh të krerëve për disa nga kategoritë.

Mbarështimi i dhive është karakteristikë e fshatrave të lokalizuar në zonë kodrinore-malore. Më shumë se gjysma e tyre (52% e numrit total të krerëve për bashki) mbarështohen në Temal dhe Vau-Dejës.

Pavarësisht potencialit të madh në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë që ka bashkia, ekzistojnë vështirësi që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm. Problem ende mbeten niveli i ulët i mekanizimit të bujqësisë, çmimet e larta të shërbimeve mekanike, numri i madh i parcelave, sipërfaqja e ulët e tyre, rregjimi i çrregullt i ujit që e ekspozon një pjesë të territorit ndaj pëmbytjeve. Forcimi i markës lokale të produkteve lokale mbetet një fushë për përpjekje në vazhdim.

Permbledhje

Duke marre shembull nga njësi administrative ne te cilat bujqesia eshte bere nje lokomotive e ekonomise eshte e nevojshme qe nderhyrja ne te gjitha hallkat e procesit te behet e shpejte dhe efikase.

Nderthurja e dy aktiviteve kryesore ekonomike ne bashkine Vau-Dejës, Bujqesia dhe Blegtoria, ben qe problematikat kryesore dhe nevoja per nderhyrje dhe përmiresim të strukturave dhe proceseve të ndryshëm të jenë edhe ato të ndërthurura.

3.5.4 Bletaria

Në zona të ndryshme të bashkisë Vau Dejës ka një traditë të hershme në zhvillimin e bletarisë, e cila karakterizohet nga një zhvillim i shpejtë i saj. Zhvillimi i bletarisë mbështetet nga kushtet e përshtatshme, florës së pasur dhe kullotave. Drurët pyjorë si pisha, vidhi, marja, frashëri, lisi, driza (ferrëkuqja), manaferra por edhe ato frutorë si kumbulla, qershia, molla, dardha, pjeshka, kajsia, hurma, ulliri dhe agrumet rrisin shëndetin e bletëve por edhe cilësinë konkurruese dhe kurative të mjaltit të kësaj zone.

Gjithashtu, ambjenti i pastër, shoqëruar me pasionin e njerëzve për t'u marrë me bletari i ka dhënë një shtysë zhvillimit të mëtejshëm të kësaj fushe. Në përgjithësi, ka një ambjent të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të bletarisë. Për më tepër, funksionojnë edhe shoqatat e bletarëve në Lezhë dhe Shkodër, të cilat u vijnë në ndihmë bletarëve, jo vetëm me anë të trajnimeve por edhe në luftimin e sëmundjeve të ndryshme të bletëve, prodhimin e produkteve për treg, dhe furnizimin me medikamente profilaktike dhe shëruese me çmime shumë më të ulta nga ato që shërbehen në farmaci.

3.5.5 Bimët mjeksore dhe aromatike

Bimët medicinale dhe aromatike janë një tjetër aset me rëndësi për sektorin e bujqësisë në këtë zonë. Të dhënat që ekzistojnë, kryesisht për njësinë administrative Bushat (në Malin e Kakarriqit), tregojnë që ka disa kompani që operojnë në grumbullimin e sherbelës, milcës, dëllinjës, tërfilit livadhor, trumzë, hidgra, mullagë murriz dhe verbenë. Këto bimë karakterizohen nga një cilësi mjaft e lartë, gjë që bën të jenë mjaft të kërkuara nga tregu.

Aktiviteti i mbledhjes dhe i tharrjes së bimëve mjekësore është i përhapur edhe në Zadrimë dhe përbën një nga drejtimet kryesore për gjenerimin e të ardhurave lokale, kryesisht për gratë. Në sajë të projekteve që COSPE , ka zbatuar ndër vite, ka bërë të mundur ndërtimin e kapaciteteve lokale për t'u marrë me këtë aktivitet. Rezultati final dhe i rëndësishëm i këtyre projekteve ka qënë krijimi i shoqatës “Malet Tona” që lindi si iniciativë për të ruajtur dhe mbrojtur interesat e grave që merren me këtë aktivitet si dhe për të ruajtur dhe përhapur eksperiencën që kanë në këtë fushë, për të nxitur dhe reklamuar bimët mjekësore jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë kufijve të saj.

Rritja e një numri të konsiderueshëm bimësh mjekësore favorizohet nga relievi, pozita gjeografike, karakteristikat e klimës dhe përbërja kimike e tokës. Nga bimët mjekësore dhe aromatike që rriten në zonën e Zadrimës mund të përmendim: sherebeli, lisna, trumza, shqemja (pyje të pamasë), mëllaga (e shumëllojshme), shqopa, dëllinja, ferra e gomarit (siç i thonë banorët) ose gjëmbaçi.

Po të krahasojmë fondin e tokës bujqësore para viteve '90 me fondin e tokës së mbjellur sot, kanë ndodhur ndryshime të mëdha të cilat nuk janë pasqyruar në librat dhe hartat kadastrale.

3.5.6 Sektori i Turizmit

Aktualisht turizmi është i sporadik dhe në nivelet minimale. Kryesisht është i zhvilluar në bashkinë Vau-Dejës përreth liqenit. Strukturat mikpritëse lenë për të dëshiruar dhe nuk ka një rrjet percjelles të turistëve që të shoqërojnë nga ftesa për të vizituar sitet dhe peisazhet natyrore deri në momentin e largimit të tyre.

Potenciali për turizmin natyror është i dukshëm dhe pjesërisht i pacenuar nga nderhyrjet informale të bera nga njeriu në dekadat e fundit. Nderthurja e burimeve hidrike dhe natyrore e bëjnë këtë vend të vecantë dhe shumë tërheqës.

Edhe pse turizmi është sektor që paraqet një gamë të gjerë problematikash, përfaqëson drejtim ekonomik të rëndësishëm aktualisht dhe me shumë potencial në të ardhmen. Bashkia Vau-Dejës ka potenciale të jashtëzakonshme për të nxitur zhvillimin e turizmit si një mundësi për rritjen ekonomike të popullatës lokale. Aktualisht, nuk mund të themi se ky sektor paraqet një drejtim të mirëfillt ekonomik, por ka gjasa që e ardhmja të jetë premtuese përse i përket përfshirjes së popullatës lokale në këtë sektor.

Potencialet për zhvillimin e turizmit lidhen më burimet e mëdha të zonës të cilat janë të shumëllojshme (historike, kulturore, natyrore, etj.). Forma të ndryshme të turizmit mund të aplikohen në Vaun e Dejës si turizmi historik, malor, agroturizmi, ujqor etj.

Territori i Bashkisë është i pasur me monumente historike të cilat mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Ndër to përmëndim: Kalaja e Danjës, Kalaja e Shurdhahut, Kalaja e Qytezës, Kalaja e Dalmacisë. Gjithashtu, ndodhen një sërë kishash të vjetra dhe objektesh fetare me shumë interes për t'u vizituar si: Katedralja e Shën Gjergj Sapës, e Nënë Terezës, kisha e Shën Markut, e Shën Marisë, e Shën Kollit, e Shën Rrokut, apo xhamia e Bushatit, Kosmacit, Melgushës etj. Zona është e njohur për figurat e shumta historike që kanë lënë gjurmë të paharrueshme në kujtesën historike të shqiptarëve të tillë si Lek Zaharia, Frang Bardhi, At Shtjefën Gjecovi, Dom Ndre Mjeda e shumë të tjerë.

Pejsazhet panoramike të tilla si kodrat dhe malet me një bukuri natyrore të veçantë, shëtitjet me varka në liqen apo plazhet buzë liqenit, fshatrat e vendosura në kodrat e bukura dhe të buta të zonës, ushqimet lokale bio dhe gatimet tradicionale e kthejnë Vaun e Dejës në një territor të përshtatshëm për agroturizëm. Bashkia paraqet një zonë të pasur etnografike. Etnografia e Zadrimës, Mirditës, Malësisë së Madhe dhe pjesa e qytetit janë pjesë e mozaikut të pasur të trashëgimisë kulturore, historike dhe shpirtërore të bashkisë.

Ne menyre spontane janë krijuar struktura të pa organizuara mirë për shërbime turistike si ajo e një kampingu Në Barbullush që vizitohet kryesisht nga të huaj. Keto zona mund të zhvillohen akoma me shumë duke shtuar dhe përmirësuar gjitha shërbimet dhe duke krijuar një koridor turistik për vizitorët që vijnë me rulot.

Ja vlen të përmenden keto destinacione tërheqëse për turizëm:

Kështjella e Danjës (Dagnum): ndodhet në rrafshirën sipërore të malit të Dejës. Në zonën e kalasë, ndodhet kisha e Shën Markut, shenjt i mbrojtës i këtij qyteti. Në derën e anës lindore ka të skalitur vitin 1455. Sipas relatorëve aty ka qenë një katedrale, pas shkatërrimit të së cilës është ngritur kisha ekzistuese në datën e skalitur. Poshtë, në pjesën e ultë të qytetit gjendet kisha e vogël e stilit gotik kushtuar lindjes së Zojës Mari. Historianët pohojnë se në këtë kishë ka vënë kurorë fetare Skënderbeu. Kisha ka pasur vlera të pallogaritshme artitektonike, historike dhe kulturore, edhe pse tani është e dëmtuar.

Kështjella e Shurdhahut (Sarda Sardum): ndodhet në një ishull të liqenit Vau-Dejës, afërsisht 10 milje nga diga e hidroçentralit nga veri lindja dhe 4 milje nga fshati Rragam në lindje. Aty ishte qyteti i vjetër Sarda i cili ka qenë një qendër e rëndësishme kulturore. Emri Shurdhah është emri i qytetit të vjetër ilir Sardis ku janë gjetur rrënojat e një kalaje të vjetër të shekullit 8-6 p.e.s. Sarda ka qenë një stacion pushimi në rrugën e vjetër të Dardanisë. Familja feudale e Dukagji- nëve kishte aty pallatin mbretëror. Kjo kështjellë ka luajtur një rol të rëndësishëm në teatrin e ngjarjeve që u zhvilluan gjatë epokës së Skënderbeut.

Kalaja e Qytezës ndodhet mbi Malin e Bardhë të Hajmelit. Kjo kala është ndërtuar me qëllimin për t'u mbrojtur nga pushtuesit turq.

Katedralja e Shën Gjergjit e Sapës: ndodhet në fshatin Nenshat të njesise administrative Hajmel. Ky objekt është i restau- ruar viteve të fundit pa iu dëmtuar autenticiteti. Sipas gojëdhënave katedralja është ndërtuar para fillimit të sulmeve invaduese të turqve, aty nga fundi i shekullit XIV. Ishte kishë katedrale por edhe famulltare. Katedralja është ngritur në një kodrinë shkëmbore që ka qenë rrethuar me mure mbrojtëse dhe fare pranë saj ndodhej selia ipeshkvnore.

Sipas eksperteve të arkeologjise dhe historianeve në zone nuk mungojnë kullat, kishat dhe ndertesat mesjetare, mbrojtja dhe rekuperimi i të cilave do ta bente zonën akoma më tërheqëse. Ia vlen të përmenden gjithashtu:

- Zona e mbrojtur arkeologjike e Komanit rreth 100 ha
- Shënkolli me tre kisha dhe dy ndertesë, ndarjet e mureve të të cilave janë me trina dhe suva në mes;
- Komani me dy kulla dhe ku vila franceze është tipike dhe i përshtatet si strukturë më mirë zone;
- Karma me disa kulla dhe kisha;

Drini dhe liqenet: një tjetër alternative për turizmin që ofron zonë është edhe mundësia për të lejuar lundrimin për qëllime turistike përgjatë Drinit dhe në liqenet e shumta të zonës. Aktualisht kjo gjë nuk është e mundur për arsye sigurie.

Nevoja për nderhyrje:

Infrastruktura rrugore

Është e nevojshme krijimi dhe mirëmbajtja e disa rrugëve aksesit për të mbërritur në zonat ku gjenden sitet arkeologjike si dhe kullat dhe kishat me vlerë historike dhe kulturore. Do të mjaftonte krijimi i shtigjeve të kalimit për të risjellë vizitorin në atmosferën e jetës që bënin banorët e zonës në kohën kur kjo zonë kishte kulmin e aktivitetit ekonomik dhe social..

Pyllezim

Zonë ka nevojë për pyllëzim pasi mungesa e kontrollit dhe keqpërdorimi i burimeve natyrore ka sjellë dëmtimin e një pjese të kurores së gjelbert të pishave.

Infrastruktura mikpritese

Për turizmin arkeologjik, agroturizmin si edhe atë natyror është e nevojshme mirëmbajtja e strukturave aktuale dhe ndërtimi i ndertesave me nderthurje të gurit dhe drurit për të mbajtur linjën historike dhe traditën vendase. Iniciativa e biznesit duhet të monitorohet në mënyrë që strukturat turistike të transmetojnë atë që ofron zonë: qetesinë, historinë, traditën dhe mikpritjen.

Trajnim i burimeve njerezore

Një vend shumë të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit e zënë burimet njerëzore. Do të ishte e nevojshme një rritje e sensibilizimit të operatorëve pjesëmarrës në turizëm që të rrisin cilësinë në shërbime duke pasur qëllim një zhvillim afatgjatë të përfitimeve.

Gjithashtu do ishte e nevojshme:

- Siguria për Turistin
- Sherbime shëndetsore me të shpeshta në zona turistike
- Me shumë kontroll atyre që ofrojnë sherbime Turistike
- Mos abuzim mbi cmimet në sezon Turistik
- Vazhdimësia e imazhit të Turizmit Autentik

3.5.7 Artizanati

Prodhimet artizanale përfaqësojnë një drejtim tjetër angazhimi ekonomik në zonë që përbërjnë një vlerë të shtuar për turizmin. Në këto aktivitete janë përfshirë gratë dhe vajzat. Punimet në tezgjah, ato të dorës dhe të qeramikës kanë rizgjuar traditën e vjetër të prodhimeve artizanale. Veshjet Zadrimore zënë një vend të rëndësishëm në këtë sektor për shkak të interesit në rritje të turistëve të huaj. Duke u nxitur nga kjo situatë një grup grash me ndihmën e shoqatës italiane COSPE formuan shoqatën "Gratë e Zadrimës". Anëtarët e kësaj shoqate zhvilluan prodhimin me tezgjah si carcafë ku dominojnë ngjyrat e kuqe dhe të verdha, mbulesa tavolinash ku mbizotërojnë ngjyrat e bardhë dhe e kuqe, si edhe mësalla me thekë dhe me kombinime shiritash ku mbizotëron ngjyra e kuqe.

Përveç punëve në tezgjah, viteve të fundit kanë marrë zhvillim edhe punimet e qeramikës në fshatin Krajën të njësisë administrative Blinisht. Edhe aty me ndihmën e një projekti të financuar nga qeveria italiane janë trajnuar dhe punojnë dy grupe punonjësish të talentuar që prodhojnë poce dekorativë për lule, kotrova, broke me zbukurime të larmishme dhe motive tradicionale zadrimore.

3.5.8 Të ardhurat e Bashkisë

Struktura e mëposhtme evidenton tendencën pozitive në të dy kategoritë e biznesit (i vogël dhe i madh). Referuar të dhënave mbi strukturën e bizneseve rezulton se biznesi i vogël në vitin 2011 përbën 86% të kësaj strukture ndërkohë që biznesi i madh përbën 14%. Në periudhën 2014-2016, të dhënat e disponueshme dhe parashikimet mbi fluksin e regjistrimeve të reja raportojnë për një strukturë biznesesh e cila do të dominohet në masën 79-80% nga bizneset e vogla dhe 20-21% nga bizneset e mëdha. Kjo tendencë argumenton një trend rritës mesatar prej 6-8% në periudhën 2017-2019. Në raport me shpërndarjen gjeografike të tyre, prezenca më e madhe konstatohet në njesitë Bushat dhe Vau-Dejës.

Struktura e Bizneseve




Fig. 71: Struktura e bizneseve (sipas numrit)

Referuar kontributit monetar të tyre në strukturën e të ardhurave në buxhet, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore kanë ardhur duke u rritur jo vetëm ndikuar nga zgjerimi aktivitetit tregtar por edhe nga përmirësimi i instrumenteve të manaxhimit të tyre. Megjithë zgjerimin e kapaciteteve fiskale, ndikimi i transfertave të buxhetit qendror në buxhet ende do të vazhdojë sakohë që financimi investimeve kapitale është parashikuar në funksion të fondeve buxhetore nga ky burim. Në figurën më poshtë treguesit financiarë vijnë të ndarë në blloqe me qëllim evidentimin e peshës specifike të sejcilit burim të ardhurash në buxhet.

Tabela 37: Përmbledhëse e të ardhurave në buxhet sipas burimit (%)

Të ardhurat sipas natyrës	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhurat sipas burimit							
Të ardhura vendore/totali	37	24	15	23	19	18	16
Taksat Vendore	35	21	7	15	13	11	10
Tarifat Vendore	1	2	5	6	5	6	5
Të tjera	1	1	3	2	1	1	1
Transferta/totalit	63	76	85	77	81	82	84
Transferta e Pakushtëzuar	19	9	13	14	12	11	10
Grant Konkruues	44	68	72	64	69	71	74
Totali	100	100	100	100	100	100	100

Mbështetur në këta tregues, pavarësisht rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në periudhën afatmesme, struktura buxhetore buxhetore në periudhën 2014-2016 vazhdon të dominohet nga fondet e buxhetit qendror të cilat janë përmes transfertës së pakushtëzuar dhe fondet nga fondi zhvillimit të rajoneve përmes skemës së granteve konkruuese. Rënia e peshës specifike të të ardhurave të veta të bashkisë në periudhën 2013-2015 nuk reflekton aspakt rënien e treguesve në vlera financiare por, zgjerimin e kapacitetit buxhetor nga transfertat. Një tjetër komponent shumë i rëndësishëm i strukturës buxhetore vlerësohen të ardhurat nga granti konkruues të cilat në vitet 2009 – 2015 përbëjnë 44-74% të totalit të buxhetit të parashikuar dhe të

realizuar. Si burime financiare të konsideruara brenda tavaneve buxhetore, transfertat në buxhet zënë pjesën kryesore duke rritur vit pas viti peshën specifike në varësi të mjeteve monetare të parashikuara në financimin e projekteve sipas prioriteteve.




Fig. 72: Pësia specifike e të ardhurave në buxhet (%)

Parë në këtë këndvështrim, të ardhurat e veta të bashkisë në periudhën 2013-2015 reflektojnë një tendencë rritje shume të ulët.

3.5.8.1 Tarifat Vendore

Të ardhurat nga tarifat vendore janë një tjetër burim i konsiderueshëm të ardhurash në buxhet. Natyra e aplikimit dhe përdorimit të tyre lidhet me dy kategori shërbimesh: publike dhe administrative. Në kontekstin e shërbimeve publike, tarifat e aplikuara në njesite administrative janë si më poshtë:

- tarifë për pastrimin dhe largimin e mbeturinave për kategoritë biznese dhe familje
- tarifë për parkimin e automjeteve
- tarifë për gjelbërimin e aplikuar vetëm në vitin 2011
- tarifë për ujin e pijshëm

Profili tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave është ndërtuar duke konsideruar të gjithë grupet taksapaguese sipas kategorizimit të bërë në paketën fiskale dhe përcaktimit të detyrimit analitik për secilën kategori. Krahasuar me nivelin e shpenzimeve të alokuara në vite dhe të parashikuara në periudhën buxhetore afatmesme, mbulimi shpenzimeve të shërbimeve publike të ofruara ndikohet nga niveli tarifave të aplikuara kryesisht për biznesin e vogël. Për disa vite mbështetur në ligjin 10117 datë 23.04.2009, neni 32 pika 1.b dhe neni 33 ku shprehimisht thuhet: "masa e taksave me karakter të përkohshëm, së bashku me taksat dhe tarifat e aplikueshme, nuk duhet të kalojë kufirin +10% të nivelit tregues të taksës së biznesit të vogël, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të këtij biznesi", mbulimi shpenzimeve të shërbimeve përmes tarifave të aplikuara mbetet larg pritshmërive. Me ndryshimin e ligjit ndonëse është bërë progres në drejtim të shpërndarjes së tarifës për kategoritë "familje" dhe

”biznese të mëdha” ende, të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e pastrimit nuk mbulojnë pjesën e shpenzimeve të shërbimit, e akoma më tej asnjë prej politikave për investime. Në një dinamikë paksa më delikate paraqitet edhe situata për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm ku të ardhurat nga tarifa për këtë shërbim, ndonëse rritur me 4 herë në vitet 2012-2015 mbulojnë nivele minimale të sigurimit të shërbimit.

Tabela 38: Raporti tarifave/strukturës së të ardhurave të veta (000/lek)

Emërtimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Totali te ardhurave te veta	150177	195442	82560	116912	117293	126825	129047
Tarifa	4150	12873	20856	25230	25283	31774	32411
Tarifa/totalit të veta (%-je)	3	7	25	22	22	25	25

Sikurse shihet nga të dhënat më sipër, volumi të ardhurave nga tarifat e shërbimeve të aplikuara në Bashki ka pësuar një rritje me 3 herë në vitin 2010 ndërkohë që pesha specifike e tyre në vitin 2009 dhe 2010 e kategorizon këtë grup të ardhurash si të ”ardhura modeste” në buxhetin respektiv. Të ardhurat e vitit 2009 janë influencuar edhe nga aplikimi i ligjit 10117 datë 23.04.2009 ku riorganizimi skemës së detyrimeve për subjektet e biznesit të vogël ishte i detyrueshëm. Në vitin 2011, të ardhurat nga tarifat vendore janë rritur me 62% ku kontributi të ardhurave nga viti 2011 (të ardhura të mbartura nga riorganizimi skemës së detyrimit për këtë tarifë për subjektet e biznesit të vogël) është reflektuar. Në tre vitet e fundit vihet re një rritje konstante si ne vlerë ashtu edhe ne peshën specifike mbi të ardhurat e përgjithshme.

Tabela 39: Struktura e të ardhurave kryesore për tarifat vendore (000/lek)

Tarifat Vendore	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifa për pastrim	2188	7981	9273	15561	15592	15903	16221
Tarifa ujit të pijshëm	178	698	1640	6517	6530	6661	6794
Tarifë gjelbërimi	-	-	6236	-	-	-	-
Tarifa për Reklamë	427	975	802	931	932	951	971
Tarifa parkimi	-	-	-	1330	1333	1359	1389
Tarifa të tjera	1357	3216	2905	891	896	6900	7037
Total	4150	12873	20856	25230	25283	31774	32411

3.5.8.2 Shpenzimet

Struktura e shpenzimeve ndërton mbi nivelin e të ardhurave të parashikuara mbështetur në kuadrin ligjor si ligjin Nr. 9936 date 26,6,2008 “ *Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise*” te ndryshuar, ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “*Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar si dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave për sistemin buxhetor dhe buxhetin vendor. Bazuar ne ligjet respektive te buxhetit te shtetit në vlerësimin e shpenzimeve janë respektuar të gjithë kërkesat ligjore për alokimin e jo më shumë se 30% të transfertës së pakushtëzuar për financimin e kostove të personelit administrativ të Bashkise si dhe alokimi në masën 10% të transfertës së pakushtëzuar për financimin e pemtarisë dhe gjelbërimit. Parë në harmoni me financimin e aktivitetit ekonomik të programeve buxhetore,

struktura e shpenzimeve është vlerësuar në raport me kërkesat buxhetore të ekipeve të manaxhimit të programeve për financimin e shpenzimeve administrative dhe operative si dhe financimin e aktiviteteve dhe produkteve konkrete brenda spektrit të programeve buxhetore të formuluar dhe të lidhura ngushtësisht me qëllimet dhe objektivat strategjik të miratuar. Në kuadër logjik, qëllimet strategjike janë tashmë pjesë e politikës së programeve buxhetore ndërkohë që objektivat strategjik janë qëllime të politikës së programeve buxhetore të miratuara. Struktura buxhetore programore “merr përsipër” mbulimin me financim të secilit prej programeve të miratuara jo vetëm në kuadrin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes por edhe të financimit të projekteve dhe aktiviteteve konkrete të programuara.

Konkretisht, sipas klasifikimit ekonomik, struktura e shpenzimeve në vite është si më poshtë:




Fig. 73: Struktura e shpenzimeve në vite sipas klasifikimit ekonomik (%-je)

Sikurse shihet, nga grafiku më sipër, struktura e shpenzimeve shkon në favor të financimit të projekteve kapitale duke ulur peshën specifike me 4% në vitin 2013 në raport me vitin 2012, me 2% në vitin 2014 dhe 2015 dhe me 1% në 2016. Rënia e peshës specifike të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes lidhet me volumin në rritje të parashikuar për shpenzimet kapitale nga grantet konkurruese.

Mbështetur në shpërndarjen e shpenzimeve të programeve, politikat e investimeve në Bashki janë bazuar në nevojat lokale duke vendosur një ekuilibër midis projekteve të parashikuara në Planin Strategjik dhe në planin e shpenzimeve të programeve në periudhën afatmesme – afatgjatë. Në periudhën 2013-2015, shpërndarja e shpenzimeve kapitale është parë e lidhur ngushtë me projektet kapitale të parashikuara. Bazuar në këtë kuadër, në periudhën afatmesme (2013-2015) çdo program është mbështetur me shpenzime kapitale (grant konkurrues dhe të ardhura vendore kapitale) në terma të projekteve kapitale të planifikuara në listën e produkteve të programeve buxhetore. Sipas kësaj logjike, pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale në vitin 2013 është realizuar për të mbështetur produktet e programit arsimit, kultura, sporti dhe kujdesi social dhe menaxhimin e infrastrukturës dhe planifikimi

territorit ndërkohë që në vitin 2014 pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale është realizuar për të mbështetur produktet e programit të menaxhimit të infrastrukturës dhe planifikimit të territorit dhe sistemit të ujësjellës kanalizimeve. Në vitin 2015, projektet prioritare janë parë të lidhura ngushtë me programin e menaxhimit të shërbimeve publike dhe mjedisit dhe programit të ujësjellës kanalizimeve. Pra, sikurse shprehet në këtë tabelë, struktura e shpenzimeve i mëshon fort dy programeve buxhetore: programit të menaxhimit të infrastrukturës dhe planifikimit të territorit dhe programit të administratës së përgjithëshme (planifikim, menaxhim, administrim).

3.5.9 Problemet sociale, kriminaliteti dhe marginalizimi

Kriminaliteti është një dukuri mjaft problematike për shoqërinë shqiptare dhe si i tillë reflektohet edhe në bashkinë Vau Dejës. Faktorët nxitës të kriminalitetit në moshat e reja duket se janë më shumë të natyrës individuale dhe familjare. Tek të rinjtë rolin nxitës e marrin faktorët socialë, të grupit ku ata bëjnë pjesë dhe për rrjedhojë shumë nga sjelljet kriminale janë të fituara / të mësuara. Ndër shkaqet kryesore mund të përmendim:

- papunësia dhe niveli i lartë i varfërisë;
- komunitet me sjellje antisociale;
- prindër që abuzojnë me alkoolin dhe me probleme të shëndetit mendor;
- praktika të varfëra prindërimi që karakterizohen nga mungesa e kujdesit të nevojshëm apo mungesa e përforsimeve pozitive në sjelljen e fëmijës;
- ekzistenca e formave të dhunës fizike dhe histori të dhunës në familje;
- familje me përmasa të mëdha (me shumë anëtarë ku mungon vëmendje për anëtarë të rinj të familjes).

Në zbatim të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", bashkia Vau Dejës bën pjesë në rrethin gjyqësor të Shkodrës. Si rrjedhim, të dhënat statistikore që tregojnë nivelin e kriminalitetit janë në nivel rrethi gjyqësor pasi, duke konsideruar dhe sensitivitetin e tyre, është e vështirë të aksesohen të dhëna ekzakte për bashkinë Vau Dejës.

Nje nga mënyrat e matjes së shpërndarjes së tij është me anë të koeficientit të kriminalitetit. Koeficienti i kriminalitetit është një parametër që mat kriminalitetin në një mjedis të caktuar në raport me popullsinë e atij mjedisi, pra tregon shkallën e konsumimit të veprave penale (krimeve ose kundërvajtjeve), duke e vendosur këtë të dhënë përballë numrit të personave. Si rregull ai shpreh numrin e krimeve për 100.000 banorë. Nga studimi i kryer për të dhënat e çështjeve penale të përfunduara (krime dhe vepra penale në tërësi), rezulton që për vitin 2015 në shkallë vendi kemi 156 krime për 100.000 banorë. (Vjetari Statistikor 2015, Ministria e Drejtësisë).

Ky koeficient, bën që bashkia Vau Dejës, në shkallë vendi, të klasifikohet në grupin e dytë, pra në bashkitë me koeficient kriminaliteti të përafërt me mesataren e vendit 100-156 krime për 100 000 banorë.

Grupet e marginalizuara

Përsa i përket grupeve të marginalizuara përkufizimet për to janë të shumta. Megjithatë, shumica e të anketuarve në lidhje me këtë temë, klasifikojnë si grupe të marginalizuara, personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, romët dhe të papunët si vulnerabël për shkak të nivelit të lartë të varfërisë; si dhe gratë dhe personat me aftësi të kufizuara si vulnerabël kundrejt rrezikut të përjashtimit social.

Familjet me kryefamiljare femra përgjithësisht janë më të varfra, dhe ato përfaqësojnë 11.3% të numrit të përgjithshëm të familjeve, që korrespondon me të njëjtën përqindje familjesh që trajtohen me asistencë sociale. Përveç kufizimeve të konsumit dhe të të ardhurave, ato përballen gjithashtu me pengesa të tjera në tregun e punës për shkak të përgjegjësisë për kujdesin dhe rritjen e fëmijëve, si dhe të detyrave të tjera në familje, të cilat janë tipike për gratë. Analiza e të dhënave identifikon aspekte të ndryshme që i vendosin gratë kryefamilja në një grup vulnerabël dhe në një situatë mjaft vështirë.

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) përbëjnë një shtresë tjetër të marginalizuar në bashkinë Vau Dejës. Nga mungesa e strukturave shtetërore që trajtojnë këtë grup konstatohet që nuk ka akoma të dhëna të qarta mbi numrin dhe problematikat e tyre. Ato shpesh herë mbahen dhe trajtohen nga familjarët e tyre në kushte shtëpiake. Miratimi i ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, është një hap i rëndësishëm në aspektin ligjor por i zbatuar shumë pak në bashkinë Vau Dejës. Ndër problematikat kryesore mund të përmendim:

- mungesën e përshtatshmërisë në ambientet publike dhe private,
- mungesën e aksesit në transportin urban publik dhe mosrimbursimin e biletës, moszbatimin e dispozitave ligjore për punësimin,
- mungesën e aksesit në arsimin publik të fëmijëve me aftësi të kufizuara,
- mungesën e statistikave për personat me sëmundje të rënda mendore,
- mosnëgritjen e qendrave rehabilituese rezidenciale për personat me sëmundje të rënda mendore.

Një gjendje e tillë bën që personat me aftësi të kufizuara përballen me kufizime ekonomike dhe sociale, duke i vendosur ata në një pozitë mjaft vulnerabël. Disa prej tyre përballen me vështirësi ekonomike, sepse nuk përfshihen në tregun e punës dhe mbështeten vetëm tek përfitimet për PAK ose ndonjëherë nënvlerësohen dhe nuk u jepen këto përfitime. Në rastet kur janë të aftë për punë, ata mund të përjashtohen për shkak të diskriminimit ose sepse vendet e punës nuk i favorizojnë nevojat e tyre të veçanta. E njëjta gjë qëndron në arsim, ku individët me aftësi të kufizuara mund të mos mbështeten për nevojat e tyre të veçanta për sa i përket arsimimit, duke ulur kështu nivelin e tyre të pjesëmarrjes në sistemin arsimor ose duke mos u ofruar atyre arsimim cilësor. Kjo gjë, nga ana tjetër kufizon pjesëmarrjen e tyre në të ardhmen në tregun e punës dhe punësimin e tyre.

Mosha e tretë. Të moshuarit ndeshen shpesh me barriera shoqërore që ndikojnë mjaft në jetën e tyre. Gjithmonë e më shumë të moshuar jetojnë të vetmuar, ndërkohë që gjendja ekonomike e tyre është më e rëndë se pjesa tjetër e shoqërisë. Masa e pensioneve të pleqërisë është shumë e ulët dhe nuk garanton mirëqënien e tyre.

Në korrik të vitit 2014 në fshatin Barbullush në njësinë administrative të Bushatit, është hapur Qendra e të Moshuarve, një investim i ish-komunës në bashkëpunim me Fondacionin Max në Hollandë, i cili prej disa vitesh është vendosur në këtë zonë duke dhënë kontribut kryesisht për njerëzit në nevojë. Aktualisht kjo qendër punon me kapacitet të plotë për 25 të moshuar.

Varfëria, punësimi dhe arsimi konsiderohen çështje të rëndësishme për tu ndjekur gjatë vëzhgimit të ecurisë së procesit të përfshirjes sociale të këtyre grupeve.

Zonat e marginalizuara

Bashkia Vau-Dejës paraqet shtrirje jo-uniforme të shërbimeve publike si edukimi, shëndetësia dhe aktivitete të jetës sociale, kulturore dhe sportive. Bazuar në dinamikën e lëvizjes së popullsisë për të siguruar këto shërbime bazë qyteti Vau-Dejës përbën qendrën e jetës komunitare për gjithë njësitet administrative të bashkisë. Shtrirja jouniforme e shërbimeve bazë ka krijuar:

- komunitete lokale të marginalizuara (veçanërisht në njësitet Vig-Mnelë, Temal e Shllak);
- presion të rritur në Vau-Dejës dhe Bushat për të ofruar shërbime që tejkalojnë mundësitë.

Njësitet administrative të Temalit dhe Shllakut, duke u gjendur në anën tjetër të liqenit të Vau-Dejës, ndodhen të veçuara me pjesën tjetër të bashkisë. Për më tepër që lidhja historike me njësitet e tjera të bashkisë së re nuk ka qenë e fortë.

Përsa i përket shërbimeve bazë si edukimi, shëndetësia, aktivitetet social - kulturore dhe atyre sportive, lëvizja e popullsisë për të aksesuar ato është e orientuar drejt dy qendrave më të mëdha të bashkisë: Vau-Dejës dhe Bushat. Njësitet administrative të Temalit, Shllakut, Vig-Mnelë nuk kanë shkollë të mesme, ndaj të rinjtë udhëtojnë drejt qendrave për arsimimin e mesëm.

3.5.10 Papunësia dhe përkrahja sociale

Nisur nga burimet e të ardhurave të njësive ekonomike familjare, bashkia e Vau-Dejës karakterizohet nga një përqindje e lartë e ndihmës sociale dhe remitancave. Indeksi për këto tregues është 20.8% për ndihmën sociale dhe 8.9% për remitancat.

Nga skema e asistencës sociale trajtohen rreth 1,559 familje, nga 13,656 familje që ka bashkia. Ky numër familjesh përbën 11% të totalit të familjeve. Njësia Vig-Mnelë ka përqindjen më të lartë të popullsisë të përfshirë në këtë skemë, 61% e familjeve, pra më shumë se gjysma e familjeve burimin kryesor të të ardhurave kanë asistencën sociale. Edhe njësitet malore, Temal dhe Shllak, konstatohen përqindje të larta të familjeve të përfshirë në skemën e ndihmës sociale.

Tabela 40: Numri i familjeve me asistencë sociale

Njësia administrative	Nr. familje ne total	Nr. familje me asistencë	Familje me asistence (në %)
Bushat	6045	223	3.7%
Vig-Mnelë	429	261	60.8%
Temal	630	272	43.2%
Shllak	624	267	42.8%
Hajmel	2133	188	8.8%
Vau Dejës	3815	348	9.1
Total	13656	1559	11.5%

Edhe pse treguesit e karakterizojnë popullsinë e bashkisë me një forcë punëtore të konsiderueshme dhe me moshë të re, papunësia realisht përbën një nga problemet kryesore për popullatën vendase. Shkalla e papunësisë për bashkinë paraqitet shumë më e lartë se mesatarja e papunësisë për vendin tonë. Saktësisht, për bashkinë Vau-Dejës, indeksi i papunësisë është 43.9% , kur mesatarja për vendin për këtë tregues është 29.2%. Ngjashëm paraqitet edhe indeksi i papunësisë për të rinjtë (mosha 15-24 vjeç), 65.9% dhe për femrat 53.7%. Këto indekse janë shumë më të larta se mesatarja e vendit.

Papunësia e lartë shpjegohet edhe nga numri i ulët i bizneseve dhe rrjedhimisht edhe numri i bizneseve për banorë në disa nga njësitë vendore të bashkisë. Në total, operojnë rreth 388 biznese, 60% e të cilave operon në njësinë e Bushatit dhe 30% në Vau-Dejës. Pjesa tjetër e territorit përmbledh 10% të bizneseve. Në Shllak ka vetëm 2 biznese dhe Temal 3. Numrin më të lartë të bizneseve për 1000 banorë e ka Bushati, ndërsa numrin më të vogël, njësia Shllak.

Konstatohet që numri i emigrantëve të kthyer gjatë vitit 2001-2011 është i lartë dhe arrin në 1,502 persona. Pavarsisht se të kthyer me ide për t'u integruar në tregun e punës dhe me mundësi financiare ato shpesh herë nuk kanë gjetur ambjentin e duhur për të investuar kursimet e tyre.

3.5.11 Edukimi dhe aktivitetet social - kulturore e sportive

Përsa i përket shërbimeve bazë si edukimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive lëvizja e popullsisë për të aksesuar ato është e orientuar drejt dy qendrave më të mëdha të bashkisë: Vau-Dejës dhe Bushat. Vau-Dejës ka dy shkolla të mesme ndërsa në Bushat tre, duke përfshirë këtu edhe një shkollë të mesme profesionale. Të rinjtë nga Temali, Shllaku dhe Vig-Mnela udhëtojnë drejt këtyre shkollave, për shkak të mungesës së shkollave të mesme në këto njësi.

Shkolla e mesme profesionale “Ndre Mjeda”, Bushat, një shkollë kombëtare e çelur më 2013 përbën një vlerë të shtuar për zhvillimin ekonomik të territorit, veçanërisht bujqësisë. Shkolla ofron arsimim dhe formim profesional në veterinari, teknologji ushqimore, bujqësi, ekonomi bujqësore. Edhe pse e çelur rishtas, kjo shkollë ka një traditë të konsoliduar në edukimin bujqësor, duke qenë se fillesat e kësaj shkollë

datojnë herët, që në 1972 kur shërbente si shkolla e Mekanikës bujqësore për rajonin e veriut.



Fig. 74: Pamje e Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”

Megjithatë, kontributi i kësaj shkolle shihet ngushtë edhe me integrimin e të rinjve në tregun e punës. Arsimi profesional krijon mundësira dhe perspektiva të sigurt punësimi për të rinjtë, duke qenë se drejtimet edukuese dhe kualifikuese të shkollës përputhen me drejtimet kryesore ekonomike të zonës, por përgjithësisht edhe të vendit tonë. Realisht, në zonat suburbane dhe rurale të vendit tonë ka kërkesë të lartë të tregut të punës për këto lloj profilesh. Për të stimuluar të rinjtë për t'u arsimuar në këtë shkollë, ofrohen edhe disa incentiva të tilla si: akomodimi falas në konvikt, shkollim me kohë të pjesshëm dhe të plotë etj. Shkolla synon zhvillimin e personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u punësuar apo vetëpunësuar në profesionin që ata kanë zgjedhur.

Shkolla e mesme profesionale bujqësore në Bushat ka një kontribut domethënës në integrimin e të rinjve në tregun e punës. Arsimi profesional krijon mundësira dhe perspektiva të sigurt punësimi për të rinjtë, duke qenë se drejtimet edukuese dhe kualifikuese të shkollës përputhen me drejtimet kryesore ekonomike të zonës, por përgjithësisht edhe të vendit tonë.



Fig. 75: Shkollë e Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”

Përsa i përket shkollave 9 vjeçare ato nuk paraqesin problem në lidhje me shpërndarjen e tyre në territor, por në lidhje me infrastrukturën fizike e cila në disa raste vlerësohet si emergjente për ndërhyrje. Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shkollat e kopshte, ku prioritet mbetet ngrohja, është transporti i nxënësve nga zonat e largëta dhe lirimi i hapësirave publike në oborret e shkollave të cilat mbeten si çështjet më kritike për t'u adresuar.

Tabela 41: Numri i infrastrukturave arsimore dhe shëndetsore në bashki

Njësitë administrative	Shkolla të mesme	Shkolla 9-veçare	Kopshte	Qendra shëndetsore/ambulanca	Qendra kulturore/sociale	Terrene sportive
Bushat	3	11	14	12	1	2
Vig Mnelë	0	4	1	0	0	0
Temal	0	5	0	3	0	0
Shllak	0	4	0	2	0	1
Hajmel	2	6	4	5	0	0
Vau-Dejes	2	7	5	8	2	0
Total	7	37	24	30	3	3

Objektet kulturore, sociale të nevojshme për të ofruar shërbime sociale për grupe të ndryshme për popullatën lokale janë shumë të kufizuara në numër dhe ato pak janë të përqendruara në Vau-Dejës (një qendër kulturore dhe një sociale) si dhe Bushat (një qendër sociale). Terrenet sportive janë të përqendruar në Bushat dhe Shllak. Numri i kufizuar i objekteve sociale, kulturore dhe sportive tregon për jetë jo shumë të pasur social kulturore. Sa më larg i largohesh qendrës (Vau-Dejës, Bushat) aq më të përjashtuar nga ana sociale janë banorët e njësive Temal, Shllak, Vig - Mnelë. Kjo situatë thërret për përpjekje të cilat do të rrisnin aksesin e popullatës së zonave

periferike të bashkisë Vau-Dejës në jetën sociale, kulturore dhe sportive të bashkisë ku ata bëjnë pjesë. Paralelisht, duhet punuar edhe për pasurimin e jetës sociale, kulturore dhe sportive në pjesën qendrore të bashkisë.

3.5.12 Shërbimi shëndetsor

Shërbimi spitalor në bashkinë Vau Dejës mbulohet nga Spitali Rajonal i Shkodrës, pasi në bashki nuk ekziston një strukturë e tillë. Duke vlerësuar dhe pozicionin gjeografik të njësive administrative, infrastrukturën rrugore dhe afërsinë me qytetin e Shkodrës problemi kryesor për mbulimin me këtë shërbim ngelen njësitë Temal dhe Shllak. Problemet e urgjencave kryesisht trajtohen në qendrat shëndetsore, dhe në disa raste dhe me mjek privat që ndodhen në zonë.

Në bashkinë Vau Dejës shërbimi shëndetësor ofrohet nga 30 qendra shëndetësore dhe ambulanca të shpërndara sipas njësive administrative. Në tabelën më sipër jepet shpërndarja qendrave shëndetsore për secilën njësi administrative.

Siç konstatohet dhe nga të dhënat, shtrirja e këtij shërbimi është jo-unifrome, e përqendruar kryesisht në njësitë Bushat dhe Vau Dejës dhe situata më problematike shfaqet në njësinë Vig Mnelë ku nuk ka asnjë qendër shëndetsore funksionale.

Duhet theksuar fakti, që edhe aty ku ndodhen, qendrat shëndetsore shpesh herë janë në gjendje mjaft të amortizuar dhe nuk plotësojnë kushtet nevojshme për trajtimin e pacientëve. Rasti tipik është ai i Qendrës Shëndetsore në Vau Dejës e ndërtuar në vitin 1999 për t'ju ardhur në ndihmë shumë kosovarëve gjatë periudhës së luftës atje.

Sot, pas rreth 17 vitesh, kjo qendër shëndetësore llogaritet t'ju shërbejë rreth 6500 banorëve por në mungesë mirëmbajtje dhe investimesh, objekti ka filluar të degradojë dhe kushtet aty janë mjaft të rënda.



Fig. 76: Pamje nga Qendra shëndetsore Vau Dejës

Në një situatë të tillë, përfaqësuesit e bashkisë Vau Dejës kanë bërë disa herë kërkesë për fonde për të ngritur një poliklinikë të re apo spital ditor që plotëson standardet e shërbimit, por akoma nuk kemi ndonjë përgjigje konkrete në këtë drejtim nga Ministria e Shëndetësisë.

Në krahasim me njësitë e tjera, në njësinë administrative Bushat, mbulimi me shërbim shëndetsor rezulton në gjendjen më të mirë. Aktualisht shërbimi shëndetësor sigurohet përmes 10 qendrave shëndetësore, në fshatrat Bushat, Rranxa, Melgushë, Stajkë, Kosmaç, Barbullush, Mali i Jushit, Shkjezë, Ashtë dhe Hoten. Numri i mjekëve që shërbejnë në këto qendra gjithsej është 8 ndërsa i infermiereve është 38, pra në këtë njësi shërbimi mjekësor mundësohet nga 1 mjek për 2977 banorë. Ky standard është 3.4 herë më i ulët nga standardi kombëtar dhe referuar standardeve ndërkombëtare raporti numër mjekësh për 1000 banorë në njësinë Bushat është 10 herë më i vogël nga standardi i BE. Gjithashtu vlen të theksohet që edhe në njësinë Bushat mungojnë qendrat shëndetësore në 4 fshatra: Plezhë, Plepan, Fshat i Ri dhe Kukël, numri i banorëve i të cilëve është brenda intervalit të numrit të banorëve për të cilët planifikohet një qendër shëndetësore.

Bazuar në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, qendrat e banuara me popullsi nga 20 000 në 40 000 banorë duhet të shërbehen nga një spital ditor. Meqënëse popullsia aktuale e bashkisë Vau Dejës e kalon këtë interval, ndërtimi i një spitali ditor është i domosdoshëm për të rritur cilësinë e shërbimit shëndetësor.

Përsa i përket këtij sektori, në bashki nuk ekziston një bazë të dhënash e mirëfilltë dhe gjetjet kryesore janë bërë nga komunikimi i drejt për drejtë me banorë dhe stafe të qendrave shëndetsore. Ndër pikat e dobëta të shërbimit të qendrave shëndetësore të cilat kërkojnë vëmendje dhe investime serioze, evidentojmë:

- Përshtatshmëria e qendrave për pacientët me aftësi të kufizuara;
- Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë e informacionit (sistemet telefonike, kompjuterike, dhe të internetit);
- Rritja e numrit të mjekëve dhe infermiereve që shërbejnë në këto qendra;
- Sigurimi i auto-ambulancave që mbulojnë shërbimin në territorin e bashkisë;
- Rritja e orareve të shërbimit në qendrat shëndetsore;
- Krijimi i një baze të dhënash elektronike që do përmirësojë shërbimin dhe do sigurojë një komunikim të qëndrueshëm midis pacientëve dhe personelit mjekësor;
- Në qendrat shëndetsore kryesore të sigurohet seti pajisjeve të lindjes për të ndërhyrë në rast urgjence ose gjatë transportimit të gruas shtatëzënë nga zonat rurale në spitalin e qytetit më të afërt.
- Në lidhje me përmirësimin e këtyre sistemeve, investimi nuk duhet të jetë vetëm mbështetje teknike por edhe investim në trajnimin e duhur të personelit mjekësor e infermior.

Duke qenë një sektor kryesisht i varur nga qeverisja në nivel qendror, bashkia në mënyrë të vazhdueshme duhet rrisë presionin për investime por njëkohësisht duhet të luaj edhe një rol aktiv përsa i përket infrastrukturës së nevojshme që siguron energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë (ujë të grohtë dhe të ftohtë) që janë dy elementë të varura totalisht nga pushteti lokal. Për funksionimin e duhur të qendrave shëndetësore kërkojnë gjeneratorë, sidomos për qendrat shëndetësore në zona të thella rurale. Energjia elektrike dhe ujë janë dy elementë që kur sigurohen siç duhet, ofrojnë mundësi

të mëdha për të përmirësuar dhe zgjeruar shërbimet në një qendër shëndetësore. Ky investim, padyshim sjell përmirësimin e komponentëve të tjerë në lidhje me infrastrukturën siç është ngrohja e ftohja e mjediseve, mbajtja e medikamenteve në mjedis me temperaturë të përshtatshme.

Kontribut të rëndësishëm përsa i përket shërbimit shëndetsor luajnë dhe organizma apo qendra me karakter misionar dhe kishtar të instaluar në territorin e bashkisë Vau Dejës 15-20 vitet e fundit

Në njësinë administrative Bushat, në ndihmë të PAK, funksionon Shtëpia Rregulltare e Bashkësisë Misionaret e Dashurisë (Vëllezërit e Nënë Terezës). Kjo qendër ka si qëllim t'u vijë në ndihmë personave me probleme fizike dhe mendore nga Bushati dhe zonat përreth, pjesa më e madhe e të cilëve janë të braktisur. Por ka edhe persona të tjerë që vijnë nga familje shumë të varfra që nuk kanë mundësi për t'i mbajtur këta persona pasi janë në gjendje të rëndë shëndetësore.

Aktualisht në sistemin rezidencial ofrohet kujdes për 25 pacientë që jetojnë aty, shumica me autizëm dhe të paralizuar. Kujdesi ofrohet për djem dhe burra, të cilët i përkasin grup-moshës 15 – 60 vjeç. Një herë në javë ofrohet fizioterapi dhe 3 – 4 herë në javë ergoterapi. Në mënyrë periodike misionarët e kësaj qendre vizitojnë të sëmurët në shtëpitë e tyre ose kudo që ata gjenden dhe u bëjnë atyre shërbimet e nevojshme.

Malteser Shqipëri është një tjetër organizatë humanitare joqeveritare, me qendrën e saj në Shkodër, që ka punuar në Shqipërinë e Veriut qysh në vitin 1994. Malteser Shqipëri mbështetet nga organizata motër gjermane “Malteser Hilfsdienst”. Misioni i tyre është të ndihmojmë njerëzit në nevojë dhe komunitetet e marginalizuara. Qysh në vitin 1995, ato ofrojnë ndihmë mjekësore humanitare për komunitetet e varfra kryesisht në rajonin verior të Shqipërisë, përfshirë këtu dhe bashkinë Vau Dejës. Një nga pjesët me të rëndësishme të aktiviteteve Malteser, është puna vullnetare. Kjo organizatë është e vetmja në Shqipërinë e Veriut që ka mbi 200 vullnetarë nga fusha të ndryshme ekspertize, të përkushtuar për të ndihmuar përmbushjen e aktiviteteve në shërbim të shtresave të pa privileguara.

Në vitin 2010 ato kanë hapur “Qendrën Malteser të Shërbimit dhe Konsultimit për Komunitetin” që është qendra e vetme për autizmin në Shqipërinë e Veriut. Qëllimi kryesor i kësaj qendre është mbështetja për njerëzit e marginalizuar, me spektër autik, fëmijët me probleme mendore dhe fizike, dhe fëmijët me çrregullime në të folur, njerëzit e moshuar dhe ata me mundësi të kufizuara. Fëmijët dhe të rinjtë nga mosha 3 deri 16 vjeç, të gjithë pothuajse brenda spektrit autik, trajtohen sipas një orari të vendosur nga terapisti. Një fizioterapist trajton fëmijët me tetraplegji.

Nga të dhënat e mbledhura në terren rezulton se në njësinë administrative Hajmel, vitet e fundit është ndërtuar një spital i pajisur me të gjithë infrastrukturën bazë të nevojshme për funksionimin normal të tij. Gjithësesi, ky spital i ndërtuar me donacione, nuk është licencuar nga organet përkatëse shtetërore dhe rrjedhimisht nuk është në funksionim.

3.5.13 Zhvillimi dhe Integrimi Gjinator

Sipas të dhënave të bashkisë, çështjet gjinore në këtë zonë i referohen mundësisë së femrave për punësim si dhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje. Aktualisht, femrat në bashkinë Vau-Dejës përbëjnë rreth 49% të popullsisë aktive ndërkohe që nga të dhënat e përmendura me lart, në pjesën e punësimit në bashkinë Vau Dejës, vihet re që edhe në qytet por edhe në fshat femrat kishin përqindjen më të lartë të papunësisë. Pjesëmarrja në vendimarrje evidentohet në numrin e femrave të angazhuara në qeverisjen vendore.

Nga të dhënat e bashkisë në vite është e vështirë që të identifikohet numri i saktë i rasteve të dhunës mbi gratë. Akoma më e vështirë është situata për sa i përket rasteve të tilla në zonat rurale.

Në territorin e bashkisë Vau Dejës kanë funksionuar shoqata të ndryshme si ajo e misionareve të të drejtave të njeriut, e cila është angazhuar me gratë, fëmijët si dhe me grupe të tjera me probleme sociale.

3.5.14 Stoku i banesave

Sipas INSTAT-it, në bashkinë Vau-Dejës, fondi i banesave njëfamiljare zë rreth 97.1% të volumit të përgjithshëm duke përballuar edhe pjesën dërrmuese të strehimit të popullsisë. Shumica e banesave kolektive janë ndërtuar përpara vitit '91.

Banesat njëfamiljare janë kryesisht një deri në tre katëshe dhe me oborr rrethues. Parcela ndërtimore mesatare është rreth 500 m² dhe në përgjithsi mesatarja e sipërfaqeve në të cilat janë zhvilluar këto godina në të kaluarën, është afërsisht 200 - 250 m².

Në përgjithsi mesatarja e sipërfaqes së banimit për banor është e ulët. Nga 25-50 m²/banor që janë rekomandimet, sipërfaqja e përdorur nga një banor mesatarisht në Vau Dejës është 14.4 m², gjithsesi e krahasueshme me mesataren e vendit (14.5 m²). Akoma më problematike është kjo e dhënë, nëse vihet në diskutim numri i banorëve, që ka diferencë të madhe nga Regjistri i Gjendjes Civile (49 399) në indikacionet e INSTAT-it (30 438), të cilave ky kapitull u referohet.

Më pozitive paraqitet gjendja e dhomave për familje, që është 3.4 dhe numri i dhomave për banor që është 0.8, pra gati një dhomë për banor, mgjs me sipërfaqe të vogël.

Në bashkinë Vau-Dejës rreth 23.4% e banesave janë të pabanuara; nga këto 16% janë të pabanuara e në përgjithsi të braktisura, ose në kushtë të këqija, kurse 7.4% janë shtëpi të dyta ose e përdorim të përkohëshëm, si shtëpi pushimi veror ose malor.

Po kaq i rëndësishëm është fakti që vetëm 34.9 % e njësive të banimit, qofshin këto apartamente apo shtëpi të veçuara, janë ndërtuar përpara vitit 1991, që tregon vëllimin e madh të ndërtimit në 25 vitet e fundit. Ky bum ndërtimesh është ndikuar sigurisht nga nevoja e madhe dhe norma e ulët e sipërfaqes së strehimit, të kushtëzuar nga gjendja e vendit në vitet e komunizmit. Mjafton gjithsesi fakti që më shumë se 65% e ndërtimeve janë ngritur në këtë segment relativisht të shkurtër kohor, për të kuptuar dëmin që i është bërë pjesës së lirë të territorit të bashkisë, qoftë ajo sipërfaqe

bujqësore, apo natyrore. Edhe pse raporti i INSTAT-it pranon se viti i saktë i ndërtimit nuk është identifikuar për rreth 30% të ndërtesave, ritmi me të cilin është ndërtuar në këto 25 vite mbetet i lartë e me pasoja të konsiderueshme për ambientin.

Një problem të madh për Bashkinë Vau-Dejës përbën egzistenca e banesave “kapanone” në pjesën veriore të qytetit, të cilat para viteve 90 përdorshin nga punëtorët e Hidrocentralit. Tashmë në këto ndërtime janë instaluar shumë familje të cilat janë zhvendosur nga zonat që u përmyten nga liqeni i hidrocentralit. Kushtet e banimit në këto ndërtesa janë të vështira, me hapësira të ngushta si dhe të patrajtuara nga pikëpamja e izolimit termik. Për më tepër mbulesa e këtyre ndërtesave përbëhet nga material eterniti, me përqindje amianti, një material ky tepër i dëmshëm për shëndetin përdorimi i të cilit në Europë është ndaluar që në Janar të 2005.

Lidhur me këtë problem Bashkia Vau-Dejes është shprehur gjithnjë e interesuar për prishjen e banesave “kapanone” dhe ndërtimin në vend të tyre të banesave sociale me të përshtatshme.

Transformimi i kësaj zone me problem në një zone të re banimi duhet të konsiderohet si mundësi zgjidhjeje për këtë problem.

Tabela 42: Statusi i përdorimit të banesave (%)

Njësia administrative	Njësi banimi	Banim i përhershëm	Banesë dytesore/ sezonale	Banesë e pabanuar
Bushat	100	76.05	9.13	14.82
Hajmel	100	83.24	1.42	15.34
Shllak	100	44.92	31.82	23.26
Temal	100	86.07	3.33	10.6
Vau-Dejes	100	82.92	3.57	13.51
Vig Mnelë	100	54.64	4.47	40.89
Bashkia	100	76.6	7.4	16

Ndërtimet për qëllime banimi të ndërtuara pas viteve 90, dallohen qartazi nga ato të kahershmet. Kanë tendencën të jenë më të larta, me larg nga vendbanimet tradicionale, por më afër rrugëve të komunikimit, më të mëdha dhe me përdorim materialesh më cilësore. Edhe në aspektin e sipërfaqes së banimit, banesat e ndërtuara së fundmi veçohen dukshëm, duke pasur hapësira që i kalojnë 100 m² për familje që sa vijnë e zvogëlohen për nga numri i pjestarëve.

Ka një tendencë të dukshme për krijimin e zonave të urbanizuara dhe kjo është më e qartë përgjatë akseve rrugore që përshkojnë rajonin, sidomos në zona pranë rrugës Tiranë - Shkodër. Këto zona do të përbëjnë thelbin e studimit urban të rajonit. Zonat e urbanizuara rishtas përbëhen nga ndërtesa me funksione banimi, industriale dhe prodhimi por jo mbi bazën e studimeve paraprake. Ndërtimet e reja shfaqen kudo, në prona private dhe nganjëherë troje publike, të përvetësuara ose të kontestuara.

Situata e përgjithshme e fondit të banesave, duke u bazuar në rezultatet e INSTAT-it për vitin 2011, paraqitet si më poshtë:

Tabela 43: Tabela e stokut të banesave

EMËRTIMI	Sasia	Njësia
Popullsia	30 438	banorë
Familja mesatare	4.1	banorë/familje
Familje	7 424	familje
Dhoma/familje	3.4	dhoma/familje
Dhoma/banor	0.8	dhoma/banor
Sipërfaqe mesatare/ njësi banimi	59.04	m ² /njësi
Sipërfaqe njësisht banimi (e jetuar)	438307	m ²
Sipërfaqe banimi/banor	14.4	m ² /banor
Njësi banimi me qera	0.66	%
Ndërtesa banimi ndërtuar para '91:	34.9	%
Njësi banimi të pabanuara	16	%

Pavarësisht numrit relativisht të lartë të shtëpive të pabanuara, rezerva që vjen nga diferenca e ndjeshme mes të dhënave nga institucionet e ndryshme për popullsinë, na shtynjë të parashikojmë një rritje të fondit të banesave në këtë bashki, bazuar në një analizë specifike, duke marrë në konsideratë parametrat e mëposhtëm:

- Norma e sipërfaqes së banimit/person dhe shkalla e formimit të familjeve të reja;
- Numrin e njësive që kërkohen për të zbutur mbi-popullimin;
- Banesat që mungojnë;
- Zëvendësimi i njësive ekzistuese të cilat do të amortizohen plotësisht gjatë periudhës së planifikimit;
- Zëvendësimin e njësive të dëmtuara ri-ndërtimi i të cilave nuk është ekonomikisht i leverdisshëm;

Si rezultat mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe tendencave të rritjes, dalin këto supozime:

- Bashkia Vau-Dejës do të arrijë një popullsi mesatare prej 41,000 banorë deri në vitet 2030, nëse ritmi i rritjes supozohet 0.15% në vit (referuar projeksionit të popullsisë);
- Mesataria aktuale është 14.4 m² sipërfaqe banimi/banor, një parametër i papranueshëm në të ardhmen, që do të ndikojë ndjeshëm në nevojën për banesa;
- Nevojitet një rritje e ndjeshme e sipërfaqes së banimit, për përmirësimin e normave në rreth 25 m² ndërtim/banor.
- Shtesa e popullsisë deri në vitin 2030 do të jetë 800 – 1 100 banorë, numri i familjeve të shtuara rreth 200 - 275;
- Rreth 200-275 njësi të reja banimi nevojiten për sistemimin e familjeve të reja, duke menduar vazhdimësinë e koeficientit prej 1 familje/banesë;
- Në total mendojmë se sasia reale për njësi të reja banimi si rezultat i rritjes së popullsisë dhe përmirësimit të kushteve të banimit pas 13 vitesh parashikohet rreth 2300 - 3000 njësi banimi.

- Reth 10% e banesave do të amortizohen krejtësisht gjatë periudhës së planifikuar ndërsa rreth 20%, do të kenë nevojë për rinovim gjatë periudhës së planifikuar.

3.5.15 Toka dhe çështjet e pronës

Çështjet e pronësisë vazhdojnë të konsiderohen ende sot, një shqetësim madhor për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit tonë. Tregu i pasurive të patundshme përballet në mënyrë konstante me sfida të shumta, që në një numër të konsiderueshëm të rasteve, e kanë origjinën tek mungesa e një sistemi të qartë e funksionues të administrimit të të drejtave të pronësisë. Mirëspecifikimi i të drejtave të pronësisë dhe regjistrimi i mirë-dokumentuar i pronave të paluajtshme kanë një rëndësi primare në projektimin afatgjatë dhe përmirësimin e planifikimit urban, si dhe të zhvillimit të infrastrukturës, duke lejuar hapësirat e nevojshme për implementimin e reformave shtetërore. Me qëllim që të jetë eficient, sistemi i administrimit të pronave duhet të garantojë pronësinë dhe zotërimin e pronës nga pronarët, e ligjshëm, duke i shërbyer përfundimisht të qendrueshmërisë së sektorit të pronave të paluajtshme, reduktimit të mosmarrëveshjeve për tokën, lehtësimit të transaksioneve në lidhje me pronat dhe mbështetjes së mirëqeverisjes. Realiteti kaotik i pronave të paluajtshme në vendin tonë dhe shqetësimet e grupeve të interesit për të drejtat e pronësisë kanë rritur vëmendjen mbi rëndësinë e efektivitetit të reformave dhe efikasitetit të agjensive shtetërore përgjegjëse për këto çështje.

Në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër i zhvillimit të drejtës së pronës në përgjithësi për vendin tonë dhe problematikat kryesore të trashëguara, në bazë të të cilave bëhet një pasqyrë e qartë e situatës ekzistuese edhe në kontekstin e bashkisë Vau-Dejës.

Aspekte juridike

Në aspektin ligjor, subjekti (personi fizik a juridik) që zotëron ligjërisht një pronë, nuk zotëron vetëm pronën si pasuri fizike me efektet ekonomiko-sociale perkatëse, por duhet të zotërojë edhe pasurinë juridike mbi “të, pra mbrojtjen ligjërisht të tërësisë të të drejtave dhe obligimeve (titulli juridik perkatës) në lidhje me zotërimin faktik të saj. Kjo është ana statike e sistemit juridik mbi pronësinë. Ndërsa transaksionet apo veprimet e tjera në vëllim, hapësirë dhe kohë e këtyre “titujve juridikë” përbëjnë “rregullimet dinamike” ligjore për zhvillimin juridiko-faktik të marrëdhënieve mbi pronën.

Juridikisht, krijimi i kadastrave në vendin tonë, ka filluar me daljen e ligjit “Mbi titujt defterhane” në vitin 1874. Në atë kohë nuk regjistroheshin ndërtimet, pemtaritë që mbilleshin etj, pasi regjistrimi nuk ishte i detyruar. Tapitë lëshoheshin për titujt e pronësisë perkatëse duke treguar: Emrin e personit, emrin e tokës, vendin dhe emrat e pronareve kufitare.

Shteti shqiptar mbas vitit 1912 filloi të zëvendësojë gradualisht legjislacionin turk mbi tokën, duke respektuar njëkohësisht edhe Regjimin juridik nën të drejtën kanunore. Por legjislacionet që rregulluan juridikisht marrëdhëniet mbi tokën filluan me statusin

themeltar të viteve 1925 dhe 1928, si rezultat i te cilave, iu dha fund ndarjes së tokës sipas Ligjit të vitit 1856 dhe të gjitha tokat u ndanë në pronësi të shtetit, personave juridike e personave fizike. Me Kodin Civil të Regjimit të Zogut, të aplikuar qysh nga viti 1929, proklamohet se prona është e shenjtë dhe e paprekshme. Në bazë të këtij parimi me Ligjin “Mbi zyrat e hipotekave dhe taksat e tyre” dt 17.04.1929 u suprimuan kadastrat dhe u krijuan zyrat e hipotekës. Tjetërsimi si transaksion, tashmë, kalonte mes detyrimeve juridike të drejtën e pronësisë, posedimit, qiradhenies etj. Pasuritë regjistroheshin nga personat e interesuar vetëm atëherë kur nevojitej prej tyre mbrojtja e ligjit për transferime dhe transaksione. Mungesa e regjistrimit ishte me evidente në fshat, ku një pjesë e madhe e tokës dhe transaksioneve ishte e pa regjistruar. Akti noterial nuk bëhej nëse regjistrimi i pasurisë nuk ishte kryer dhe gjithashtu kadastra nuk lëshonte asnjë dokument, pasi ajo ishte e dobët dhe e karakterit të një Regjistri deklarativ. Pra institucionet e sigurojnë dhe garancojnë se pronave nga pikepamja juridike kanë funksionuar kryesisht për disa qytete kryesore dhe për një numër të kufizuar të pronarëve në zonat rurale.

Perioda e regjimit politik 1945-1990 nga pikëpamja e regjimit juridik të Tokës filloi me Reformën Agrare të viteve 1945-1946 e cila e kufizonte shumë të drejtën e pronësisë për tokën (deri në 5 ha për pronarët e mëdhenj), por veç kësaj me Qarkoren e datës 19. 01.1945 ndalonte noteret të merrnin veprime për shit-blerjen për objekt të tokës bujqësore. Sipas Ligjit të Reformës Agrare (neni 12) fshatrat që morën tokë u regjistruan në regjistra të posaçëm në Zyrat e Reformës Agrare, por nuk u pajisen kurrë me titujt juridike të tokës. E drejta e zotërimit të pronësisë mbi tokën u zëvendësua në mënyrë graduale dhe “defakto” në vitin 1967 nuk kishte më pronë private mbi tokën ndërsa “de jure” me kushtetutën e vitit 1976 u sanksionua përfundimisht se toka ishte në pronësi të shtetit. Sistemi kadastral i organizuar teknikisht mjaft mirë qysh në vitin 1947 nuk kishte për bazë parcelën e bazuar në të drejtat e pronësisë së tokës, por të parcelës së poseduesit faktik e cila kishte të bënte me kadastrën fiskale dhe jo atë juridike. Matja e tokave në vitet 1950-1953, pavarësisht se u bë me matje të thjeshta, u shtri në gjithë territorin e vendit për kadastrimin e tokave bujqësore dhe përbën një informacion mjaft të vlefshëm në krijimin e një kadastre teknike dhe shërben si bazë për tatimet mbi tokën. Kadastrimi vazhdoi me tej me matje topografike, të cilat kishin standarte mjaft të larta dhe u bazua kryesisht në parcelën e përdorimit të tokës. Në prag të viteve 1990 ishin kadastruar në këtë mënyrë rreth 90% të tokave bujqësore të shtrira në rreth 11 000 km² në mbarë vendin.

Duke filluar qysh nga viti 1991, regjimi i marrëdhënieve pronësore të pasurisë mbi tokën mori përcaktime raportesh të reja. Reforma për tokën që u shpall në ligjin nr 7501 “Për tokën” e që u pasurua me vonë me ligje të tjera të cilat përcaktuan juridikisht kategorizimet juridike të tokës bujqësore e jobujqësore. Ky ligj solli shpërndarjen e organizatave kooperativiste e të fermave bujqësore, duke rishpërndarë pronësinë juridike mbi tokën gjithë popullsisë së zonës fshatare, fillimisht duke moslejuar shit-blerjen e tokës bujqësore. Tokat fizike dhe të drejtat mbi të u kaluan për zotërim juridik në formë pronësie apo përdorimi fshatare, nëpërmjet komisioneve në nivel fshati, komune e rrethi të cilët kishin të drejtën e dhenies së titullit juridik (tapisë) në pronësi e përdorim. Pra sipas këtij ligji tokat bujqësore iu ndanë personave që i punonin dhe familjeve të tyre (gati dy të tretave të popullsisë, gjithsej). Të gjitha ish-kooperativat u

shpërndanë në kuadër të këtij procesi, megjithëse hollësitë e zbatimit ndryshonin nga krahina në krahinë (Për shembull, në zonat malore në veri të Shqipërisë, komunitetet lokale nuk e shpërndanë tokën sipas frymëve, siç e kërkonte ligji, por sipas familjeve dhe sipas trashëgimisë së pronës që prej kohërave përpara regjimit komunist). Kjo qasje e pabarabartë solli mosmarrëveshje të shpeshta, të cilat zakonisht autoritetet vendore nuk ishin në gjendje t'i zgjidhnin.

Përsa i përket zonave të urbanizuara, ligji nr. 7652, dt. 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, u dha personave që i kishin në shfrytëzim banesat mundësinë që t'i merrnin në pronësi ato. Sipas këtij ligji janë privatizuar rreth 440.000 apartamente dhe shtëpi.

Në tabelën në vijim jepet një përmbledhje të legjislacionit kryesor për të drejtat e pronës në Shqipëri.

Tabela 44: Legjislacioni për pronat pas viteve ‘90

Ligji Nr. 7501 dt. 19.07.1991	“Për tokën” sipas të cilit tokat bujqësore iu ndanë personave që i punonin.
Ligji Nr. 7652 dt. 23.12.1992	“Për privatizimin e banesave shtetërore” , i kaloi pronësinë e banesave personave që i kishin në shfrytëzim ato
Ligji Nr. 7698 dt. 15.04.1993	“Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” , shërbej si bazë për privatizimin e pronave në qytet (shfuqizuar me ligjin 9235, në 2004)
Ligji Nr. 7843 dt. 13.07.1994	“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” shfuqizuar në 2012 me ligjin 33/2012
Ligji Nr. 7850 dt. 29.07.1994	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë reformimi i të drejtës civile siguroi kuadrin ligjor për veprimet private me pronat.
Ligji Nr.8417 dt. 21.10.1998	Kushtetuta e Shqipërisë miratimi i Kushtetutës, përfshin dispozita që garantojnë të drejta mbi pronat e paluajtshme.
Ligji Nr.9235 dt. 29.07.2004	“Për kthimin dhe kompensimin e pronave” zëvendësoi ligjin e vitit 1993 dhe futi kompensimin me vlerën aktuale të tregut.
Ligji Nr.9404 dt. 29.10.2004	“Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale” , vendosë rregulla për ndërtesat e paligjshme, në bazë të një procesi vetëdeklarimi të administruar nga pushteti vendor.
Ligji Nr.9482 dt. 03.04.2006	“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” zëvendëson ligjin e vitit 2004 dhe vendosë rregulla për vendbanimet dhe ndërtesat e paligjshme të ndërtuara përpara muajit maj 2006, duke ia nënshtruar një procesi vetëdeklarimi të administruar nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).
Ligji Nr.10239 dt. 25.02.2010	“Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”
Ligj Nr.33/2012 dt. 21.03.2012	“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”

Akt Normativ Nr.3 dt. 01.08.2012	Për lirim e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar (Miratuar me ligjin nr.82/2012, datë 13.9.2012) Akti normativ përcakton hapa dhe afate konkrete për lirim e banesave ish-pronë e subjekteve të shpronësuar. EKB caktohet institucioni që do ndjek procesin.
Ligj Nr.133/2015 dt. 05.12.2015	“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” shfuqizon ligjin nr.9235, dt. 29.07.2004 dhe ligjin nr.10239 dt. 25.02.2010

Procesi i kthimit të pronave filloi me ligjin nr. 7698/1993 i cili përbën përpjekjen e parë për t'i dhënë zgjidhje çështjes së pronave të shtetëzuara, të shpronësuar apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944, të cilat ishin marrë pa të drejtë nga shteti. Sipas këtij ligji u krijuan Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në bashki dhe në ish-Këshillat e Rretheve (respektivisht për zonat urbane dhe për zonat jashtë urbane), të cilat njihnin të drejtën e pronësisë, kthenin apo kompensojnë pronat e subjekteve të shpronësuar. Komisionet drejtoheshin nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili funksiononte si organ monokratik që drejtohej nga Kryetari i tij.

Pas vitit 2004, me miratimin e ligjit 9234/2004, u rrit kufiri maksimal i sipërfaqes së tokës bujqësore për njohje, kthim apo kompensim, u zgjeruan mënyrat e kompensimit, u vendos detyrimi për krijimin e fondit të pronave të paluajtshme për kompensim fizik, si dhe detyrimi për krijimin e fondit për kompensimin financiar. U krijua Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, si një organ kolegjal me 5 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi dhe me komisione vendore në varësi për secilin qark. Në vitin 2006, Komiteti u suprimua, nëpërmjet krijimit të Agjencisë të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronës. AKKP-ja, së bashku me zyrat e rajonale në qarqe, u krijua në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, për të siguruar një organizim të centralizuar, efektiv dhe të shpejtë vendimmarrës. Zyrat Vendore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në secilin qark të vendit u suprimuan me ndryshimet ligjore të vitit 2009 dhe tashmë i gjithë procesi administrativ i shqyrtimit dhe vendimmarrjes është përqendruar në AKKP-në Tiranë, që drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili në zbatim të përgjegjësi për kompensimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, ndaj vendimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, shprehet me vendim.

Hapi i parë për futjen në përdorim të një sistemi bashkëkohor për regjistrimin e pronave u hodh në vitin 1994, mirëpo procesi i regjistrimit fillestar të pronave nuk ka përfunduar ende. Ligji për regjistrimin e pronave të paluajtshme, i miratuar në vitin 1994, parashikon një sistem modern regjistrimi të bazuar në parcela, dhe krijon një dikaster të posaçëm për administrimin e këtij procesi: Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).

Ligji 33/2012 përveç përshtatjes me nevojat e kohës synon marrjen e një sërë masash juridike që do të rregullojnë shitjen e apartamenteve pas bumit të ndërtimëve të shfaqur pas viteve 2000. Kjo nisur nga shqetësimi që një pjesë e madhe e kredive me probleme është e kolateralizuar me pasuri të patundshme dhe është e koncentruar kryesisht në sektorin e ndërtimit. Një nga ndryshimet kryesore të propozuara është që shoqëria e ndërtimit do të ketë detyrim ligjor regjistrimin si të lejes së ndërtimit ashtu

edhe të kontratave të sipërmarrjes/porosisë, duke rritur dhe sigurinë juridike për këtë kategori kolektive.

Gjithashtu konstatohet se shumë prona u janë nënshtruar veprimeve informale me kalimin e viteve dhe përdoruesit e tanishëm shpesh kanë kaluar mjaft probleme për të gëzuar të drejtën e pronësisë. Shitblerja dhe ndarja e mëtejshme shpesh bëhet pa dokumentacion dhe, edhe atëherë kur ka dokumente për shitblerjen, ato shpesh janë jo të noterizuara apo të regjistruara për shkak se prona nuk i është regjistruar shitësit. Për pasojë, shumë përdorues të tanishëm kanë paguar shuma të konsiderueshme parash për pronën por kanë shumë pak mbrojtje juridike sepse veprimi i shitblerjes mbetet informal nga këndvështrimi i ligjit.

Informaliteti dhe procesi i legalizimit

Vlerësohet se në gjithë vendin janë ngritur rreth 350.000 deri në 400.000 ndërtesa pa leje. Migrimi i brendshëm i vrullshëm gjatë viteve me pasiguri ekonomike dhe me liri të lëvizjes 1990-2000, çoi në zaptim në masë të tokave shtetërore dhe private, sidomos në zonat bregdetare dhe zonat ngjitur me qytetet (zonat peri-urbane).

Mungesa e një mekanizmi zyrtar që orientonte këto banorë që zhvendoseshin nga vendlindja e tyre për një jetë më të mirë, bëri që njerëzit thjesht të zinin tokën dhe fillonin të ndërtonin. Toka u copëtua në mënyrë informale, mirëpo një pjesë e mirë e saj mbeti e klasifikuar si tokë bujqësore dhe, kështu, nuk e plotësonte kriterin si truall për leje ndërtimi. Ndërtimet bëheshin pa marrë në konsideratë ligjet e rregullimit të territorit apo të ndërtimit, pa leje nga autoritetet zyrtare, pa infrastrukturën e duhur dhe, shpesh (por jo gjithmonë), në tokë e cila nuk i takonte ndërtuesit. Për pasojë, shumë prona në qytet konsiderohen si jo të ligjshme. Mungesa e planifikimit dhe kontrollit të efektshëm të ndërtimeve mundësoi ndërtimin e shtesave në ndërtimet ekzistuese, të cilat tani konsiderohen si jo të ligjshme.

Sipas disa vlerësimeve të bëra, ndërtimet jo të ligjshme përbëjnë një të tretën e inventarit strehues gjithsej dhe kanë kushtuar afro 10 miliard euro për t'u ndërtuar. Afërsisht një e treta e tokës në të cilën janë ndërtuar objektet e paligjshme u përket ndërtuesve, një e treta i përket shtetit dhe një e treta një personi tjetër, si për shembull një pronari të cilit i është kthyer prona ose një personi i cili ka marrë tokë sipas ligjit për tokën të vitit 1991. Procesi i krijimit të vendbanimeve informale dhe i ndërtimeve informale shkaktoi tensione shoqërore, vështirësi për organet shtetërore dhe solli pasoja politike. Në vitet 1990, përdoruesit përdorën forcën për ta shtënë në dorë dhe për ta mbrojtur pronën e zënë nga përpjekjet sporadike (dhe kryesisht jo të suksesshme) të autoriteteve për t'i nxjerrë nga prona. Me rritjen e komuniteteve të zaptuesve, autoritetet filluan të kenë gjithnjë e më shumë kujdes të mos ndërhyjnë. Qasja jo e ligjshme e banorëve të rinj dhe mosndalimi i tyre nga autoritetet shkaktoi mëri te banorët e qyteteve pranë tyre, si edhe inat dhe acarim tek pronarët e tokave të zaptuara. Një sfidë konkrete për të gjitha bashkitë del sot urbanizimi dhe ofrimi i shërbimeve kryesore këtyre vendbanimeve informale.

Në bazë të statistikave të ALUIZNI-t, Qarku Shkodër (ku përfshihet edhe Bashkia Vau-Dejës) numri i vetë-deklarimeve të bëra arrin 24 893 që përbën rreth 9.2% të totalit (270 592 në gjithë vendin)

Pavarsisht angazhimit serioz të qeverisë shqiptare akoma konstatohet që procesi i legalizimit ka ecur ngadalë përkundër burimeve financiare që i janë kushtuar. Së fundmi (në vitin 2015) ALUIZNI ndërmori nismën për të bërë fotografimin ajror për të bërë evidentimin e gjendjes reale të informalitetit pasi konstatohet që nga viti 2006 gjendja në territor ka ndryshuar në mjaft zona të Shqipërisë përse i përket këtij fenomeni.

Sipas raportimeve të ndryshme, një ndër faktorët kryesorë që kanë penguar procesin e legalizimit janë problemet e bashkërendimit midis ALUIZNI-t, ZRPP-së dhe AKKP-së. Të dhënat gjeografike të ALUIZNI-t, të cilat janë prodhuar në bazë të teknologjisë më të fundit të fotografimit ajror dhe GPS, mbështeten në një teknologji më të saktë dhe më të fundit se ajo e ZRPP-së.

Problematikat kryesore të sistemit

Historiku i zhvillimit të së drejtës së pronës në vendin tonë tregon qartë edhe problematikat e trashëguara në sigurinë juridike të pronës. Ndër problematikat kryesore të evidentuara edhe në raportet ndërkombëtare për këtë qëllim, mund të cilësojmë:

- Mungesa e një qasje të qartë dhe konsistente politike në reformat e ndërmara 25 vitet e fundit, pavarsisht qëllimeve të pranura gjerësisht nga të gjitha palët, ka rezultuar në një implementim të dobët të kuadrit ligjor në këtë drejtim. Si rezultat i kësaj paqartësie në vendim-marrje, statistikave të Gjykatës së Strazburgut për çështjet shqiptare të pronësisë tregojnë që gjyqësori shqiptar të jetë në shkallë në 85% të vendimeve të dhëna.
- Së dyti, reformat janë implementuar me definicione të ndryshme ligjore për lloje të ndryshme të pronave bujqësore, pyjore, kullota, banesa publike apo toka tregtare ose industriale, duke krijuar një sistem kompleks me shumë zbrastime dhe mbivendosje.
- Faktor i tretë vlerësohet të jetë fragmentimi i njësive të pronave dhe parcelave të tokës, duke kërkuar në këtë mënyrë angazhimin e çdo pronari në marrëveshje të shumfishta suplementare për të realizuar përdorimin rutinë të pronës.

Të marrë së bashku, këta faktorë e kanë bërë të vështirë adaptimin e marrëdhënieve të tregut dhe modeleve të të drejtës civile europiane, në mjedisin shqiptar, duke ngadalësuar progresin e reformave dhe duke e bërë sistemin të çnueshëm ndaj rritjes së praktikave informale dhe korruptive.

Angazhimet kryesore që duhen ndërmarrë

Duke Sa më sipër ndër angazhimet kryesore që dalin të nevojshme për t'u ndërmarrë në këtë sektor janë:

- Agjensitë shtetërore si ZQRPP, AKKP and ALUIZNI duhet të rritin koordinimin mes tyre për të siguruar një sistem administrimi të shpejtë, mirë-funksionues dhe të pakontestueshëm. Në të njëjtën gjatësi vale duhet të jetë edhe bashkëpunimi mes qeverisë lokale dhe asaj qendrore.

- Unifikimi i databazës së pronave të paluajtshme duke aplikuar të njëjtat kërkesa dhe standarde teknike, mbështetur në dokumentet e pranuar ligjore të pronësisë në përputhje me të dhënat hartografike, është një proces i rëndësishëm.
- Procedura më efiçente të regjistrimit të pronës do të ndikojnë në reduktimin e kostove për transaksionet dhe do të përmirësojnë sigurinë e të drejtave të pronësisë.

Duhet theksuar që në këtë dokument, duke bërë një analizë juridike të së drejtës së pronës në vendin tonë janë evidentuar edhe problematikat e marrëdhënieve të pronësisë, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit. Këto problematika kanë një karakter të ngjashëm (pothuajse të njëjtë) në të gjithë vendin dhe zgjidhja e trajtimi i tyre nuk mund të jenë objekt as i PPV as i pushtetit lokal, por duhen adresuar pranë pushtetit qendror që harton dhe politikat dhe kuadrin ligjor përkatës.

3.5.16 Pronat publike

Në zbatim të ligjit nr.8744, dt. 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Bashkia Vau-Dejës ka krijuar strukturat dhe njësitë përkatëse, për inventarizimin dhe transferimin në pronësi apo përdorim të saj të pronave në fjalë.

Procesi ka nisur fillimisht me inventarizimin e pronave të transferuara dhe sigurimit të bazës të nevojshme teknike (harta treguese, librat e ngastrave etj.). Procesi mbyllet me përgatitjen e dosjeve përkatëse dhe dërgimin e tyre në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Prioritet për transferimin në pronësi apo përdorim të Bashkisë po u jepet objekteve (aseteve) ku kryesisht përfshihen:

- Godinat administrative;
- Social-Kulturore, Arsimore,
- Shëndetsore
- ambiente të tjera publike (sheshe ,lulishte, rrugë trotuare).

Bazuar në informacionet ekzistuese dhe hulumtimeve të mëtejshme të bëra nga ekipi, plani duhet të marrë parasysh paraqitjen e analizave të hollësishme të përdorimit të pronës publike, duke përfshirë edhe vendndodhjen, funksionin dhe pronësinë.

Nga procesi inventarizimit transferimit të pronave në vitin 2008 kanë kaluar në administrim të bashkisë një pjesë e pronave shtetërore. Këto prona janë asetet e bashkisë dhe në pjesën më të madhe janë infrastrukturë publike, kryesisht rrugë, sipërfaqe të gjelbra, sheshe dhe truall.

Gjykojmë që evidentimi i qartë i gjithë pronave publike në dispozicion dhe përshpejtimi i ritmeve të regjistrimit të tyre do ndihmon të bashkisë Vau-Dejës në disa aspekte:

- Kryerje të investimeve për nevoja të komunitetit në pronat e vetë bashkisë (kopshte, çerdhe, banesa për strehime social etj.);

- Sigurimi i të ardhurave nga dhënia si në zona urbane për qëllime biznesi ashtu edhe në toka bujqësore dhe pyjore për mbarshtim pyjesh apo qëllime të ndryshme bujqësore;
- Hyrja në marrëveshje të tipit PPP për investime strategjike, në të cilat bashkia ofron truallin ndërsa biznesi shërbimin e caktuar;

Gjithashtu në zbatim të VKM Nr. 1108, dt 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit” ka kaluar në pronësi të bashkisë Vau-Dejës :

- Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit, sipas tabelave 1 dhe 1/1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- Asetet e paluajtshme, nga bordet e kullimit te bashkitë në territorin e të cilave është vendndodhja e tyre, sipas tabelës 2

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe sigurinë e digave të rezervuarëve që përdoren për ujitje dhe që u janë transferuar bashkive.

4 Përgatitja e bazës të dhënave territoriale në platformën GIS

4.1 Përditësimi i të dhënave ekzistuese

4.1.1 Harta bazë dhe GIS

Harta bazë, më tepër se sa për kryerjen e analizave territoriale, shërben për të gjithë procesin e planifikimit vendor. Harta bazë, dhe harta të mëtejshme analitike e tematike të PPV-së, prodhohen në sistemin gjeografik të informacionit (GIS), si sistemi më i përshtatshëm për të lidhur informacionin sasior të territorit me vendndodhjen e tij. GIS, është një bashkësi procesesh, qëllimi i të cilës është të mbledhë të dhëna, t'i "magazinojë" sipas një strukture tabelare dhe hartografike, t'i analizojë ato e të ndihmojë në vendimmarrjen e autoriteteve. Sistemi GIS që po ndërtohet për qëllimin e planifikimit Vendor do të japë informacion gjeohapësinor në lidhje :

- a) Gjendjen aktuale të territorit (Ndërtesa, Rrugë, Hidrografi, Parcelizim, Reliev)
- b) Klasifikim i territorit sipas 5 sistemeve bazë dhe nënkategoritë përkatëse;
- c) Rrjetet e infrastrukturës publike, për ndërtesat dhe për territoret e tyre;
- d) Statusin ligjor të territorit, bazuar në dokumentet e planifikimit të territorit e të përdorimit tokës;
- e) Zona të veçanta, me regjim ligjor të veçantë, të përcaktuar në bazë të legjislacionit apo rregulloreve sektoriale, si zona të mbrojtura, me rrezikshmëri, etj.;
- f) Trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen natyrore, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi rregulloret për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e ruajtjen e natyrës;
- g) hartimin, miratimin dhe monitorimin e instrumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit të territorit.

4.1.2 Legjislacioni

Si referencë bazë për organizmin e bazës të dhënave është përdorur informacioni nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Hapësinor (ASIG), ndërsa si bazë ligjore, ligjin 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjithashtu ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", sanksionon përdorimin e GIS për hartimin e planeve territoriale në vendin tonë (specifikisht në nenet 54 deri në 57 të tij). Sipas këtij ligji, "Informacioni në regjistër organizohet sipas një rrjeti të integruar e shumëqëllimësh të bazave të të dhënave shtetërore për tokën dhe zhvillimet në të, të pavarura e ndërvepruese ndërmjet tyre. Autoritetet përgjegjëse ndërtojnë, administrojnë e mirëmbajnë bazën e tyre të të dhënave, pjesë përbërëse të regjistrit, sipas një platforme teknike, strukture dhe standardeve të përbashkëta gjeodezike e GIS-it për të siguruar përputhshmërinë e ndërveprimit ndërmjet tyre dhe shkëmbimin e përdorimit të informacionit të regjistruar në to." (neni 55).

Me akte nënligjore (sipas nenit 57 të ligjit) përcaktohen "standardet e përbashkëta gjeodezike dhe të GIS-it, ... rregullat e lidhjes në rrjet dhe të transferimit të ndërsjellë

të të dhënave ndërmjet autoriteteve të planifikimit dhe institucioneve të tjera shtetërore, ...", si dhe të drejtat e detyrimit e autoriteteve në përdorimin e Regjistrat. Fakti që Regjistri i integruar i territorit është i bazuar në formatet e GIS dhe detyrimi i ngarkimit të "shapefile-ve" në të, krijon një incentivë që GIS të përdoret në çdo hap të hartimit të planeve territoriale.

4.1.3 Identifikimi dhe Mbledhja e të dhënave

Hapi i parë për përgatitjen e një baze të dhënash të saktë gjeohapësinore është identifikimi dhe mbledhja e të dhënave. Në këtë rast burimet institucionale për marrjen e informacionit hartografik kanë qenë :

1. AKPT

Te dhënat janë marrë fizikisht në format digjital dhe janë si në tabelën më poshtë:

Tabela 45: Struktura e të dhënave nga AKPT

Nr	Elementet	Layer	Përshkrimi	Tipi	Marre nga:
1	Kufijtë Shtetëror dhe Kufijtë Administrativ	AB_Line_Of_Concern	Kufijtë Administrativ te bashkisë se re	Poligon	
		AB_Urbanizimi	Zona ku mund te ndërhyhet ne funksion te zhvillimit urban	Poligon	AKPT
		AB_Urbanizimi_Buffer	Zona buffer +15m sipas vendimit Nr.5 dt.29.12.2014	Poligon	AKPT
		AB_Yellow_Line	Vija e verdhe	Poligon	
2	Ndërtesat	BD_Building	Vendndodhja e ndërtesave	Poligon	MB
3	Përdorimi i tokës Vendbanime	LU_131_Mineral extraction sites	Vendndodhje minerale	Poligon	CORINE
		LU_121_Industrial or commercial units	Njësite industriale dhe komerciale	Poligon	CORINE
		LU_PublicFacilities_142_Sport and leisure facilities	Objekte publike, Sporte dhe objekte kalimi te kohës se lire	Poligon	CORINE
		LU_Monumentet	Monumentet Historike	Poligon	IMK
		LU_Landfill_132_Dump sites	Vend depozitime mbeturinash	Poligon	CORINE
		LU_Industrial_and_Comercial	Zonat Industriale	Poligon	MZHETTS
		LU_Comercial_and_Industrial	Zonat Ekonomike	Poligon	MZHETTS
		LU_Excavation_and_Mining	Vendndodhja e Lejeve te shfrytëzimit minerar	Poligon	AKBN
4	Përdorimi i tokës Hidrografia	LU_Floating_and_Standing_Water	Hidrografia (Lumenj, Liqene)	Poligon	CORINE
		LU_Sea	Deti	Poligon	CORINE
		LU_Dock	Portet	Poligon	CORINE
5	Përdorimi i tokës Transporti dhe Trafiku	LU_Road	Rrjeti rrugor	Line	Instituti i Transportit
		LU_Railroad	Rrjeti hekurudhor	Poligon	Corine

		LU_Shipping_Traffic	Portet	Poligon	CORINE
		LU_Air_Traffic	Aeroportet	Poligon	CORINE
6	Natyrë dhe mjedisi	LU_Agriculture	Përdorimi i tokës Bujqësi	Poligon	CORINE
		LU_Forest	Pyjet	Poligon	CORINE
7	Shërbime Publike	PU_Substacion	Nënstacionet	Pike	OSHE_KKT
		PU_Cable	Linja e Transmetimit	Vije	OSHE_KKT
8	Kushtet sociale,	SEC_Kindergarden_School	Pozicioni i shkollave	Pike	MAS
9	Te tjera	Monumente Natyre	Vendndodhja e Monumente te Natyres	Pike	MM
		Zonat e Mbrojtura Natyrore	Vendndodhja e zonave te mbrojtura natyrore	Poligon	MM
		Kurora e Tiranës		Poligon	AKPT
		Digat	Digat bujqesore	Pike	MBZHRAU
		Vendbanime Rome Census	Vendodhja e banimeve rome	Pike	CENSUS

1. Gjeoportali Kombëtar

Si burim të dhënash i rëndësishëm në këtë proces ka shërbyer dhe Gjeoportali Kombëtar, i cili administrohet nga Autoriteti Shtetëror për Informacioni Gjeohapësinor, dhe ndodhet në linkun <http://geoportal.asig.gov.al>. Në këtë portal janë publikuar një pjesë e madhe e informacioneve hartografike që administrohen nga Autoritete Publike. Informacioni mund të aksesohet në programet GIS Desktop në mënyrë të hapur nëpërmjet shërbimeve online të shikimit sipas standardeve WMS dhe WMTS.

Ky lloj shërbimi mundëson jo vetëm shikimin e të dhënave (si raster) por edhe marrje informacioni id. Shërbimi nuk lejon shkarkimin e tij si format vektorial dhe përpunimin nga ana jonë. Më poshtë, në formë tabelare, po listojmë të dhënat që janë përdorur nga gjeoportali:

Tabela 46: Struktura e të dhënave Gjeoportali Kombëtar

	Institucioni Qendror	Institucioni Varësi	Emërtimi i Shtresës	Përshkrimi
1	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)		Ortofoto e Zonave Urbane 2015	Ortofoto për zonat urbane (59 qytete , 1028 km ²). Rezulucion 8 cm/pixel në formatin RGB.
2	Ministria e Zhvillimit Urban	ALUIZNI	Ortofoto 2007	Ortofoto për territorin e Republikës së Shqipërisë me rezolucionin 20/35 cm për pixel
3	Instituti Gjeografik Ushtarak		Index 1:100000; 1:50000; 1:25000 ; 1:10000; 1:5000 ;1:2500	Nomenklatura për Harta Topografike të Shk.1:100000; 1:50000; 1:25000 ; 1:10000; 1:5000 ;1:2500
			Harta Topografike 1: 10000	Skanime të Hartave Topografike 1:10000 për pjesën perëndimore dhe vijën bregdetare të territorit të Republikës së Shqipërisë, 423 nomenklatura (flete) .
			Harta Topografike 1: 25000	Skanime të Hartave Topografike 1:25000 për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, gjithsej 256 nomenklatura (flete) .
			Harta Topografike 1: 50000	Skanime të Hartave Topografike 1:50000 për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë , gjithsej 82 nomenklatura (flete) .

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

			Harta Topografike 1: 100000	Skanime të Hartave Topografike 1:100000 për gjithë territorin e Shqipërisë ,gjithej 35 numenklatura (flete) .
			Harta Topografike 1: 200000	Skanime të Hartave Topografike 1:200000 për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ,gjithej 10 nomenklatura (flete) .
4	INSTAT		Ndarja Administrative	Ndarja është kryer nga konstatimi në terren bazuar në Ortofoto 2007 në periudhën e Censurit 2011.
			Njësite Vendore	Ndarja është kryer nga konstatimi në terren bazuar në Ortofoto 2007 në periudhën e Censurit 2011.
			Grid 1 Km	Dendësia e popullsisë në kushtet e rrjetit të qelizave (grid) prej 1 km katror. Grid 1 km katrorë (EUROSTAT - GEOSTAT)
			Ndërtesat	Të dhënat e Censurit 2011 për Ndërtesat
5	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Gjeologji	Harta Gjeologjike e territorit të Republikës së Shqipërisë Shk.-1:200 000
			Hidro-Gjeologji	Harta Hidro Gjeologjike e territorit të Republikës së Shqipërisë të skanuara në Shk-1:100 000
6	Ministria e Mjedisit	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Brezi i Gjelbër Tirane	
			Rrjeti Emerald	Ngritja e rrjetit EMERALD bazohet në Ligjin 8906, 06.06.2002 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar. Ky rrjet rrjedh si detyrim nga Konventa e Bernës (Konventa për Ruajtjen e Flores dhe Faunes së Eger dhe Habitave Natyrore të Evropës) ku Shqipëria është
			IBA Bregdetare	IBA (Important Bird Areas), shpallur me Urdhërin e Ministrit nr. 283, datë 10.04.2013, "Për miratimin e listës së sipërfaqeve ligatinoresh bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendet migratore"
			Monumente Natyre	
			Zonat e Mbrojtura	Zonat Mjedisore të Mbrojtura të miratuara në bazë të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për Zonat e Mbrojtura" i ndryshuar.
			Zonim i Zonave të Mbrojtura	Zona Mjedisore të Mbrojtura të miratuara në bazë të LIGJ Nr. 8906, datë 6.6.2002 "PËR ZONAT E MBROJTURA" ndryshuar me LIGJIN . Nr.9868, datë 4.2.2008 "PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8906, DATE 6.6.2002 "PËR ZONAT E MBROJTURA"
7	Ministria e Zhvillimit Urban	Ministria e Zhvillimit Urban	Vend depozitimet e mbetjeve të ngurta urbane	Vend depozitimet ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane për çdo njësi të qeverisjes vendore.
8	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Harta Treguese e Pasurive të Paluajtshme (Kufi Zone)	Kufijtë e zonave kadastrale të marra nga Hartat Treguese të Pasurive të Paluajtshme.
			Harta Treguese e Pasurive të Paluajtshme (Ndërtesat)	Ndërtesat të marra nga Hartat Treguese të Pasurive të Paluajtshme.
			Harta Treguese e Pasurive të Paluajtshme (Parcelat)	Parcelat të marra nga Hartat Treguese të Pasurive të Paluajtshme
9	Ministria e Kulturës	Instituti i Monumenteve të Kulturës	Harta e Monumenteve të Kulturës , Zonave të Mbrojtura etj	

4.1.4 Analiza e informacionit

Informacioni Hartografik i marrë nga AKPT kalon në disa faza inventarizimi dhe kontrollit të cilësisë në bazë të kriterëve si :

- Mbulim i territorit me informacion
- Format i të dhënave
- Cilësia e të dhënave
- Saktësia e të dhënave
- Përditësimi i të dhënave

Duke mos dashur të ndalemi në analizë të thelluar të gjendjes për çdo grup të dhënash, nga ana jonë u vlerësua që informacioni në përgjithësi kërkon korrigjim, përditësim, konvertim, transformim, digjitalizim dhe në disa raste krijim nga fillimi. Si shembull mund të japim këto raste

- Korrigjim kërkojnë të dhënat që janë marrë nga projekti CORINE, për arsye se origjina këtij lloj dataseti nuk plotëson saktësinë dhe cilësinë që kërkohet në këtë fazë të planifikimit të territorit.
- Përditësim kërkojnë ato shtresa (layer) informacioni hartografik thelbësore në krijimin e Hartës bazë si ndërtesa, infrastruktura rrugore, përdorimi i tokës.
- Konvertim dhe transformim kërkon një pjesë e madhe e informacionit që është në format jo GIS por CAD. Të dhëna si relievi, kadastra e pronave etj., kërkojnë një punë të konsiderueshme që të sillen në formate GIS në mënyrë që të importohen në një Gjeodatabazë.
- Digjitalizim i të dhënave është bërë në ato raste kur materiali hartografik ka qenë në format raster (Gjeologjia, Hidrogeologjia, Sizmika etj.).
- Krijim nga fillimi për grupin e të dhënave të hidrografisë (lumenj, liqen, rezervuare, kanalizime)

Duhet theksuar që mjaft nga këto grupe të dhënash nuk ishte specifikuar së në çfarë referencë Gjeodezike (Projeksion/Eliposid) ndodheshin dhe kjo kërkonte një kontroll të detajuar vizual nga ana e operatoreve për të përcaktuar dhe transformuar materialin.

Përsa i përket informacionit që mund të aksesohet nga Gjeoportali Kombëtar shtresat Ortofoto 2007 & 2015 dhe Harta Topografike të shkallëve të ndryshme na siguron një bazë Hartografike ku do të zhvillohet e gjithë Gjeodatabaza e PPV-së. Po ashtu informacioni si Grid i Popullsisë (INSTAT) dhe monumentet e kulturës do të digjitalizohen duke u kthyer në format vektorial GIS nga ana jonë.

4.1.5 Përpunimi i Informacionit

Përpunimi i informacionit hartografik është kryer në dy fazash punimesh :

- Zyrë
- Terreni

Në fazën e parë informacioni është importuar brenda gjeodatabazës së PPV-së në mënyrë që të realizohet “Overlay” i informacionit.




Fig. 77: Paraqitje skematike e përpunimit të informacionit

Për të realizuar integrimin në këtë databazë janë kryer disa kategori përpunimi në programet GIS, ku mund të dallojmë :

Projektimi i të dhënave

Siç u trajtua dhe më sipër informacioni ekzistues i vënë në dispozicion nuk ishte në një referencë të njëjtë gjeodezike. Zakonisht të dhënat janë në projeksione të ndryshme si psh:

Tabela 47: Projeksioni i të dhënave

Te dhëna	Projeksioni	Elipsoid
Harta Kadastrale	Gauss Kryger 4N	Krassowsky
Ndërtesa	UTM 34N	WGS84

Kjo vecori sjell që të dhënat të mos përputhen dhe të mos jenë të përdorueshme. Për këtë arsye është kryer korrigjimi i të dhënave dhe sjellja në një sistem Referimi Unik që është UTM34/WGS84 .

Për parametrat e transformimit janë përdorur koeficientët e marrë nga: *Udhëzim Nr.4381/1, datë 22.9.2015“Për Transformimin e Koordinatave nga Korniza Referuese Gjeodezike Globale “Itrf2005 (Epoka 2007.2)” dhe Sistemi Gjeodezik Shqiptar “Alb86” në Kornizën Referuese Gjeodezike Evropiane “Etrf2000 (Epoka 2014.177)” dhe “Etrf2000 (Epoka 2008)”*.

Azhornimi dhe korrigjimi i të dhënave

Gjatë fazës të vlerësimit të informacionit nga grupi i ekspertëve u konkludua që disa shtresa (layer) inofrmacioni kishin nevojë për azhornime, ndër më kryesoret shtresa Ndërtesë dhe Infrastrukturë Rrugore.

Azhornimi dhe korrigjimi për këto të dhëna është kryer duke përdorur bazë hartografike të saktë, të cilat janë përpunuar në programet GIS Desktop si QGIS nëpërmjet Shërbimeve Online. Për këtë qëllim Ortofoto 2015 (zonat Urbane), Orto 2007 por edhe shumë të dhëna të tjera u aksesuan nga Geoportali Kombëtar në linkun <http://geoportal.asig.gov.al/InfoandServices.aspx?lang=AL> . Për pjesën jo Urbane janë përdorur shërbime online si Bing Aerial ose OpenLayers.

Unifikimi i të dhënave në formatin GIS.

Rasti që ka kërkuar më shumë punë nga ana e operatorëve ka qënë ai i hartave kadastrale që ishin në formatin Cad. Për kalimin e të dhënave në formatin Esri Shapefile është kryer një proces topologjie shumë rigoroz mbi të dhënat grafike në mënyrë që të mos kemi mbivendosje informacioni ose dhe zona bosh.




Fig. 78: Paraqitje skematike e tipeve të topologjisë

Duam të theksojmë që të gjithë Datasetet e integruara në Gjeodatabazën e PPV-së ka kaluar Topologjinë, si masë kontrolli.

Digjitalizimi i të dhënave

Për shumë grupe të dhënash informacioni i mbledhur ka qënë në format jo Vektorial si p.sh. harta gjeologjise ose harta e bonitetit të tokës. Informacioni për këto raste është gjeorefencuar në reference gjeodezike UTM34/WGS84 dhe më pas është digjitalizuar.

Po ashtu shtresa inofrmacioni si Hidrografia ose Grid Instat janë përfituar nga digjitalizimi në vektor ku si bazë janë përdorur shërbimet online që janë të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar.

Punime terreni

Pjesa më e rëndësishme dhe që ka kërkuar më shumë burime njerëzore dhe teknike kanë qënë marrja e të dhënave në terren. Me përcaktimin e një modeli te komplikuar të dhënash, grupeve të terrenit i është parashtruar një volum shumë i madh pune. Organizimi i punës si dhe materialet ndihmëse hartografike dhe tabelore nëpërmjet programeve GIS në këtë rast luajnë një rol të rëndësishëm në saktësinë dhe shpejtësinë e marrjes të dhënës.

Në rastin e Ndërtesave objektet janë indeksuar me një ID unike me anë të cilit Ndërtesa identifikohet si në hartë po ashtu në terren.

Baza finale e të dhënave

- Harta bazë
- Të dhënat bazë të 5 sistemeve territorial
- Kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës (ekzistues)
- Shërbime urbane ekzistuese
- Kufizime – element përjashtues (zonat tampon - buferike)

Te dhënat bazë (metadat) për secilin sitem bazë duhet të jenë në përputhje me përcaktimet VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”

4.1.6 Analiza e situatës ekzistuese

Gjatë fazës së evidentimit të gjendjes ekzistuese, në njësitë vendore është kryer dhe inventarizimi Hardware, Software si dhe ai i burimeve njerëzore. Ky proces do na shërbejë në rekomandimet, që konsulenti duhet të japi mbi veprime dhe masa për të rritur efikasitetin e GIS dhe strukturën e Regjistrat Urban.

Tabela 48: Inventari i kapaciteteve

	Vau-Dejës
Sektor GIS	mungon
Ekspert GIS	mungon
Software GIS	mungon
Workstation Comp	mungon
Server	mungon
Local Network	mungon

4.1.6.1 Veprime dhe masa për të rritur efikasitetin e GIS dhe strukturën e Regjistrat Urban.

Rezultatet e inventarit na çojnë në përfundimin se bashkia duhet investojë sidomos në rritjen e kapaciteteve e burimeve njerëzore. Propozimi i konsulentit është që të krijohet një sektor i dedikuar, që do ketë si objektiv përpunimin e të dhënave hartografike e tabelore, me qëllim mirëmbajtjen e databazës territoriale GIS. Ky sektor duhet të përbëhet nga specialistë që kanë njohuri në:

- sistemet GIS (preferohen sistemet OpenSource)
- administrimin e Databazës
- administrimin e Sistemeve Kompjuterike dhe Hardware-ve

Patjetër kjo iniciativë duhet të shoqërohet dhe me trajnimin e stafit të Bashkisë për fushat GIS dhe IT. Megjithatë stafi i bashkisë gëzon statusin e nënpunësit civil, trajnime të këtij lloji mund të sigurohen nëpërmjet ASPA (Shkolla e Administratës Publike) ose dhe nga vetë AKPT (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit).

Nga rezultatet e inventarit, vërejmë që duhet dhe një investim në pajisjet Hardware. Megjithatë Databaza Territoriale për disa grupe të dhënash do të kërkojë mirëmbajtje, përditësim dhe përpunim të informacionit, ky sektor duhet të pajiset me kompjutera të llojit Workstation (specifikime AKSHI), që do të përdoren nga specialistët e GIS-it. Databaza GIS si dhe materialet hartografike që do të përfitohen nga PPV, do të duhet të administrohen në një Server Qëndror, në këtë mënyrë do të evitohet humbja dhe vështirësia e qasjes në informacionin e dokumentuar nga stafi i Bashkisë. Serveri duhet të instalohet në një infrastrukturë të sigurtë që mundëson furnizim të pandërprerë me Energji, Network & Internet dhe sistem ventilimi. Për rregullat, rolet, kufizimet dhe mënyrën e qasjes në Databazë, nga punonjësit e njësisë vendore, duhet të krijohet një rregullore nga specialistët e Teknologjisë së Informacionit. Përsa i takon softwareve GIS, propozojmë që të përdoren softere Opensource që nuk do të ndikojnë në kosto të mëtejshme. Thëkssojmë që konsulenti, në momentin e dorëzimit të produktit

përfundimtar, do të instalojë të gjithë softet e nevojshme për aksesimin e informacionit GIS, si dhe do të japi sugjerimet e nevojshme teknike për administrimin e informacionit nga ana e njësisë vendore. Nga konsulenti do të dorëzohen dhe Metadatat për të gjithë të dhënat GIS të PPV-së.

Nga ana e konsulentit është angazhuar për të ndërtuar një faqe WebGIS: <http://www.geoportale.org/lizmap-webclient/master/...>, e cila mund të hapet nëpërmjet cilitdo WebBrowser. Në këtë Webgis, përdoruesit e interesuar mund të aksesojnë dhe shikojnë informacionin hartografik, të përpunuar nga konsulenti gjatë fazës së parë dhe të dytë të planit.

Megjithatë përsa i takon përcaktimit të metodologjive, proceseve të punës dhe investimeve, njësia vendore duhet të ketë kontakte të vazhdueshme me Autoritetet Publike Qendrore dhe të sigurojë akses në sistemet GIS Qeveritare si: Gjeoportali Kombëtar, ALBSREP, Sistemi i Adresave etj. Sidomos aksesimi i shërbimeve online nga sistemet e mësipërme do të sigurojë dhe një proces përditësimi sistematik dhe të saktë të të dhënave hartografike bazë të **Databazës territoriale GIS** si Ortofoto, Kadastër e Pronave dhe Sistem Adresash.

4.1.7 Krijimi i Strukturës së Bazës së të Dhënave

Të dhënat, e marra nga njësia, kanë qenë materiale hartografike në formate të ndryshme si Raster, Cad dhe GIS, kryesisht të PPV-ve të mëparshme.



Përveç materialeve të mbledhura nga AKPT dhe Bashkia, informacioni është mbledhur edhe nëpërmjet vëzhgimit të territorit dhe rilevimit të zonave të njësive administrative, bazuar në një plan veprimi të hartuar paraprakisht.

Gjithashtu, informacion plotësues është mbledhur nëpërmjet formularëve – pyetësorë dhe burim i fundit dhe mjaft i vlefshëm i të dhënave, ka qenë edhe një direktori e sinkronizuar e AKPT-së ku është mbledhur informacion.

Baza e të dhënave GIS është përgatitur nga ana e konsulentit dhe do të dorëzohet në mbarim të projektit. Kjo bazë të dhënash është konform kërkesave të akteve ligjore në fuqi, si dhe kërkesave teknike të njësive vendore. Në parim modeli i të dhënave GIS është ndarë në 9 kategori kryesore (grupe të dhënash), të cilat janë:

- Planifikim
- Ndarje Administrative
- Ndërtesa
- Kadastër
- Kulturë dhe Trashëgimi
- Përdorimi i Tokës
- Natyrë dhe Mjedis
- Shërbime Publike
- Infrastrukturë Rrugore

Për secilin nga këto grupe të dhënash, ekziton një model logjik prej të cilit janë përfutur të dhënat GIS në formatet GIS, si ESRI Shapefile ose Geographic Markup Language (gml).






Fig. 79: Paraqitje skematike e modeleve

Më poshtë, po ju paraqesim kategoritë e të dhënave si dhe shtresat e informacionit GIS (formati Shapefile) që janë dorëzuar si databazë territoriale GIS.

Tabela 49: Kategoritë e të dhënave dhe shtresat e informacionit

Nr.Kat	Kategoritë	Nr.	Shtresat
I	Administrative	1	AB_Border.shp
		2	AB_LineOfConcern.shp
		3	AB_MiniMunicipality.shp
		4	AB_YellowLine.shp
II	Ndërtesë	5	BD_Building.shp
III	Kadastër	6	CD_Block.shp
		7	CD_Building.shp
		8	CD_CadastreZone.shp
		9	CD_Parcel.shp
IV	Planifikimi	10	GLP_Plan.shp

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

		11	GLP_RestrictedZone.shp
		12	GLP_Sector.shp
		13	GLP_Zone.shp
V	Përdorimi i Tokës	14	LU_Agriculture.shp
		15	LU_AirTraffic.shp
		16	LU_Cemetery.shp
		17	LU_Dock.shp
		18	LU_ExcavationAndMining.shp
		19	LU_Forest.shp
		20	LU_FloatingWater.shp
		21	LU_Heap.shp
		22	LU_Heath.shp
		23	LU_IndustrialAndCommercialZone.shp
		24	LU_Landfill.shp
		25	LU_Monument.shp
		26	LU_PublicFacility.shp
		27	LU_RecreationalZone.shp
		28	LU_ResidentialZone.shp
		29	LU_Railroad
		30	LU_Road.shp
		31	LU_Sea.shp
		32	LU_ShippingTraffic.shp
		33	LU_Square.shp
VI	Natyrë dhe Mjedis	34	LU_StandingWater.shp
		35	LU_Swamp.shp
		36	LU_Way.shp
		37	LU_ZoneOfMixedUse.shp
		38	NE_ChemicalsInStock.shp
		39	NE_ContaminatedZone.shp
		40	NE_DemolitionWasteSite.shp
		41	NE_DesolateIndustry.shp
		42	NE_FloodRiskZone.shp
		43	NE_FoundationSoil.shp
		44	NE_GarbageContainer.shp
		45	NE_GasStation.shp
		46	NE_GreenZone.shp
		47	NE_HillslideRiskZone.shp
		48	NE_LandFill.shp
		49	NE_PetrolStation.shp
		50	NE_PharmaceuticalIndustry.shp
		51	NE_Quarry.shp
		52	NE_RadonRiskZone.shp
		53	NE_SeismicRiskZone.shp

		54	NE_SeismicStation.shp
		55	NE_TransferStation.shp
		56	NE_Tree.shp
		57	NE_UrbanWasteSite.shp
		58	NE_WasteTreatmentSite.shp
VII	Shërbime Publike	59	PU_AntennaTower.shp
		60	PU_Cable.shp
		61	PU_ElectricPoint.shp
		62	PU_OpticalFibre.shp
		63	PU_PumpingStation.shp
		64	PU_SewageManhole.shp
		65	PU_SewagePipe.shp
		66	PU_Spring.shp
		67	PU_Substation.shp
		68	PU_TelecomLine.shp
		69	PU_TelecomPoint.shp
		70	PU_WaterDepot.shp
		71	PU_WaterManhole.shp
		72	PU_WaterPipe.shp
		73	PU_Well.shp
		74	PU_WLANHotspot.shp
VIII	Infrastrukturë Rrugore	75	RT_BusRoute.shp
		76	RT_BusStop.shp
		77	RT_Junction.shp
		78	RT_PublicParking.shp
		79	RT_RailwayLine.shp
		80	RT_Road.shp
		81	RT_TaxiStop.shp
		82	RT_TrafficLight.shp
IX	Sociale	83	SEC_Clinic.shp
		84	SEC_Hospital.shp
		85	SEC_Kindergarden.shp
		86	SEC_School.shp
		87	SEC_University.shp

Për çdo shtresë informacioni do të dorëzohet dhe një file Metadata përkatës, që do japi një përshkrim të detajuar mbi të dhënat. Kjo do t'i shërbejë stafit të bashkisë që të ketë informacionin e duhur si është krijuar e dhëna dhe se për çfarë qëllimi mund të përdoret.



Fig. 80: Informacioni për çdo shtresë

Sëbashku me të dhënat nga ana e konsulentit do të dorëzohet dhe një paketë softwaresh GIS, me anë të së cilës mund të aksesohen të dhënat GIS:



PostgreSQL është një sistem databaze “open source object-relational”. Zhvillohet që prej 15 vitesh dhe ka një nga arkitekturat më të mira.



PostGIS mundëson komponentin e hapësirës në databazën PostgreSQL.



Quantum GIS (QGIS) është një program klient Open Source (GIS) që mundëson editimin dhe analizimin e të dhënave në mjedis desktop.



CatMedit është një software për krijimin dhe editimin e metadatave për informacionin gjeohapësinor sipas standarteve ISO.

Po ashtu, do të bëhet një trajnim i personave përgjegjes në njësitë vendore mbi aksesimin dhe përdorimin e informacionit Gjeohapësinor që do dorëzohet.

Plani i veprimeve afat-shkurtër:

- Korrigjimi i Ndarjeve Administrative të Bashkisë.

- Përcaktimi i saktë nëpërmjet koordinatave në një sistem të referimit hartografik. Eliminimi i mbivendosjeve dhe hapësirave boshe me njësite vendore kufitare.
- Përcaktimi i saktë i ndarjeve të njësive të bashkisë.
- Hartimi i PDV-ve sipas Planit të Përgjithshëm Vendor.
- Kontrolli dhe përditësimi i informacionit gjeohapësinor (kadastër, ndërtesë, sistem rrugor etj.) në zonat ku do të hartohet PDV.
- Informacioni Gjeohapësinor, i gjeneruar gjatë PDV, duhet të integrohet dhe të jetë konform **Databazës territoriale GIS**.
- Baza hartografike për përmisimin e databazës territoriale GIS.
- Për editimin, përditësimin dhe përmirësimin e databazës territoriale GIS, duhet të sigurohet aksesimi dhe ndërverprimi me Bd Shtetërore GIS si Gjeoportali Kombëtar, ALBSREP, Sistemi i Adresave etj.

Plani i veprimeve afat-gjatë:

- Përmirësimi i të dhënave të Kadastrës të pronave për zonat me zhvillim.
- Përditësimi sistematik i databazës, nëpërmjet rilevimit në terren të grupeve të dhënave kryesore si ndërtesa, sistem rrugor, zona rreziku etj.
- Krijimi i WebGIS të njësisë vendore, ku të shfaqet informacioni hartografik i Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe Planeve të Detajuar Vendorë.

Trajnimi sistematik i stafit të bashkisë në implementimin e standarteve hartografike, GIS dhe TIK.

5 Plani i komunikimit

Komunikimi, informimi dhe përfshirja e qytetarëve në procesin e hartimit të planit të përgjithshëm vendor

Qeverisja lokale bazohet në parimet e autonomisë vendore dhe transparenca është një ndër elementet kryesorë. Qeverisja e mirë duhet të sigurojë shërbimin e informimit dhe komunikimit konstant dhe sa më efektiv për qytetarët e saj, në mënyrë që këto të fundit të jenë aktiv në dhënien e kontributit të tyre për zhvillimin e mjedisit ku jetojnë.

Në shoqëritë demokratike ekziston një nevojë e vazhdueshme që qeveritë të veprojnë si lehtësues: duke i përfshirë qytetarët në çështjet e pushtetit lokal; duke i bërë ata partnerë në zgjidhjen e problemeve dhe duke i ofruar shërbimet më të mira me koston më të arsyeshme.

Strategjia për informim komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e hartimit të PPV-së

Strategjia për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e hartimit të PPV-së ka për qëllim të nxisë qytetarin të përfshihet në këtë proces të rëndësishëm duke kontribuar në këtë mënyrë (1) që pushteti lokal të jetë sa më efektiv në angazhimin ndaj qytetarëve, mundësi kjo që ofron (2) hapësirë për qytetarët, në mënyrë që ata të japin kontributin e tyre në procese zhvillimi, (3) si model i partneritetit që e krijon konceptin lokal të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje për të kombinuar përpjekjet e përbashkëta.

5.1 Strategjia e komunikimit është proces

Zhvillimi i strategjisë për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në hartimin e planit të PPV-së është proces i cili kërkon:

- **Ekip të përkushtuar** që ka njohuri si për kontekstin lokal ashtu edhe për metodologjinë e planifikimit strategjik.
- **Identifikimi i objektivave të planit të komunikimit** ku pasi të jetë identifikuar gjendja aktuale, do të përcaktohen masat dhe veprimet specifike për të arritur targetin e synuar. Plani do ketë objektiva konkret dhe të realizueshëm duke konsideruar kontekstin lokal në të cilin operohet.
- **Njohja e mekanizmave** që do përdoren për praktikatat e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe që do ndiqen për procesin e hartimit të planit të PPV-së.
- **Zhvillim të planit të veprimit** i cili do të paraqesë aktivitetet, kornizën kohore, dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre. Plani i veprimit do t'i mundësojë ekipit konsulent dhe stafit të bashkisë matjen e ecurisë e punës dhe parashikimin e aktiviteteve të rëndësishme që do zhvillohen periodikisht dhe kanë si qëllim përfshirjen e qytetarëve në këtë proces.

- **Monitorimi i planit të komunikimit** ku në bazë të objektivave të përcaktuar, do të identifikohen aktorët përgjegjës për zbatimin e tyre dhe do të përkufizohen treguesit kryesor për procesin e monitorimit.




Fig. 81: Paraqitja e ciklit të Procesit të Komunikimit

Strategjia e komunikimit i sjell përfitim:

Pushtetit lokal: Informimi, komunikimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e hartimit të PPV-së, i vijnë në ndihmë vendimmarrësve për realizimin e një qeverisje të mirë. Krijon ura lidhëse dhe kushtet e nevojshme për të kuptuar nevojat, marrë idetë dhe kërkuar përkrahjen e komunitetit.

Qytetarëve: Përmes një informimi efikas gjatë procesit të hartimit të PPV-së, qytetarët arrijnë të kenë një kuadër të qartë të zhvillimeve të ardhshme, me qëllim që të përfshihen dhe të bëhen pjesë e zgjidhjes së problemeve pasi ky plan zhvillimi i përket atyre dhe ata mund të jenë aktorët kyç të ndryshimeve.

Sipërmarrësve dhe biznesit: të cilët duke u bërë pjesë e procesit të hartimit të PPV-së, kuptojnë trendin dhe nevojat e sektorëve të ndryshëm që mund të zhvillohen në territorin e bashkisë. Dokumenti i PPV, në kuptim të biznesit, është një kontratë afatgjatë mes institucioneve publike dhe sektorit privat me qëllim realizimin e objektivave zhvillimor.

Institucioneve qendrore: Duhet pasur parasysh që PPV e bashkisë Vau-Dejës zbaton me përpikmëri dhe madje i detajon më tepër gjithë politikat dhe orientimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar për territorin që mbulon kjo bashki. Si i tillë, ky plan bën analiza dhe propozon ndërhyrjet e nevojshme për mjaft sektor të zhvillimit që nuk janë të decentralizuar ose janë pjesërisht të decentralizuar.

Kompanisë konsulente: e cila përmes takimeve me banorët dhe grupet e interesit arrin të kuptojë qartësisht kontekstin zhvillimor, nevojat dhe sfidat kryesore të cilat duke u materializuar në PPV i japin dokumentit qëndrueshmëri dhe zbatueshmëri.

5.2 Mekanizmat e komunikimit

Përvoja e Bashkisë Vau-Dejës në fushën e informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e hartimit të PPV-së është në hapat e saj të para. Kjo bashki disponon faqen e saj zyrtare në internet në të cilën kanë filluar të publikohen informacionet/dokumentet e para të planit.

Stafi i Bashkisë që përfshin këshilltarin e Kryetarit për marrëdhënie me publikun dhe njëkohësisht edhe zëdhënësin e bashkisë, do të mbështesë konsulentin në procesin e komunikimit gjatë gjithë fazave të planit.

Stafi i bashkisë Vau-Dejës në bashkëpunim me konsulentin aktualisht kanë strukturuar disa kanale të komunikimit përmes mekanizmave si më poshtë.

5.2.1 Interneti si mjet informimi dhe komunikimi

Faqja Zyrtare e Bashkisë Vau-Dejës: është portali kryesor që mundëson informimin e qytetarëve për dokumente të përgatitura gjatë procesit të hartimit të PPV-së. Postimi/publikimi i vazhdueshëm i materialeve në faqen zyrtare [http://www.vaudejes.gov.al/](http://www.vaudejes.gov.al) sipas fazave, do rrisë ndjeshëm nivelin e transparencës së të procesit në tërësi.




Fig. 82: Faqja zyrtare në web e bashkisë

Regjistri i Integruar i Territorit: që sipas kuadrit ligjor për planifikimin e territorit është baza e të dhënave shtetërore, në të cilin regjistrohen dhe administrohen në mënyrë të pavarur, të dhënat për tokën e zhvillimet në të, dokumentet e planifikimit dhe të zhvillimit, në proces miratimi apo të miratuara. Botimi në regjistrë i gjithë

Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit

dokumentacionit të PPV është një detyrim ligjor dhe si i tillë ky instrument rrit transparencën e procesit.




Fig. 83: Regjistri i integruar i territorit

Facebook: Është krijuar një faqe e posaçme në Facebook për PPV-në e Bashkisë Vau-Dejës <https://www.facebook.com/PPVvauDejes/> ku i është bërë ftesë të gjithë banorëve për të qënë pjesë aktive e procesit, pavarësisht vendndodhjes së tyre. Aty do të përcillen vazhdimisht informacione mbi procesin e hartimit të planit të PPV-së dhe ndërkohë janë postuar një pyetësorë.



Fig. 84: Faqja në facebook e PPV

Youtube: Aktualisht ky mekanizëm është i pa përdorur akoma. Në kuadër të faqes së bashkisë dhe faqes në facebook për PPV-në do të ketë publikime të herë pas hershme të informacionit në format video që do të gjenden edhe në kanalin YouTube.

5.2.2 Takimet si mjet komunimi dhe ndërveprimi

Takimet me komunitetin dhe fokus grupe të ndryshme: Deri tani janë zhvilluar disa takime me komunitetin apo fokus grupe të veçanta, pothuajse në të gjitha njësitë administrative të cilat janë reflektuar në aneksin fund të këtij dokumenti. Nëse në fazën e parë të hartimit të dokumentit të Analizës së Thelluar të Territorit takimet kanë pasur si qëllim më shumë njohjen e konsulnetit me kontekstin zhvillimor dhe nevojat kryesore të komuniteteve, në vijim takimet kanë më shumë në fokus njohjen me propozimet dhe projektet strategjike të komunitetit vendor, grupeve të interesit, përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe fokus grupe të ndryshme (të rinjtë, gratë, të moshuarit etj.);

Takimet me stafin e bashkisë dhe njësive administrative. Pavarësisht se në procesin e hartimit të PPV-së, bashkia është udhëheqësi dhe autori kryesor i tij, konsulenti ka organizuar takime të vazhdueshme edhe me zyrat/departamentet që nuk janë direkt të përfshira në hartimin e këtij dokumenti. Gjithashtu vizitat në terren dhe takime të ndryshme janë udhëhequr nga administratorët e njësive dhe stafet e tyre të cilët përveçse janë informuar kanë dhënë një kontribut të vlefshëm në proces.

Takimet (Dëgjuesat) Publike: Deri tani nuk janë zhvilluar dëgjesa publike. Në vijim do të paraqitet një plan takimesh për çdo fazë të zhvillimit të planit. Çdo prezantim i plotësuar me përfundimet e nxjerra pas mbarimit të dëgjësave do të bëhen publike në faqen e web-it të Bashkisë Vau-Dejës dhe më pas do të publikohet edhe në faqen e PPV-së Bashkisë Vau-Dejës në facebook. Ky proces do të ndiqet nga një staf i bashkisë;

Forumi për bashkërendimin e planifikimit: është një mekanizëm për të nxitur diskutimet strategjike të pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe ekspertëve të ndryshë,; për të arritur koordinimin e çështjeve të planifikimit gjatë procesit të hartimit të PPV.

Takime me diasporën: Këto takime janë parashikuar të zhvillohen në data të caktuara, kryesisht në periudha festash fetare apo pushimet verore, ku ata e kanë më të mundur të jenë pranë familjeve në vendin e tyre të origjinës. Duke vlerësuar këtë fakt, takimi i parë është parashikuar të ndodh për festën e Pashkëve Katolike. Gjithashtu konsulneti po punon edhe me stafin e bashkisë për të lokalizuar përqendrimet e komunitetit të bashkisë Vau-Dejës jashtë vendit, kryesisht në Itali dhe për të realizuar edhe atje një takim me qëllim përfshirjen e diasporës maksimalisht në proces.

5.2.3 Anketime/Pyetësorë/Skeda informative

Gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është shumë e rëndësishme të realizohet përfshirja sa më e gjerë e komunitetit dhe grupeve të interesit. Qëllimi kryesor i kësaj përfshirje është që të japë mundësi të gjithë banorëve për të marrë

pjesë në mënyrë aktive duke shprehur mendimet dhe duke parashtruar nevojat e tyre. Gjithashtu synohet që nëpërmjet përfshirjes së komunitetit vendor procesi të jetë sa më transparent dhe të krijojë besim ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve publike.

Për këtë arsye banorëve të Bashkisë së Vau Dejës u është vënë në dispozicion një pyetësor i cili mund të plotësohet lehtësisht online si nga banorët e bashkisë ashtu edhe nga diaspora.

<http://uts-01.com/new/2017/pyetesori.php?bashkia=VD>

Përveç pyetësorëve online gjatë vizitave në terren, në bashkëpunim me ekspert lokal janë plotësuar Skedat informative për secilën njësi administrative. Qëllimi i këtyre skeda është grumbullimi i informacionit teknik mbi të dhënat për infrastrukturën kryesore dhe gjendjen e tyre në secilën njësi administrative. Është për t'u vlerësuar fakti se vetë punonjësit apo ekspertet e bashkisë janë përfshirë direkt në këtë proces duke grumbulluar të dhëna dhe në disa raste edhe me vizita në terren duke dhënë kështu një input mjaft të vlefshëm për analizën dhe vlerësimin e territorit.

5.2.4 Mediat tradicionale (TV, radio, shtypi)

Bashkia Vau-Dejës ka vetëm një ekspert që mbulon marrëdhëniet me shtypin dhe që ndjek pothuajse gjithë aktivitetet institucionale. Ky ekspert shpesh herë luan dhe rolin e kameramanit dhe duke u lidhur me mediat lokale bën shpërndarjen e materialeve vizive dhe asiston në përgatitjen e kronikave për transmetim.

Në Vau-Dejës nuk ka televizion apo radio lokale me qendër brenda territorit të bashkisë. Raportimi i ecursisë së procesit të hartimit të planit do të mbulohet nga mediat që mbulojnë rajonin e Shkodrës (Shkodra TV1, Rozafa, Chanel 1, Star Plus, etj.) apo stacione radiofonike lokale.

Aktualisht përmes mediave vizive është mbuluar me një kronikë të veçantë takimi i prezantimit të Raportit Fillestar (Inception Report), raport ky që përveç një vlerësimi fillestar të kapaciteteve ka si qëllim konsolidimin e marrëdhënieve mes bashkisë, kompanisë konsulente dhe aktorëve të tjerë direkt të përfshirë në procesin e hartimit të PPV-së. Kjo rubrikë e transmetuar në televizionin lokal Chanel 1, mund të ndiqet në link më poshtë.

<https://www.youtube.com/watch?v=Fhvoj62RTDQ>

Gjithashtu konsulenti në këtë fazë ka analizuar dhe gjetjet kryesore të studimit të bërë nga programi PERFORM¹⁰ dhe Ministria e Zhvillimit Urban për “Rolin e Komuniteteve në përgatitjen e Planeve të Përgjithshme Vendore”. Një përmbledhje e shkurtër e këtij studimi paraqitet në vijim:

¹⁰ PERFORM is a project of Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC), implemented by HELVETAS Swiss Intercooperation and University of Fribourg.

ROLI I KOMUNITETEVE NË PËRGATITJEN E PLANEVE TE ZHVILLIMIT VENDOR

Përmbledhje e gjetjeve dhe sugjerimeve për rrëfjen e efikasitetit të procesit të konsultimit qytetar

Mbështetur nga PERFORM (Performing and Responsive Social Sciences) – Zyra e Komëtare e Koordinimit në Shqipëri në partneritet me Ministrinë e Zhvillimit Urban, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit

Gjatë periudhës nëntor 2015 – shkurt 2016, PERFORM Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban, mbështeti një proces vlerësimi formativ të më shumë se 40 Planeve të Zhvillimit Vendor të hartuara gjatë periudhës 2009 – 2013. Qëllimi ishte vlerësimi i rolit dhe kontributit të qytetarëve gjatë procesit të përgatitjes së këtij dokumenti strategjik. Rezultatet e këtij studimi shkencor i janë shpërndarë kompanive të konsulentëve, që po përgatisin planet e zhvillimit 2015 – 2030, janë ndarë me bashkitë e reja, me AKPT dhe me palë të tjera të interesuara.

Kjo përmbledhje paraqet rezultatet e vlerësimit të shoqëruara me sugjerime për aktorët e përfshirë në zhvillimin vendor në Shqipëri.

Gjetje	Sugjerime	Metoda & Instrumente të Propozuara
1. Dominon roli i konsulentëve të jashtëm në përcaktimin e objektivave të zhvillimit vendor. 2. Përfshirja e komuniteteve në planet e zhvillimit vendor realizohet kryesisht për të përmbushur detyrimet ligjore apo objektiva ekonomike. 3. Format e grumbullimit të informacionit rreth organizimit të komunitetit janë të kufizuara. 4. Pas dëgjësive publike, banorët nuk informohen rreth ndryshimeve të bëra apo rreth impaktit të dëgjësive në planet e zhvillimit vendor.	1. Pronësia e hartimit të planeve të zhvillimit vendor duhet t'i përkasë autoriteteve dhe komuniteteve vendore që ato përfaqësojnë. 2. Përfshirja në planet e zhvillimit vendor duhet të trajtohet si një e drejtë themelore, të cilën duhet ta gëzojë çdo individ që jeton në komunitet. 3. Duhet të përdoren forma të larmishme të grumbullimit të informacionit që çojnë në njohuri të thelluar të problematikave të komunitetit. 4. Dëgjësia publike duhet të shërbejë si një forum ku banorët informohen në vazhdimësi se çfarë është bërë me sugjerimet e tyre.	1. SWOT, panairi i ideve, takimet publike, grupet e fokusuara, grupet dhe forumet, bashkëpunimi me organizatat lokale, mobilizimi i drejtuesve lokale. 2. Panairi i ideve, takimet publike, kartat e raportimit qytetar, kartat e pikezimit komunitar, vlerësimi pjesëmarrës, buxhetimi me pjesëmarrje. 3. Përdorimi i të dhënave ekzistuese, hartëzimi i burimeve, hartëzimi social, hartëzimi i institucioneve, matrica e të ardhurave dhe shpenzimeve, anketat. 4. Dëgjesa publike të organizuara në formatin "Rëkthimi në komunitet: Ju flet, ne ju dëgjuam. A ju kemi kuptuar drejt?", media lokale dhe media sociale, buletine, fletëpalosje, broshura.

5. Ekspertët e përfshirë në procesin e hartimit të planeve, shpesh, besojnë se banorët nuk janë të kualifikuar për të kontribuar në planet e zhvillimit vendor.
6. Prezantimi i planeve, shpesh, bëhet në formë abstrakte dhe materiali është i jo lehtësisht i kuptueshëm.
7. Nuk është ende i qartë niveli në të cilin prioritetet strategjike ndryshojnë si rezultat i diskutimeve me banorët.
8. Analiza e situatës dhe përcaktimi i vizionit, në disa raste, realizohet nga zyrtarët, pa u konsultuar me banorët.
9. Përfaqësimi i grave dhe grupeve të përjashtuara, si komuniteti rom dhe egjiptian, është i ulët krahasuar me peshën e tyre në popullatë.
10. Një nga format e përdorura gjerësisht për mobilizimin e komunitetit është shpërndarja e ftesave; megjithatë, ftesat u dërgohen personave 'të kualifikuar' dhe të afërm.
5. Ekspozimi ndaj modeleve përfshirëse të aplikuara në vende të tjera, diskutimi i evidencës rreth rolit të komuniteteve, takimet publike, grupet e fokusuara, bashkëpunimi me organizatat lokale.
6. Prezantimi dhe shpjegimi i koncepteve në gjuhën shqipe; përdorimi i mjeteve vizuale të përstatshme për kontekstin dhe që stimulojnë pjesëmarrje aktive.
7. Publikimi i ndryshimeve eventuale të prioritetëve strategjike në median lokale, komunikimi i ndryshimeve në takime publike, postera, fletushka, buletine.
8. SWOT, panairi i ideve, ushtrime në grup me temën "Bashkia që dëshiroj" takimet publike, intervistat, anketat, grupet e fokusuara, grupet dhe forumet.
9. Intervistat, hartëzimi social, hartëzimi i institucioneve, matrica e të ardhurave dhe shpenzimeve, diskutimet në grup, grupet dhe forumet, media lokale, media sociale, bashkëpunimi me organizatat lokale, mobilizimi i drejtuesve lokalë.
10. Media sociale, media lokale, postera, buletine, fletushka, editoriale. Shpërndarja e informacionit në shkollë, qendra shëndetësore, stacionet e autobusave, organizata, dyqane.

Ekipi i Punës: Dr. M. Dauti & Dokt. O. Kurti – Hulumtuese shkencore; A. Hackaj, A. Dodaj – PERFORM ZKK Shqipëri; N. Jole, B. Meniku – MZHL, Mars 2016

6 Aneks

6.1 Aneksi 1: Mbledhje dhe takime për hartimin e PPV

6.2 Aneksi 2: Aneksi i hartave

ANALIZA E THELLUAR DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE TË TERRITORIT. BASHKIA VAU-DEJËS

Lista e materialit hartografik:

U/I-01	Harta bazë e njësisë vendore
U/I-02	Harta topografike
U/I-03	Harta gjeologo-inxhinierike
U/I-04	Harta gjeologjike
U/I-05	Harta hidrografike
U/I-06	Harta hidrogjeologjike
U/I-07	Harta e riskut hidrologjik
U/I-08	Harta e zonimit sizmik
U/I-09	Harta e tokave natyrore
U/I-10	Harta e problemeve mjedisore
U/I-11	Harta e monumenteve të natyrës
U/I-12	Harta e monumenteve të kulturës
U/I-13	Harta e pozicionit strategjik në raport me rajonin
U/I-14	Harta e vlerësimit ekonomik
U/I-15	Harta e vlerësimit social
U/I-16	Harta e vlerësimit demografik
U/I-17	Harta e analizës së planeve të mëparshme

- U/I-18 Harta e pronave
- U/I-19 Harta e rëndësisë kombëtare
- U/I-20 Harta e elementeve përjashtues
- U/I-21 Harta e sistemeve bazë
- U/I-22 Harta e tokave bujqësore
- U/I-23 Harta e kategorive bazë të sistemit urban
- U/I-24 Harta e lartësisë së objekteve
- U/I-25 Harta e infrastrukturës rrugore
- U/I-26 Harta e tipologjisë hapësinore
- U/I-27 Harta e periferialitetit
- U/I-28 Harta e elementeve të veçantë në territor
- U/I-29 Harta e intensitetit të ndërtimit